

MEELIS FRIEDENTHAL

MBRETI I SHELGJEVE

Zogjtë e Muzave

Përktheu Orkida Muça

SHTËPIA BOTUESE “FAN NOLI”
TIRANË, 2017

“Mesilased”, Meelis Friedenthal

© Meelis Friedenthal

First published by Varrak in 2012, Tallinn, Estonia

© i botimit shqip “Fan Noli”



Co-funded by the
Creative Europe Programme
of the European Union

**“This project has been funded with support from the European
Commission.**

**This publication reflects the views only of the author, and the Commission
cannot be held responsible for any use which may be made of the
information contained therein.”**

**Ky projekt u mundësua me mbështetjen e Komisionit Europian.
Ky publikim reflekton vetëm pikëpamjet e autorit dhe Komisioni nuk mban
përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit që përmban
publikimi.**

Redaktor Rexhep Hida

Art grafik Aida Kumi

ISBN 978-9928-203-93-9

www.booksal.com

Ka rënë shi pa pushim. Shiu i ka prishur të korrat në fusha; ka shkaktuar myk në muret e drunjtat të shtëpive, dhe i ka bërë kuvertat e anijeve të lagështa si leshterikët e detit. Laurentius ka muaj që ha bukë të ndenjtur dhe që jeton në shtëpi me myk; këtë javën e fundit gjithashtu ka hyrë vjedhurazi në kuvertat e lagështa. Vrer i zi është grumbulluar brenda tij si llumi që vesh një degë që hidhet në lumë. Më në fund, ai lëvizti nga anija që lëkundej në molin e portit, dhe prej andej në dërrasat e rrëshkitshme të ngulura në shtylla të futura thellë në baltë dhe ai vështroi me pasiguri rreth e rrotull tij. Ndërsa shkulme ere nga qielli i ulët lëshojnë pika shiu në fytyrën e tij, ai u përpoq të kuptojë çfarë lloj vendi mund të ishte ky, ku kishte ardhur me vullnetin e tij të lirë. Rripi i ngushtë i zhveshur i bregut, me rërën e tij të bardhë dhe xunkthe të rrallë aty këtu, dhe retë gri të njëtrajtshme që i ngjanin shumë portit nga ai u nis për udhë. Në sfondit e qiellit gri spikasin njësoj si më parë direktet e anijes postale, dhe pëlhura e velave e shpalosur midis tyre ishte po aq gri dhe e ngrirë njësoj si kur nisi udhëtimin e tij. Pranë molit, që shtrihej përtej në det, mund të shihej një dallgëpritëse, gjysmë e zhytur në ujin me baltë dhe në fund të saj kërrusur në ujë ishte një shtëpi e vjetër roje. Pa dyshim kishte kohë që askush se kishte përdorur.

Ndërtesa të rrënuara si kjo mund të gjesh në çdo mol, dhe pavarësisht pamjes së mjerë tek ai pati një efekt qetësues. Edhe

këtu molet ishin rindërtuar; edhe këtu ato ishin zgjeruar për t'i bërë vend anijeve të reja, ndërsa shtëpitë e vjetra të rojës ishin lënë pas dore. Ai psherëtiu dhe luajti me ankth me mbulesën e kafazit të tij, e cila pikonte ujë.

Ia kishte dalë të sillte të gjithë takëmet me vete, pa shumë telashe. Një sënduk prej dërrasash dushku të mbërthyera bashkë i kishte nxënë shumë mirë të gjitha gjërat e tij që kishte menduar të ishin të nevojshme për t'u marrë në kërkimet e tij. Tani ndodhej në kabinën e doganës me të gjitha mallrat e tjera që kishte anija dhe ai me siguri nuk do ta merrte dot deri në mbrëmje. Ngarkesa e anijes dhe bagazhet personale të udhëtarëve ishin kontrolluar me kujdes dhe gjithçka që e zë taksa ishte mbajtur shënim. Ai nuk kishte patur asnjë shqetësim lidhur për sa i përket kësaj, sepse nuk kishte ndonjë gjë me vlerë me vete. Ato pak libra personale që kishte ishin të autorizuar, dhe kishte marrë me vete vetëm minimumin e ilaçeve. Telashtet iu hapën nga paraketi i tij me unazë rozë në kafaz. Atë e kishin paralajmëruar në vendin e tij që nuk do të ishte e lehtë ta transportoje zogun, dhe gjithsesi ai nuk do t'i përballonte kushtet e udhëtimit. Por ai s'kishte dëshirë që ta linte pas mikun e tij të mirë, dhe kështu vendosi të marrë në sy rrezikun. Tani që mbërriti, shqetësimi i tij i kryesor ishte të largonte zogun nga shiu i ftohtë dhe ta fuste në të ngrohtë sa më shpejt të ishte e mundur.

Megjithëse kishte në kokë një kapelë strehëgjere, shiu po i rridhte në fytyrë Laurentius-it dhe ai duhet të fshinte ujin e shiut nga sytë. Ai i hodhi një sy përkitazi poshtë pardsesysë së tij orës së xhepit dhe filloi të kërkojë për dikë që ta drejtonte në ndonjë bujtinë, dhe më vonë ndoshta të sillte sëndukut nga kabina e doganës. Ai nuk guxonte t'ia besonte askujt kafazin. Tani duhet të vepronte shpejtë sepse rrugët ishin kushte të këqija, dhe nuk mund të vononte më shumë udhëtimin e tij në vijim. Reshjet e shiut të vjeshtës sa vinin dhe bëheshin më të forta dhe tashmë kishin filluar të gërryenin rrugët e buta, kështu që çdo ditë sa vinte

dhe bëhej më e vështirë t'i përshkoje. Gjithashtu ajri kishte filluar të bëhej akull i ftohtë dhe ai frikej se paraketi i tij do të sëmurej. Ai duhet të gjente një karrocë apo karro dhe të fillonte të udhëtonte sa më shpejt të ishte e mundur drejt Dorpat.

“Hej!” thirri Laurentius.

Moli i portit po shkëlqente nga shiu, dhe vetëm disa shikues kureshtarë nuk kishin pyetur për motin e keq dhe po prisnin që të vinin anijet. Ata me sa duket e kishin mbledhur mendjen që kishte pak gjasa të gjenin punë, kështu që fillimisht nuk menduan të reagojnë ndaj thirrjes së Laurentius. Marinarët kishin shkarkuar ngarkesën e anijes pranë kabinës së doganës, dhe atje ishin mbledhur transportuesit që punonin për tregtarët e mëdhenj. Disa prej tyre kishin filluar të shkarkonin kuti të rrëshqitshme dhe çanta të njomura me një mërzi indiferente në fytyrë, ndërsa nëpunësit e molit mbajnë shënim mallrat.

Laurentius thirri përsëri.

“Hej, ju atje!”

Një shikues veshur me një pallto të ngrënë me stof të hollë, ngriti sytë dhe më pa i hutuar dhe Laurentius ia bëri me shenjë që të vinte, për t'u siguruar që e kuptoi që e kishte me të. Burri dukej si ata personazhet e artistëve të zymtë të Mesjetës që kishte parë në Hollandë. Flokë të ngatërruar të një ngjyre të papërcaktuar i dilnin nga poshtë një kapeleje shajaku të shtrembër; hundën e kishte të kuqe dhe të ënjtur, dhe një mjekër me gropë mund të shquhej poshtë qimeve të ashpra të rralla. Laurentius-i mendoi se tabela që varej në qafën e burrit me shkrimin “Poshtërsi” i përshtatej atij mjaft mirë. Këta tipa mund t'i gjesh duke u sorollatur në çdo port, dhe instinkti që ke bazuar në pamjen e tyre të thotë ishte zakonisht i drejtë. Por ata dinin më shumë për hotelet dhe bujtinat e qytetit, prandaj disi mund t'ua kishe nevojën. Ata sigurisht mund të ta hidhnin, çështja qëndron se sa shumë mund të ta hidhnin.

“Ju lutem më tregoni ndonjë bujtinë të mirë,” udhëzoi prerë

Laurentius, pastaj pa ndërsa burri u kthye prapa dhe u nis pa thënë asnjë fjalë. Me shpresë, ai kishte kuptuar çfarë tha Laurentius, ndonëse ka mundësi që të ketë hamendësuar kuptimin.

Laurentius ngriti kafazin ku mbante paraketin e tij, dhe duke e mbajtur nën sqetull, ndoqi burrin në drejtim të qytetit. Zogu filloi të klithë me nervozizëm.

“Shh, Klodia, pusho.”

Ata vazhduan të ecnin derisa i zuri muzgu, ndërsa Laurentius u përpoq ta tundë sa më pak kafazin. Në sfondin e mbrëmjes ai mund të shquante siluetat kërcënuese të mureve të thepisur të qytetit, të formuara nga kamina poplash të forta e të trasha, kështjella të rrumbullakëta të mesjetës dhe katër kambanore të larta kishash. Ndërtesat më të ulëta të qytetit ishin gëlltitur nga mjegulla e lagësht që kullonte nga retë e dendura. Burri që ecte para tij papritur filloi të ecë shpejt, dhe me sa duket e njihte shumë mirë rrugën që ndiqte. Por tashmë Laurentius mund të ndjente përkeqësimin gjithnjë e më shumë të sëmundjes së tij të vjetër. Lagështia e vazhdueshme depërtonte ngado, duke e bërë gjithçka të mbytur në ujë, dhe tani ai u ndie edhe më i pambrojtur ndaj saj se në vitet e mëparshme. Tepria tëmthit të zi që po brufullonte brenda tij zakonisht nuk do të kishte shkaktuar këtë plogështi deri në vjeshtën e vonë, por këtë vit shirat kishin nisur në Ditën e Shën Gjonit dhe spërkat e vazhdueshme i kishin mbështjellë organet e brendshme, zemrën, trurin e tij me një mjegull të lagësht. Edhe kur zbriti nga anija në tokë të thatë, dhe eci në gurë kalldrëmi të sheshtë, të lëmuar nga fërkimi, kujtimi i detit që përkundet e bëri të ndjehet sikur çante rrugën nëpër një moçal. Çdo hap që bënte ishte një stërmundim. “Uh,” pëshpëriste ai me gjysmë zëri. “Edhe pak më tutje.” Ai shihte rreckamanin kurrizo që ecte përpara tij, dhe vendosi që do të bënte mirë të dërgonte dikë tjetër për të marrë sëndukun e tij. Shpesh mund të kesh telashe nga ky lloj tipi i gjetur rastësisht në port. Bujtinari do të mund ta ndihmojë. U përpoq të

kujtonte monedhën që përdorej në Reval; udhëtarë të ndryshëm në anije kishin dhënë mendimin e tyre, prej të cilëve ai nxori përfundimin që nuk mund të shpresonte për një qartësi të plotë mbi çështjen. Ars apodemica, librat mbi artin e të udhëtuarit, nuk jepnin pothuajse asnjë të dhënë për situatën në Estoni dhe Livonie, kishte vetëm një farë orientimi për ato që ia vlente të shiheshin, dhe për mënyrën më të mirë për të kuptuar mjedisin rrethues. Këto vise dhe qytetet e tyre kanë qenë pothuajse të panjohura nga këndvështrimi i librave të udhëtimit, fundja, cilido që ka udhëtuar për qejf do të shkonte gjetkë, në jug. Në vendet e kulturës dhe historisë. Laurentius-it filloi që t'i dhembë koka dhe në mendje nuk i vinte asgjë që të kishte lidhje, fare.

“Shumë mirë,” vendosi më në fund ai. “Një e gjashta e një ore duhet të mjaftojë.”

Kur u ndalën poshtë një feneri që ndriçonte një bujtinë për çudi të mirë, të pozicionuar shumë pranë nga portat e qytetit. Rreckamani u kthye nga Laurentius duke i zgjatur dorën. Laurentius kishte nxjerrë që më parë një monedhë të vogël nga xhepi dhe tani e la në pëllëmbën e burrit, duke u siguruar të shihte përtokë ndërsa e bënte këtë. Burri kontrolloi paratë shpejt e shpejt dhe pastaj i dha një buzëqeshje të madhe.

“Djalli ta marrë,” mendoi Laurentius. “I dhashë shumë para.”

Ai u kthye dhe filloi të hyjë në bujtinë duke shtyrë kafazin përmes derës përpara tij.

“Do të dëshironte diçka tjetër?” pyeti rreckamani me një gjermanishte për habi të mirë.

Laurentius ngurroi. Ai i dinte mirë se ata që të qepen për interes janë zakonisht horrat më të këqinj, dhe normalisht mezi priste sa të ikte.

“Më duhet të filloj të lëviz në drejtim të Dorpat,” u gjend ai duke thënë me vete. “Dhe sa më shpejt të jetë e mundur.”

Mund të dërgonte dikë tjetër t'i sillte sëndukun, megjithatë ndoshta nuk kishte ndonjë problem të pyeste ç'drejtim duhet të merrte. Në një farë pike, karrocet e postës duhet të kalonin; në anije i thanë se pothuajse çdo javë një grup udhëtarësh nisej drejt Dorpat. Atij iu treguan dy rrugë të mundshme në hartë: për të përshkuar secilën duheshin disa ditë, madje edhe më gjatë në varësi të kushteve të rrugës.

Burri i hodhi edhe një shikim tjetër kafazit të paraketit, u përkul në mënyrë disi të pasinqertë dhe u largua.

Laurentius mblodhi supet dhe hyri në bujtinë. E vuri kafazin në tryezën më afër vatrës, ngriti mbulesën e errët, të lagësht prej saj, dhe ndenji duke parë paraketin të pastrojë puplat në shkop.

“Atëherë, Klodia, je gati për një udhëtim tjetër?” e pyeti Laurentius.

Nxehtësia e lëshuar nga vatra e zjarrit pati një efekt shërues, duke e ngrohur trupin e ngrirë të paraketit dhe duke i ngritur humorin Laurentiusit. Ai nxori një copë letre të palosur nga xhepi dhe shpërhap i disa fara prej saj në fund të kafazit. Nuk e dinte me siguri nëse do të gjente fara luledielli ndokund në këto anë, kështu që kishte marrë ca me vete. Si zakonisht, klientë të tjerë të bujtinës, që kishin qenë duke u sorollatur kot, u grumbulluan shpejt rrotull kafazit, duke shpresuar ta shohin më nga afër zogun e çuditshëm, me ngjyra.

“Nga vijmë këta zogi?”

“Çfarë ha?”

“A mund të këndojë?”

Laurentius filloi të shpjegojë. Nga njëra anë, të tërhiqte me vete paraketin e tij me vete ishte e bezdisshme dhe e pavolitshme, dhe jo vetëm për Laurentiusin: padyshim zogu vuante edhe më shumë, por ishte një mënyrë e mrekullueshme për të njohur njerëz. Klodia kishte qenë një ndihmë e madhe në këtë aspekt në anije.

“Pra qenke një student universiteti, apo jo?” pyeti dikush duke

u ngritur në këmbë nga prapa njëres prej tryezave.

“Po,” u përgjigj Laurentius. Me sa duket burri kishte një farë kohe që e ndiqte me sy, ai e kuptonte gjithmonë fort mirë këtë, dhe kishte mësuar t’i ngulte sytë përtokë, për të mos parë në sy pa dashje ndonjë shikues. Si i ri, kishte kuptuar se kjo gjithmonë të çonte në telashe. Fillimisht njerëzit u bënë dyshues për të; më pas kryqëzonin gishtat pas kurrizit për fat kur flisnin me të, ose madje ktheheshin në kthesë për ta shmangur. Gjëja më e sigurt ishte t’i mbante sytë të ngulur përtokë. “Nuk do të të këshilloja të shkoje tani në Dorpat,” tha burri.

Pavarësisht mirësjelljes së jashtme, në fjalët e burrit tingëllonin me sarkazëm, dhe përdorimi i tij i mënyrës së sjellshme kur të drejtohej dukej disi qesëndisëse.

“Përse cilën arsye?” shprehu me pakënaqësi Laurentius. Sigurisht, ai e dinte, cilat argumente mund të ngrihen kundër shkuarjes në Dorpat.

“Ai vend po kalon kohëra të vështirë. Madje edhe profesorët janë bërë më shumë të përtuar në bërjen e detyrave të tyre. Vera ishte me shi, uria është e pashmangshme, dhe çmimet do të ngrihen,” tha burri.

“Po kështu është ngado,” u përgjigj Laurentius. Laurentius e lejoi për një çast vështirimin e tij të bredhë nëpër shprehjen e fytyrës qesëndisëse, dhe nxori përfundimin nga shpata e shkurtër që varej nga rripi i tij sei ai duhet të ishte një aristokrat.

Laurentius kishte dëgjuar aq ata kishin një lloj antipatie ndaj Dorpat.

“Por bursa ime është për Dorpat-in,” shpjegoi Laurentius.

“Ha! tha burri me një dhënie të dorës përbuzëse.

Laurentius hapi me kujdes derën e kafazit, dhe e nxorri paraketin e tij duke e mbajtur me një gisht. Zogu e njihte mirë dhe mund t’i kuptonte gjendjet e tij shpirtërore, dhe Laurentius-in e qetësonte prania e tij e zakonshme, tamam si një mik i mirë tek i

cili mund të gjente mbështetje dhe këshillë.

Zogu u lëkund në mënyrë komike ndërsa përpiquej të mbahej në lëkurën e dorës së tij si pergamenë, e cila ishte mbuluar me njolla nga tinkurat dhe ilaçet që merrte. I dha një çukitje me dashuri në thua. Shikuesit kureshtarë bën një hap prapa për të qëndruar larg, sikur të kishin frikë s’e mos zogu do t’i sulmonte nga çasti në çast, sikur Laurentiusi kishte nxjerrë nga kafazi i tij një djall të vogël. Ai e ledhatoi me dashuri zogun dhe ndjeu ngrohtësinë e trupit të tij, gjakun e fshehur poshtë puplave dhe lëkurës, jetën që vërshonte brenda. S’mbahet mend që kur ai e ka patur paraketin e tij. Që kur kishte lindur, ai kishte vuajtur nga sasia e shtuar e tëmthit të zi, dhe ja përse Pastori Theodus, kumbari i tij, fillimisht ia kishte bërë Klodia-n dhuratë. Theodus e kishte huazuar idenë nga Plutarku, i cili te *Bisedat Familjare* përmend zogjtë si mjekim për llojin e sëmundjes që mundonte Laurentius-in. Cicërimi optimist dhe sjellja gazmore e paraketit të tij e kishte mbajtur vërtet nën kontroll temperamentin e tij dhe e ndihmoi të përballonte me mirë sëmundjen e tij. Falë paraketit të tij ai ia kishte dalë mbanë gjithashtu të përballonte shirat e verës.

“Ai zogu yt nuk do t’i mbijetojë udhëtimin për në Dorpat, për këtë të jesh i sigurt,” tha aristokrati, duke mos dashur haptaz ta lërë të qetë Laurentius-in.

Kam përshtypjen se do të më duhet të gjej një karrocë të mbuluar, pastaj të nisem menjëherë për Dorpat. Gjithsesi nuk kisha planifikuar të shkoja më këmbë,” shpjegoi Laurentius.

Ai e dinte shumë mirë që pjesa më e madhe e studentëve të universitetit shkonin në këmbë, dhe se vetëm një numër i vogël prej tyre do t’i lejonin vetes luksin e pagesës së një karroce, por në situatën e tij të tanishme me sa duket kjo ishte e vetmja mundësi zgjedhjeje.

Aristokrati e pa drejt e në sy dhe buzëqeshi vesh më vesh. Laurentius ktheu shpejt kokën mënjanë, buzëqeshi, dhe i dha

Klodias një ledhatim me dashuri. “Kam gati dhjetë vjet që e mbaj, e di çfarë mund të përballojë. E duron të ftohtin shumë mirë.

“Mos shko me këdo. Këto janë kohë të vështira; mund të të vjedhin,” tha aristokrati.

“E di. Por s’kam shumë për t’u vjedhur,” u përgjigj Laurentiusi.

Mendoi se do të ishte më mirë të mos përmendte orën e xhepit me zbukurime të fshehur poshtë rrobave të tij. Kjo orë e bukur dhe e shtrenjtë ishte punuar nga një mjeshtër zanatçi anglez, dhe ishte një tjetër dhuratë nga kumbari i tij Theodus.

“Si fillim do të të merrja pallton. Gjithashtu kapela jote është mjaft e këndshme. Mund të humbisje edhe jetën,” tha aristokrati.

Laurentius nuk po pikaste asnjë kërcënim në zërin e burrit; tingëllonte më shumë si shprehje e asaj çfarë është e drejtë. Ndoshta edhe atij dikur ia kanë vjedhur kapelën, dhe e kanë lënë të rrëzuar në anë të rrugës, gjysmë i vdekur. Në fund të fundit jeta e njeriut është e brishtë. Duron brenda caqeve të trupit si diçka e mrekullueshme, si zogjtë që ngrihen lart në qiell, si yjet që varen pezull në sferën mbihënore qiellore.

Laurentius u përpoq t’i japë një ton të shkolluari zërit të tij. “Nëse nuk ka qenë e imja që nga fillimi, atëherë askush nuk mund ta marrë prej meje.”

“Ke studiuar më parë diku?”

Laurentius pohoi me kokë.

“Do të ngatërroshesh me shoqëri të keqe atje në Dorpat, ata janë tufa më e madhe e pijanecëve në shtetin e suedez. Dhe suedezët njihen si pijanecë,” tha burri me mospërfillje.

Laurentius mblodhi vetullat dhe pa rrotull dhomës me nervozizëm. Biseda kishte filluar ta bezdisë. Ai kishte nevojë të gjente bujtinarin, për të marrë me qira një dhomë dhe të interesohej për të shkuar në Dorpat. Ai nuk kishte asnjë dëshirë

të fliste për hollësitë më të imta të jetës së tij me të panjohur. Por atij nuk iu ndenj pa iu përgjigjur komenteve kritike të burrit duke i hedhur edhe ai një thumb. “Flet nga përvoja personale?” pyeti ai.

Burri buzëqeshi vesh më vesh dhe u ul pranë Laurentiusit. “Në një farë mënyre ke të drejtë. Ç’punë kam unë me planet e tua? Por është e qartë që nuk je vetë suedez. Nga ç’anë je?”

Laurentius u zu pak në befasi nga pyetja, dhe u largua vrazhdë instinktivisht. Sigurisht ai kishte patur të drejtë. Tani ndjehej i turpëruar që e kishte qesëndisur ashtu burrin. Ishte saktësisht ajo lloj situatë që udhëzuesit e udhëtimit të këshillojnë për t’iu shmangur. “Më falni. Nuk desha aspak të tregohem i pasjellshëm,” tha ai.

“E pranoj ndjesën tuaj,” tha aristokrati.

“Gjithsesi, dua të shkoj në Dorpat sa më parë. Kushtet e rrugës po vështirësohen dita ditës, dhe e di se do të më duhet pothuajse një javë për të mbërritur atje.” Laurentius futi dorën në kafazin e vogël dhe zogu kërceu pupthi nga dora e tij dhe përsëri në shkop.

“Ku është bujtësi?” pyeti Laurentius.

“Unë jam pronari i kësaj bujtine,” njoftoi aristokrati. “Bujtinari ka shkuar në qytet për t’u marrë me ca punë.”

“Kjo është bujtina juaj?” pyeti Laurentius.

“Më dëgjo, përse kërkon të shkosh me kaq ngut në Dorpat?” pyeti aristokrati, duke e shpërfillur pyetjen. Dukej sikur tashmë ishte bërë tapë, dhe kishte një mendjemadhësi gazmore në zërin e tij e cila nuk ishte një shenjë e mirë. “Mos të ka kapur mërzia? Zakonisht njerëzit shkojnë në Dorpat kur nuk pranohen diku gjetkë, ose nuk kanë para. Ti nuk dukesh t’i përkasësh asnjërës prej këtyre kategorive.”

“Dorpat është qyteti i kushtuar më shumë ndaj Nëntë Muzave,” shpjegoi Laurentius.

“Pra po shkon atje për të zditur mendjen? Shumë mirë, nuk do të zhbiroj më shumë në sekretet e tua,” tha aristokrati.

“Ç’do të thuash me këtë?” pyeti Laurentiusi.

“Parashikoj se nuk do të bësh shumë jetë intelektuale këtë vjeshtë dhe dimër. Por sigurisht do të shohësh mjaft vende të tjera interesante,” tha aristokrati. Laurentius u ngrit dhe filloi të ecë me nervozizëm nëpër dhomë. Nxorri orën nga xhepi dhe i hodhi një sy. Menjëherë u pendua që e nxori në sy të të gjithëve, por tashmë ishte tepër vonë. I nxehur, e ktheu orën në xhepin e tij të gjoksit.

“Shumë mirë,” murmuriti ai me vete.

Kishte ende pak kohë për të shëtitur rrotull qytetit përpara se të mbylleshin portat e qytetit. Ai pyeti veten nëse aristokrati e kuptoi se nëse ai kishte arritur tashmë në Estoni, nuk kishte të ngjarë të ndryshonte planet e tij nga një muhabet koti në një bujtinë. Ajo lloj sjelljeje zemërpule i përshtatej vetëm atyre që nuk kishin respekt për disiplinën intelektuale. Por ai kishte respekt; duhet të kishte.

“Më fal, por tani duhet të largohem,” i tha Laurentius aristokratit.

“Epo, vazhdo atëherë. Por po të paralajmëroj, do të pendohesh për vendimin tënd,” iu përgjigj aristokrati.

“Mund ta lë këtu kafazin?” e pyeti Laurentius.

E HËNË

“**M**M, AAHH.” Ai mori frymë, nxori frymën. Në freskinë e mbrëmjes vjeshtore, fryma e lagësht kondensohej në një mjegull që në këtë çast rrinte pezull përpara fytyrës së tij. Kjo ishte frymënxjerrja nga brenda trupit të tij, dhe tregonte se shpirti i tij ishte i pranishëm, se ishte i gjallë. Në vend që të maste pulsën e dikujt tjetër, ishte e mundur të vendosje një pasqyrë përpara gojës dhe të përcaktoje nga avulli që krijohet atje nëse personi ishte gjallë. Nëse ishte në gjendje të krijonte lagështirë, të tregonte që shpirti i tij ishte i pranishëm.

“Jam gjallë,” pëshpëriti ai dhe pohoi me kokë, përpara se të futej në karrocë bashkë me udhëtarë të tjerë.

Zgjodhi një ndenjësë poshtë një dritareje e cila përbëhej prej jo më shumë se vrimash të çara në pllaka metalike të veshura me plumb, dhe ai vështronte ndërsa udhëtarë të tjerë hynin në atë kuti të pashpirt të ndërtuar nga metali dhe druri, dhe u ulën në vendet e tyre, duke marrë frymë me vështirësi. Ishin të gjithë gjallë, të gjithë lëviznin, të gjithë e dinin qëllimin e tyre, dhe se për ku ishin nisur. Ata kishin qëndruar ulur në pritje për t’u nisur për dy ditë dhe i kishin mbaruar të gjitha temat e bisedës. Emocioni që Laurentius kishte ndjerë në fillim kur kishte nisur udhëtimin e tij ishte kthyer në një plogështi të mërztishme, me një hije shqetësimi për Klodia-n.

Shoferi i karrocës fshikulloi frerët, dhe kutia filloi të ecë përpara

mbi rrotat e saj prej druri. Kishte qëndruar atje si një monument i zgavërt, si një guaskë, por pasi njerëzit hynë brenda saj mori jetë, dhe tani u nis sikur të ketë ndonjë plan, duke u përkundur dhe dridhur ndërsa filloi të ecë përpara. Një objekt që nuk kishte një vullnet të vetin kishte fituar shpirt të vetin, dhe nga ai shpirt jetë. Por a ua falën shpirtrat njerëzit brenda kutisë një trupi të jashtëm, apo a i mbajtën për vete në një farë mënyrë, për t'i përdorur vetë?

“Kur hipi në karrocë,” mendoi Laurentius, “a jam prapëseprapë vetvetja, apo kam fituar një trup të ri, një trup i cili nuk bën më hapa por rrokulliset mbi rrota, një trup që mund të lëvizë vetëm në rrugë të mbuluara me baltë dhe zhavorr i ashpër?”

“Çfarë?” pyeti personi pranë Laurentius-it. “Asgjë...” iu përgjigj Laurentiusi.

“Mos the gjë?” e pyeti përsëri personi pranë.

“Vetëm po murmurisja me vete, s'është e rëndësishme. Më fal,” shpjegoi Laurentiusi.

Laurentius mbështeti kokën në anë të karrocës, duke bërë sikur po përpiquej të flinte. Por trupi i ri i përbashkët i udhëtarëve po përpiquej të gjente rrugën, rrotat e mëdha me rreze futeshin në brazdat e forta, të cilat ishin shembur vende vende duke formuar gropa të mëdha, dhe koka e tij u përplas me dhimbje pas veshjes me plumb sipas ritmit shtingëllues.

“O!” thirri Laurentius.

Ai po mendonte për paraketin e tij. Sapo ai u largua për të shkuar në qytet, personazhet në bujtinë me sa duket e kishin ushqyer me diçka, ndonëse të gjithë e kishin mohuar fort. Kur u kthye, Klodia kishte filluar të dridhej. Drithërima dhe këputja kishin zgjatur gjatë gjithë natës; zogu i tij nuk kishte pirë dhe nuk kishte ngrënë asgjë dhe kur erdhi mbrëmja tjetër kishte dhënë shpirt. Laurentius kishte parë me shqetësim shenjat e para të vdekjes. Fillimisht dridhjen e lehtë, pastaj humbjen e ekuilibrit, më pas iu dobësua dhe turbullua shikimi. Klodia nuk kishte mbijetuar dot as dy ditë

në tokën e estoniane. S' ishte faji i tij që ajo ngordhi, por kjo nuk e ngushëllonte. Nëse e kishte apo s' e kishte fajin, zogu i tij kishte ngordhur. Harabeli i vogël qëndron i shtrirë, i ngrirë dhe pa jetë brenda kafazit të tij, në hapësirën e drunj të bagazhit mbrapa karrocës.

Laurentius nuk kishte dashur ta linte pas, kështu vendosi ta merrte me vete në Dorpat. Ai ia kishte dalë t' i rregullonte një vend në karrocë, dhe prandaj vendosi të mos shkojë në këmbë. Ndoshta rrugët ishin vërtet të rrezikshme siç i thanë njerëzit.

“Një trup i ri,” ia nisi përsëri gruaja që ishte ulur pranë tij. “Një trup i ri, the, apo diçka e tillë...por si mund të vijë këtu një trup i ri?”

“E marrim përsipër vetë.”

“Çfarë the? Mendova se po flisje sërish për paraketin tënd. Tani nuk po kuptoj asgjë fare.”

Laurentius i mbloodhi duart grusht pastaj i hapi përsëri. Këto ishin duart e tij, trupi i tij. A ishin ato pjesë e trupit në të njëjtën mënyrë se si ai tani ishte pjesë e karrocës? Kjo ishte karroca e tij, udhëtimi i tij. A ishte gjithashtu vallë kafazi i tij?

Gruaja bëri me dashje gjestin e vendosjes së duarve sipër çantës së saj të udhëtimit.

“Më fal,” tha Laurentiusi.

Nuk kishte ndonjë gjë të madhe për të shpjeguar gjithsesi; ishte një histori e zakonshme, por për ndonjë arsye ai nuk donte ta përsëriste edhe një herë. Kur udhëtarët ishin njohur fillimisht me të në Reval ai i kishte treguar atyre për paraketin e tij, por asnjë prej tyre nuk kishte kuptuar përse ishte aq shumë i mërzitur. Për ta një paraket ishte veçse një zog i shtrenjtë, ekzotik. Ata e ngushëlluan njësoj si të ngushëllojnë një tregtar të madh ngarkesa e të cilit është fundosur në një stuhi. Këto gjëra ndodhin, s' ke ç' i bën, jeta vazhdon... Laurentius psherëtiu dhe heshti, duke e mbështetur kokën pas panelit të plumbit duke e lënë freskinë e

metalit të zbusë dhimbjen e vendit të vrarë ashtu si një lugë zbut dhimbjen e një xhungë. Jeta vazhdon. “Çfarë do të thotë atëherë, ky trup i ri?” pyeti gruaja, duke mos dashur të dalë nga tema.

Burri i gruas kishte qëndruar në heshtje me maturi, por tani u ngërdhesh dhe tundi kokën, haptaz i acaruar. “Mos fillo tani edhe një herë nga e para,” i tha ai gruas së tij.

Laurentius i uli sytë në tokë i tensionuar, duke pyetur veten se si mund të ndryshonte temë, zëri i gruas kishte filluar të tingëllojë i ngjirur dhe i shqetësuar. Këto bisedat në karrocë shpesh mund të bëhen të çuditshme dhe të sikletshme. Laurentiusi nuk kishte dhuntinë e të kuptuarit me të tjerët, sado që do t’i kishte pëlqyer.

“Vetëm po mendoja se pikësëpari, shpirti është brenda trupit. Por shpirtrat janë sigurisht të pavdekshëm,” tha ai më në fund. “Pra, për t’i rënë shkurt, pyetja ime është: kur trupi vdes, ku shkojnë shpirtrat përpara ringjalljes së tyre?”

“Çfarë do të thuash? Shkojnë te Zoti, apo jo?” tha gruaja.

“Por ku është Zoti?” pyeti Laurentius.

“Në qiell, ngado,” u përgjigj gruaja.

“Ashtu, por atëherë duhet të ketë shpirtra ngado. Këtu gjithashtu,” sugjeroi Laurentius.

“Mos do të thuash se ka shpirtra edhe në këtë karrocë?” hamendësoi gruaja me acarim.

“Jo, jo ashtu...më shumë si kujtimet,” tha Laurentiusi. “Pra atëherë,” nxori si përfundim gruaja fitimtare, “Nëse ka kujtime në këtë karrocë, dhe kujtimet janë shpirtra, atëherë kjo karrocë duhet të jetë e gjallë. Por nuk është, apo jo? Nuk mund të ketë fëmijë!”

Laurentius mendoi për Aristotelin dhe martesën. “Jo të gjithë njerëzit e gjallë kanë fëmijë,” tha ai.

Gruaja u kthye nga ana tjetër dhe u ul gjithë inat në drejtim të rruginës midis ndenjësve.

“Çështja nuk qëndron te të paturit fëmijë, sigurisht,” shtoi Laurentiusi.

Por gruaja nuk foli, pothuajse me kokëfortësi, me vendosmëri. Laurentiusit mendoi ta tregonte sërish historinë e tij, të shpjegonte arsyen e humorin e tij të keq. Por e pati bërë këtë disa herë tashmë, dhe iu duk e pakuptimtë ta bënte këtë përsëri. Ndoshta s'ia vlente të bezdiste bashkudhëtarët e tij duke e treguar. Klodia e kishte ndihmuar gjithnjë të shkonte mirë me njerëzit, duke sjellë gjallëri me cicëritjen e saj të gëzueshme. Në këtë çast, shoqëria e saj ishte tamam ajo që i duhej. Por tani shoqja e tij e fëmijërisë qëndronte shtrirë e mbështjellë me një çarçaf në kafazin e saj, e futur si pykë midis valixheve të lagura. E ngordhur.

“E tmerrshme,” murmuriti ai me vete me zë të ulët.

“Çfarë thatë?” pyeti gruaja.

“Asgjë,” u përgjigj Laurentius.

“Jam sigurt se dëgjova diçka,” tha gruaja rëndë, por pastaj heshti përsëri. Katër udhëtarët e tjerë po i shihnin me mosbesim: Laurentiusi dhe gruaja ishin përpjekur gjatë gjithë udhëtimit për të nisur një bisedë të sjellshme, por përpjekjet e tyre shkuan kot.

Laurentius psherëtiu i pezmatuar, mbylli sytë, dhe filloi të mundohet fort ta zërë gjumi. Karroca tundej monotonisht, me rrotat që futeshin te brazdat e sipërfaqes së rrugës të gërryera nga moti me një ritëm të ngadalshëm, si lëkundja e lavjerrësit të orës. Ai përfytyroi sikur karroca ishte statuja e një golemi të madh që është sjellë në jetë me magji, bërë nga Rabbi Eliyah, me njerëz të ngjeshur në stomakun e tij si shiritë letre, secili me emrin e Zotit të shkruar në të. Por si ndjehej ai rrip letre brenda makinerisë së stomakut? A ka vendin e vet enkas, apo është thjesht në kalim e sipër duke shtyrë kohën në mërzë? Si është të jesh brenda një njeriu? Nga vjen shpirti, dhe ku shkon? Po brenda paraketit të tij?

Laurentius tundi kokën dhe pa rrotull me shqetësim. Ai nuk donte të futej në ato lloj mendimesh, duhet të sigurohej të qëndronte racional. Por nuk iu durua dot. Copëza mendimesh,

fjali të veçanta dhe kujtime depërtuan në vetëdijen e tij si gjaku që njom fashë. Kjo ishte plaga e vetëdijes së tij të cilën ai e fashonte dhe e mjekonte por më kot. Laurentius ishte përpjekur ta zhyste veten në nxënie, letërsi, teatër, shoqërinë e njerëzve të tjerë, në gjithçka për të qetësuar plagën dhe për t'a ndihmuar të shërohet. Por ajo u qelbëzua, të njëjtat mendime vazhdonin të vinin, dhe gjaku i sëmurë vazhdonte të dilte në sipërfaqe.

Ai dëgjoi një zhurmë kërcitëse. Karroca kishte kaluar mbi një nga gropat e mëdha, duke shkundur udhëtarët, fytyrat e të cilëve u shtrembëruan nga frika. Një çantë udhëtimit ra në dysheme nga gjunjët e burrit që ishte ulur përballë.

“Ou!” thirri nga dhimbja dikush.

Çanta kishte rënë anash në këmbët e udhëtarit ngjitur.

“Më fal, më zuri gjumi për një çast dhe godita kokën,” shpjegoi burri, duke fërkuar veshin me një shprehje fytyre të mërzitur.

“Gjendja e rrugëve këtu është më e keqe se në asnjë vend tjetër ku kam udhëtuar...Tani, në Suedi, kanë rrugë të mira. Toka është më e fortë atje, sigurisht nuk ka kaq shumë moçale. Ndërsa këtu...”

Gruaja seç murmuriti diçka me vete me zemërim.

Burri vazhdoi të dërdëllis, sikur të ishte përmbajtur për një farë kohe dhe nga shkundja kishte filluar të shkarkohet nga gjithçka që kishte patur në mendje.

“Pronarët vendas të tokave duhet t'i mirëmbajnë rrugët, por s'e bëjnë. Do të bëjnë gjithçka për të mos e bërë. Gjithashtu gjendja e bujtinave buzë rrugës as që mund të zihet me gojë. Në disa prej tyre, je me fat nëse gjen diçka tjetër përveç birrës dhe pijes alkoolike. Duhet të flesh mbi kashtë të mykur në një dysheme me baltë. E megjithatë gjithçka është kaq e shtrenjtë. Bujtinat në Suedi janë mjaft të mira: mund të hash ushqim të ngrohtë në të gjitha, dhe ka shtretër me kashtë të freskët. Më

dëgjo mua, atje ndryshon puna.”

Laurentius qëndroi drejt në karrige dhe buzëqeshi zyrtë. Ai e dinte nga përvoja e tij se në fakt në Suedi nuk ishte më mirë. Ai e palosi të kthyerën e jakës së palltos së tij për të patur një material të trashë që ta vinte midis ballit të tij dhe anës së karrocës. Amortizonte pak tronditje , por s’ë mbronte aspak llototia e vazhdueshme e burrit. Kërcitja e pikave të shiut në anën e jashtme të karrocës u bë gjithnjë e më e fortë, duke rrahur në tëmthin e tij. Filli i thurur i palltos së tij u pushëzua nga lagështia, dhe një erë myku që mezi ndjehet filloi të përhapet midis fijeve. Në fakt ai kishte qenë me fat që gjeti një vend në një karrocë të mbuluar. Pjesa më e madhe e karrocave që udhëtojnë midis Reval dhe Dorpat nuk ishin veç se qerre të hapura me bar të thatë, dhe udhëtarët bëheshin qull në shiun e ftohtë siç ishin bërë tani karrocieri dhe këmbësori.

“Hmm, ç’ndyrësi,” shfryu burri i ulur përballë meje ndërsa lëshoi një rrëke të sharash kundër rrugëve dhe bujtinave të Estonisë dhe Livonies. Ai shtriqi këmbët gjerë e gjatë, të cilat ishin mbuluar nga çizmet e gjatë me baltë.

Ndërkohë, Laurentius po mendonte ende për paraketin e tij të shtrirë atje pa fuqi në kafazin e saj, duke pyetur veten nëse duhet ta vendosë në një kuti më të vogël. Dukej e çuditshme të ecje poshtë e lart me një zog të ngordhur në një kafaz. Por ai u mësua aq shumë duke tërhequr me vete kutinë me tela, duke dëgjuar cicërimën që vinte nga brenda saj, duke folur me Klodia dhe duke u kujdesur për të. Ajo kishte qenë gjithmonë shumë e lumtur të qëndronte në dorën e tij dhe të çukiste gishtërinjtë e tij. Trupi i saj i vogël me pupla befas u ndie ngrohtë, pothuajse sikur të kishte ethe, u ndie plot gjallëri. Por është e pavend të sjellësh një kafaz me zog të ngordhur në karrocë. Udhëtarët e tjerë do të mendonin edhe më keq për të se më parë.

“Vërtet,” tha Laurentius duke mos iu drejtuar ndonjërit në

veçanti. Pasoj heshtje, dhe ai u kollit me ngurrim. Mbylli sytë dhe u përpoq të mendonte se çfarë do të bënte pasi të kishte mbërritur në Dorpat. Së pari, do të sistemohej në dhoma me qira; pastaj mund të shkonte të shihte për herë të parë universitetin. Në vend të mendimeve të qarta, gjithsesi, ai dëgjoi shungullimën e rrotave prej druri të karrocës, pëshpëritjen e shkulmit të erës, kërcitjen e valixheve të udhëtarëve të lidhura bashkë poshtë mbulesës prej cope dhe kërcitjes së pandërprerë të shiut. Koka e tij tundej sipas ritmit shtingëllues dhe tëmthi i tij përplasej me dhimbje tek jastëku që ai kishte krijuar me pallton e palosur. Asnjë mendim i vetëm i qartë dhe i kuptueshëm, vetëm rrëmujë e plotë.

“Mm,” murmuriti Laurentius.

Hapi sytë, u ul drejt, dhe pa njerëzit e tjerë në karrocë. Të gjithë i mbanin sytë ulur, të gjithë qëndronin në heshtje duke parë secili punën e vet. Tani ai mund t’i vëzhgonte s’i duhet. Gruaja pranë tij ishte ulur në një pozicion të mbledhur, sikur të ishte shtyrë anash pas ndenjësës prej druri. Koka e saj ishte kthyer nga ana tjetër, dhe shihte mënjanë. Trupi i saj ishte pa diskutim pranë tij, por dukej sikur e zonja e tij ishte diku gjetkë. Një trup pa sy, që nuk sheh, i pajetë. Vetëm një trastë e zbrazur. Laurentius ndjeu nevojën të flasë, të flasë me dikë, por nuk po i vinte ç’të thoshte. Kishte frikë se do të hapte përsëri një diskutim nga hiçi.

Nxorri orën nga xhepi dhe lexoi fushën e orës me akrepin e saj të vetëm. Pas pak jashtë do të bëhej errësi e plotë. Ai u përkul përpara drejt dritares, për të parë përmes vrimave të vogla. Një pamje e botës jashtë iu shpalos përpara syve. Një lumë i larmë, që rridhte pa dashur drejt qëllimit të tij. Gjethe shumëngjyrëshe, të stërpikura me rruaza vezulluese shiu. Lirishta pyjore të vetmuara, kalonin ngadalë para syve. Por syri i tij nuk ndalej gjatë tek asgjë, tek asgjë që mund t’i bënte këto mendime të kishin një lidhje logjike. Në këtë çast, ai kishte nevojë për cicërimën mbështetëse të Klodias, por tani e vetmja shoqëri që kishte ishin udhëtarët e tjerë,

gjysmë në gjumë, gjysmë të vetëdijshëm. U përpoq të largonte mendimet që i vlonin në kokë, të shpërndara aty këtu, por lufta me demonët e kujtesës së tij vetëm sa i bënte imazhet më të qarta, iu dha formë atyre. Përbindësja të lindur nga arsyeja.

Laurentius u kollit dhe ndjeu një gërvishtje në fytyrë. Po i merrej fryma.

Ngadalë u bë i vetëdijshëm për një grahmë që të shponte hundët që po depërtonte në karrocë. Fillimisht ishte gati e pakapshme, por tani po përshkonte gjithçka, duke sunduar plotësisht shqisat, duke e mposhtur atë ashtu si gjumi mposht një trup të lodhur.

Ai u kthye pas me shpejtësi në panik. Nga po vinte ky kundërmim? Udhëtarët e tjerë rrinin ulur qetësisht në ndenjësjet e tyre, madje as po rrudhnin hundët. Ai u zgjat te dritarja dhe pa përsëri jashtë. Ajo grahmë duhet të vijë nga diku! Mund të shquante në largësi siluetën e errët të një ndërtese, një kolos binarësh të mëdhenj që qëndronte në gjysmëdritën e kobshme, të ankthshme që vinte nga rënia e muzgut. Duke u munduar të shihja përtej ujit të shiut që hynte në vrimat e dritares, ai fshiu sipërfaqen e brendshme të lagur, që i la një vijë të përhitur, me baltë në pëllëmbën e dorës së tij. Atje, përmes mjegullës, pranë një lirishteje në mes të një pylli që vezullonte nga shiu, ai mund të shquante mure të rrëzuara, qepra çatie të shtrembër, të bëra shkel e shko nga dërrasa të trasha, pllaka çatie dhe shtylla të kreshpëta. Mos ishte një plevicë? Nuk dukej asnjë dritë gjëkund, asnjë shenjë jete që vinte nga karabinaja e ndërtesës.

Grahma duhet të vij prej diku andej, prej atyre qeprave të prerë pjerrët, të mykur, përcaktoi Laurentiusi. Patjetër, prej andej duhet të vijë.

Ai pa nëse dikush mund të kishte bërë ndonjë zjarr bubulak pranë pelvicës, ndonëse ishte e qartë se me këtë mot askush nuk mund të mbante zjarrin nderur për një kohë të gjatë. Nuk dukej gjëkund asnjë shkëlqim i verdhë e flakës që dridhet, vetëm një

skenë pa ngjyrë, pa jetë që ka në sfond qiellin blu të errësuar. Por diku duhet të jetë diçka, ndonjë substancë, ndonjë lëng, ndonjë kalbëzim prej të cilit vjen kundërmimi helmues. Ndoshta ishte bar i thatë që digjet ngadalë brenda plevicës?

Ai ngjeshi kokën në veshjen e ftohtë metalike dhe vështroi me vëmendje të madhe nga dritarja për të parë më mirë mjedisin rrethues, por gjithçka që mund të shihte përmes të çarave të ngushta të metalit ishte peizazhi që tronditet, që sa vjen dhe bëhet më i errët, veç hollësi të veçanta që nuk krijojnë asnjë tablo të madhe.

Laurentius u përpoq vendoste syrin në një nga vrimat më të mëdha, por në atë çast karroca u trondit aq fort, sa ai e përplasi vetullën me dhimbje në hekurin e ftohtë, dhe gjithçka filloi të notojë përpara syve të tij. Ai nxorri një rënkim të mbytur. Udhëtarët e tjerë u ngritën me frikë nga ndenjëset e tyre dhe u mbajtën në anët e karrocës. Ai dëgjoi një zhurmë kërcitëse, që fillimisht mezi u dëgjua, por ngadalë filloi të bëhej gjithnjë e më e madhe, derisa papritur ndenjëset u anuan anash, dhe pati një përplasje të madhe, e ndjekur nga zëri i karrocierit që shan dhe ja bën ya kuajve. Karroca u ngadalësua pastaj ndaloi përnjëherësh. Për një çast, mbizotëroi heshtja, e cila u thye nga zhurma e rënies së valixheve nga hapësira e drunjte e bagazhit që përfunduan në rrugën me baltë pas.

“Aah!” bërtiti Laurentius.

Ai fërkoj vendin e vrarë në kokën e tij dhe filloi që të dalë karroca e anuar, ndonëse s’ishte fort e lehtë. Kur më në fund arriti të hapte derën, pa se karrocieri dhe këmbësori i gruas prapa karrocës ishin gjallëruar shumë. Për fat të mirë, rrota me rreze nuk ishte dëmtuar shumë: vetëm kishte dalë nga boshti i saj dhe kishte rënë anash gjysmë e futur në baltë. “Do të më duhet ndihma juaj,” tha karrocieri. S’besoj se do ta vë dot vetë në vend. Dilni të gjithë.”

“Por po bie shi, apo jo?” tha gruaja e ulur pranë Laurentiusit

me një ton të bezdisshëm.

“Le të qëndrojë gruaja brenda,” u përgjigj karrocieri. “Sa mund të peshojë ajo, gjithsesi?”

Laurentius drejtoi kurrizin dhe kundroi skenën. Në buzë të rrugës kishte disa pemë të vetmuara që era ende nuk ua kishte rrëzuar gjethet e vjeshtës, dhe midis trungjeve të tyre të përhimë ai mund të shikonte një lirishtë ngjyrëkafe në mes të një pylli. Pak më lart në mes të saj qëndronte një plevicë e nxirë të cilën Laurentius e kishte parë kur përpiquej ta dallonte nga dritarja e karrocës. Seç kishte ajo pamje që e bëri të rrëqetëj trupi. Ndjeu përsëri grahmën që të shponte hundët, si një kujtim i lemerishëm të cilin ishte përpjekur ta ndrydhë. Esenca e tëmthit të zi, e përzier me acid, ndoshta sulfur, po derdhej mbi udhëtarët dhe karrocën me pikat e shiut. Era e keqe u fut në rrobat e tyre të lagështa, poshtë kapelave të tyre dhe në flokë, kalon lëkurën dhe depërton brenda në vrimat e hundës, dhe pastaj më tej në mushkëri, mish, dhe zemra. Fillimisht në gjuhë, pastaj në hundë, shpuese, e fortë, armiqësore dhe e papritur. Ai mund të mbajë mend vetëm turbullt se para ca kohësh, kishte ndjerë një kundërmim të tillë, një tmerr të ngjashëm. Thërmijat e kësaj grahme, esenca e të cilës mbarte kujtimet, mbërthenin thumbat e tyre në vrimat e hundës së tij, në qiellzën e gojës, pastaj vazhdonin më tej duke kaluar përmes kanaleve të gjatë deri në tru, dhe më pas në shpirtin e tij. Kundërmimi e mposhti, duke sjellë kujtime nga një skenë e tmerrshme, me vrasje, përdhunim dhe njerëz në ankth që vajtojnë, një skenë të cilën ai nuk do ta harronte kurrë. Trazonte përvojat e vjetra të cilat ishin megjulluar nga kalimi i viteve duke i zgjuar ato. Gjak rridhte nga plaga. Ai ende e mbante mend, si të mos e mbante?

“Më falni,” tha Laurentius, duke u përpjekur t’i tërhiqte vëmendjen e karrocierit.

Ai fërkoj me ankth hundën, madje u përpoq të mbajë mbyllur vrimat e hundës, por më kot. Kundërmimi ishte përhapur ngado dhe ai ndruhej se nuk do të mund të çlirohej prej tij. Atë filloi ta pushtojë një ndjenjë frike. Ndërkohë, udhëtarët e tjerë i kishin hyrë punës në fund të karrocës me kuaj, me pamje pothuajse të qeshur.

“Duket sikur Satanai ka shtënë mallkim në atë rrotë,” shfryu karrocieri. “Kontrollova vetë gjithçka para se të niseshim, s’kishte asgjë që s’shkonte. Kush e di kush e ka parë me sy të keq.”

“Më falni!” tha Laurentius me dëshpërim. Por karrocieri nuk mori mundimin as të shihte nga ai; vetëm vazhdonte duke mallkuar me vete, sikur të bënte një lutje apo magji. “Ej, ç’ke kështu?! Eja dhe mbaje këtë anë dhe do ta ngremë bashkë,” udhëzoi burri që kishte mallkuar gjendjen e rrugëve në vend.

“E ke vënë re edhe atë kundërmim?” pyeti Laurentius. Më fal, si thatë?” pyeti burri.

“Nuk nuhas asgjë. Kam patur një të ftohur të keqe këto ditën e fundit. Ndoshta e sjellë era nga diku këtu rrotull. Vendasit djegin lloj lloj plerash,” tha burri.

Laurentius tundi kokën, pa përqark përsëri dhe fërkoj hundën me ankth. Po i merreshin mendtë.

“Tani, të gjithë bashkë, ngrijeni!” bërtiti karrocieri. Laurentius mbërtheu karrocën bashkë me të tjerët.

Duke sforcuar muskujt, duke zhytur çizmet në baltë, më në fund ata arritën ta ngrenë karrocën në lartësinë e duhur dhe karrocieri filloi të fusë në vend rrotën me goditje, duke vazhduar të murmuritë nëpër dhëmbë diçka me vete ndërkohë që godiste me çekan. Por brenda Laurentiusit, brenda mendimeve të tij dhe në trurit e tij, grahma që të shpon hundët po bëhej edhe më e fortë; tëmthi i zi po shpërhapej edhe më gjerë, duke u shtrirë në të gjithë gjymtyrët e tij: tmerr, neveri, skëterrë. Po ku

gjendeshin ata?

“Ku ndodhemi tani, gjithsesi?” pyeti Laurentiusi.

Karrocieri murmuriti nëpër dhëmbë diçka të pakuptueshme, bëri shenjë me kokë në drejtim të rrugës, dhe vazhdoi të godasë rrotën me çekiç. Laurentius, që ka humbur fillin nga nervozizmi, nuk guxoi të bëjë më shumë pyetje; thjesht po rrinte dhe shihte i shqetësuar mjedisin rrethues. Vërtet, ku mund të ndodheshin ata?

“Pothuajse arritën, edhe pak rrugë kemi. Mora me mend se Dorpart do dukej përpara se të binte muzgu,” shpjegoi një nga burrat kur më në fund e ulën sërish poshtë karrocën. “Puna e rrotës ishte fat i prapë, është e sigurt; kur të mbërrijmë atje do të jetë bërë natë. Bëjmë mirë të mbledhim shpejt bagazhin.”

Laurentius buzëqeshi dhe mblodhi të gjitha forcat për të bërë një shprehje fytyre miqësore. “Ç’bezdi.”

Fatmirësisht valixhja e tij ishte ende në hapësirën e bagazhit. Por kafazi që kishte paraketin e tij të ngordhur s’dukej gjëkund, ose nuk u gjet mes gjërave të shpërndara nëpër rrugën me baltë. Laurentius u mundua të shihte në drejtim të lirishtës së errët. Udhëtarët e tjerë bënë uf duf me zemërim ndërsa ngrinin valixhet e tyre dhe i fusnin prapa karrocës, dhe këmbësori i lidhi fort, ndërsa karrocieri vazhdoi të eglendisete rrota. Laurentius pa rrotull sikur të kërkonte diçka. Por s’ishte e mundur të shihje hollësisht në mugëtirë dhe me shiun që ngrinte pikla. Duke bërë kujdes të mos shkelte në pellgje të mëdha ai u largua disa hapa nga rrota e karrocës.

U drodh ndërsa pati një ndjesi nxehtësie të ngjitet ngadalë lart nga stomaku në kokë. Këto ishin lëngjet e trupit të nxehtë, të lagësht, ato që shkaktonin zemërim dhe frikë.

Disa metra më tutje, kërrusur në hijen e një peme të lartë të dendur bredhi, qëndronte një siluetë kurrizo i rreckosur me tipare të groposura. Ai mbante në dorë kafazin e paraketit të

Laurentiusit. Dera e kafazit ishte shqyer, dhe Laurentiusi mund të shihte diçka me ngjyra të ndezura në dorën e bardhë në gri të gjatë dhe të hollë të rreckamanit. Grahma e çuditshme sa vinte dhe bëhej më e fortë. Silueta e rreckosur tha me zë të përzishëm ca fjalë në një gjuhë të pakuptueshme dhe u duk sikur vuri buzën në gaz. Nga brenda mjekrës së vogël ngjyrë gri doli një gojë, plot me dhëmbë të thyer të shtrembër, të zinj të madhësive të ndryshme.

“Ma kthe atë që ke marrë,” tha Laurentius, duke u përpjekur ta bënte zërin të sigurt.

Silueta ende duke buzëqeshur, ndenji drejt dhe e kapi për supesh. Sy të kaltër, pothuajse në të njëjtën ngjyrë si qielli i verës, e panë me habi nga zgavrat e groposura të syve. Laurentiusi donte ta largonte shikimin. Nëse mund ta shmangte, ai kurrë nuk i shikonte të tjerët në sy. Por këtë herë ai nuk mundi ta heqë shikimin apo të mbyllë sytë. Pa ngultas sytë e plakut, dhe atje, mes ngjyrës së rimitë, pa dhimbje dhe vdekje. Një plak i uritur, i detyruar të shkëputet nga rruga e tij, tepër i vjetër dhe i dobët për të punuar, tepër zhelan dhe i sëmure që dikush të kujdeset për të.

“S’mundem...” filloi të shpjegojë Laurentius. Ai prapë nuk e largonte dot shikimin. Por tashmë ishte tepër vonë.

“Nuk duhet,” tha Laurentius.

Plaku u kthye dhe iku me të katra me hap çuditërisht të shpejtë në drejtim të plevicës së kalbur.

Laurentius ndenji duke e parë të largohet, pa mundur të bëjë asgjë. Ai duhet ta kishte ndjekur, duhet t’ia kishte marrë kafazin, ndoshta t’i jepte ca para, por mpirja e shkaktuar nga grahma dhe frika e mbajti të mbërthyer në vend. Tëmthi i zi e kishte gllabëruar, e kishte futur në një rrugë pa krye; nuk mund të reagonte shpejt. Ai kishte frikë nga plaku i shkurtër.

“Do ikim tani. Përpara se të bëhet shumë errësirë,” bërtiti

dikush nga ana tjetër e karrocës.

Fillimisht Laurentiusi nuk u përgjigj; vetëm rrinte dhe shihte i hutuar plevicën e zezë dhe fërkonte hundën. Grahma që vinte valë valë e pushtoi të tërin; dukej sikur të buronte nga pemët aty rrotull dhe nga qeperat e kalbur, si drita që përhapet nga qiriu. Apo mos vinte nga vetë Laurentius? A ishte ai qiriu?

“Ej!” thërriti përsëri dikush.

Laurentius tundi kokën dhe filloi të kthehet ngadalë drejt karrocës. “Nuk e patë?”

“Çfarë? Nxito tani,” tha një nga udhëtarët. Ishte dikush atje,” tha Laurentius.

“Miku im, ka mundësi të ketë qenë një pjesë mjegulle,” tha udhëtari.

“Kafazi im...” ia nisi ai, por e dinte që s’kishte kuptim të përpiqej të shpjegonte. Tashmë grahma po e mbyste; nuk duronte dot të qëndronte atje më gjatë.

Mbrëmja e së Hënës

PERIFERITË E QYTETIT kishin gjithmonë të njëjtën pamje. Papritmas do të fillonin të shfaqeshin lirishta midis pemëve të pyllit, ndjekur nga kolibe të pandriçuara, të vetmuara. Ndërlíkimi arkitekturor dhe dritat e verdha të fenerëve ishin ruajtur për qendrën e qytetit; këtu në zonën e mjegullt të përkohshme ndodheshin vetëm ndërtesa të vjetruara, punishte me përshkrime të ndryshme, lëkurëpunuesit me xhamashet e tyre erëkeq për zbutjen e lëkurëve, gjithë ata njerëz që për shkak të profesionit të tyre apo pozitës shoqërore nuk lejoheshin të hynin në qytet, ose ata që zgjidhnin të mos kalonin muret e saj. Kjo zonë nuk ishte bërë ende qytet, por fshati kishte filluar të zhdukej. Megjithatë njerëzit ende flisnin për kufirin e qytetit, sikur të ishte e mundur të vizatoje një vizë ndarëse, përtej të cilës papritmas fshati nuk ekzistonte. Ku ishte ai kufi i prerë me thikë që ndante qytetin nga fshati, që ndante fundin nga fillimi? Mos ishte muri i qytetit? Jo, sigurisht, manastiret, bujtinat, varrezat dhe kopshtet tregonin se qyteti kishte filluar shumë përpara këtij. Ku ndodhen kufijtë e jashtëm të qenies sime? A janë ato lëkura ime, flokët e mi, rrobat e mia, kafazi im? Karroca ime?

Laurentius mbylli sytë, por grahma nuk kishte ikur. Fillimisht frikej se ishte tepër e keqe për t'u mësuar me të, pastaj mendoi se mund ta hiqte mendjen prej saj për një farë kohe. Por sapo filloi t'i ngrinte moralin ky mendim, u kthye, duke mbushur vrimat e tij

të hundës me gjithë forcën e saj, dhe ai s'mund të mendonte për asgjë tjetër. Kuptoi se kjo ndodhte prej krimit që kishte kryer dhe ndjenjës mbytëse të fajit që nuk e linte të qetë asnjë çast. Por nga vinte vallë? Atë po ndjente kaq shumë neveri sa vendosi të lutej me zë të ulët me vete. Por as lutja nuk e ndihmoi. Ku ishte Klodia e tij e dashur tani që kishte nevojë për të?

Laurentius lëvizte në ndenjëse sikur kishte krimbat. “Ende s'arritëm?” pyeti ai, duke mos iu drejtuar ndonjërit në veçanti.

“Duhet të mbërrijmë në bujtinë nga çasti në çast. Është e pamundur të shquash diçka me gjithë këtë errësi. Duhet të ketë ndonjë fener të varur jashtë,” tha burri i ulur përballë tij.

Laurentius tundi kokën, rrëmoi në xhepin e tij për një shami dhe fshiu fytyrën. U përkul përpara për të parë jashtë dritares, por mund të shquante shumë pak nga vrimat e vogla. Pa vetëm një uniformë, dobësi të papërcaktuar ndriçimi, bashkë me përvijimet e turbullta të një kasolleje të rastit dhe një kalimtar i çuditshëm që i shihte ndërsa ata kalonin. Në largësi ai mund të dallonte konturet e mureve të qytetit dhe ledhet e bastioneve.

“S'arrij të shoh as edhe një dritë të vetme,” tha Laurentius. “Aha,” u përgjigj udhëtari tjetër.

Laurentius mbylli sytë dhe u përpoq të përqendrohej te mendimet e veta. Grahma vazhdonte të hynte në vrimat e hundës, sikur një demon hekuri të kishte futur tek ai një shpirt të farkuar në një kudhër. Shpirti i ri kishte hyrë brenda tij dhe kishte filluar të zhvendosë avullin që kishte qenë i varur pezull atje, të cilin ai e kishte sjellë me vete nga një vend tjetër, nga një tokë tjetër.

Pa e ditur plotësisht përsenë, i hyri paniku.

“Tani mund ta shohësh,” tha me ngazëllim burri i ulur përballë tij.

Karrocieri ua bëri yja kuajve, dhe karroca u kthye. Kaloi me gjëmim mespërmes buzëve të trotuareve të fundosur që të çonin në një shesh të vogël të rrethuar me një rradhë hunjsh druri. Drita

e fenerëve të varur lart ndriçoi pellgjet e panumurt që valëzohen duke mbuluar sipërfaqen e përbaltur të truallit. Ndërsa rrotat e mëdha mëshonin mbi pellgjet ato krijonin brazda të thata, përpara se uji të kthehej në vendin e tij. Pika të vogla uji binin mbi sipërfaqen e pellgjeve, duke shkaktuar valëzime bashkëqendrore dhe era fishkëllente midis rrezeve të rrotave që pikonin.

“Arritëm!” thirri me një zë triumfues burri i ulur përballë, sikur ta kishte ngarë vetë karrocën dhe t’ia kishte dalë ta çojë në vend të sigurt përmes shumë provash të rënda dhe vështirësish. Udhëtarët e tjerë filluan të lëvizin dhe të mbledhin vandakët e tyre.

Dera e veshur me lëkurë u hap me një kërcitje; karrocieri i njoftoi udhëtarët që të zbresin me kujdes shkallët, dhe ata zbritën mbi pllakat prej guri që ishin vënë në buzë të sheshit për atë qëllim. Laurentiusi qëndroi ulur duke pritur derisa të zbrisnin udhëtarët e tjerë, duke parë se si gruaja e ulur pranë tij ngriti fustanin e madh që i rrinte gjerë në mënyrë që të ngrihej dhe dhe të dilte nga karroca.

“Zbritën të gjithë?” pyeti karrocieri.

“Më falni,” murmuriti Laurentius, dhe u ngrit. Po i dridheshin këmbët. Qëndroi për një çast në shkallën e karrocës, duke thithur në mushkëri ajrin jashtë. Një lloj avulli iu hodh kalimthi në fytyrë, dhe ai mund të ndjente erën e sqfurit, hekurit dhe kallajit.

“Kujdes atje,” i tha karrocieri Laurentiusit.

Ai qëndroi në këmbë në shesh duke parë se si u çuan në stallë kuajt e vegjël, duke tundur krifat, ndërsa karrocieri shante me vete. Kishte nisur sërish të frynte erë dhe po shqyente copa kashte nga çatitë e kashtuara. Copërat vërtiteshin në ajër përpara se të binin në pellgje ku qëndronin, duke pluskuar në sipërfaqe. Laurentiusi ishte i fundit që hyri me zhurmë në derën e bujtinës. Sapo u fut brenda, uroi t’u hiqej sysh sa më parë bashkë me valixhen klientëve të tjerë të bujtinës. Për ndonjë arsye pati përshtypjen se të gjithë po e vëzhgonin me dyshim, dhe agorafobia që ndjente në

vende të tilla, e thelloi këtë. A do të ishte ky çasti kur dikush do ta tregonte me gisht? Disa klientë të tjerë ishin mbledhur rreth një vatre me qymyr dhe po ngrohnin duart, dhe ndërsa ai hyri në derë ata u kthyen për ta parë. Disa të tjerë ishin ulur në tryezat e vogla që s'u mbanin këmbët pranë murit, po kështu edhe ata e panë me kureshtje.

“Mirëmbërëma të gjithëve,” theu ai me një murmurimë heshtjen e shkurtër që kishte pasuar kur hyri, dhe shkoi drejt e te bujtinari.

“Një natë të lutem,” tha ai, duke i hedhur një shikim të shpejtë bujtinarit.

Bujtinari me pamje sportelisi e shqyrtoi mirë e mirë për një çast përpara se t'i tregonte rrugën te një dhomë e vogël në pjesën e pasme të bujtinës, ku ishin dy shtretër të vegjël të vendosur pothuajse pranë njëri tjetrit.

“Këtu ka një hapësirë të lirë,” tregoi ai me gisht një kuti druri të vendosur pranë murit. “Dritarja s'fut fare lagështirë. Por do të të duhet të ndash shtratin me dikë tjetër. Zotëria tjetër është ende në qytet duke u marrë me disa punë të tij, por do të kthehet patjetër në mbrëmje.”

Laurentius psherëtiu. Të ndaje shtratin me dikë tjetër ishte një domosdoshmëri e zakonshme por mund të dilte diçka mjaft e mërzitshme, sidomos nëse personi rastiste të ishte pijanec.

“Kuptova. Do ta mbaj parasysh,” tha Laurentiusi.

Ai tërhoqi valixhen e tij te koka e shtratit. Dritarja e vogël sipër ishte me xham të trashë, por nuk ishte mbushur ende me kashtë për ta izoluar për dimër, kështu që mund të merrje me mend pa frikë se lagështia dhe i ftohti i natës do të depërtonin në dhomë. Por prapëseprapë ishte shumë më e mirë se ato pensionet buzë rruge ku ishte detyruar të flinte flinte mbi pallton e tij të shtruar mbi dyshemenë e zhveshur. Kishte shumë të drejtë të kishte frikë se mos lëvizte në gjumë, pastaj të gjitha përpjekjet e tij për të fjetur do të shkonin dëm. Por ai nuk kishte zgjidhje tjetër, ata vinin

bashkë të flinin disa njerëz, në të gjitha pensionet. Në këtë mënyrë kursehej hapësira dhe ishte më ngrohtë.

“Faleminderit,” tha ai me mirësjellje.

Bujtinari tundi kokën në shenjë mbështetjeje, dhe e mbylli derën prapa tij, duke lënë pas një rreze drite qetësuese që hynte në dhomë nga e çara në fund.

Laurentius ul mbi dyshekët e mbushur me gjethe mështekne, dhe u mbështet pas murit. Asnjë nga klientët e tjerë të bujtinës nuk kishin shkuar ende të flenë, dhe ai mund të dëgjonte një potere në dhomën fqinjë. Dikush madje kishte filluar të këndoje me zërin e atij që është dehur.

“Pijanecë përsëri,” murmuriti ai me vete.

Laurentius tundi kokën me frikë, dhe filloi të lexojë një lutje mbrëmësore me gjysmë zëri. Ai mund të dëgjonte pothuajse çdo fjalë në holl, përmes derës së hollë të dhomës së gjumit, dhe nuk mund të përqendrohej në asnjë prej rreshtave të lutjes së tij përveçse “na shpëto nga i ligu”.

“Amen,” tha ai me një zë pak më të lartë dhe pa jashtë dritares.

Mendoi se do të ishte me vend të bënte një lutje ndërmjetësuese për paraketin e tij, por nuk po vendoste. Ishte e vërtetë se Klodia kishte qenë zog, prandaj nuk kishte një shpirt logjik, por qeniet që kalojnë shumë kohë në shoqërinë e njerëzve në fund të fundit bëhen një me qeniet dhe dëshirat e tyre, dhe me fantazmat e shpirtit të tyre, dhe filluan të ndryshojnë. Plutarch ishte përpjekur të ngushëllojë gruan e tij pas vdekjes së vajzës së tyre duke e krahasuar shpirtin me një zog që kishte fluturuar nga kafazi i tij. Nëse zogu kishte qëndruar në kafaz për një kohë të shkurtër, atëherë do të fluturonte shpejt prej tij, por nëse do të kishte qëndruar më gjatë, atëherë zogu do të mësohej me kafazin; do të ishte bërë shtëpia e tij, dhe nuk do të kishte qenë edhe aq e lehtë të largohej. Kur fëmijët e vegjël luajnë me kukulla të bëra prej cohe dhe druri, kukullat reagojnë ndaj tyre. Sepse për fëmijët ato janë qenie me shpirt, dhe t'i bësh

ato të vuajnë është si të bësh të vuajë një person i gjallë. Këtyre kukullave prej druri dhe copëzash pëlhere fëmijët u japin jetë dhe qëllim, ashtu sikurse karroca mori jetë dhe qëllim kur udhëtarët udhëtuan brenda saj; ashtu sikurse kafazi merr jetë dhe qëllim kur zogu është brenda tij. Në mënyrë të ngjashme Klodia kishte kohë që ishte bashkuar me shpirtin e tij; ajo i kishte ekuilibruar lëngjet e shpirtit të tij me ngrohtësinë e saj, duke vepruar si kundërpeshë ndaj melankolisë së tij. Bashkë, kishin formuar një të tërë, si artisti dhe furça që mban në dorë. Ata janë të papërzieshëm e megjithatë të pashkrishëm. Nëse Ovid u kushtoi një elegji paraketit të tij, atëherë përse Laurentius nuk duhej të lutej për të tijin? Fundja, ai ishte kujdesur për gati dhjetë vite, çdo ditë, që Klodia të ishte mirë dhe ajo në kthim e kishte ndihmuar për ta mbajtur të ekuilibruar. Por tani harabeli i tij s'ishte më, e kishte marrë një farë plaku i rreckosur.

Shpirti ynë është si zog

I ka shpëtuar lakut të Gjahtarit:

Laku u këput dhe ne ia mbathëm.

Duke parë që edhe Psalmi e krahasoi shpirtin me një zog, Laurentius tundi kokën dhe e lexoi deri në fund duke u përpjekur të mos lejonte asnjë mendim tjetër t'ia largojë vëmendjen. Por grahma në vrimat e hundëve i kujtonte atij vazhdimisht praninë e saj, si një dhimbje me rrahje, që pengonte përqendrimin e tij dhe ia tërhiqte vëmendjen. Ai u ndal së lexuari dhe e mbështeti kokën e tij në duar.

“Shumë mirë,” tha Laurentius me nënshtrim.

Me një psherëtimë hapi valixhen e tij dhe nxori një shishe të vogël që kishte brenda një tinkturë të errët e cila duhet të përdorej vetëm në raste ekstreme. Ai rrëkëlleu një gjysmë gllënjke dhe rrudhi hundën. Tinktura pati një shije të hidhur të keqe, por ai shpresoi të neutralizonte kundërmimin e neveritshëm. Hodhi një vështrim të fundit jashtë dritares, dhe më pas u mbështoll

me vendosmëri me pallton. Kishte qenë në këmbë për një kohë të gjatë; tani vetëm gjumi mund ta shëronte.

“Ora e gjumit,” tha Laurentius me vete.

Gjethet e mështeknës fëshfërinin në dyshekun e tij, duke lëshuar një erë pylli të njomë që mezi ndihej; me sa dukej sapo ishin zëvendësuar. Atij nuk i ishte dhënë rasti të flinte në dyshekë të tillë të mirë gjatë gjithë udhëtimit; zakonisht si dyshek kishte patur një çarçaf të hedhur sipër kashtës të shkelur me këmbë, të mykur. Hera e fundit që kishte fjetur në një dyshek me pupla kishte qenë para se të niste udhëtimin, kur ishte në pritje të largohej në shtëpinë e kumbarit të tij. Laurentius u mbledh kulaç në shtrat dhe ngjarjet e ditës që shkoi filluan t’i kujtohen. Imazhet i kaluan vetëtimthi përpara syve dhe pjesë bisedash i jehuan në vesh, të përziera me zërat në hollin e bujtinës. Ndërsa zërat dërdëllitës i vërtiteshin rreth kokës plaku që i kishte rrëmbyer kafazin u kthye tek ai orë e çast, dhe bashkë me të u kthye edhe grahma. Edhe pse e piu tinkturën, sërish i futej në vrimat e hundës. Laurentius mbylli sytë fort dhe e ngjeshi fytyrën më fort pas gjetheve të mështeknës, duke shpresuar që era e tyre e dlië do të largonte fëlliqësinë. U përpoq të përfytyronte një livadh vere të ngrohtë, një lirishtë në mes të pyllit e ndriçuar nga drita rrëzëllitëse e diellit, me gjelbërim të harlisur plot dritë rreth e rrotull. Ai mund të dëgjonte zogjtë të cicërinin dhe bletë të zukatnin. Qielli ishte ngjyrë bojëqielli e fortë dhe shumë lart, në shtresat më të larta të sferës së lagësht e cila ishte mbështjellë për qark planetit, mund të shiheshin nja dy re të gjata të verdha, duke e bërë kaltërsinë e paanë të kupës qiellore të duket edhe më lart. Ai u zhyt në barin fëshfërites dhe u shtri në pritje poshtë boshtit imagjinar të sferës së kaltër. Ai mund të ndjente erën e ëmbël të trëndafilave dhe aromën e fortë pyjore të trumzës. Ai pothuajse mund të shihte kozmosin dymbëdhjetë faqesh, qiellor, të kthjellët, dhe të pastër.

“Do të fle, e ndoshta do të ëndërroj,” pëshpëriti Laurentius me

vete. Por pastaj iu kujtuan sytë blu të çelët të plakut të rreckosur.

Kërcitja e shiut jashtë u bë më e fortë. Pika shiu rridhnin në xhamin e dritares; era buçiste si një zjarr në vatër; prej diku vinte një zhurmë kërcitjeje. Feneri i varur sipër derës jashtë filloi të lëkundet me forcë, lëvizja e saj e çrregullt hidhte një dritë opake që dridhej në muret e dhomës.

Laurentius ngriti kokën i alarmuar.

Një grahmë kalbësie vërshoi përmes të çarës së madhe midis kornizës së dritares dhe murit dhe madje as aroma e gjetheve fëshfëritë verore të mështeknës nuk ia hiqte dot nga hunda. Laurentius brofi në këmbë dhe pa jashtë me zemërim.

Një siluetë njeriu i veshur me mantel po qëndronte atje. Parë përmes barit të gjelbër të xhamit të dritares kishte një çehre të çuditshme, si kufomë, dhe flokët i kishte të ngjitura në fytyrën dhe shpatullat në tufa të errëta të ngatërruara.

Laurentius ia nguli sytë me tmerr. Krijesa kurrizo po qëndronte në buzë të rrethit të dritës të fenerit, atje jashtë në shiun e rrëmbyer, dhe nuk pyeste që buza e kapelës ishte bërë si pellg: uji ishte përthithur nga fijet ashpra të copës dhe po ngjitej me shpejtësi lart. Përmes ujit të shiut që rridhte në xhamin e dritares fytyra e siluetës ishte e dallgëzuar dhe të shformuar, gjë që e pengonte Laurentiusin të dallonte ndonjë shprehje të saj.

Pa u menduar për atë që bënte, ai kërcëu nga shtrati dhe kaloi me nxitim rrëmujën e hollit të bujtinës dhe doli nga porta kryesore e bujtinës. Por kur doli jashtë në shi fantazma ishte zhdukur, dhe madje edhe pasi u pllaqurit nëpër shi për njëfarë kohe në perimetrin e dritës së fenerit dhe errësirës, duke u përpjekur të gjejë vendin ku silueta kishte qëndruar, nuk mund të shihte as gjurmën më të vogël. Megjithatë, ishte i sigurt se dikush kishte qenë atje jashtë, duke qëndruar dhe duke parë me dëshirë të madhe në drejtim të bujtinës, nga dritat.

“Ej!” thirri dikush, dhe dera e bujtinës u hap tejprtej, duke përhapur një katror verbues dritë dhe ngrohtësie që vërshoi jashtë në oborrin me baltë.

“Po?” u përgjigj Laurentius.

“Mos të ka humbur gjë atje jashtë?” u dëgjua larg zëri i bujtinarit.

“Jo, isha duke parë nga dritarja dhe kujtova se pashë dikë të qëndronte këtu jashtë,” u përgjigj Laurentiusi, dhe filloi të kthehet drejt derës së bujtinës.

“Ahh... duhet të kenë qenë vendasit, Ka rënë shi gjithë verën, dhe tani sillen rreth shtëpive të të tjerëve të uritur. Shumë shpejt situata ka të ngjarë të bëhet edhe më e keqe për ta.”

“Por çfarë do të bëhet me ta?” pyeti Laurentius.

“Ç’do të thuash?” pyeti bujtinari, me sa duket duke mos e kuptuar pyetjen.

Por Laurentius vetëm tundi kokën dhe u fut përsëri brenda. Fundja, ai e dinte që njerëzit që vdesin urie, nuk janë ndonjë çudi e madhe. Tashmë ndodhte ngado.

Natë

PO VDES URIE; kam dhimbje në të gjithë trupin; kam një dhimbje koke shpuese. Mbështetem pas një peme bredhi për të pushuar. Degët e poshtme të holla më shpojnë, por të paktën degët e trasha mbajnë shumicën e shiut. Rrobat i kam të lagura qull; duhet të ndez zjarr, por ku mund ta bëj këtë me gjithë këtë shi? Për fat të mirë nuk më ka mbetur shumë rrugë. Thonë që në Dorpat të gjithëve u japin diçka për të ngrënë. Shumë njerëz kanë shkuar andej: vetëm dje takova dy vajza në rrugë, që po nxitonin të shkonin atje pothuajse me gëzim. Sikur të ishin nisur për të bërë famë. Sigurisht, nuk donin të merrnin me vete një babagysh si unë. Dhe kishin të drejtë: për mendimin tim, më mirë mos të më marrin për t'i bërë shoqëri. Më janë bërë këmbët copë. Jam aq i rritur sa të mos u besoj më atyre historive me ushqimin falas. Por këtë herë mund të ketë një grimë të vërtete. A do të më japin ndoshta diçka për të ngrënë atje? Pastaj gjithsesi, ka më shumë mundësi të mbijetoj në qytet se sa këtu jashtë në pyll. Nuk më kanë mundur ende, aha! Unë jam një burrë nga Ugandi, nuk na mundin dot kollaj ne burrave nga Ugandi! Po, s'e luan topi, do të pushoj pak, pastaj do të eci përpara.

Në verë dhe në fillim të vjeshtës, kur piqeshin pemëlat, do të ndreqesha, por meqë moti është ftohur, është bërë krejtësisht e pamundur. Pyjet janë bosh, më përplasnin derën ngado që shkoj,

më japin pak pije alkoolike sa të lag buzët.

Mund të dëgjoj degët të fëshfërijnë nga shkulumet e erës; uji i shiut po rrjedh curril poshtë jakës sime; këtu nuk mund të gjesh dot strehë. Atje tej në një kodër, ka një plevicë por nuk guxoj të shkoj atje. Gjatë luftës ushtarët e mbushnin plot me njerëz dhe i vinin flakën; shikuesit thoshin se shpirtrat e këqij fillonin të shkonin e vinin si shigjetë nëpër flakët, duke i marrë shpirtrat e njerëzve në ferr. Ushtarët i qëllonin shpirtrave, por nuk mund t'i lëndonin dot. Oh, të gjithë e dinë që vetëm një plumb i argjendtë mund t'i kapë ata. Por qysh atëherë, njerëzit kanë dëgjuar llototitje dhe kakaritje të vijnë nga ajo plevicë; thonë se shtrigat shkojnë atje që të bëjnë vallëzimet e tyre dhe i çojnë shpirtrat e njerëzve te Djalli. Nuk kam frikë nga ato shtriga plaka dhe plakushër; në të vërtetë nuk ka djaj atje lart. Megjithatë është më mirë t'i rrih larg asaj plevice, për çdo rast. E di që janë vetëm historira, ndoshta gënjeshtra, por këtu mund të ketë ndonjë grimë të vërtete. Ndonëse nuk e di me saktësi se ku, thjesht nuk mund të vësh dot gishtin.

Buzët më janë tharë; pështyj; mukusi më bie në mjekër dhe mbetet aty.

Dëgjoj trokëllimën e thundrave të kuajve, dikush po ua bën yja, pastaj dëgjohet një zhurmë përplasjeje. Qëndroj atje në muzg, dhe shoh ndërsa karroca ngadalë bie anash dhe çantat rrëzohen përtokë...

Fshih mjekrën me kurrizin e dorës. Kur ke qëndruar pa ngrënë për një kohë të gjatë fillon të shohësh lloj lloj gjërash të çuditshme: kam dëgjuar të thonë. Thonë që nuk duhet t'i besosh asgjëje prej këtyre, këto janë gjëra nga Djalli. Por kush e di? Kam parë gjithfarë gjërash. Njerëz që enden përçark me koka qensh, dhe ç'të duash ti. I sheh këto kur je i uritur. Por karroca atje tej duket madhështore: me ngjyra të ndezura, rrota të mëdha. Kush e di me siguri nëse është e vërtetë, apo duket

sikur është aty?

Po më dhemb koka; ka çanta të shpërndara në tokë gjithandej. M'u aty përpara meje është një lloj kafazi me tela. Brenda tij ndodhet një zog me ngjyra me pamje të çuditshme, i vogël dhe i dobët. Kam ditë të tëra që nuk ha asgjë dhe atë zog mund ta haja me një kafshatë. E ç' do të humbisja? Pa ta provoj njëherë. Hap derën e kafazit.

Një djalë me kapele me pamje të frikësuar më afrohet dhe pëshpërit diçka. Dëgjoj me vështirësi çfarë thotë.

“Çfarë kërkon?” ia kthej unë fjalën.

Ai pëshpërit diçka me zë të ulët, duket si ndonjë lloj shtrigërie. Më kap për supesh; sytë e tij janë të errët si dheu, i ndriqnë si thëngjij të ndezur dhe më sheh drejt e në sy. Unë dua ta heq shikimin, por s'mundem: ka re mjegulle dhe hije në vështrimin e tij të ngulët, dhe mbërthehem atje, i pambrojtur si një xixëllonjë. Mund ta ndjej atë të thithë shpirtin tim prej meje, sikur ta nxjerrë nëpërmjet një pipëze. Njësoj siç pija ujthin e mëshateknës kur isha i vogël. Po më dhemb koka, unë përpëlitem. Por pastaj më le të lirë.

“Ah!” bërtas, dhe filloj të vrapoj.

Nuk vë re që kafazi, burgu i thurur me tel, është ende në dorën time. Vrapoj, por këmbët më rëndojnë; shputat më zhyten në tokën e lagur dhe më rrëshqasin mbi bar. Vrapoj, pastaj pengohem në disa cungje druri, ndrydh këmbën dhe bie në tokë, m'u sipër diçkaje. Jam tepër i frikësuar të ngrihem, era gjëmon, uji i shiut kullon mbi mua dhe toka është e ftohtë dhe e lagësht. Jam shtrirë poshtë gjerbave të çatisë së plevicës; m'u pas meje ndodhet një mur i kalbur, trarë dhe qepra të nxirë ngrihen përpjetë nga të dyja anët, duke lëshuar ngjyrën e zezë mbi mua. Nuk guxoj të shkoj brenda. Do të jem mirë këtu ku jam. Është lagështirë, port ë paktën kam mbrojtje nga era. Përpiqem të dëgjoj hapa. Mund të dëgjoj barin të fëshfërijë

dhe të shkelet, dhe disa zëra që pëshpëritin lehtë. Duket sikur dikush po pëshpërit shumë pranë, mu në anën tjetër të murit. Pres. Mund të dëgjoj disa murmuritje dhe dënesje nga brenda plevicës. Mos janë shtrigat?

Kalon njëfarë kohe, dhe asgjë s'po ndodh. S'më bëhet vonë të më shohin apo të lëviz shumë, kështu që filloj të rrjep aty për aty puplat e zogut. Është një zog i vogël, jo më i madh se një harabel, por do të mjaftojë pa dyshim për një kafshatë të madhe. Mishi i tij është i butë; kockat janë të brishta: i thyej me dhëmbë.

Nxjerr me kujdes kokën te cepi i rrugës, dhe me sa duket karroca është zhdukur. A ishte vërtetë atje? Ndjej një pështjellim në stomak, pasuar nga një dhimbje therëse. Dreqi e mori, ai zog duhet të ishte i prishur. Ndoshta kishte kohë që kishte ngordhur. Mishi kishte një shije të mirë; të ëmbël; nuk kishte shije të neveritshme të prishur. Por tani më ka mbetur në gojë një shije thartësire dhe hidhësire, që më vjen nga stomaku. Si pelin.

Ndjej një dhimbje shtrënguese në bark, si ngërç. U hodha përpjete dhe mbajta me dorë stomakun. Mos kam qëndruar tepër gjatë pa ngrënë sa nuk më punojnë më zorrët? Disa ditë më parë më dhanë një kore buke dhe një gllënjë të madhe pije alkoolike në një bujtinë, prandaj mirë i kam punët. Por shtrëngimet më vazhdojnë. Jam kërrusur më dysh nga dhimbja. Përpiqem ta përmbaj, por diçka e hidhur si tëmth fillon të më ngjitet në fyt. Vjell në tokë pranë këmbëve të mia, dhe pastaj zogu me ngjyra të ndezura del nga goja ime, rreh krahët e tij, dhe ikën fluturimthi.

Dreqi e mori, më kanë bërë magji.

Ai burrë atje pas më bëri magji dhe shpirti im sapo doli duke fluturuar nga goja ime. Ç'lloj kafazi është ky? Ndoshta është bërë për të grumbulluar shpirtra: shpirtrat janë mbyllur brenda tij. Por nëse burri ishte Djalli vetë, si do të mund ta gjej

tani? Karroca nuk duket gjëkund, dhe së shpejti do të erret. Më duhet të lëviz.

Dëgjoj krikëllimën e derës që hapet, dhe zërat bëhen më të ngjirur.

Vras trurin por gjithçka është ende e ngatërruar. I tregoj grushtet plevicës, zbres kodrën dhe filloj të eci përgjatë rrugës. Tragat e rrotave janë të thella dhe plot me ujë të ftohtë. S'ka problem nëse janë nisur për Dorpat, edhe unë mund të shkoj atje. Kisha planifikuar të shkoja atje gjithsesi, një arsye më shumë nëse mund të mund të gjej përsëri shpirtin tim. Me siguri ai zog po e ndjek. Megjithatë mund të jetë shpirti i dikujt tjetër që unë sapo lëshova nga kafazi, ndoshta ishte shpirti i dikujt tjetër që sapo iku fluturimthi?

Shoh rrotull. Nuk duken korba gjëkund, as laraska bishtgjata, asnjë zog i vetëm që t'i bëjë rojë shpirtit tim. Çfarë ndodhi pak më parë? Koka më dhemb dhe më shpon; kam dhimbje shtrënguese në stomak. Eci më tej duke m'u marrë këmbët; rruga të çon teposhtë dhe pastaj kthehet, kalon përmes një pylli dhe mbërrin në një livadh. Nëpër shi arrij të shoh një lumë, që gjarpërohet dhe kthehet pranë grumbuj gëmushash, në të dyja anët e lumit ka shelgje të fortë me degë që varen. Po bëhet natë; tashmë është e vështirë të dallosh format e gjërave; gjithçka ka filluar të shkrihet në një. Atje tej, midis pemëve, mund të shoh një formë të errët. Duket si një shtëpi, e gjatë dhe e ulët si një qivuri. Atje kishin shkuar ata? Rrotull saj nuk duket asnjë shenjë jete njerëzore, as qen, as kuaj. As edhe një dritë e vetme që dridhet nga dritaret. Por Dorpat duhet të jetë pranë. Duhet të eci.

Mos është karroca e tyre ajo përpara shtëpisë? Kështu duket; fundja ata mund të kenë ndaluar atje. Ndoshta nga këtu ku jam nuk mund të shoh dritat në dritare. E vërtetë është se nëse do të ishin vonuar ata do të qëndronin në pensionin e parë

që do të gjenin, çfarë mund të bënin tjetër? Le të shohim pak më afër se ç'ka atje poshtë.

Vazhdoj të eci nëpër rrugën me baltë; era po vërshëllen dhe pëshpërit përmes telave të kafazit. Mos ndoshta ajo zhurmë vjen nga diku gjetkë? Kthej kokën prapa, ka pemë, shëlgje që kullojnë nga uji i shiut të shpërndara aty këtu. Por më duket sikur dikush po më vëzhgon nga prapa. Kthej kokën përsëri, dhe më duket se mund të dalloj atje tej një kurorë dhe një mantel. Fytyra të zbehtë, buzë të zbardhëta, të uritura pak të hapura sikur përpiqen të pëshpëritin ndonjë lloj paralajmërimi.

Por jo, nuk mund t'i besoj gjithçkaje që shoh. Më bëhen gjëra nga uria, thonë që janë vetëm vegullime, të cilave nuk duhet t'u kushtosh vëmendje. Përndryshe çmendesh, dëgjon zëra, vërtitesh rrotull dhe kafshon njerëz. Kam parë njerëz të tillë edhe më parë, njerëz që nuk mund të duronin më murinë dhe thjesht u dorëzuan.

Jo, ne jemi burra nga Ugandi: nuk na mundin dot kollaj. Duhet të vazhdoj rrugën.

E martë

LAURENTIUSI HAPI SYTË dhe qëndroi i shtrirë, duke ia ngulur sytë i përhumbur tavanit. Trarët kishin marrë ngjyrëkafë, pothuajse të zezë, nga tymi i qymyrit torfë nga vatra. Jashtë kaloi një karrocë dhe xhamat e dritareve u drodhën. Ai mund të dëgjonte ujin e shiut të kullonte nga gjerbat, dhe herë pas here një zë që bërtiste diçka në gjuhë estonishte të panjohur. Ishte mëngjes.

U ngrit ndenjur dhe kërkoi qorrazi në xhepin e gjoksit orën e tij; akrepi i saj i vetëm ishte midis pesës dhe gjashtës. I shtrirë pranë tij ishte një burrë me flokë të gjatë, me yndyrë, i mbështjellë fort me pallton e tij, që kundërmonte erë birrë bajate. Mos ndoshta kjo e zgjoi?

“Hmm...” murmuriti Laurentius me vete.

Dielli ende nuk kishte lindur dhe drita e mjegulluar para agimit po vagëllonte përmes xhamit të gjelbër të dritares. Zakonisht Laurentius nuk ngrihej kurrë kaq herët: dikush duhet të vinte ta zgjonte, dhe madje edhe atëherë bënte ç’është e mundur të vazhdonte të flinte. Kurrë nuk ia dilte mbanë të shkante të flinte në orën e duhur, dhe shpesh e kapte pagjumësia, por pasi binte në gjumë s’e kishte problem të flinte deri në drekë. Deri tani në jetën e tij ai nuk e kishte bërë disiplinë të zgjohesh çdo ditë në të njëjtën orë, gjithmonë do të varej nga rrethanat. Dhe ato rrethana prireshin të ndryshonin shumë shpesh.

I mërzhitur që kishte humbur të paktën një orë gjumë, Laurentius mbylli sytë dhe ra prapa në dyshekun fëshfëritës. Burri pranë tij vazhdoi të gërhasë për shtatë palë qejfe.

“I pashpresë.” Tani ndjehej plotësisht i zgjuar, plotësisht i çlodhur. Nxori nga xhepi orën dhe qëllimisht filloi ta kurdisë.

“Përse u zgjova kaq herët?” pyeti ai veten.

Filloi të ndjehet gjithnjë e më shumë i shqetësuar. Copëza ëndrrash filluan të depërtojnë sërish në vetëdijen e tij të kthjellët të mëngjesit. Kishte përshtypjen e paqartë që ishte zgjuar prej diçka që kishte parë në ëndërr, por nuk e mbante mend çfarë ishte. Nuk kishte qenë një zgjim i ngadaltë, gradual; kishte qenë më shumë sikur dikush e kishte zgjuar duke e tundur fort, sikur të vidhej në mes të rrugës. I pidentifikuar, dhe papritur.

“E pra,” murmuriti ai, ende i zhytur në mendime.

Në atë periudhë të shkurtër kur nuk po flinte por nuk ishte plotësisht i zgjuar, një siluetë e asaj që kishte parë duhet të ketë gjetur rrugën për të hyrë në kujtesën e tij. Ishte vetëm një kujtim i mjegull, por prapëseprapë i njohshëm. Si nëpër mjegull ai mund të shihte një figurë të qartë: një lumë dhe pemë.

“Pemë, gjethe me majë të mprehtë, trungje të fortë,” tha ai me vete. Filloi të kujtojë se midis atyre degëve dhe gjetheve kishte parë edhe një shtëpi. Një ndërtesë të errët, të ulët. Ai kishte qenë duke qëndruar në rrugën me baltë, në dritën e dobët, dhe kishte filluar të ecë, duke mbajtur në dorë kafazin e zogut. Atje tej qëndronte një mbret, me një kurorë të lartë dhe një mantel të madh të errët. Dhe kishte radhë të drejta të gjera me verri apo shelgje në të dy anët e rrugës.

“Kishte edhe diçka tjetër atje,” tha me vete Laurentiusi.

Pastaj ai kujtoi atë që e kishte munduar. Kur ishte ende në gjumë ishte përpjekur tmerrësisht të ngulë gjithçka në kujtesë, por kishte kuptuar se ishte ëndërr, dhe pastaj u zgjua.

Mori një penë pate dhe bojë nga sënduku i tij dhe shkroi me

nxitim në një fletë letre të bardhë. Një mbret, sheligje, një ndërtesë në formë qivuri. Ai e dinte nga përvojat e kaluara se pa patur një pikë refererimi ëndrrat e tij shumë shpejt do të harroheshin, madje edhe kujtimi i tyre nuk do të mbetej më. Fillimisht nja dy fjalë do të mjaftonin, më pas njeriu do të lejonte kujtesën bashkëshoqëruese të bënte punën e saj, sikurse ka shkruar edhe Aristoteli. Kishte shumë mundësi që njëfarë ngjarje në dukje palidhje do t'i mundësonte atij të kujtonte të gjithë ëndrrën, ose të paktën një pjesë të saj.

Ai palosi në dysh fletën e letrës, e futi përsëri në valixhen e tij, dhe qëndroi atje i pavendosur.

Imazhet po i vërtiteshin për qark në mendje, përshtypjet ndijore të ndërtesës, pemëve dhe ai kundërmim. Vetëm tani ai kuptoi se ai kundërmim i ditës së djeshme nuk kishte shkuar gjëkund, që kishte qenë pjesë e ëndrrës së tij. Ishte sikur të kishte depërtuar aq thellë brenda tij sa ishte bërë pjesë e tij, aq sa madje e kish harruar. Por pastaj në mënyrë të pashmangshme do ta kujtonte për praninë e tij, tamam si një ndjenjë faji për gjërat e papërfunduara, si brejtja dëshpërues e ndërjegjegies për krime të kryera pa dashje.

Ai tundi kokën, u ul në gjunjë pranë sendukut të tij dhe lexoi Psalmin e parë me vete:

“Ai do të jetë si një pemë, e mbjellë gjatë brigjeve të ujit, që jep frytin e tij në stinën e tij dhe të cilit gjethet nuk i fishken; dhe gjithçka bën do të ketë mbarësi.”

Ai u përpoq të përfytyronte ujërat që rridhnin dhe pemët frutore, por kjo nuk e ndihmoi aspak të qetësohej. Në vend të kësaj, në imagjinatën e tij shfaqeshin sheligje të hollë dhe të fortë dhe ujëra të errët, të ndotur.

“E pra,” tha ai duke ia dalë të mbërrijë në fund të Psalmit.

Vendosi të mos i japë rëndësi pemëve. Së pari do të shkonte të fliste me rektorin dhe të vendoste emrin e tij me studentët e tjerë në listën e regjistrimit. Ishte e rëndësishme të sigurohej që do ta merrte të plotë bursën: edhe me zemërgjerësinë e kumbarit të tij ai

nuk do t'ia dilte dot pa mbështetjen e shtetit.

Ai bëri nja dy hapa të shpejtë para prapa dhe praktikoi disa lëvizje skerme, duke u përpjekur të largojë kujtimet nga udhëtimi i djeshëm, plevica që kundërmon, sytë e plakut të rreckosur dhe ëndrrën e tij. U përkul mbi sëndukun e tij dhe kontrolloi rrobat e palosura me rregull. Ato ishin pothuajse të reja fringo, pa asnjë arnim në to. Për siguri, veshi çizmet e tij të gjata; më pas drejtoi mëngët e këmishës dhe rregulloi shaminë e gushës prej dantelle që t'i dukej sipër jakës së xhaketës. Gjatë udhëtimit ishte zverdhur pak, por ishte e pashmangshme. Laurentius nuk donte që rektori të mendonte se vinte nga familje e varfër, por nuk donte as të linte përshtypjen e një spitullaqi.

Pasi përfundoi së veshuri, u sigurua që shpata të krijonte një kënd të hijshëm me ijën e tij, dhe kaloi në hollin e bujtinës. Ai që flinte në një shtrat me të nuk kishte lëvizur asnjëherë që kur Laurentius ishte zgjuar, dhe e la të shtrirë atje.

“Kam ca punë në universitet,” i tha Laurentius bujtinarit.

Bujtinari buzëqeshi dhe shpjegoi me një ton pak begenisës që universiteti gjendej lehtë. Nuk ishte larg nga bujtina, dhe ishte pranë kishës së Shën Gjonit, të cilën dikush mund ta dallonte që nga larg prej kambanores së saj të veshur me metal. Kështu nëse Laurentius do të merrte drejtimin e kullës së kishës do të dilte me siguri tek akademia.

Laurentius ndoqi me përpikëri udhëzimet, dhe pasi mbërriti në vend zbuloi se ndërtesa e akademisë sapo kishte përfunduar kohët fundit dhe ishte vërtetë “sipas modës së fundit dhe mjaft luksoze,” tamam siç i kishte thënë bujtinari. Ndonëse në qytet kishte shtëpi të tjera të porsandërtuara, ndërtimet me gur përbënin pakicën dhe në disa vende trojet e mbytura nga barishtet dëshmonin për faktin se këto anë ishin rrënuar nga lufta vetëm njëzet vjet më parë. Por edhe nëse ende nuk ishte rindërtuar plotësisht, përshtypja e përgjithshëm që qyteti

të linte s' ishte e keqe. Rrugët ishin shtruar, dhe nga mënyra se si shtëpitë kishin vazo me lule dhe dritare xhami, mund të thoshe se njerëzit bënë një jetë të rehatshme. Ndërtesa e akademisë ishte e pastër dhe me dritë brenda, dhe hollitë ishin të gjerë dhe ishin të ndritshme dhe të këndshme.

Rektori i universitetit, profesor Below, e priti pothuajse menjëherë, u tregua miqësor dhe i gjindshëm gjatë gjithë bisedës. A madje i dha rëndësi edhe lavdërimit të bashkëkolegëve të tij profesorë, duke theksuar që ata nuk qëndronin aspak më poshtë atyre në Upsalë.

“Ku planifikon të jetosh? E pyeti më në fund profesor Below.

“Ende nuk kam gjetur një dhomë me qira. Shpresoja të merrja këshillë nga universiteti. Zakonisht, dikush nuk mund t' u besojë të zotërve të shtëpive në këto çështje.”

Below psherëtiu. “Jam i sigurt që jeni në dijeni se leksionet kanë filluar prej disa javësh, prandaj kemi të drejtën të mbajmë nga bursa juaj një shumë të përpjesëtuara. Për sa i përket këshillës, kam frikë se do të të duhet të ndash një dhomë me dikë tjetër. Situata e tanishme e dhomave të lëshuara me qira është shumë e keqe, ndonëse s' kam dyshim që në fund do të gjesh diçka.”

“Më falni, por udhëtimi doli më i vështirë se ç' e prisja. Deti ishte aq i stuhishëm sa asnjë anije nuk guxoi të shpalojë velat më parë. Ju e dini sigurisht se sa i keq është moti në shtator,” u përgjigj Laurentius.

Por ai nuk ishte i bindur nëse ky ishte një shkas mjaft i mirë. Dihej që deti në shtator ishte i trazuar, që do të thoshte se do të ishte veprim i zgjuar nga ana e tij të nisëj për udhë në gusht, e jo në tetor.

Profesori Below ngriti vetullat hutueshëm i habitur dhe pastaj u zhyt në letrat që Laurentius kishte paraqitur.

“Mirë pra, shoh se diplomën e parë e ka marrë në Leiden! Unë kam studiuar vetë në Holandë, është një vend i mrekullueshëm. Shumë mirë, le ta lëmë mënjatë tani për tani mbërritjen tënde me vonesë. Shko të takosh profesorin Dimberg; ai është profesori i matematikës dhe mund të vlerësojë nivelin tënd të gjuhës. Të tilla janë formalitetet këtu. S’besoj të jetë e nevojshme të bësh përsëri formalitetet e pranimit. Është një zakon shumë e pakëndshëm, gjithsesi.”

Laurentius tundi kokën pak përhumbshëm. Sistemi i shqyrtimit i universitetit kishte kohë që ishte ngritur, kur nxënësit që ishin pak më të mëdhenj se djem dhe të tjerë që kishin patur vështirësi në mësimet fillonin të vinin në universitet. Por ndoshta jo më shumë prej njohurisë së tij por prej gjasës që ai kishte qenë i detyruar të largohej nga Holanda për shkak të bindjeve të tij fetare, që tani përbënte problem. Situata në Holandë njihej si e favorshme për mendimin e lirë, dhe studentët që vinin prej andej ndonjëherë kishin bindjet më të çuditshme, nga ateizmi apo panteizmi deri te anabaptizmi dhe pietizmi. Gjithsesi, sipas politikës zyrtare suedeze, të gjitha besimet fetare të ndryshme nga Luteranizmi ortodoks ndaloheshin rreptësisht. Vetë mbreti jepte shembullin e tij nga kjo anë, duke cituar Biblën në gjykatë, dhe duke mbajtur një qëndrim të prerë lidhur me sektet e tjera.

“Unë i bëra tashmë formalitetet e pranimit,” tha me mirësjellje Laurentius, duke e shmangur çështjen e ardhjes me vonesë. “Nga kjo anë do të doja të kërkoja që të mos caktohem në asnjë grupim të veçantë kombëtar. S’besoj të kem ndonjë bashkatdhetar që studion këtu gjithsesi.”

Rektori e pa drejt e në sy haptaz i habitur. “Nga e dini? Gjithsesi, e kemi traditë që çdo student caktohet në një grupim kombëtar. Nuk shoh asnjë arsye përse duhet të bëj një përjashtim në rastin tuaj. Kështu do të marrësh edhe dhomë me qira.”

“Zoti më ndihmoftë,” u përkul deri në tokë Laurentius. “Unë jam një nënshtetas besnik i Madhërisë Sonë të Nderuar, por besnikëria ime më e lartë është ndaj sundimtarit të engjëjve dhe kryeengjëjve.”

“Hmm,” murmuriti rektori në mënyrë skeptike, dhe Laurentius iu bë sikur pa të shfaqet një buzëqeshje e lehtë në fytyrën e tij. Megjithatë së pari shko të takosh profesorin Dimberg; ai do të jetë pa dyshim i interesuar t’i dëgjojë bindjet e tua fetare. Le të shohim se ç’mund të bëjmë për dhomën me qira.”

“Unë jam një ithtar i kushtuar i Luteranizmit ortodoks: qëndrimi i Speneristëve ndaj Shkrimeve të Shenjta, dhe fetaria e jashtme janë teologjikisht të papranueshme për mua. E gjithë ajo mënyrë këndvështrimi është në kundërshtim me arsyen për të besuar në shpëtimin vetëm nëpërmjet besimit,” tha Laurentiusi, duke u përpjekur të largojë çdo dyshim lidhur me bindjet e tij teologjike.

“Ah, ashtu?” tha rektori, këtë herë me një buzëqeshje më se të dukshme, e cila madje u duk sikur shprehu një Schadenfreude të lehtë. “Pra ky është qëndrimi yt për këtë çështje. Shumë interesante.”

Laurentius buzëqeshi dhe tundi kokën. Ai nuk e dinte se ç’mendonin njerëzit për politikën suedeze fetare këtu në Dorpart, por ishte i sigurt që ata i zbatonin të paktën sa për formë. Gjithsesi ishte më mirë për të nëse do të përpiqej t’i shmangej çdo mosmarrëveshjeje dhe konflikti, madje edhe nëse këto ishin mes Pietistësh të cilët dikush kishte shumë të ngjarë të ndeshte pikëpamjet më moderne dhe liberale. Pietizmi po fitonte një popullaritet gjithnjë e më të gjerë mes studentësh, dhe po bëhej vazhdimisht shkas për ato lloj mosmarrëveshjesh në të cilat e kishin tërhequr me zor në Holandë. Grindje të tilla sa vinin e bëheshin më të nxehta, dhe sa hap e mbyll sytë dilnin

probleme të tjera më serioze. Bisedat e tij të pakujdesshme kishin qenë arsyeja që ai kishte ndërprerë studimet e tij në Leiden, dhe shpresonte që në Dorpart ende të mos ketë dalë fjala për të, sidomos duke marrë parasysh që rektori i tanishëm kishte studiuar në Holandë, ndonëse kjo mund të ishte një arsye e mirë që të mos i merrte të gjithë thashethemet si të vërteta. Në vendlindje, miqtë e kumbarit të tij Theodus e kishin këshilluar të shkonte në Dorpart për të vazhduar studimet. Ndonëse nuk flitej mirë për situatën e përgjithshme në universitet, shteti suedez ofronte bursa për të ardhur dhe për të studiuar këtu.

Dorpat njihej për zëniet e vazhdueshme midis studentëve dhe forcave të armatosura, për marrëdhëniet e tensionuara midis gjermanëve vendas dhe apartamenteve të tyre të shtrenjta me qira. Por pavarësisht të gjithë anëve negative, shumë poetë suedezë ushqenin bindjen se ishte një nga ambientet më të mira për të shkruar poezi, ndoshta pikërisht prej këtyre tensionimeve. Gjithsesi, ishte pa dyshim një pjesë periferike e bukur e botës.

“Nëse do të kishit mirësinë,” tha Laurentius, duke e nxitur profesorin duke ia bërë me shenjë me kokë.

“Ah po. Nëse do t’ia dalësh mbanë të përfundosh provimin nesër, atëherë shiko të vish edhe në banketin e së enjtes. Në këtë periudhë të vitit e kemi traditë të organizojmë një pritje të madhe për studentët, kështu duke marrë parasysh të gjitha gjërat ke ardhur në kohën e duhur.

Laurentius e falenderoi rektorin për ftesën. Toni i zërit të tij lehtësisht qesëndisë kur fliste për ardhjen me vonesë të Laurentiusit nuk e kishte shqetësuar atë, dhe duke marrë parasysh rrethanat ia kishte hedhur lehtë. Ai buzëqeshi, vuri përsëri në kokë kapelen, rregulloi shpatën që i varej nga ija dhe doli nga ndërtesa e universitetit. Jashtë, binte një shi i imët, dhe Laurentius ngriti sytë lart në qiell, duke shpresuar të shohë çfarë premtonte moti. Ditët ishin ende shumë të gjata, por për

ndonjë arsye dukej sikur ishte fundi i dhjetorit, atëherë kur dikush sheh shumë pak dritë dielli përpara se fillon të zhduket krejt. Sidoqoftë, binte ende shi, shkulumet e erës e lëshonin ujin curril nga gjethet e pemëve që rriteshin në rrugën e tatëpjetë jashtë ndërtesës së akademisë.

Në mëngjes rrebeshi dukej sikur do të qetësohej, por tani s'kishte fare shpresë për këtë. Laurentius tundi kokën me shqetësim.

Paraqitjen për provim ai e kishte nesër; tani gjëja më e rëndësishme ishte të gjente një dhomë me qira. Laurentius nuk ishte kundra mendimit të ndarjes së dhomës me dikë tjetër, dhe kjo do të ishte e volitshme edhe nga ana financiare. Por njerëzit kishin tendencën të ndanin dhomën me bashkatdhetarët e tyre, dhe ai s'besonte se do të gjente dikë nga anët e tij. Ai mund të rrinte me dikë nga Småland apo Skåne, por nuk mund të lidhej pas dikujt vetëm mbi bazë gjeografike. Jo sepse kishte diçka kundra idealit hiperborean të bashkimit kombëtar gotik; thjesht dukej diçka e rëndomtë të mburrësh me të kaluarën fisnike. Skandinavia ishte një rajon i ri, dhe ishte ende mjaft i pazhvilluar krahasuar me pjesën tjetër të Europës. Këtë s'mund ta ndryshonte as numri i madh i gjenealogjive imagjinare apo historive krenare të frymëzuara nga mitologjia.

“Toka e shtatë yjeve të veriut,” murmuriti Laurentius me vete.

Legjenda e yjeve që njihen si Arusha e Madhe, dhe fabulat për pushtimet e Teoderikut, udhëheqësit të Gothëve, në Perandorinë Romake ishin fantazuar për të zgjuar ndjenjën e krenarisë së tepruar të burrave të shtetit të shteteve nordike. Ata i mundësuan filozofëve mburravecë të ngjashëm me Rudbeckius të sjellin ide qesharake, si për shembull Suedia ishte Atlantida dhe se latinishtja dhe hebraishtja, e kishin prejardhjen nga gjuha suedeze. Edhe sikur të ekzistonte mundësia më e vogël që gjëra

si këto ishin të vërteta, Laurentius nuk u ndie aspak i tunduar të pajtohej me këtë lloj shovinizmi. Dhe të ndaje dhomën mund të çonte në vështirësi të tjera të padëshiruara.

Gjëja më me mend ishte të merrte një dhomë me qira vetëm.

Laurentius rregulloi kapelën dhe vështroi pak më tutje rrugën me baltë. Vuri re një të ri t'i kalonte pranë që ishte mbështjellë fort me mantelin e tij, dhe kishte pamjen e një studenti, dhe vendosi që t'i thërriste për t'i tërhequr vëmendjen. Pasi kishte dëgjuar që shumica e studentëve dhe profesorëve ishin suedishtfolëse, ai provoi të flasë suedisht. Siç pat thënë edhe Robert Burton në shkrimet e tij mbi depresionin fetar: kur je në Romë, bëj si romakët.

“Përshëndetje, or mik. Jam një i porsaardhur në qytet dhe do të doja të merrja një dhomë me qira. Sapo jam regjistruar në universitet. S'besoj se mund të më këshillonit diçka, apo jo?”

Kalimtari e pa drejt e në sy dhe u përgjigj, me një theks të rëndë por përveç kësaj fliste me një suedishte të saktë. Nuk ke dëgjuar që po planifikojmë ta zhvendosin universitetin në Pärnu? S'ka përse të vendosesh këtu. Gjithsesi, qiratë kanë shkuar në qiell dhe pas verës së shpifur çmimi i ushqimeve gjithashtu është rritur shumë.

“Po e di. Por kështu është bërë ngado tani. Situata është vështirësuar gjithandej,” duke kaluar rrjedhshëm në gjermanisht dhe duke u përpjekur gjatë gjithë kohës t'i shmangej vështrimit të tij bashkëbisedues.

“Ah, pra qenke gjerman. Nga cila trevë?” ngriti zërin i riu, me një ton më miqësor.

“Në fakt nuk jam gjerman. Por jam një nënshtetas besnik i Madhësisë së Tij. Vërtet do të fillojnë ta zhvendosin universitetin në mes të semestrit?” pyeti Laurentius.

“Sigurisht që jo. Por sapo ka mbërritur një delegacion nga Pärnu, ku është diskutuar çështja. Thuhet se kanë rënë dakord me Zëvendës Rektorin Fischer që universiteti do të transferohet sapo

të bëhen gati ndërtesat. Ndoshta në fund të pushimeve verore,” i shpjegoi me padurim i riu. Me sa duket kohët e fundit kishte dëgjua ca thashetheme mbi këtë temë dhe tani po përpiqej ta bënte sa më reale gjasën e lumtur dhe emocionuese duke ia përcjellë të tjerëve.

“Atëherë ka logjikë që unë të marr dhomën me qira të paktën deri atëherë,” tha Laurentiusi.

Studenti tundi kokën, duke u dukur disi i zhgënjyer. “Epo, them se po.”

Mesditë e së martës

KUR LAURENTIUS u kthye përsëri në bujtinë jashtë ngëlonte një turmë njerëzish, dhe mund të dëgjonte dikë që shante me zë të lartë në estonisht. Tani ai kishte mësuar të dallonte kur vendasit shanin: e folura e rrjedhshme bëhej pak e ashpër dhe e palidhur, dhe rrokjet dilnin me zhurmë dhe tingull gërvishtës.

“*Kurat!*” bërtiti dikush.

Erdhën dy burra dhe ngritën diçka që dukej si një kufomë e mbuluar me çarçaf dhe e futën në një karrocë dore. Filluan ta shtynin karrocën e dorës duke kaluar mbi pellgje drejt qendrës së qytetit, duke çarë me bërryla rrugën përmes turmës. Trupi i lëshuar po lëkundej në bazamentin e karrocës së dorës dhe Laurentiusi mund të shihte këmbë të dobëta, lakuriqe, dhe parakrahë të hollë dhe të gjatë të dellëzuar që dilnin nga çarçafi i lagësht, i rrecksosur. Bëri kryqin në mënyrë instinktive, u kthye, dhe hapi rrugën me të shtyra përmes shikuesve në drejtim të derës së bujtinës. Era po përhapte një kundërmim të keq nga diku, drejt e në vrimat e tij të hundës. Pasi Laurentius u fut brenda, bujtinari e përshëndeti me një tundje të përciptë të kokës për t’u kthyer përsëri te dritarja që vazhdonte të shihte si guhak çfarë po ndodhte jashtë.

“Nuk do të përfundojë me kaq,” tha ai, duke parë nga dritarja e ngushtë.

“Çfarë ndodhi?” pyeti Laurentius.

“Nuk e di saktësisht. Këtu çdo ditë del ndonjë telash i ri.”

Bujtinari filloi të tregonte çfarë dinte, qartazi duke e shijuar mundësinë. “Me sa duket njëfarë rreckamani po vraponte andej këndeje si i marrë, duke kafshuar njerëz. Disa njerëz thanë se do ta kishte patur nga uria, të tjerë menduan se ishte çmendur. Në fund nuk kishte rrugë tjetër përveçse të merrnin ndihmësin e lëkurëpunuesit për t’i dhënë një dackë me shkopin e tij. Ndonëse jo shumë fort, por gjithsesi një goditje të mirë. Ai djalosh ishte mjaft i fortë, ndonëse nuk është shumë i zgjuar. Por gjithsesi, me sa duket ai e la të vdekur kallkan, koka e plakut është mbuluar nga gjaku dhe ai rri i ngrirë.”

Laurentius u ngrit dhe dëgjoi se çfarë po i thoshte bujtinari, duke u shqetësuar gjithnjë e më shumë. “Atëherë çfarë mendojnë të bëjnë tani?”

“Ndoshta do ta çojnë djalin në burg garnizoni, dhe do t’i duhet të dalë në gjyq. Njerëzit e panë ç’ndodhi. Ishte shumë e qartë që ai nuk e bëri me qëllim. Por të vrasësh dikë s’është shaka. Ndoshta do t’i sulen keq.”

Laurentius tundi kokën. “Bëj mirë të largohem prej këtej, mund të ma dërgosh përpara sëndukun tim?”

“Ku të ta dërgoj?” pyeti bujtinari me gatishmëri.

“Kishte një dhomë të lirë në atë shtëpinë Fendrius; ma sugjeroi një student të provoj të shkoj atje. Duket se ka kushte të mira.”

Johannes, studenti që Laurentius kishte takuar, e kishte adresuar te shtëpia e fundit prej guri në Rrugën Cloister, ku kishte një dhomë të lirë në katin e dytë. Doli që ishte mjaft e shtrenjtë por me sa dukej ai nuk kishte zgjedhje tjetër. Johannes i kishte thënë që qiraxhiu i mëparshëm kishte dalë prej saj vetëm disa ditë më parë pas një skandali dhe e kishte këshilluar gjithashtu se vendet e mira nuk gjenden lehtë. Një ushtar apo ndonjë student tjetër mund të ta rrëmbejë menjëherë. Në përgjithësi, vendasit parapëlqenin të merrnin studentë si qiraxhinj, dhe madje ndonjëherë do t’u ofronin qira më të lirë. Ushtarët nxirrnin gjithmonë telashe,

ndonëse as studentët nuk ishin engjëj. Gjithsesi, Laurentius duhet të vepronte shpejt.

“Aha,” ishte gjithçka që Laurentius arriti të thotë si reagim ndaj historisë së Johannes, e cila u duk sikur binte erë thashetheme.

Ai kishte buzëqeshur sapo e kishte parë dhomën e vogël. Mobilimi përbëhej vetëm nga një tryezë shkrimi, një raft me pamje të brishtë të mbështetur në njërin prej mureve dhe një shtrat. Por dukej të ishte një vend mjaft i këndshëm dhe i rehatshëm, madje kishte edhe një vatër të vogël në fund të oxhakut.

“Sa pamje të bukur keni këtu,” i kishte thënë ai pronares.

Me muret e saj të lyer me të bardhë, me dyshemënë me dërrasë të fërkuar me sapun, dhe dritaren e vogël me pamje nga muri i qytetit dhe përballë hapësirës së gjerë të ulët të kullotave të gjelbra, dhoma kishte një atmosferë familjare. Laurentius kishte pranuar menjëherë të merrte dhomën me qira deri në fund të semestrit, dhe i tha pronares që do të hynte po atë ditë, pasi të merrte gjërat e tij nga bujtina. Ajo kishte tundur kokën me miratim dhe i kishte premtuar që do t’ia shpjegonte kur të kthehej rregullat e shtëpisë.

Laurentius ishte larguar me një përshtypje të mirë; madje edhe moti ishte hapur. Por iu prish humori menjëherë kur pa turmën e njerëzve të mbledhur përpara bujtinës. Ai kishte patur një parandjenjë sapo kishte parë shikuesit kureshtarë që ishin mbledhur, veshur me jelekët e lëkurës tradicionale ngjyrë gri. Por ai pa plakun me rrobat e tij të grisura, këmbët e tij të gjata e të holla të shtrira sa gjatë e gjerë në bazamentin e lagur të karrocës së dorë, parandjenjat e tij u kthyen në një bindje të fortë që diçka nuk shkonte.

Bujtinari thjesht qëndroi i ulur galiç, duke parë jashtë dritares, ndërsa Laurentius mblodhi me nxitim gjërat e tij. Ai

nuk donte të qëndronte më gjatë aq afër më shumë se sa ishte absolutisht e nevojshme.

“Sa ju detyrohem?” e pyeti Laurentius bujtinarin.

“Me ç’monedhë do të paguash?” u përgjigj bujtinari.

Laurentius nxori nga çanta llojshmëri monedhash dhe i hodhi në pëllëmbë të dorës, ndërsa bujtinari i pa me vëmendje të madhe për të çmuar vlerën e tyre.

“E pra, le t’i hedhim një sy,” tha ai, dhe me një lëvizje të shkathët të gishtave, pickoi nga dora e Laurentiusit nja dy monedha. “Le të themi kaq? Në rregull?”

Laurentius ende nuk ishte i sigurt për vlerën e monedhës vendase apo për çmimin e saktë të gjërave, prandaj vendosi të mos e vinte në diskutim llogarinë që kishte bërë bujtinari. Dukej pak a shumë e saktë.

“Në rregull. Faleminderit,” i tha ai bujtinarit.

Sapo doli jashtë, dy ushtarë me pamje serioze, mbërritën përpara bujtinës. Ata shkuan drejt e tek ndihmësi i lëkurëpunuesit. E ndalën duke i vënë dorën në secilin sup. Laurentius priti në hyrje, duke zgjatur dorën instinktivisht te shpata që i varej nga ija, ndërsa turma e njerëzve u trazua dhe filloi të zmbrapset.

“Ç’drejtin bëhet?!” protestoi dikush me zë të ngjirur.

Duke gjykuar nga përparësja e bollshme me erë të rëndë që kishte veshur, kishte mundësi të ishte lëkurë punuesi. Ai bëri dy hapa në drejtim të ushtarëve, pastaj ndaloi në vend, si i humbur në mendime. “Le ta marrin, atëherë! Unë s’kam ç’të bëj,” tha ai më në fund.

Pastaj iu kthye ndihmësit. “Ti idiot! Përse e godite aq fort?” i bërtiti ai.

Ndihmësi e pa syshqyer. “Nuk e di çfarë ndodhi. Nuk desha ta vras. Por sapo mora shkopin në dorë m’u duk sikur më kishin bërë magji. Të tjerët që ndodhen këtu mund ta kuptojnë se ai

ishite një lloj shtrigani, i lidhur me djaj. Përfundimisht diçka nuk shkonte me të.”

Një murmurimë pajtimi u ngrit në turmë, më pas dikush erdhi me vrap duke mbajtur në dorë një kafaz me tela. Laurentiusit iu duk i njohur, por nuk mund ta shihte më nga afër prej të gjithë njerëzve të zhurmshëm.

“Ai kishte këtë gjënë me vete. Duket si një send magjie i dyshimtë,” tha triumfalisht burri që e gjeti.

“Çfarë po thua? Është kafaz zogu,” tha lëkurëpunuesi prerë.

“Po si kishte arritur rreckamani ta shtjerë në dorë? Këto gjëra nuk i gjen përtokë dhe i merr, ai me siguri kishte planifikuar ta përdorte për ndonjë lloj magjie,” u përgjigj burri.

Zhurma e turmës sa vinte dhe bëhej më e madhe, ushtarët filluan të duken të shqetësuar.

“Nuk ka asgjë për të parë. Ky do të vijë me ne. Qetësohuni të gjithë,” e urdhëroi prerë turmën njëri nga ushtarët ndërsa largonte tutje ndihmësin e lëkurëpunuesit. I nxitur nga shfaqja e iniciativës e kolegut të tij, ushtari tjetërën e mbërtheu nga jaka ndihmësin, dhe i dha një dackë në stomak me millin e shpatës. Ndhimësi nxori një zhurmë gromësime të dhembshme, por u duk më shumë i mërzhitur se sa i lënduar fizikisht. Për një farë kohe pa rrotull me një shprehje të dëshpëruar, të padjallëzuar, ndonëse e kuptoi qartë që nuk kishte rrugë tjetër veçse ta merrnin ushtarët.

Ndërsa ata largoheshin Lëkurëpunuesi vazhdoi të lëshojë rrëkenë e të sharave nga pas. “Le ta marrin, pra. Ç’ të bëj unë? Gjithsesi punë s’ kemi shumë. Le të hajë të paktën ndihmësi për ca kohë nga buka e mbretit. Fundja, atje nuk do ta lënë të vdesë urie. Shumë nga gjithë sa janë këtu do të futeshin me gjithë qejf për ca kohë në qeli.

Duke qenë me sa duket i vendosur ta mbyllë me një notë optimiste ai qëndroi duke parë përçark me luftëdashje, dhe në

atë pikë vuri re Laurentiusin, i cili po përpiquej me kujdes të shihte nëse kafazi ishte i tij apo jo. Ai tashmë ishte i bindur që rreckamani në karrocën e dorës ishte i njëjti që i kishte rrëmbyer atje lart pranë plevicës.

“Ai kafaz është përfundimisht një lloj sendi magjie,” i tha lëkurëpunuesi Laurentiusit, duke u shtyrë më pranë tij. “Nuk e di për ç’lloj magjie përdoret, por sigurisht asgjë e mirë s’të vjen prej saj. Pa shihe vetë.”

Ai ia ngjeshi në dorë Laurentiusit kafazin, në rast se do të kishte ndonjë dyshim lidhur me çfarë donte që ai të bënte.

“Atëherë, hidhi një sy!” i tha lëkurëpunuesi.

Një grahamë mbytëse vinte nga burri, aq e fortë sa atij i vinte për të vjellë. Vinte nga oturakët e urinës në të cilët lëkurëpunuesit njomnin lëkurët ditë për ditë, ato kundërmonin aq shumë sa u desh që punisitet të vendoseshin jashtë mureve të qytetit. Por Laurentius edhe grahamën e lëkurëpunuesit mund ta duronte më shumë se kundërmimi nga atje lart pranë plevicës, i cili ende po i shtillej në vrimat e hundës.

“Por më parë thatë që ishte thjesht një kafaz zogu,” kundërshtoi Laurentius, duke u përpjekur të krijonte përshtypjen që sapo e kishte parë për herë të parë, ndonëse sigurisht e kishte bërë vetë dhe e kishte sjellë me vete prej matanë detit, kështu që e njihte mirë. Ai vuri re që dera ishte ishte shtrembëruar në njërën anë pa kujdes dhe kishte nevojë të rregullohej.

Lëkurëpunuesi e vështroi nga koka në këmbë. “Duhet të jesh i porsaardhur në qytet.”

“Po,” pohoi Laurentius. “Jam student. Sapo kam ardhur.”

“Po të paralajmëroj që këtu bëjnë lloj lloj magjish. Vetëm kohët e fundit djali i pronarit të shtypshkronjës Brendeken i bënë një magji kaq të keqe sa filluar t’i rriten qime në qafë dhe në fytyrë, dhe në fund përfundoi i vdekur,” i përrallisi lëkurëpunuesi. Ndoshta e di shumë mirë se magjia është kthyer

në shqetësim të madh kudo tani. Kush e di kush është viktima e radhës, madje edhe kafshët.”

“Po, ç’lidhje ka ky kafaz me të?” pyeti Laurentius, duke mos pranuar të dalë nga tema.

“Epo atyre shtrigave u vijnë nga pas gjithfarëlloj krijesash të çuditshme. Korba dhe sorra, edhe ata lloje zogjsh të huaj. I mbajnë me vete në kafaze. Kam parë ilustrimet në libra, shtrigat mbajnë gjithnjë me vete ndonjë lloj kafshe. Buburrecë, merimanga, bretkosa dhe të tjera si këto. Djali i Brendeken i hodhi një grusht ujë lopës së Madlen-ës, dhe lopa filloi të shajë në estonisht. Aty për aty filluan t’i rriten qime; ia shkulinin tufa tufa por s’mundën ta shpëtojnë dot.”

“Por ajo ishte lopë,” tha Laurentius, me shpresë që lëkurëpunuesi do të kuptonte se lopa nuk është një kafshë e përshtatshme për një shtrigë.

“Çdo shtrigë mban me vete ndonjë lloj kafshe,” tha lëkurëpunuesi, duke u nxehur. “Qoftë lopë apo korbë, nuk ka shumë rëndësi.”

“Në fakt, ka. Në përgjithësi shtrigat mendohet se shoqërohen kafshë nate,” argumentoi Laurentius.

“Unë e di ç’është lopa. Ato kanë brirë, shiko kafkat e tyre. Janë me brirë!” këmbënguli lëkurëpunuesi.

Laurentius vendosi që mund të dukej e dyshimtë të përpiquej aq fort për të fituar një debat. Do të ishte më mirë të mos tërhiqte shumë vëmendje. Nëse do të merrej vesh që kafazi i përkiste atij atëherë do të futej në shumë telashe.

“Zakonisht, po,” tha ai, duke u pajtuar me lëkurëpunuesin.

“Ja pra,” tha lëkurëpunuesi me një ton zëri fitimtar. “Ç’të thashë? Dhe fakti që ky plak po kafshonte njerëz tregon aq më mirë se atë e mundonin demonë. Ata e detyrojnë të pushtuarin nga djalli të hajë mish njeriu, dhe të bëjë lloj lloj gjërash të tjera të neveritshme. Ta them unë, djali bëri mirë që e la të vdekur në

vend. Ai i kurseu kohë dhe mundim gjykatës.”

Laurentius nuk dinte si t’i përgjigjej kësaj. Ishte i sigurt se nëse do të shpjegonte se si rreckamani ia kishte mbathur me kafazin e tij kjo nuk do ta ndihmonte aspak ndihmësin e lëkurëpunuesit. Mund ta përkeqësonte edhe më shumë situatën, nëse ata do të pretendonin që plaku ishte i çmendur, dhe e mundonin shpirtrat e këqij atëherë ndihmësi do të kishte më shumë mundësi t’i shpëtonte litarit.

“Teologët në përgjithësi janë të mendimit se shumica e rasteve të magjisë së zezë janë thjesht rezultat i keqkuptimit. Dikush duhet të bëjë hetime të hollësishme përpara se të akuzojë dikë që ka lidhje me demonë,” shpjegoi Laurentius, duke u përpjekur ta njohë lëkurëpunuesin me shpjegimin fetar të magjisë së zezë. “Shpesh njerëzit në mënyrë të gabuar mendojnë se janë shtriga apo shtriganë: iluzione të tilla mund të ndodhin shumë shpesh. Njerëzit pretendojnë se shohin djaj dhe demonë, por në fakt s’është veçse një dhi apo ndonjë kafshë tjetër shtëpiake e fshehur pas një gëmushe. Zakonisht gjithçka mund të shpjegohet me besëtytninë.”

“Mos po përpiqesh të thuash se plaku s’ishte i magjepsur? Përpiqu pak të mendohesh vetë, pastaj mund nxjerrësh përfundimet e duhura. Ata teologë nuk dinë asgjë fare. Unë di vetë ta ndaj shapin nga sheqeri. Sikurse thonë, unë u besoj syve të mi. Për këtë nuk duhet shkollë,” tha lëkurëpunuesi, duke treguar besim të patundur në zgjuarsinë e tij të lindur. “Gjithë ata të marrë në universitet janë bërë budallenj nga të studiuarit, të gjithë e dinë këtë.

Laurentius buzëqeshi trishtueshëm dhe u kthye e iku. S’kishte kuptim të hahej me lëkurëpunuesin. Tipa si ai, gjithmonë të sigurt që kanë të drejtë, madje as teologët dhe filozofët s’mund t’ua ndryshojnë dot mendjen. Ata e dinin ç’do të thoshte të shikoje diçka me sytë e tu, dhe kjo u dha atyre

siguri absolute. Ata kishin bindjen se i gjithë informacioni që marrin nëpërmjet organeve ndijore nuk ishte as më pak e as më shumë se e vërteta absolute. Laurentius nga ana tjetër nuk ishte ndonjë përkrahës i filozofisë Karteziane, por duhet të pajtohej me francezin e mendimit të lirë që janë shqisat ato mbi gjithçka tjetër që na shpërudhin dhe na bëjnë që të shpërudhim të tjerët. Kjo ishte sigurisht një e vërtetë e pranuar, të cilën Skeptikët e Lashtësisë e kanë rrahur në kohën e tyre. Laurentius e dinte se duhet të kishte parasysh gjithmonë se shqisat mund të na gënjejnë, se ato na bëjnë të shohim fantazma. Ndoshta kjo ishte arsyeja përse Dekarti ishte përpjekur aq fort t'i përmbahej metodës shkencore, të përjashtonte nocionet me imagjinatë, të synonte klasifikimin e qartë dhe të pastër të koncepteve. Shqisat ishin vendi ku përvidheshin fantazmat.

Laurentius vazhdoi të ecë, duke mos kuptuar që nga forca e zakonit kishte marrë kafazin dhe po e tërhiqte me vete.

Mbrëmja e së martës

LAURENTIUSTASHMË EKISHTEVËNËRE oshtimën
Le lehtë në veshët e tij ndërsa largohej nga bujtina. Ishte një tingull i thellë që membrana e tij e dëgjimit mezi e kapte; ishte më tepër një ndjesi e paqartë diku pas kokës së tij, sikur dikush po i frynte në zverk: një rrahje e thellë njëkohësisht me pulsimin e gjakut nëpër vena. Atij i gumëzhinë veshët, fillimisht jo shumë, pastaj vazhdimisht, derisa gumëzhitja dhe fryma e huaj kaloi në kokërdhokët e syve dhe prej andej në tru. Kështu i fillonin gjithnjë ethet Laurentiusit.

Në fund të vitit të tij të dytë në Leiden ai kishte shkruar një diskutim rreth temës së sëmundjeve që hynin në trupat e njerëzve duke përshkuar organet e tyre ndijore. Disa prej tyre futeshin nëpërmjet syve, të tjera nëpërmjet veshëve, gojës, hundës, apo pjesëve të ndjeshme të lëkurës. Kur trupi ekspozohet ndaj të ftohtit apo lagështirës së tepërt, bajamet do të ishin të parët që e shfaqnin, duke u zmadhuar. Prej fryrjes së bajameve dhe përhapja e sëmundjeve në zonën përreth tyre veshët dhembnin. Llojet e sëmundjes që hynin nëpërmjet hapjes së gojës apo vrimave të hundës kishin tendencës të stimulonin ato organe. Prej andej, infeksioni mund të arrinte në shpirtrat e njerëzve. Laurentius ishte mjaft i sigurt kur kishte çekuilibruar lëngjet e trupit të tij. Ka shumë të ngjarë të kishte ndodhur kur ai ndihmoi për të nxjerrë karrocën nga balta dhe kishte

humbur kafazin me tela të Klodias. Atëherë lagështira e keqe kishte hyrë në shpirtin e tij. Kishte ardhur nga mjedisi rrethues i lagur, i kalbur, nga plevica e nxirë, nga pellgjet, sytë e kaltër të rreckamanit dhe avulli që ai kishte nxjerrë nga goja, dhe tani trupi i tij po përpiquej ta eliminonte. Të paktën, shpresonte që ishte sëmurrur prej të ftohtit dhe lagështirës, dhe jo prej diçkaje tjetër.

Buzëqeshi me trishtim.

Grahma që kishte ndjerë fillimisht atje në plevicë akoma i shtillej në vrimat e hundës, një grahmë e rëndë, e hidhur. Por tani ajo kishte zënë vend edhe në organet e tij të brendshme, si një lloj kalbëzimi. Myku i bardhë në sipërfaqeje ishte vetëm një shenjë e jashtme e pranisë së saj; forca e vërtetë shkatërruese ishte në rrënjët e përdredhura poshtë, të cilat kishin depërtuar aq thellë sa edhe marangozi më i zoti nuk do t'i hiqte dot tërësisht. Vetëm zjarri mund të shkatërronte mykun, ashtu si vetëm ethet mund të shkatërrojnë sëmundjen. Shpesh e gjithë shtëpia duhet të digjej për ta ç'rrënjosur, dhe Laurentius frikej se kjo do të ishte mënyra e vetme edhe me të. Kalbëzimi i sëmundjes së tij, të cilën e kishte mbartur brenda tij që nga fëmijëria, nuk do të largohej prej tij derisa trupi t'i digjej. Ose nga ethet, ose nga djegia në turrën e druve. S'mbahej mend që kur kishte kërkuar një ilaç për sëmundjen e tij, por më kot.

Ai kishte patur marramendjen e parë, nga e cila i shkuan valë të nxehta e të ftohta në të gjithë trupin, sapo kishte kaluar Portën Gjermane dhe mbërriti brenda mureve të qytetit. Duke u mbështjellë edhe më fort me pallton e tij, ai kishte nxitur të shkonte në dhomën e tij me qira. Pronarja e kishte përshëndetur me gëzim kur ishin takuar në katin e parë, por kur ajo vërejtë kafazin e pisët, të shtrembëruar që mbante në dorë e kishte parë shtrembër.

“Pra qenke kthyer. Çfarë do të parapëlqeje? Të ta sjell

ushqimin në dhomë?” e pyeti pronarja. Laurentius u përkul shpejt deri në tokë. “Falemnderit, por jo tani.”

Jam ende i lodhur nga udhëtimi. Do të doja të pushoja pak.” Pronarja pohoi me kokë dhe filloi t’i shpjegojë me hollësi kushtet e qiramarrjes dhe se si kërkonte ajo t’i mirëmbahej shtëpia. Por të gjitha rregullat i hynë në njërin vesh dhe i kaluan në tjetrin ndërsa ai qëndronte i pavëmendshëm, duke përqaftuar kafazin. E vetmja hollësi që arriti të kapë ishte se duhet të siguronte vetë kashtën dhe shtresat e krevatit. Dhe kishte arritur të kuptojë vetëm pak rregullën që kishte theksuar pronarja se qiraxhinjtë mund të përdornin vetëm shkallën e shërbimit. Ai sa vinte dhe ndjehej gjithnjë e më keq.

“Falemnderit,” i tha pronares, u kthye dhe u largua. “Kam kërkuar të ma sjellin këtu nga bujtina sëndukun tim. Personi do të vijë pas pak, por tani dua të shkoj në dhomën time.”

Pronarja u duk sikur e pa me shqetësim dhe shpëlqim, por tha mirupafshim me mirësjellje dhe mbylli derën.

Laurentius mezi u ngjiti lart dhe u këput në anë të krevatit, i gjithë trupi iu duk çuditërisht i rëndë, dhe këmbët brenda çizmeve i kishte zënë ngërçi. Nuk ishte hera e parë që sëmurej jashtë shtetit. Siç edhe paralajmëronin manualët mjekësorë një nga rreziqet më të rëndomtë ishte të sëmururit. Nëse trupi i njeriut ishte mësuar me një ambient të caktuar dhe e kishte përshtatur ekuilibrin e lëngjeve sipas tij, atëherë ndryshimi i shpejtë mund ta destabilizonte fizikisht, dhe do të shfaqej në formën e sëmundjes apo etheve. Prandaj këshillohej të bëheshin ndalesa të shpeshta dhe të shmangej bërja e largësive të mëdha në një ditë të vetme. Laurentius nuk ishte i sigurt nëse kishte përshkuar largësi tepër të mëdha, por ishte e qartë se njerëzit ishin më të prekshëm ndërsa udhëtonin, dhe kjo ndodhte nëse u mungonte forca e duhur shpirtërore, atëherë sëmundja mund t’i zinte lehtë. Paraketi i tij kishte qenë forca e tij shpirtërore.

“Mmm...” murmuriti Laurentius me vete.

Mbylli sytë dhe u përpoq të përquendrohej te diçka më e qartë dhe e kuptueshme. Por përsëri nuk e zinte dot gjumi. E dinte mirë se nëse një njeri i sëmurë i linte mendimet e tij të hallakateshin, rezultati mund të ishte i tmerrshëm dhe i pakëndshëm. Ai duhet të priste pak më gjatë. Pasi t’i kishin dërguar valixhen e tij, pastaj mund të flinte. Dhe të ëndërronte ndoshta.

Tundi kokën dhe u përpoq të dallonte çfarë kishte jashtë dritares.

Fragmente mendimesh nga udhëtimi i tij dhe mbërritja në Dorpart i vinin vërdallë në mendje, të shkëputura, të rrëmujshme. Disa prej tyre i kalonin në mendje si re të rënda fantazmagorike që shtillen në qiell. Të tjera i vinin dhe shkonin më shpejt, si zogj që kalojnë fluturimthi pranë dritares. U përpoq të mendonte për paraketin e tij, por në vend të Klodias së tij me cicërimë optimiste, i doli përpara imazhi i plakut me flokët e tij të errët që i kullojnë. Qëndronte i shtrirë në karrocën e dorës, me kokën e çarë.

Dikush trokiti në derë, dhe ai u zgjua menjëherë i trembur. Kaloi një copë herë përpara se të kujtohej ku ishte. U ngrit në këmbë me njëfarë vështirësie, dhe u rregullua me nxitim për t’u dukur mirë.

“Hyr,” tha Laurentius, duke u përpjekur ta bënte zërin të dukej sa më normal.

Hynë dy burra dhe, pa thënë asnjë fjalë, e vendosën sëndukun e tij pranë derës. Njëri prej tyre i zgjati dorën drejt Laurentiusit. Siç kishte bërë në Reval, kërkoi qorrazi në kuletën e tij dhe gjeti një monedhë të vogël. Hamejtë tundën kokën dhe u larguan në heshtje ashtu siç kishin ardhur. Ka mundësi të jenë estonianë, mendoi Laurentiusi me vete. Dëgjoi hapat e tyre të zbresin rëndë shkallët e drunjta, dhe pastaj u kthye dhe u shtri

përsëri mbi dërrasat e shtratit. Tani mund të flinte.

Buzëqeshi me vete, duke iu gëzuar fillimit të harresës.

Por ndjesia e lumtur e shtrirjes kaloi shpejt ndërsa bazamenti i fortë i shtratit filloi t'i shpojë shpatullën dhe ijën. Pronarja i kishte thënë që ta siguronte vetë kashtën për shtratin e tij, por ai thjesht nuk ishte i aftë të merrte përsipër vetë atë detyrë në shtetit ku ishte. Të dridhurat nga të ftohtët sa vinin e bëheshin gjithnjë e më të forta.

“Dreqi e mori...” murmuriti nëpër dhëmbë Laurentius.

Duke u munduar shumë për t'u drejtuar, Laurentiusi u pengua te valixhja e tij. Ai nuk kishte marrë me vete rroba shtrati përveç një dysheku bosh dhe një jastëk të vogël me pupla. Gjatë udhëtimit ai kishte fjetur zakonisht poshtë mantelit të tij të udhëtimit dhe tani u mbështoll edhe më fort me të. Një mantel plisi kishte marrë erën e dhomave të bujtinave dhe lagështirës, duke e përforcuar disi ndjenjën e të qenët në një ambient të huaj. Edhe jastëku i tij me pupla ishte i lagësht dhe mbante pak erë myk.

“Nesër do të përpiqem të gjej ca kërcunjt për zjarrin,” tha ai me vete. Në vatër kishte vetëm disa copa qymyr, por drutë s'duken gjëkund.

Me njëfarë vështirësie u lëshua përsëri në shtrat, dhe ndërsa qëndroi shtrirë atje copëza të ndryshme bisedash filluan të hyjnë vjedhurazi në mendjen e tij. Fraza të shkëputura, fytyra, skena. Por pastaj këto u zëvendësuan nga një frikë e papërmbajtshme që sëmundja mund t'i merrte jetën. Ndoshta kur ai e kishte lënë lagështirën të depërtojë në trupin e tij shumë pranë plevicës ai e kishte prishur përgjithmonë ekuilibrin e shëndetit të tij. Tani duke u dridhur poshtë mantelit të tij, ai po tretej pak nga pak, dhe avulli që ai kishte futur dhe nxjerrë nga mushkëritë do të zhdukej në një pështjellim të patrajtë.

Për çfarë kishin folur ata në karrocë? Për jetën?

Ai ia nguli sytë kafazit të vënë mbi tryezë me derën e shtrembëruar. Kishte qenë kafazi i Klodias. Zbrazëtia mizore, qortuese e kutisë prej teli e bëri të ndjehej shumë keq. Natyra e urren vakumin, boshllëkun, pagjallërinë. Diçka e re, diçka ndryshe do të shfaqej gjithnjë në vend të saj.

“*Natura abhorret vacuum,*” i tha ai kafazit. Dhe nën ritmin e këtyre fjalëve një pjesë nga vargu që e kishte mësuar dikur filloi t’i kujtohet:

Nëse një kuti burnoti ka qenë bosh për njëqind vjet,
Atëherë padyshim që Qoftëlargu do të shkojë aty.

Vargu i gjëmoi në vesh si rrahja e gjakut në vena, dhe pavarësisht tonit të tij të gëzuar tani dukej qartë ogurzi. Por ndoshta nuk do të vinte vetëm Qoftëlargu? Boshllëku do të thoshte mosekzistenca, mungesa e realitetit. Vetëm Perëndia ishte një qenie e pastër, realitet i pastër, siç ka thënë Thomas Aquinas. Forca lëvizëse e patundur. Ai filloi të lutej me një pëshpëritje që mezi dëgjohej, duke shpresuar që ritmi i njohur dhe shqisa e kthjellët e lutjes do të largonte fantazmat që sëmundja kishte zgjuar në shpirtin e tij. Laurentius e dinte që ethet ishin të nevojshme për të rivendosur ekuilibrin e brendshëm. Por kur trupi ishte i zbalancuar atëherë fantazmat e shpirtit dhe ndikimet e jashtme mund ta mposhtnin lehtë atë. Kjo ishte arsyeja përse njerëzit kur ishin me ethe shihnin vegullime, kjo ishte arsyeja përse ishte thelbësore të mbroje trupin dhe shpirtin nga çfarëdo lloj ndikimi i keq kur ishe sëmurë. Ai kujtoi se si fshatari në Holandë i kishte folur për një mbret shelgu lotues apo verri, që erdhi për të vjedhur shpirtrat e njerëzve të sëmurë. Njerëzit me shpirtra të dobët, sidomos fëmijët, të cilët shpesh do ta shihnin, me një kurorë në kokë dhe mantel të errët. Figura e gjatë e turbullt do të qëndronte atje

në zbrazëtinë e errët poshtë pemëve me degë të zhveshura dhe do t'ia bënte me shenjë të sëmurëve të vinin me të. Laurentius e dinte shumë mirë që kjo ishte një shtrigëri e vërtet, dhe jo thjesht imagjinata e fshatarëve. Vetë shpirti i tij kishte qenë gjithnjë i dobët, tëmthi i zi ishte ulur e ngritur brenda tij. Por a do të qëndronte asgjëja në kafazin e tij, apo ndonjë lloj tjetër realiteti do të merrte formë atje?

“Amen,” pëshpëriti Laurentius.

Duke përfunduar lutjen, u mblodh kutullaç në shtrat dhe dëgjoi pronaren të lëvizte me ngut dhe të flasë me dikë në katin e parë. Laurentius mund të kapte vetëm pjesë të mërzitshme, të parëndësishme, nga murmuritja që i vinte përmes dërrasave të dyshemesë dhe me sa duket pronarja ishte duke shkëmbyer me dikë lajmet e ditës. Dëgjoi më me vëmendje, duke u përpjekur të kuptojë për çfarë po flisnin, por ishte e kotë. E dinte që duhet të kërkonte diçka të ngrohtë për të ngrënë dhe që zjarri të ndizej, por ngurroi, nuk donte të shqetësonte askënd.

“Tinktura...” pëshpëriti ai me vete. “Sigurisht, tinktura.”

U drejtua dhe mori një shishe të vogël nga sënduku i tij. Përbante më pak se gjysmën e përzierjes që atij i nevojitej për të mjekuar ethet, dhe u pendua që nuk kishte përgatitur më shumë më parë. Ca kohë më parë ai kishte shkruar një numër recetash esencash nga libri i Dioscorides *De materia medica* dhe manual të tjerë, dhe i kishte provuar tashmë te vetja. Ai kishte shpresuar të gjente një kurë për sëmundjet e tij duke përdorur kiminë inorganike arabe dhe zbulimet e studiuesve më bashkëkohorë. Por deri tani tinktura kishte rezultuar e vetmi mjet efikas për lehtësimin e dhimbjes uljen e etheve. Ndonëse ajo sa vinte dhe s'bënte më efekt.

Ai tundi kokën me shqetësim.

Çdo herë që Laurentius binte i sëmurë ai ndjente një ndjesi shumë të fortë që po jetonte në një realitet paralel, dhe se

njerëzit e tjerë kishin vetëm një lidhje shumë të imët me të. Ata dukeshin të largët dhe të dhe të paqartë, sikur po zhytej gjithnjë e më thellë në një burim me rreze dielli vertikale që shkëlqenin poshtë, dhe drita kishte fituar një cilësi tjetër. Gjithmonë merakosej se nëse do të hapte gojën dhe do të pyeste diçka atëherë njerëzit do ta shihnin sikur të ishte një i huaj që s'fliste gjuhën e tyre dhe kishte filluar të përpiqej t'u shpjegonte diçka me tinguj dhe gjeste të çuditshme. Fytyrat e tyre do të shprehnin njëkohësisht keqardhje dhe përbuzje. Por jo ai duhet të pushonte së menduari në atë mënyrë.

“Tinkturë,” pëshpëriti ai. “Ajo do të bëjë punë.”

Ai mati pak nga lëngu kaf dhe piu një gllënjë të madhe. Tashmë kishte mbetur shumë pak, dhe vetëm nesër mund të fillonte të përgatiste një porcion të ri. Vetëm duhet të priste që kriza e parë e etheve të bënte punën e saj. Në teori, një natë ethesh dhe djersitjeje duhet të tregonte se së shpejti sëmundja do të largohej, por nuk kishte djersitje atëherë mund të zgjaste më shumë. Duke u lutur të mos vdiste natën, Laurentiusi u mblodh kutullaç si mace dhe u përpoq fort të mos mendonte për sëmundjen e tij. Do të ishte më mirë të shqetësohej për probleme të vërteta, si provimi nesër, dhe mësimet e tij. Jo për disa shpirtra të imagjinuar, lagështirën ngjitëse, dhimbjen e kokës, ethet, mbretin e shelgjeve dhe natyrën e realitetit ...

“Ah!” bërtiti fort Laurentius.

U ngrit menjëherë në këmbë. Ndjeu se i kishte zënë ngërç këmba e djathtë, dhe ija i dhembte nga qëndrimi shtrirë mbi dërrasat e forta të shtratit. Kishte një ndjesi të çuditshme në stomak.

Mund të dëgjonte gërhitje që vinin nga diku shumë pranë.

Laurentius u rrotullua me nervozizëm, duke u përpjekur të shohë nga vinte zhurma, por nuk mund të dallonte asgjë në errësirë. Kuptoi vetëm atëherë se ishte bërë natë dhe se në fakt

kishte fjetur gjumë prej disa orësh. Kishte shumë të ngjarë që të gërhiste njëri prej anëtarëve të familjes që flinin një kat më poshtë.

Duke u ndjerë pak më i qetë u ul me kujdes përsëri në shtrat, dhe filloi t'i bëjë masazh këmbës. Muskujt e tij ishin tendosur nga nxehtësia e etheve, dhe tërheqja po i bënte pulpat e këmbëve t'i zinte ngërçi, duke e bërë të pamundur të shtrihej rehat. Ndonëse shtanga e këmbëve mund të ketë ardhur nga udhëtimi i tij dhe shtrati i fortë.

Ndjeu një rrëqethje t'i përshkrojë të gjithë trupin ndërsa kuptoi që bënte ftohtë, kuptoi që ajri me lagështi vërshonte përmes të çarave të dritares. Ai pothuajse mund të dallonte konturet e reve të ulëta përmes xhamave të vegjël të dritares. Pika shiu pikonin në sipërfaqen e xhamit, dhe një pellg i vogël uji ishte mbledhur në pezulin e dritares. Ndërsa rrinte shtrirë atje kuptoi se duhet të shkonte në tualet. Por pastaj solli ndërmend si për ta mërzhitur, se nuk kishte pyetur ku ndodhej, dhe ende nuk kishte arritur të siguronte një oturak.

“Satanai dhe rrugët e tij dredharake,” shau me vete me zë të ulët.

Ndonjëherë nevojtorja ndodhej jashtë në oborr, ndonjëherë brenda shtëpisë.

Laurentius kërkoi qorrazi në majë të dollapit gurin e xixave dhe eshkat, por pastaj kujtoi se s'kishte llambë. Nuk i kishte kushtuar vëmendje fjalëve që kishte thënë pronarja edhe për këtë.

“Bela...” murmuriti nëpër dhëmbë Laurentius.

Duke qëndruar në këmbë në mes të errësirës pus të dhomës, vendosi se gjëja më e mirë për të bërë ishte të provonte fatin jashtë. Nëse do të fillonte të kërkonte nevojtoresh brenda, me siguri do të zgjonte familjen. I la çizmet poshtë krevatit, dhe u nis zbathur, duke shkelur me kujdes. Zbriti poshtë, hapi derën

e pasme, u gjend në një oborr të rrethuar me mur, madhësinë e të cilit nuk mund ta përcaktonte në errësirë dhe në shi. Ishte e mundur të dalloje përvijimet e paqarta të disa objekteve nëpër mjegullinën e lagësht, por që nuk krijonin një tablo të plotë. Ishin veçse disa lakore të errëta dhe valëzimi i sipërfaqes së tokës, që ishte mbuluar me pellgje. Ai u drodh dhe e shtrëngoi edhe më fort rreth vetes mantelin e tij të udhëtimit.

Në dritën që vinte nga hyrja filloi ngadalë të shquante shkallë druri të gdhendura trashë. Disa hapa më tutje, në sfondin e errësirës mund të shihte përvijimin e një barake të vogël, dhe atëherë pikasi grahmën shpuese të amoniakut të përhapej prej saj, të cilën e njihte nga çdo punishte lëkurëpunuesi, pension familjar dhe nevojtoje në oborr ku kishte qenë. Iu kujtua biseda që kishte patur me lëkurëpunuesin pranë bujtinës, dhe s'iu durua pa pyetur veten, duke u dridhur, se çfarë i kishte ndodhur në fund të fundit plakut dhe ndihmësit të lëkurëpunuesit.

Laurentius eci nëpër tokën e përbaltur drejt barakës, duke shkelur në gurët e rrëshqitshëm të ftohtë që me sa duket ishin vendosur atje për atë qëllim. Pasi mbërriti atje, vendosi gjithsesi se do të ishte më mirë të mos futej atje. Kush e di ç' do të shkelte brenda me këmbë. Tani që sytë i ishin mësuar me errësirën rrathët e përsosur bashkëqendrorë që riga e shiut po bënte në pellgje. Koka po i vinte vërdallë nga ethet.

“Mirëmbërëma,” dëgjoji dikë të thotë.

Laurentiusin e pushtoi habia, dhe me nxitim ngriti lart pantallonat. Duke parë prapa mbi sup pa një siluetë të veshur me një këmishë të gjatë me ngjyrë të ndezur, që qëndronte te shkallët poshtë strehës. “Mirëmbërëma,” iu përgjigj ai me ngurrim, duke u përpjekur sa më shumë të rregullohet pa rënë në sy.

“Ju jeni qiraxhiu i ri?” e pyeti silueta. Po, unë jam,” ia konfirmoi Laurentius.

“Ke ardhur nga larg?”

Laurentius rregulloi këmishën, dhe, me ngurrim, eci në majë të gishtave nëpër gurë për te streha. Kur qëndroi përballë gruas së re vuri re se lëkura e zbehtë e fytyrës së saj shkëlqente si një pikturë me ngjyra dylli të shkrirë. Duke u mbështetur pas murit, Laurentius u përpoq të buzëqeshë, por kuptoi menjëherë se gjërat nuk shkuan siç kishte dashur. Ai ende ndihej sikur trupi i digjej nga ethet, dhe gjithçka rrotull tij po e bënte të dukej disi joreale, sikur të vezullonte si ajër i nxehtë mbi një hekur apo mangall.

“Po, vij nga larg,” iu përgjigj Laurentiusi.

“Ke marrë diçka për të ngrënë?” e pyeti vajza.

“Për të ngrënë?” e pyeti Laurentius, duke mos e kuptuar mirë pyetjen.

“Po,” pohoi vajza.

“Jo,” tha ai, duke u kujtuar që kishte gjithë ditën pa ngrënë. “Nuk kam fare ç’ të ha.”

“Do të doje diçka për të ngrënë?” e pyeti ajo.

Balta dhe uji i ftohtë në oborr i thanë këmbët, dhe kjo ndjesi po e nervozonte. Ndërsa u përpoq fort të mendonte nëse do të hante, ndjeu përsëri ngërç në këmbën e djathtë. Nuk duronte dot të qëndronte më gjatë atje. Ia nguli sytë gishtave të zbathur të këmbëve të vajzës mbi dërrasat e lagura.

“Do të ha nesër,” u përgjigj më në fund Laurentiusi.

Bëri një gjest të paqartë me dorë dhe vuri njërën këmbë te shkallët. Ishte e pasjellshme t’i shmangesh bisedës ashtu vjedhurazi, por nuk mund të qëndronte më gjatë në këmbë. Dhe ende e kishte përshtypjen se po ëndërronte. Mos ndoshta ishte vërtet ende në gjumë?

“Prit pak, je i sigurt që ndihesh mirë?” pyeti vajza.

“Kam edhe,” u përpoq të shpjegojë Laurentius.

Vajza i vuri dorën në ballë. “Shiko nga unë,” i tha ajo.

“S’mundem. S’mundem vërtet,” i tha Laurentius.

“Shiko këtu,” tha vajza duke këmbëngulur, dhe e detyroi të kthehet me fytyrë nga ajo. Laurentius mund të shihte se sytë e saj kishin një ngjyrë të verdhë të hapët si mjalti i Atikës, sikur pas tyre digjej një qiri. Si ari, që mund t’i kthente fuqinë dhe t’i largonte melankolinë. Psherëtiu i lehtësuar.

“Je sëmurë, duhet të marrësh veten. Shko të flesh,” i tha vajza, dhe kjo tingëlloi si një bekim, si një uratë.

“Po... E di. Duhet të fle. Gjumë,” murmuriti Laurentius me vete ndërsa filloi të ngjisë shkallët.

Vajza buzëqeshi dhe ia bëri me dorë ndërsa ai u largua.

Natë

NGRIJ NË VEND PËR NJË ÇAST; sytë më janë mbushur me lot ndërsa i pulit në dritën e një ure zjarri, dhe turma është e hareshme.

“Përbindësh!”

“Do ta shohësh tani!”

Sekretari i gjykatës më shtyn një hu të ndezur në fytyrë. Mund të ndjej nxehtësinë e saj përvëluese të më prekë lëkurën time ngjyrëkafe, dhe nxehtësia e thatë të më përcëllojë qerpikët dhe vetullat.

“Ah!” Bërtas fort, dhe të gjithë trupin e mbërthen paniku. Largoj kokën instinktivisht; njëra këmbë përdridhet prapa; duart po më dridhen; zemra po më rreh fort si një rrahës drithi. Kthehem në përpjekje për t’u zhdukur në errësirën që më thërret përtej rrahëve të shndritshëm të dritës së pishtarit, pas turmës, diku larg prej këtu.

Por sekretari i gjykatës më zë rrugën, më kap për flokësh, dhe më detyron të shikoj turmën përmes flakës ngjyrëportokalli. Dora me dorashkë më nduk e më tërheq derisa shpirti im nënshtrohet, i rraskapitur dhe i dorëzuar. Zhurma vërshuese, gumëzhitëse e turmës, filloi të bjerë, si shiu pas stuhisë, ende duke stërpikur për një farë kohe; diku disa zëra ende murmurisnin; kukurisma e herëpashershme e të qeshurës dëgjohet larg. Aty ka radhë njerëzish, burra e gra, të rinj dhe

pleq, disa prej tyre ende fëmijë si unë. Ata më vëzhgojnë ndërsa qëndroj në dritën e dobët të natës pranë trekëmbëshit për varje. Një djalë i rreckosur, me një fytyrë si balta e shtypur me këmbë. Pra ky qenka përbindëshi, këlyshi i vogël, ai që mund të shohë shenjën e shtrigës.

“E neveritshme!” bërtiti fort një nga gratë. “S’është për t’u habitur...”

“Turp të ketë!”

Ngrihen duar, më tregojnë me gisht mua, fytyrën time të nxirë dhe buzët e plasaritura. Njerëzit hedhin kripë në zjarr, për të parandaluar të keqen, dhe për të përzënë turpin, që të mos i prekë magjia, në mënyrë që asgjë prej meje apo prej asaj që po ndodh këtu në trekëmbësh të mos i ndjekë në shtëpinë e tyre. Të gjithë këta njerëz janë të panjohur për mua, port ë gjithë ma kanë frikën dhe më përçmojnë. Kam treguar me gisht, dhe kjo është arsyeja përse kjo grua është dënuar sepse është shtrigë.

“Njeri i pështirë!” klith dikush.

Mbështes dorën në gjoks, mbledh grushtet. S’mund të bëj asgjë, është sikur koha të ketë ngecur në vend. Ajri vezullon nga nxehtësia e pishtarëve dhe skena duket si një shëmbëllim në një pasqyrë argjendi të ngrënë. Rrezaton nxehtësinë e ferrit; zërat dhe fytyrat e njerëzve zgjaten; humbasin të gjithë kuptimin e tyre; ato bëhen hije të mjera të vetvetes së tyre të vërtetë. Unë hedh vështrimin poshtë, tej.

Sekretari i gjykatës fillon të lexojë vendimin me zë gjëmues: “Pasi xhelati të ketë përfunduar punën e tij, në mënyrë që koka të ndahet nga trupi, atëherë trupi do të digjet në zjarr. Gjykata e ka marrë këtë vendim bazuar në ligjin e shenjtë të Eksodi 22:18, Levitiku 20: 6 dhe Ligji i Përtërirë 18: 11, dhe ligjeve të shtetit suedez. Lidhur me këtë shtrigë ajo është njohur nga djali profet; ajo mban shenjën e shtrigës në sytë e saj dhe menjëherë pas arrestimit pranoi fajin e saj.”

Xhelati godet.

Më merren mendtë, sikur të qëndroja mbi urë, ndërsa shoh lumin që rrjedh me shpejtësi poshtë. Një lojë ngjyrash e vazhdueshme, drita e diellit përthyeret nga ujërat gurgulluese në retinën time, duke më verbuar. Tani zjarri vezullues merr formën e një shpate që xhelati e mban në dorë, me një rrëke gjaku që rrjedh curril në hullizën e saj qendrore. Maja e shpatës më është drejtuar mua, larg gruas, e cila është rrëzuar para, përkulur mbi trungun e xhelatit. Gishtat e xhelatit shtrëngojnë fort dorezën e shpatës, por koka e gruas është varur prapa. Në venat e prera të qafës së saj ende pulson gjak. Sytë e saj janë pjesërisht të mbuluar nga tufa të dendura flokësh të errët të ngjitura në fytyrë, dhe gjaku po i rridhte çurg mbi buzë, duke gurgulluar midis dhëmbëve të saj ndërsa jep frymën e fundit. Por ende nuk ka vdekur.

“Ah...” pëshpërij unë.

“Ky është ligji. Që ta marrësh vesh!” bërtiti fort sekretari i gjykatës.

Qëndroj atje; me sytë që përpijnë imazhet, por mendja ime nuk mund t’i kuptojë ato. Ato thjesht rrëshqasin poshtë flokëve të mi dhe hyjnë në kokë, një nga një, të shkëputura si ëndrrat, si hije që rrinë pezull në mjegull. Fragmente të shkëputura, pjesë të pashpjegueshme, asgjë që të jetë e qartë, apo të krijojë të tërën. Por ato fërkohen pas meje, duke çarë me forcë rrugën për të hyrë brenda, si krimbat e drurit që hapin tunele gjarpërues, të pakuptimtë në një pemë.

Sytë e saj më shqyrtojnë...

Tani turma e ka kapërcyer tronditjen e fillimit dhe filloi të bëhet zemërake. Disa njerëz në radhët e fundit duket sikur po bëhen gati të largohen, dhe po diskutojnë diçka midis tyre me një gjysmë pëshpëritje; nja dy burra po vështrojnë nga unë me inat.

Por unë vështroj ngultas syshqyer platformën e ekzekutimit; drita po më përcëllon fytyrën, duke djegur kornetë e syve të mi.

Për ndonjë arsye e di se nëse mbyll sytë gjithçka do të humbasë në mënyrë të pakthyeshme. Ata kërkuan që unë t'u tregoj shtrigën, kështu që ua tregova. Përse vallë e bëra këtë? Ndoshta sepse isha i uritur, jashtëzakonisht i uritur...

Sytë e gruas kanë kërcyer, janë zgurdulluar, sikur dikush po e mbyste. Ajo nuk merr frymë.

Shoh se është vështrimi i një njeriu që po vdes, plot tmerr dhe dhimbje. Ajo më mbërthen me sy si të jetë veprimi i fundit që bën sa është gjallë, dhe e di se nëse nuk veproj, nuk do të ketë kthim pas. Atje mund të shoh kujtimet e saj, të gjithë jetën e saj. Por sfondi është dhimbja dhe frika; nga krenaria e çmendur që i trembte aq shumë të gjithë, dhe prej të cilës ata kishin aq shumë frikë, nuk kishte mbetur asnjë gjurmë.

Sekretari i gjykatës zvarrit këmbët pa rehati, i pakënaqur pa dyshim që xhelati s'është i zoti të përmbushë detyrat e tij si duhet. E çfarë xhelati është ai nëse nuk ia heq dot kokën asaj me një goditje të vetme?

“Hë de, o njeri, godite përsëri!” bërtet me të madhe ai.

Xhelati ngre shpatën e tij me ngathtësi, e mban me ngurrim për një çast sipër kokës së gruas, dhe godet përsëri siç e urdhëruan.

Nuk mund t'i shoh më sytë e gruas, por papritur më vjen në mendje kujtimi i jetës së saj. Fëmijëria, krezmimi, dasma e saj. Ajo qëndron në këmbë përpara altarit me një fustan të bardhë të gjatë, dhe dhëndri i saj është i gjatë dhe i pashëm. Ajo lind shumë fëmijë, dhe katër djemtë rriten dhe bëhen burra. Fillimisht jetojnë mirë; shkojnë në kishë majë kalit, veshur me çizme, dhe dëgjojnë fjalën frymëzuese të Perëndisë. Por pastaj burri i saj sëmuret me ethe. Vazhdon të jetë i sëmure për një farë kohe, dhe pastaj vdes. Pas vdekjes së burrit të saj

gruaja fillon të shkojë herë pas here në pyll, dhe së shpejti ajo krenohet se është marrë vesh me Djallin për punë të mbrapshta, se tani është nusja e Djallit. Djemtë fillojnë të frikësohen prej saj; përpiqen ta ndalojnë, por ajo vazhdon të shkojë në pyll, sepse Djalli i shfaq asaj shpirtrat e njerëzve dhe di si t'i kuptojë ata. Shpirtrat janë kujtime dhe ndodhen ngado.

Xhelati buzëqesh i kënaqur ndërsa kockat e qafës së gruas kërcasin. Delli i fundit i qafës së saj mbahet fort për një çast, por pastaj trupi dhe koka e saj janë mjaftueshëm të ndara nga njëra tjera siç e kërkon ligji. Sekretari i gjykatës e kap kokën nga flokët dhe e ngre triumfalisht për t'ia treguar turmës, e cila ka filluar të rrallohet.

Nuk ka ulëritje ngazëlluese, vetëm nja dy njerëz aty këtu që përqeshnin me zë të lartë xhelatin. Sekretari i gjykatës tund kokën i kënaqur.

Bie në gjunjë, mbështes duart në gjoks, dhe qaj. Nuk di as përse. Por qaj me zë të lartë, me sa kam fuqi; bërtas.

Të gjithë njerëzit, të gjithë fytyrat e tyre, duken disi të largëta dhe të shtrembëruara. Përmes lotëve të mi ata duken të vegjël si fëmijë, të mjegulluar dhe njëdimensional si vizatime të bëra me qymyr mbi lëvoren e bardhë të mështeknës.

Një siluetë e veshur me të zezë shfaqet prej diku. Ai afrohet nja dy hapa më pranë dhe përkulet.

E vëzhgoj në heshtje për njëfarë kohe; sytë e tij janë të zinj të shkëlqyer si qymyr të zinj. Ka një kurorë në kokë.

E Mërkurë

LAURENTIUS U ZGJUA nga një tringëllimë që vinte nga diku aty rrotull. Shumë shpejt kuptoi që duhet të ishte kambana e kishës së Gjon Pagëzorit në derën ngjitur, e cila kishte një kumbim disi si teneqe. Vetë kisha ishte ndërtuar me shpenzime të mëdha dhe me një mjeshtëri të madhe arkitekturore, dhe ishte e famshme për punën e saj dekorative me zbukurime me argjilë të kuqe; madje ishte përmendur edhe në disa udhëzues udhëtimi. Nga sa thuhej kumbimi metalik ishte rezultat i futjes në tokë të kambanës gjatë luftës së fundit, prej të cilës kishte pësuar njëfarë dëmtimi. Pas gjithë atyre zvarritjeve, groposjes dhe zhgroposjeje, në bronz ishin shfaqur disa plasaritje të holla. Ato nuk mund të shiheshin me sy por e bënë disi të çuditshme dhe të mbytur të rënën e saj. Ndoshta arsyeja ishte sepse diçka s’kishte shkuar mirë me derdhjen e kambanës apo ndoshta dëmtimi i saj ishte shkaktuar nga rënia e vazhdueshme e saj gjatë Murtajës. Kambanat e kishave kishin kishin tendencën të plasaritshin nga tronditjet, dhe shpesh nuk mund të riparoheshin. Ato plasaritje, dhjetëvjeçarë më vonë do të mbeteshin si dëshmi e atyre kohërave. Ndoshta ato do të shërbenin edhe si paralajmërim për gjëmat që do të vinin....

Laurentius u ngrit mbi bërryla dhe pa nga dritarja, por kulla e kishës nuk mund të dukej prej aty. Ai mundi të shohë vetëm qiellin e rimtë, dhe re shiu. Me sa duket kjo ditë do të ishte si

gjithë të tjerat.

“Ah,” psherëtiu Laurentius.

Për shkak të fillimit të sëmundjes dje, ai nuk ia kishte dalë mbanë të vizitonte as edhe një kishë. Zakonisht ai do të njihej me një qytet duke parë kishat; meremetimi i tyre dhe pamja e jashtme zakonisht të jepnin një ide të qartë se si jetonin njerëzit në atë qytet, dhe cilat ishin përparësitë e tyre. Udhëzuesit e udhëtimit këshillonin të vizitoje fillimisht ndërtesat kryesore të qytetit. Në disa qytete mund të gjeje derra, pula dhe kafshë të tjerë m’u në mes të ndërtesës së kishës, dhe pleh e kashtë të shpërndarë në gjithë dyshemetë. Shpesh të gjitha pikturat ishin prishur gjatë Reformacionit, duke krijuar një përshtypje të përgjithshme papastërtie dhe lënie pas dore. Por në të tjera mund të gjeje një rojë që paguhej për të mos i lënë kafshët brenda shtëpisë së adhurimit. Do të kishte dysheme të shtruara me pllaka guri; mbeturinat do të hidheshin rregullisht, dhe muret do të lyheshin me të bardhë puritane, duke dhënë përshtypjen e rregullit. Kjo tregonte diçka për vetë qytetin.

Laurentius numëroi sa herë ra kambana, duke bluar në mendje nëse duhet të shkonte menjëherë në kishë. Edhet i ranë pak dhe u ndie pothuajse mirë përsëri, vetëm grahma e kalbur që kishte zënë vend në vrimat e tij të hundës kur kishte mbërritur në Dorpat kishte mbetur, duke i kujtuar atij ngjarjet e këtyre ditëve të fundit. Ngjarjet e së djeshmes, përfshirë këtu vdekjen e rreckamanit dhe takimin e çuditshëm me vajzën të shkallët i dukeshin si kujtime të turbullta, të largëta, madje si histori që dikush i kishte treguar dikur. A kishte ndodhur vërtetë takimi? Ai pa poshtë këmbët e tij me baltë, dhe duhet të nxirrte përfundimin që kishte shkuar vërtetë jashtë. Të paktën ajo pjesë nuk kishte qenë ëndërr. Por a s’kishte ëndërruar diçka gjithashtu?

Laurentius tundi kokën, s’i mbahej mend saktësisht. Piu

një gllënjکہ të madhe nga shishja e tij e tinkturës, e cila përsëri kishte shije të hidhur, si vrer. E vuri përsëri shishen e boshatisur mbi tryezë duke rrudhur hundën me inat. Mendimet e tij ende nuk ishin qartësuar. Kujtimet e ditëve të fundit dukeshin disi të shkëputura, të zhvendosura, të mbuluara me errësirë dhe ethe, duke filluar prej kurrkundi në veçanti dhe duke përfunduar me pak gjë, prandaj nuk mund të ishte i sigurt se ishin të vërteta. U përpoq të kujtojë fytyrën e gruas së re që kishte parë te shkallët: ajo ishte elegante, me flokë të errët, dhe e kishte lëkurën pothuajse të tejndritshme. Por nuk mund të shihte më qartë se aq. Imazhi mund të ishte ruajtur në kujtesën e tij nga një ëndërr apo nga jeta reale, por ishte i zbehtë. Pastaj iu kujtua imazhi i dikujt i veshur me rroba të errëta, me një kurorë në kokë.

“Mbreti?”

Mbylli sytë dhe u përpoq të rrinte zgjuar për njëfarë kohe, sikur të shpresonte se kjo mund ta ndihmonte të kujtonte çfarë kishte parë atë natë, por shtrati i fortë dhe i ftohti që i depërtonte nëpër mantel largoi edhe atë pak gjumë që i vinte. Mbreti, një grua? Nuk mund të kujtonte saktësisht. Dhoma pa ngrohje vinte era myk; me sa duket rrobat e tij kishin thithur lagështirën nga ajri rretheqark, dhe dërrasat e shtratit poshtë tij ishte të ftohta s gur; e kishte ngrirë gjithë kurrizi. Ai kujtoi se gruaja e re i pat thënë që duhet të përpiqej të merrte veten, por tani ishte i bindur që sëmundja e tij vetëm mund të përkeqësohej. Dhe e kishte pirë gllënjکہën e fundit të tinkturës.

Dëgjoi një kërcitje që vinte nga shkallët, e ndjekur nga një trokitje në derë.

“Hyr,” thirri Laurentius, duke qëndruar ngritur në shtrat dhe duke parë rrotull nëse dhoma dukej mirë.

Një shërbyese me pamje të hijshme, me faqe buçko hyri dhe qëndroi në këmbë, duke e parë ngultas. Dukej qartë që ishte e pakënaqur me diçka.

“Mirëmëngjesi, zotëri,” tha ajo.

Laurentius uli sytë për të parë këmbët e tij të zbuluara me një shprehje fytyre të hutuar. Pa dyshim, kjo nuk ishte e njëjta vajzë që ai kishte takuar dje në oborr. Gruaja e re që rrinte më këmbë përpara tij kishte një çehre të kuqe dhe buzë të rrudhura, dhe dukej qartë që s’i kishte mbushur të njëzetat. Prej shamisë së kokës së kaltër të qëndisur, i dilnin vetëm pak tufa flokësh tufa flokësh biond dhe fustani i saj i bardhë i linjtë i rrinte ngjitur mbi gjokset e saj të plota, të rrumbullakëta nga një bolero. Ajo mbante një gotë balte në njërën dorë, dhe mbi të ishte vendosur një dërrasë për prerjen e bukë me një copë bukë. Ajo nuk ngjasonte aspak me vajzën e mbrëmjes së djeshme. “Më vjen keq sigurisht t’ju shqetësoj që në mëngjes, por rrethanat e shtynë pronaren të më kërkojë t’ju përcjell se nuk mund t’ju ofrojmë mëngjes, siç ishte rënë dakord në fillim. Kam frikë se e tillë është situata. Nga ana tjetër, i kam dhënë rëndësi gjithnjë t’u jap qirxhinjve të mi vaktet, dhe ushqimi gjithmonë ka qenë i mirë, jo si gjetkë që të japin vetëm bukë e birrë,” i shpjegoi Laurentiusit shërbyesja.

Ajo lëshoi me zhurmë bukën dhe birrën mbi tryezë. Dukej shumë qartë se ishte shumë e mërzitur për diçka, megjithëse përveçse tingëllonte formale dhe e panatyrshme, gjermanishtja e saj ishte e mirë. “Por tani s’di ç’të bëj, çmimet janë rritur aq shumë sa nuk do t’ia dalim dot të gatujmë vetë, Perëndia më ndihmoftë. Sa mirë që sigurova bukë, përndryshe do të vdisnim për bukë, njësoj si ata të gjorë atje jashtë. Madje nuk guxoj më të eci në rrugë me një copë bukë në dorë, se mos ma rrëmben dikush. Kjo nuk është asgjë në krahasim me atë që po ndodh përtej mureve të qytetit!”

Laurentius tundi kokën. Ai tashmë kishte kuptuar që diçka nuk shkoi edhe aq mirë kur ai kishte shkuar të flasë me rektorin dje në mëngjes. Qyteti kishte harenë e duhur, por njerëzit që pa

ishin nervozë, dhe madje edhe me rigën e shiut që vazhdonte të binte kishte fshatarë të kërrusur që sorollateshin kot ngado. Disa prej tyre ishin vetëm, të tjerë në grupe, dhe fytyrat i kishin të vrenjtura, dhe të parruara, me grushte të shtrënguara. Moti dhe pamja e mërzitur e njerëzve, krijojnë një atmosferë të nderë, plot tension, ogurzezë.

“Ju kuptoj mirë; mos u shqetësoni për atë punë. Do të siguroj vetë diçka për të ngrënë. Gjithsesi, mua s’më hahet në mëngjes,” tha Laurentius, duke u përpjekur të tregohet i sjellshëm.

Shërbyesja buzëqeshi me mirënjohje.

“Por mund të më jepni ca dru për zjarrin?” e pyeti Laurentiusi. “Këtu ka shumë lagështirë.”

“Sigurisht,” ngriti zërin vajza me gëzim. “Unë do t’i hedh dru zjarrit. Pronarja mund t’ia shtojë shpenzimin qirasë tënde. Çështja është se nuk kemi dru rezervë për dhomën tuaj. Në fakt pronarja dje tha se duhet t’i sigurosh vetë. Shiten në Haymarket, pranë lumit. Nëse shkon atje poshtë dhe t’i blesh, ata t’i sjellin këtu. Më pas do t’u them atyre ku t’i stivojnë, “shpjegoi shërbyesja.

Pastaj u nis e iku, duke u dukur me ngut.

“Meqë ra fjala,” tha Laurentiusi, duke e ndalur shërbyesën përpara se të dalë nga dhoma. “Mos keni ndonjë vajzë në familje, apo ndonjë tjetër që jeton këtu?”

Vajza ngriti vetullat me habi. “Jo nuk ka...s’kemi asnjë vajzë këtu,” shtoi ajo pas një ndalese të shkurtër. “Burri i shtëpisë u largua sot në mëngjes, dhe fëmijët e pronares janë të gjithë sëmurë. Për atë Zot, mos e hapni atë temë me të.”

Ajo buzëqeshi pak me siklet, mbylli derën pas saj dhe zbriti me hap të rëndë shkallët me këpucët e saj prej druri. Laurentius e pa atë të largohet dhe tundi kokën. Bëri disa hapa nëpër dhomë për të shtriquar këmbët që i ishin mpirë nga shtrati i fortë dhe

ethet, dhe praktikoi disa shmangie goditjesh me shpatën e tij.

“Le të lutemi për një trup të shëndetshëm dhe për një mendje të shëndetshme,” shpalli Laurentiusi.

Komentuesit nuk ishin të gjithë të një mendimi nëse kjo do të thoshte se nëse trupi ishte i shëndetshëm atëherë edhe mendja ishte e shëndetshme, ose nëse një gjendje e mirë mendore do të siguronte që edhe trupi të ishte në formë të mirë. Shkollat e ndryshme me mendimit mjekësor me sa duket përqendroheshin ose në shërimin e trupit ose të mendjes, në përpjekje për të gjetur shkakun e parë të çdo sëmundjeje të njërit apo tjetrit. Por për Laurentiusin nuk kishte ndryshim midis trupit dhe mendjes: mendja ishte forma e trupit, pa të cilën nuk mund të ekzistonte. Kështu që ai duhet të sigurohej ta mbante veten në formë të mirë.

Ai e ktheu përsëri shpatën në mill dhe u përkul për të marrë një fetë bukë nga tryeza. Nuk ishte shumë i uritur, por vendosi të hante me zor, sepse s’mbante mend që kur nuk kishte ngrënë. E dinte se ishte e rëndësishme të mos e lejonte organizmin të dobësohej shumë kur ishte i sëmurë... Për më tepër, buka dukej të ishte bërë me miell cilësor, dhe ishte ende pak e ngrohtë, me sa duket sapo kishte dalë nga furra.

“Dreqi e mori!” mallkoi Laurentius me zë të lartë.

Ndenji duke vështuar ngultas fetën e bukës i tronditur. Ishte papritur e hidhur dhe e pakëndshme, sikur të haje sanë apo gjethe mështekne, si tinktura e tij për ethe.

“Shpresoj të mos jenë të gjitha ushqimet kështu,” mendoi ai me vete ndërsa e shtyu me disa gllënjka birre të butë. Copa e fortë e bukës i rrëshqiti në gojë ndërsa ai u përpoq ta përtypte, njësoj si gjethet e lagura nga një pellg ngjiten të ngjiten në çizme dhe në rroba dhe nuk i shqit dot. Atij iu desh të pinte disa gllënjka të tjera birre që më në fund t’i shkonin poshtë dy fetat e bukës.

“Ptu!” murmuriti ai nëpër dhëmbë me vete. “Është gjë e mirë që nuk japin më mëngjes këtu.”

Ose kanë blerë bukën më të lirë të bërë me ndonjë lloj mbetjeje, ose situata në qytet ishte aq e keqe sa ishte e pamundur të gjeje miell të mirë. Ai shpresonte të ishte e para.

“E pra,” i tha ai vetes me vendosmëri. “Është koha të ngutemi.”

Veshi çizmet, vuri rripin e shpatës dhe doli. Atij i duhej ende të siguronte disa gjëra për t’u rregulluar mirë në dhomën e tij me qira, por së pari duhet të kalonte nga akademia për të marrë vesh për provimet. Përndryshe nuk do të kishte shpresë të pranohej në universitet, dhe mund të humbte pjesën e parë të bursës së tij. Gjithashtu do të mund të merrte vesh nëse kishte diku ndonjë pajisje laboratorike, që të përgatiste si duhet tinkturë.

Laurentius rregulloi shpatën dhe mori frymë thellë ajrin e ftohtë. Dhoma e tij kishte qenë e ftohtë dhe me lagështirë, por jashtë ajri i pastër kishte një efekt fuqিদhënës dhe pastrues. Uji i shiut kishte filluar të derdhet nga trotuaret dhe ai u nis në drejtim të akademisë, duke u përpjekur të shkelë midis pellgjeve dhe i hodhi një vështrim të shpejtë me nxitim njerëzit dhe shtëpitë në të dyja anët. Pa vetëm njerëz të zakonshëm dhe shtëpi që ngjanin të gjitha njësoj, siç kishte ngado ku kishte shkuar. Por në përgjithësi Dorpat nuk të linte aspak përshtypje të keqe, përveçse shiut që binte pa pushim. Duke ecur në dritën e dobët të mëngjesit ai u kthye në Rrugën Broad, shkoi deri te dera e akademisë, dhe u ndal. Ky ishte një vend më i hapur dhe drita dukej disi më e fortë. Ai buzëqeshi me vete, dhe lëvizi kokën prapa për të parë kambanoren e madhe të veshur me metal. Falë nuancave ngjyrë ulliri të çatisë, kisha dukej shumë e ndryshme nga ndërtesat e tjera, të cilat në përgjithësi kishin çati me qepra të përhimë Laurentius kujtoi se si bujtinari i kish

folur dje me krenari për kambanoren e kishës. Ishte në fakt shumë e bukur, ndonëse Laurentiusi ishte pothuajse i sigurt se do të dukej më e bukur po të ishte pak më e hollë hollake.

Ai u mundua të shohë më lart, dhe vuri re që gjeli i njomë që qëndronte në majë të çatisë së shkurtër pothuajse prekte retë e ulëta. Shkulmat e erës sillnin shi të imët që e qukte në fytyrën e tij, duke e detyruar të picërrojë sytë. Ndërsa u mundua të numërojë statujat e vogla prej balte në fasadë, poshtë kapakëve të syve të tij u mblodh lagështirë dhe gjithçka filloi të bëhej e mjegulluar. Statujat prej balte filluan të duken të hallakatura, sikur të ishin zbukurime me brumë letre. Shija e keqe e bukës së fortë të këtij mëngjesi filloi depërtonte përsëri në gjuhën e tij me pikat e shiut, duke kujtuar fort kundërmimin e kalbur, rreckamanin dhe sëmundjen e tij. Imazhet mendore që ishin të mjegulluara dhe të pavërteta kur ai u zgjua papritur u kthyen, dhe tani ishin më të qarta se fytyrat e figurave prej terrakote që kishte përpara. Humori i mirë i çastit i kaloi shpejt. Kambanorja e kishës tani i dukej çuditërisht pa proporcion dhe kërcënuese.

Duke u kthyer dalloj një student që nxitonte në drejtim të akademisë, ai e ndali dhe e pyeti, “Si mund të gjej Profesor Dimberg?”

“Profesor Dimberg? Nëse do t’i flasësh menjëherë, atëherë je i pafat. Ai vjen vetëm pas drekës. Kohët e fundit pret vizitorë në shtëpi,” u përgjigj studenti.

Laurentius e falenderoi shkurtimisht. Tashmë, kundërmimi i rëndë që i shtillej në vrimat e hundës dhe dobësia që ndjente te këmbët po e paralajmëronin atë se ethet do të ktheheshin përsëri. Ndoshta nuk duhet të kishte dalë jashtë aq shpejt, por të rrinte shtrirë në dhomën e tij të ftohtë, të lagësht, nuk do ta bënte të ndjehej më mirë. Nuk kishte kuptim të kthehej tani në dhomën e tij me qira, por nuk kishte dëshirë as t’i kërkonte Dimberg-ut ta priste në shtëpi. Vizitat e papritura shpesh

kërkonin të presësh gjatë, do të bënte thashetheme dhe do të hynte në biseda. Ishte më mirë të priste dhe të takonte Dimbergun në akademi, që do të thoshte se tani kishte të paktën dy orë për t'i kaluar më nge.

Tundi kokën dhe u nis në drejtim të lumit, duke ndjekur rrugën që shërbyesja i kishte shpjeguar. Mund t'i mbushte me shumë gjëra ato dy orë të lira. Pa poshtë dhe vuri re disa pllaka guri që ishin vendosur anë rrugës që njerëzit të shkelnin mbi to. Ato kishin kërcyer nga pellgjet, dhe me pamjen e tyre të dukshme të mesjetës shërbenin për të shtuar disi atmosferën melankolike të përgjithshme. Ai filloi të ecë, duke mos menduar për diçka në veçanti, duke parë gjurmët e këpucëve të njerëzve të tjerë të cilët sapo duhet të kishin qenë aty pak më parë se ai. Mendoi se si këto mund të jenë paraprirë shumë vite më parë nga çizmet e ushtarëve polakë, mokasinët e vegjël të fëmijëve, sandalet e murgut, opinga grash, këpucë të rënda burrash me lëkurë të trashë, këpucë me qafa e me takë druri, këpucët pa takë fshati dhe këpucët e lypsarit. Kaq shumë gjurma këmbësh me forma të ndryshme që tani dukej sikur e kisha privilegj të shkelja atje gjithashtu me çizmet e tij. Por sa shpesh ndodh që po këto çizme që hahen nga gurët, të marrin komandon e personit që i vesh, duke përcaktuar drejtimin e tij? Për shembull, kur çizmet fillojnë të hahen, dikush në vend që të ecë mezi mund të shkojë çalhti, ose kur dikush vesh një palë çizme luksi, dhe nuk i bëhet të futet nëpër pellgje me baltë. Ose situata e kundërt, nëse dikush ka veshur çizme ushtari dhe shkon me to në opera konsiderohet shkelje e rregullave të mirësjelljes. Mund të duket se ai që vishet me to e ka planifikuar vetë rrugën që duhet të ndjekë, por në një farë pike këpucët marrin komandon dhe shkojnë saktësisht atje ku duan, shkojnë atje ku e kanë për natyrë të shkojnë. Dhe ai që i mbath nuk ka zgjedhje tjetër veçse t'u bindet. Ushtari shkon në luftë, fshatari në fushë, dhe

të dy i pret vdekja.

Laurentius u ndal, duke patur një shprehje fytyre të mërzitur.

Jo, mendoj ai me vete. Është në natyrën e njerëzve të bëhen vetvetja. Vdekja është një gjendje e të mos qenit, prandaj është një largim nga normalja. Vdekja ndodh, por kjo nuk do të thotë që gjithçka përfundon. Një person lë pas kujtime, përshtypje. Tani këto përshtypje janë futur thellë në shpirtin e Laurentiusit, duke lënë gjurmë të thella në të, dhe gjithçka tjetër mund të lërë veçse një gërvishtje të lehtë në sipërfaqe.

“Klodia,” tha Laurentius.

Ku ishte paraketi i tij tani? Ku ishte shoku i tij që mund ta ndihmonte të largonte fantazmat e tij, apo të paktën të mos i lejonte të afroreshin për një farë kohe?

Ai u nis përsëri, duke ecur me hap të rëndë me vendosmëri, pothuajse me inat duke dalë nga portat e qytetit, pastaj ndaloi duke vështruar ngultas me pamje të zymtë ujin e kafenj të lumit që rridhte në shtratin e tij me buzë të cekëta. Ai u përpoq të përqendrohej te diçka tjetër nga mendimet e tij që i vinin vërdallë në kokë, për të gjetur diçka të cilës ta mbërthente me sy. Ai duhet të përpiqej të mendonte në mënyrë të arsyeshme. Kishte për të bërë një provim; nuk mund të hutohej. Por ç’të bënte?

Kishte barka të vogla që lëviznin poshtë e lart në lumë, transportonin dru në bregun matanë. Ai vështroi skifet e vegjël, dërrasa të mbërthyer me nxitim, të lyera me të zezë me katran pishe, dhe nga aty ku ishte ai dukeshin të vogla. Ai u përpoq të kuptonte cili ishte qëllimi i gjithë kësaj lëvizjeje dhe gjallërie. Askush se dinte se sa ftohtë do të bënte dimri këtë vit, por me sa duket njerëzit po përpiqeshin të furnizoheshin me dru për çdo rast. Ata që ishin të aftë ta bënë këtë, kështu nxirrnin bukën, dhe në rrethanat e tanishme kishte plot njerëz të gatshëm të merreshin me këtë punë.

“Dru, sigurisht.” Laurentius u zgjua nga mendimet e tij.
“Kam nevojë për dru për vatrën: Kjo do të më bëjë punë. Dhe kashtë. Më duhet të ngutem.”

Mesditë e së mërkurës

PELLGU ISHTE PLOT ME KALLAMA, mbetje dhe leshterikë, dhe një kundërmim i neveritshëm përhapëj prej tij. Kundërmimi që ishte shtjellur në vrimat e hundës së Laurentius që kur kishte mbërritur në Dorpat tani ishte përzierë me grahmën mbytëse që vinte nga moçali me baltë në breg të lumit, duke krijuar një përzierje e cila ishte e njohur, e megjithatë e re. Ai qëndroi pa lëvizur dhe u përpoq të rrokte pamjen, e cila me shiun dhe erën dukej pothuajse si peizazhi i një pikturë. Rruga ndodhej paksa jashtë Dorpat, pranë Portës Ruse, por dukej të ishte në mes të një djerrine, diku përtej çdo qyteti apo popullimi, larg gjithçkaje. Pas tij, matanë lumit, ishin periferitë e qytetit, por ai atje tashmë s'mund të shihte as edhe një shtëpi të vetme, dhe muri i qytetit pothuajse ishte zhdukur në fund. Nga aty ku ishte bastion i bregut të lumit dukej më shumë si një kodrinë që e kanë mbytur barishtet. Rruga që dilte direkt nga buza e pellgut te kodrina ishte shtruar me shtylla dhe degë të rrumbullakëta mështekne pastaj ishte mbushur me rërë dhe gurë, dhe tani ishte shtruar me gjethe të rëna. Moçali shtrihej deri pranë mureve të qytetit dhe në verë pothuajse thahej krejtësisht, por tani, pas disa muajve shi, dukej më shumë si liqen i vogël. Rruga që kalonte mospërmas dukej tani si një dërrasë e shtruar për të kapërcyer pellgun, e paqëndrueshme dhe e rrezikshme.

Laurentius shkeli mbi dërrasat e urës, të cilat ishin të rrëshqitshme dhe lëshuara nga kalbja dhe pa rrotull. Në të dyja anët e rrugës buzë lumit kishte shelgje të fuqishëm të argjendtë, të mbjellë ndoshta para ca kohësh më parë për përforsim, që rruga, e ndërtuar mbi themele shumë të buta, të mos zhdukej e gjitha poshtë në tokë. Kishte një masë rrënjësh të thella të përdredhura, të ngatërruara që përpiquej me të gjithë fuqinë t'i mbante të bashkuara masivet e dheut, por vende vende uji kishte gërryer shtresën e dheut në sipërfaqe, dhe disa nga pemët dukeshin sikur po rriteshin pezull. Ky duhet të jetë vendi i duhur.

Laurentius i kishin treguar rrugën për atje nga Haymarket, ku pasi ishte ngrënë në pazar për drutë dhe kashtën kishte marrë guximin t'i kërkonte mendim njerit nga tregtarët që u tregua më miqësor. Ndoshta paratë e Laurentiusit e kishin ndihmuar që tregtari të ishte pak më i prirur për mirë, sepse duke u nisur nga përvojat e kaluara që ai kishte paguar një çmim tepër të lartë. Por nuk iu duk e zgjuar të hahej shumë kështu që lëshoi pe shpejt, sikur të mos donte të shqetësohej shumë me provimin e pasdites përpara. Çfarëdo lloj stresi dhe lodhjeje të kishte ethet do t'i nisnin përsëri, njësoj si rripat e lëvores që digjen pa flakë në vatër kur njerëzit u fryjnë. Lëvizja dhe ankthi ishin ato që nxitnin ethet, prandaj ai përpiquej t'i baraspeshonte duke mos lëvizur dhe duke qëndruar i qetë. Prandaj të zinin ethet aq shpejt kur udhëtoje, dhe njerëzit që kishin prirje të nervozoheshin kishin më shumë të ngjarë të sëmureshin.

Ethet e kishin ndalur këtu.

Ndërsa qëndroi pranë kishës duke ndjerë ethet të shtohen ai filloi të shqetësohet për tinkturën e tij. Kur ishte nisur në udhëtimin e tij ai nuk e kishte menduar të nevojshme të merrte shumë me vete, por qysh prej vdekjes së paraketit të tij dhe

çastit kur grahma i kishte shpuar hundët për herë të parë ai e kishte përdorur një sasi të madhe të paparashikuar. Tani kishte kaluar shumë kohë që s'bënte një porcion të ri.

Laurentius nxori nga çanta e shpinës një thikë të vogël dhe një copë letër.

Tregtari kishte mbetur çuditërisht i hutuar nga pyetja e tij, por pasi kishte ngurruar për një çast e kishte këshilluar që vendi më i mirë për të gjetur shelgje ishte pranë Portës Ruse. Por toni miqësor i zërit ishte larguar; sytë e tij ishin picërruar, dhe u duk sikur e zotëronte me më shumë pasiguri gjermanishten. Laurentius ishte përpjekur t'i shpjegojë se e donte lëvoren e shelgut për qëllime mjekësore dhe shkencore, por pamja e frikës dhe dyshimit në fytyrën e tregtarit nuk ishte larguar. Dukej sikur kishte njëfarë antipatie për atë pjesë të qytetit. Ai thjesht tundi kokën ndaj përpjekjeve të ngathëta për t'u shpjeguar, duke shtuar me një ton therës se asgjë e mirë s'kishte ardhur kurrë nga ato që ndodhnin në ato anë. Laurentius ishte përpjekur të vërë në dukje se nuk planifikonte të kurdiste asgjë të papëlqyer, gjë që e zemëroi tregtarin dhe filloi me ngut të përpiqej t'i shpjegonte diçka. Duke mallkuar një mijë herë, ai i tha Laurentiusit se një lloj strehe për të uriturit ishte ngritur matanë periferive të qytetit, dhe gjithfarë njerëzish të çuditshëm kishin filluar të vërtiten rreth atij vendi. Pastaj kishte treguar me gisht shpatën e Laurentiusit dhe e pyeti me përbuzje nëse dinte ta përdorte, po t'i paraqitej nevoja. Ai shtoi se vetëm dje, kishte patur një incident me një plak që doli të ishte një kanibal, dhe për ta ndalur u desh ta vrisnin. Ai kafshonte kalimtarë si qen në mes të ditës, dhe kishte përlarë madje të tërën një bebe të vogël.

“Ai plak nuk vrau askënd,” i kishte thënë Laurentius tregtarit. “Në atë kohë rastisa të kaloj pranë; dhe me sa pushë ai as nuk kafshoi ndokënd.”

“Epo bëri sigurisht si i tërbuar,” kishte murmuritur nëpër

dhëmbë tregtari duke tundur kokën. Por pastaj bëri një gjest nënshtrimi dhe nxori përfundimin, “Ç”më duhet mua gjithsesi? Puna ime është të shes kashtë.

Laurentius e falenderoi dhe filloi të kërkojë portën tek e cila e kishin drejtuar. I ra mespërmes periferive të qytetit, të cilat ishin përplot me ndërtesa të rrënuara me fëmijë që qëndronin në rrugëhyrje duke e parë me fytyra pa buzëqeshje ndërsa kalonte. Të gjitha ata ishin shumë të dobët me vështrime të ngulëta qortuese dhe syshqyer. Laurentius i kishte zgjatur një djali një monedhë dhe ai ia kishte rrëmbyer nga pëllëmba e dorës dhe ishte zhdukur në errësirën e shtëpisë së tij pa buzëqeshur dhe pa thënë asnjë fjalë. Kur fëmijët e tjerë e panë këtë, ata u gjallëruan dhe erdhën duke vrapuar nëpër shi dhe filluan të mblidheni si mizë rreth Laurentius dhe filluan ta tërheqin nga rrobat. sikur të ishte miniera e tyre, dhe shkundi duart sa andej këndeje më kot, shpejtoi hapin pastaj ia krisi vrapit për t’u shpëtuar prej tyre. Ai i kishte ndjerë edhe më parë ta shihnin ashtu, dhe e kishte provuar vetë si ndjeheshin fëmijët. Kjo ishte ndjesia e varfërisë dhe urisë. Pasi kaloi shtëpitë dhe mbërriti në një zonë shkurraje pranë lumit nxorri një psherëtimë lehtësimi “E pra,” tha Laurentius, duke parë rrotull dhe duke rrokur mjedisin rrethues.

Iu afrua një peme me pamje të përshtatshme, u kacavor te rrënjët dhe rroku mirë thikën e tij. Nja dy copa të mëdha lëvoreje duhet të mjaftonin, por ato duhet të priteshin nga një degë që ishte afërsisht dy vjeçare, ku lëvorja do të ishte më e fortë. Në rrethana ideale ai do ta kishte mbledhur në pranverë, por tani s’kish ç’ti bënte kësaj. Kumbari i tij Theodus kishte qenë i pari që i kishte mësuar atij artin e përgatitjes së barnave dhe tinkturave, me këshillën e kumbarit të tij ai kishte shkuar përfundimisht në Leiden për të studiuar. Në atë kohë akademia Leiden ishte qendra kryesore e mjekësisë; kishte aparaturat

më të reja dhe ishte e azhurnuar me doktrinën më të fundit në fushë. Nga mënyra se si i kishte folur kumbari kishte qenë e qartë se ai ishte penduar që puna e kishte larguar nga studimet. Theodus do të buzëqeshte me përmallim dhe do të tundte kokën ndërsa kujtonte kohët e universitetit. Por do ta përfundonte gjithnjë kujtimet prej tij duke i fërkuar krahët Laurentiusit me kurajim.

“Mos e ndërprit studimet si unë. Sigurohu t’i përfundosh me çdo kusht,” e kishte këshilluar Theodus.

Duke e kapërcyer pendimin i tij, Theodus, do të fillonte të shpjegonte me entuziazëm si të luftonte sëmundje të ndryshme, dhe si të forcohej shpirtërisht. Ishte pa dyshim i gëzuar që kishte mundësi të ndante njohurinë e tij. Ai kishte bërë përpjekje të mëdha për ta edukonte Laurentiusin dhe t’i këshillonte atij libra për të lexuar. Ai do të thoshte gjithnjë se sa më i arsimuar të ishte një njeri, dhe sa më i kultivuar të ishte shpirti i tij, aq më i fortë dhe me rendiment do të ishte. Fillimisht, Laurentius nuk e kishte kuptuar ç’donte të thoshte kumbari i tij. Melankolia dhe zbrazëtia e kishin mbërthyer shpirtin e tij të dobët, dhe ai nuk dinte ç’të bënte, ndonjëherë nuk guxonte të dilte nga shtëpia. Bota i dukej një vend i tmerrshëm; demonë përvidheshin ngado. Vetëm duke mësuar pak nga pak më shumë për veten dhe natyrën e melankolisë së tij ai u bë i vetëdijshëm për lidhjen midis përvojave të tij dhe kthimeve të sëmundjes. Përvojat dhe sëmundjet do të futeshin përmes syve, hundës, gojës dhe lëkurës, po të mos tregonte kujdes ato do të ndërtonin një fole brenda tij dhe do të zhvilloheshin si salikorie apo myk. Ilaçe dhe metoda të ndryshme mund të përdroreshin për të frenuar përjetimet e këqija, për t’i mbajtur larg ato, por pasi ato kishin çarë rrugën për të hyrë në shpirtin e tij ishin njësoj si ai zakoni i keq, siç ishte pirja e pijeve alkoolike për disa. Vetëm ta provonin njëherë dhe ata s’e përmbanin më veten: mësimi keq i kishte në dorë. E tillë ishte edhe melankolia e Laurentiusit. Prandaj qëllimi i studimeve të tij kishte qenë të përforcojë zakonet dhe

përvojat e mira, dhe të shmangte ato të këqija. Dhe nëse nuk ia dilte t'i shmangte, atëherë të paktën ato mund të lehtësoheshin, zbuteshin dhe të mbaheshin nën kontroll. Tinktura kishte këtë efekt tek ai, njësoj si Klodia dikur.

Ai u shty lart rrënjëve me nyja të pemës së shëlgut, duke u përpjekur të mos bënte rrobat pis në lëvoren e lagësht, dhe filloi të kërkojë për një degë të përshtatshme. Rrafsh me fytyrën, ai mund të shihte disa qoka që dikush kishte bërë në trung. Tani ato ishin bërë gërvishtje të shëruara, dhe kishin marrë një pamje groteske të rrudhur. Laurentiusit ato i ngjanin me vulën e pavend të palexueshme të shpirtrave të Olimpmit, apo diçka e ngjashme. Por ngjitur me to ai mund të shihte disa degë të shtrira që kishin trashësi të përshtatshme, kështu që i hyri punës, duke fishkëllyer me vete. Ai shkuli disa copa të mëdha lëvoreje nga pema dhe i mbështolli ato me një copë letër. Këto duhet të mjaftojnë si fillim.

“E pra,” tha ai, dhe u kthye.

Ndërsa ndjeu ethet, që ia kishte dalë t'i harronte të kthehen furishëm si një vërshim gjaku në kokë, pothuajse desh i ranë thika dhe lëvorja e shëlgut nga dora. Duke u përpjekur të mbështetet, Laurentius u kap fort te një nga degët. Poshtë në rrëzë të pemës tre burra me pamje të ashpër po rrinin e vërenin në heshtje lëvizjet e tij. Me sa duket ata kishin njëfarë kohe që rrinin aty, duke parë ç'po bënte atje lart në pemë. Laurentius nuk kishte parë asnjë frymë njeriu ndërsa ecte përgjatë bregut të lumit, dhe nuk kishte dëgjuar hapa as murmurimë zërash. Ndoshta burrat ishin fshehur në hijen e bregut të lartë të lumit? Por ç'donin ata?

“Vetëm ca lëvore po mblidhja,” tha Laurentius pa ndonjë qëllim dhe bëri një gjest palezet me dorë.

Burrat pështynë mbi shpatull njëkohësisht dhe bënë disa hapa anash, por nuk dukeshin të kishin ndërmend të largoheshin.

Duke mbledhur supet dhe duke u shtirur moskokëçarës, Laurentius u përkul para, vuri përsëri thikën në çantën e tij të shpinës dhe letrën me lëvoren e vuri në një anë të saj. Tashmë ishte shumë i vetëdijshëm për sëmundjen e tij; nga ethet i kishin filluar t’i rrihnin tëmthat, dhe i merreshin mendtë. Burrat ende po rrinin atje, me kokën anash, duke shikuar lëvizjet e tij të ngathëta. Laurentius kujtoi atë që i tha tregtari për këtë pjesë të qytetit. I alarmuar, vuri me nxitim dorën në dorezën e shpatës së tij.

Burri që dukej më i vjetër tha diçka në estonisht dhe tregoi me gisht në drejtim të pemës.

Laurentius vështroi ndërsa të tjerët u ngjitën me vështirësi në pemë dhe filluan të shohin vendin ku ai ishte prerë lëvoren. Njëri prej tyre shpjegoi diçka me nervozizëm dhe ua bëri me shenjë të tjerëve. Dukej sikur në njëfarë mënyre i kishte zemëruar ata.

Laurentius hodhi mbi shpinë çantën dhe filloi ngadalë të largohej, duke shpresuar që situata do të zgjidhej vetë. Por fshatari që i kishte zënë rrugën nuk po e linte të largohej. Burri u përkul përpara tij disa herë me mirësjellje dhe pastaj filloi t’i shpjegojë diçka me një ton zëri shumë këmbëngulës, duke vënë gishtin në drejtim të tij ndërsa e bënte kështu. Laurentius uli vështrimin përtokë dhe tundi kokën.

“Nuk po kuptoj çfarë po thoni,” tha ai.

Burri shtrembëroi buzët me përcmim; turfulloi me vendosmëri, pastaj filloi të flasë përsëri, duke treguar me gisht pemën. Kishte marrë një qëndrim të pahijshëm, anash Laurentiusit. Laurentius filloi të lëvizë ngadalë mbrapsht, duke i hedhur një vështrim të shpejtë burrave dhe pemës ndërsa bënte këtë, dhe duke u përpjekur t’ua bënte të qartë se nuk fliste estonisht, por me sa duket burri që i kishte zënë rrugën nuk kishte ndërmend të tërhiqej.

“Hapu nga rruga!” bërtiti Laurentius, duke u përpjekur të dukej i inatosur dhe duke vënë dorën te doreza e shpatës së tij. Tashmë situata ishte bërë e sikletshme dhe e pakëndshme, por ai nuk habitej shumë që kishte ndodhur. Në çdo vend ku kishte jetuar herët a vonë e njëjta gjë kishte ndodhur. Njerëzit fillonin të dyshonin se ai kishte sy të keq; fillonin të përhapeshin thashetheme dhe pas pak i gjithë qyteti e merrte vesh. Madje edhe ata njerëz që nuk donin të pranonin haptas që besonin në syrin e keq fillonin ta shihnin ndryshe dhe flisnin me të të tërhequr.

“Çfarë po ndodh këtu?” pyeti dikush papritur në suedisht.

Laurentius mori frymë i lehtësuar dhe u kthye andej nga vinte zëri. I përkiste një studenti që dukej mjaft i ri në moshë, po të gjykoje nga bastuni dhe çizmet me baltë, do të thoshe se atë ditë kishte bërë rrugë të gjatë. .

“Laurentius Hylas,” tha Laurentius, duke u paraqitur. “Këta fshatarë duan të më thonë diçka, por s’kuptoj asgjë nga ato që po më thonë.”

“Peter Börk, nga Dalarna,” tha i riu.

Ai filloi të flasë me burrat që treguan me gisht pemën dhe Laurentiusin pastaj pështynë përsëri mbi shpatullën e majtë I ri dhuroi një buzëqeshje të madhe, mblodhi supet, dhe iu drejtua Laurentiusit në suedisht: “Për fat të keq ka patur një keqkuptim. Burrat pretendojnë se t’i po bëje një lloj magjie. Thonë se të panë duke prerë zinxhirët e disa shpirtrave që rrinin fshehur brenda pemës. Janë të bindur se ke syrin e keq.”

“Epo, sa injorantë janë treguar,” tha Laurentius, duke u përpjekur të qeshë me Peter. “Isha duke mbledhur vetëm ca lëvore shelgu për qëllime shkencore.”

Kur dëgjoji këtë Peter ngriti vetullat, por pastaj u kthye dhe foli përsëri me burrat, duke i thënë çdo fjalë ngadalë dhe me kujdes. Ata qëndruan atje dhe tundën kokat me shprehje

të ashpër në fytyrë, dhe me sa duket po këmbëngulnin në disa pika.

Peter mblodhi supet dhe ia bëri me shenjë Laurentiusit të vinte me të. “Le të vihemi në lëvizje; nuk ka asnjë shpresë ta zgjidhim këtë ngatërrësë.”

Ai tundi bastunin e tij disa herë me zemërim dhe e mori për krahu Laurentiusin. Fshatarët të vrenjtur i panë ndërsa ata largoheshin.

“Ec ngadalë dhe me kujdes,” tha Peter. “Mos shih pas tani.” Përse?” e pyeti Laurentiusi.

“Jetojmë në kohëra të këqija; njerëzit janë çmendur fare. Nuk ia vlen t’i nxehim shumë. Ata kujtojnë se kërkon t’i shohësh me sy të keq,” shpjegoi Peter.

Ndërsa largoheshin Laurentius mund të ndjente vështrimet gjithë urrejtje të burrave ta ndiqnin nga pas.

Më në fund Peter u kthye nga Laurentiusi dhe e pyeti “Përse po merrje lëvore gjithsesi? Në situatën e tanishme njerëzit do të fillojnë të mendojnë lloj lloj gjërash.”

“Në fakt e mora për të bërë pak tinkturë,” shpjegoi Laurentius. “Jam sëmurrur këto kohët e fundit dhe është e vetmja gjë që mund të më lehtësojë ethet.”

Peter psherëtiu. “Që ta dish, s’është e lehtë të merresh vesh me këta fshatarë. Kur i ngulitet diçka në kokë, në botë s’mund t’ia heqësh. Janë njerëz shumë dyshues, shohin shtriga ngado. Është diçka e mirë që sistemi ynë gjyqësor funksionon mirë, përndryshe tashmë ata do të kishin vlarë gjysmën e popullsisë. Një copë herë më parë dogjën rrafsh me tokën mullirin Vōhandu sepse kujtuan se shkaktonte motin e ftohtë. Ka mundësi të kenë të njëjtat mendime për motin e keq që po bën tani, duke kërkuar dikë që ta fajësojnë. Jetojmë në kohëra shumë të turbullta,” tha Peter, duke tundur kokën mendueshëm

“Them se gjërat kështu qëndrojnë ndonjëherë, s’ke ç’i bën,”

vazhdoi ai, ndonëse tani dukej pak më i pasigurt në vetvete. “Ndonjëherë ka periudha historike të tilla. John Napier bëri një parashikim matematikor se bota do të përfundojë në 1697. Dikush tundohet ta besojë atë, ndonëse të gjithë parashikuesit përmendin vite dhe data të ndryshme. Pikërisht sot në mëngjes po ecja buzë bregut të lumit, dhe po shkruaja gjashtërokësha. Kisha gati një orë që po ecja pa parë këmbë njeriu. Por më pas në një farë pike dikush më afrohet nga pas, një tjetër del nga pylli, dhe më në fund dikush mbërrin në kurriz të kalit.” Peter pa shprehjen e fytyrës së Laurentiusit, duke kërkuar me sy konfirmimin që ai nuk ishte hedhur në një temë të re.

“Më në fund të gjithë takoheni; përfundoni duke ecur krah për krah në të njëjtën rrugë, dhe njerëzit shtrëngohen e rrinë në siklet...por pastaj pas kësaj askush vjen për një kohë të gjatë. Gjëra si këto ndodhin gjatë gjithë kohës. Të tilla janë kohët në të cilat jetojmë. Një ngjarje tundon tjetrën...dhe pastaj gjithçka ndodh njëherësh. Ka shumë shenja që fundi është afër, por askush nuk di t’i shpjegojë si duhet,” përsiati në mënyrë filozofike, duke qëlluar fort fijet e barit me bastunin e tij ndërsa ecte.

“Unë pajtohem me mendimin se fundi i botës nuk përcaktohet në një çast specifik por është më mirë diçka vetjake,” kundërshtoi Laurentius. “ Është një fund vetjak, siç thoshin dikur teologët e parë. Të gjithë vdesim por asnjë nuk e di se kur. Është e njëjta gjë me fundin e botës; nuk ka ndonjë ndryshim të madh.”

“Vërtet,” tha Peter me një buzëqeshje vesh më vesh, duke fluturuar përpjetë një lule bar pezmi me një rrahje të bastunit të tij. “Por prapëseprapë më bën të pyes veten. Kur sheh mjerimin dhe vuajtjet e fshatarëve, nuk mund të mos mendosh se fundi i botës do të ishte gjëja më e mirë për ta.”

“Por ç’thanë ata fshatarët për magjinë?” pyeti Laurentius, duke ndryshuar temën.

“Oh, njëfarë historie për një mbret shëlgjesh. Qoftëlargu jeton

në zgavrat e trungjeve të shelgjeve të gjata. Dhe se mund ta dallosh shtriganin e keq duke e parë në sy. Një histori shumë e ngatërruar; as unë nuk arrij ta kuptoj plotësisht.”

Pasditja e Së Mërkurës

PROFESORI DIMBERG po shfletonte temën e diplomës së Laurentiusit i përqendruar, duke tundur kokën me vete, herë pas here.

“Jo keq, aspak keq,” komentoi ai.

Ndërkohë Laurentius po ecte poshtë e lart nëpër dhomë, duke vështruar instrumentet dhe aparatet matës të Dimberg. Atij i ishin kthyer ethet, dhe ndonëse mund të mendonte ende me kthjelltësi, gjithçka i dukej sikur kishte ngjyrën e gabuar. Ai kishte ecur me Peter-in deri te ndërtesa e akademisë dhe pastaj ai i kishte treguar rrugën për te Dimberg. Teksa po largohej ai i tha Laurentiusit që duhet patjetër të vinte në banketin e të nesërmes, dhe shprehja dinake e fytyrës së tij linte të kuptonte se pritej të bëhej festë në shkallë të gjerë.

Ai i kishte rrahur shpatullat Laurentiusit në mënyrë miqësore dhe i përsëriti, “Sigurohu të vish!”

Laurentiusit i kishin filluar përsëri ethet dhe pas frikës që e zuri pranë pemëve të shelgjeve, dhe tani mund t’i ndjente të bëheshin gjithnjë e më të forta. E dinte se duhet të rrinte shtrirë në qetësi në dhomën e tij, dhe të priste shërbyesen të vinte dhe të ndizte zjarrin dhe të mbushte dyshekun me kashtë të freskët, që ai të mund të flinte aq sa mund ta zinte gjumi. Por nuk kishte zgjedhje: ai duhet të kalonte provimin.

Ai puliti sytë dhe fërkoj tëmthat. Drita që pasqyrohej në

objektet e xhamit të verbonte, dhe pasqyrimi tek ata prej bronzi ishte tepër e gjelbër, si ngjyra e barit pranveror. Ai mund të dëgjonte njëkohësisht t'i gjëmonin veshët. U përpoq ta detyrojë veten të mendojë qetësisht dhe të kuptonte përdorimin e të gjitha instrumenteve. Ishte e qartë që kimia dhe astronomia ishin në interesin personal të profesorit, dhe Laurentius dalloi disa pajisje të ndryshme moderne, duke përfshirë këtu një astrolab gjeometrik dhe në krye të vendit ishte një teleskop mbresëlënës dymbëdhjetë kut. Ai duhet të duronte edhe pak.”

“Sa keq që s’ke përdorur kërkimet e fundit,” tha më në fund profesori.

“Kam studiuar thellë traktatin e Frommann mbi syrin e keq, por nuk m’u duk e nevojshme të kumtoja të gjitha pikëpamjet e tij,” tha Laurentius duke u përpjekur të jepte një përgjigje sa më të plotë dhe të qartë. Por po kuptonte që zëri i tij tingëllonte pak çuditshëm, sikur të fliste përmes një tubi. “Për mendimin tim puna e tij bazohet së tepërmi në konceptimet popullore të problemit; ai mund të kishte përfituar nga një qasje më shkencore.”

Ai kishte lexuar të gjithë literaturën e disponueshme mbi syrin e keq, por nuk kishte arritur ta kuptojë fenomenin. Në përgjithësi, autorët kishin paraqitur më vete parashtrimet e tyre; asnjë prej tyre nuk kishte sjellë me një teori shkencore të plotë. Por nga leximet që kishte bërë kishte kuptuar se sytë nuk komunikojnë vetëm natyrën e tyre, sytë mund të shihen si të gjithë objektet e tjerë, por gjithashtu përcjellin të gjithë qenien e të zotit, gjendjen e tij shpirtërore. Kjo shpjegonte zanafillën e shprehjes që sytë janë “pasqyra e shpirtit”. Ne përmes syve shikojmë anët e personit që mund të mbeten të fshehura me një shqyrtim më sipërfaqësor. Literatura thoshte se krijesat më të egra madje mund të vrasin me një shikim. Plini Plak shkruante se kishte gra të lindura në Skiti që quheshin Bythiae të cilat thuhej se kishin dy bebe në secilin sy, dhe nëse zemëroheshin shumë mund të vrisnin dikë vetëm duke e

parë. Dikush mund të nxirrte përfundimin se prania e dy bebeve të syrit ishte çelësi, sepse ishte bebja e syrit ajo që përmbante *virtus visiva*, kështu që e gjithë përmbajtja e zemërimit të madh të Bythiae-s mund të përcillej me një forcë shumë më të madhe nëpërmjet një bebeje syri të vetme.

“Frommann është i kujdesshëm dhe i saktë, por nuk jep një shpjegim të plotë,” tha Dimberg duke u pajtuar. “Sapo jam kthyer nga Anglia, ku po bëhet një punë e madhe në fushën e forcave okulte.”

“Oh vërtet?” tha Laurentius, i lehtësuar që Dimberg i jepte përshtypjen se e kishte kuptuar. Gjithçkaje që i hidhte sytë dukej sikur ishte e veshur me mjegull, dhe gjuhën e ndjente sikur ishte mbështjellë me leckë.

Dimberg iu afrua aparatit të distilimit i cili ishte vendosur më këmbë në njërën nga tryezat, preku lehtë njërën nga shishet e laboratorit dhe me një nxjerrje të frymës me shumë etikë tha, “Molekula dhe avuj.”

Laurentius mund të hamendësonte cilin drejtim do të merrte tani biseda e tyre. Frommann gjithashtu fliste për avuj dhe erë të qelbura në kontekstin e magjepsjes. Por sigurisht ishte e pamundur të shpjegoje plotësisht procese të tilla me teorinë e avujve. Sipas pikëpamjes së Laurentius teория e Aristotelit e elementëve dhe trajtës ofronte një shpjegim shumë më të kënaqshëm, të cilin Laurentiusi e kishte vërtetuar në përvojat e tij personale, të cilat shpesh s’kishin qenë aspak të këndshme. Por do të ishte fort e pavend të filloje të ndërtoje një teori magjepsjeje bazuar thjesht në përvojat personale. Po t’i hynte asaj rruge do të ishte me fat t’i shpëtonte pa u bërë gazi i botës; në rastin më të keq mund të përfundonte në gjyq. Mbrojtja e temës së tij të diplomës në Leiden i kishte hapur probleme, të cilat kishin marrë përmasa të tilla sa Laurentius kishte dyshuar nëse do të ishte me mend të ndante me të tjerët përsëri punën e tij. Sigurisht, në temën e diplomës nuk ishte

shkruar asgjë që dikush të kapej, ai e kishte fajësuar veten ndërsa hahej me kundërshtarin e tij, gjatë diskutimit. Ishte saktësisht ajo lloj pamaturie për të cilën tani betohej se do ta shmangte. Duhet të mësonte të kafshonte gjuhën.

“Do të isha i interesuar të dëgjoja më shumë,” tha ai, duke e nxitur Dimberg-un të vazhdonte.

“Robert Boil ofron këtu zgjidhjen më të qartë dhe dhe më të kuptueshme,” ia nisi profesori, duke gjetur kënaqësi në mundësinë për të treguar njohuritë e tij.” “Molekulat e avullit ngjiten nga organizmi i një qenieje te një tjetër, dhe pastaj e infektojnë atë. Për shembull, kur dikë e kafshon një qen i tërbuar, pjesa përkatëse e trupit infektohet, konkretisht koka. Kështu molekulat nga pështyma e qenit shkakton një transformim në mendjen e personit. Disa lloje molekulash janë të afta të...” Dimberg-u kishte ngritur zërin, dhe u ndal një copë herë për të vënë në dukje atë që po thoshte.

“Janë të afta, e përsëris, të përdorin parimin e afrisë, t’i bëjnë gjërat e tjera të ndryshojnë, dhe të bëhen si to. Kthimi i metalit ndodh saktësisht në të njëjtën mënyrë, sigurisht, ashtu si vetë Kimisti ka demonstruar. Ai e krahasoi këtë veti me mënyrën se si rriten farat: tregoni vëmendje, tani! Disa molekula janë të afta të kapin dhe të mbartin të tjera me vete. Për shembull, kur nga një farë rritet një pemë, lënda e saj nuk vjen vetëm nga fara; vjen nga ajri, toka dhe uji, por forma dhe trajta e saj jepen nga shpirti që fshihet brenda farës.

Dimberg i soll përqark në mënyrë teatrale dhe mori nga rafti një kopje të librit *Kimisti Skeptik* të Robert Boil *Sceptical Chymist*.

“Pa shihe njëherë vetë; është një punë e shkëlqyer. Ta këshilloj fort që të familjarizohesh me të.”

Laurentius tundi kokën. Teoria e Boil ishte mjaft bindëse, ndonëse e dinte se kishte kundërshtime ndaj saj. “Afria është ende një koncept shumë i paqartë; është e vështirë të kuptosh si mund

të funksionojë.”

Dimberg vuri librin mbi tryezë dhe eci poshtë e lartë nëpër dhomë. “Pajtohem. Teoria ka hasur vërtet kritika, por mbetet shpjegimi më i logjikshëm që kemi. Sigurisht, njerëzit kanë kundërshtuar edhe teorinë e gravitetit sepse përshkruan një forcë të fshehur dhe në dukje okulte. Prandaj nuk mund të jetë shkencore, thonë! Imagjinoje pak! Por sigurisht ata nuk mund të mohojnë se ajo i përshtatet modeleve matematikore të tanishme më shumë se cilado teori tjetër. Jam i bindur se janë pikërisht këto lloj forcash që veprojnë midis molekulave. Papajtueshmëria, afria dhe graviteti.”

Ai qëllloi me pëllëmbë të dorës tryezën për të theksuar këtë pikë, duke i bërë të kërcasin shishet e laboratorit dhe instrumentet matëse.

Laurentius tundi kokën. Ai as nuk donte dhe as nuk ishte i zoti të hahej me fjalë; Dimberg e kishte shprehur mendimin e tij, dhe nuk kishte të ngjarë të tërhiqej prej tij tani.

“Shumë interesante,” tha ai për të treguar pajtimin e tij në përgjithësi. Dimberg buzëqeshi triumfalisht. “Teoria korpuskulare aktualisht ka fuqinë shpjeguese më të madhe. Nga shpirtrat dhe frymërat, te rastet e njerëzve që ngrihen prej së vdekuri, gjithçka shpjegohet në terma mekanikë. Absolutisht gjithçka!”

Laurentius buzëqeshi me ankth. Dimberg duhet ta kishte pyetur për bindjet e tij fetare, por Laurentiusi kishte përshtypjen se pyetjet mund të lindnin nga vetë idetë e profesorit. Teoria mekaniciste në vetvete nuk ishte në kundërshtim me Ortodoksinë Luterane; ishin vetëm disa degëzime të mundshme që linin vend për pyetje.

Dimberg po vëzhgonte Laurentius, duke u përpjekur qartazi të vlerësojë reagimin e tij. “Marr me mend se nuk je kundra ta mbaj një copë herë temën tënde të diplomës? Do të doja ta lexoja më mirë, dhe jam i sigurt se edhe Profesori Sjöbergh do të donte t’i hidhte një sy. Me sa duket këtu paske mjaft mendime interesante,

ndonëse i shprehni në mënyrë disi të paqartë dhe të ngatërruar. Ju këshilloj të ndiqni leksionet private të Profesor Sjöbergh të premtën në mëngjes, ai tani trajton temën e shpirtit. Mund të mësosh disa gjëra. Nesër nuk kemi leksione sepse do të bëhet banketi. Je ftuar apo jo, ma merr mendja?” Dimberg u ndal që Laurentius të tundte kokën me miratim.” Shumë mirë. Por duhet të vish patjetër të premtën. Kam dëgjuar se Sjöbergh planifikon të paraqesë disa mendime të reja mbi temën. Sapo kam sjellë literaturë nga Anglia për të, kërkimet më të fundit!”

Dimberg ngriti lart gishtin dhe eci nëpër dhomë i heshtur ashtu për disa çaste, i zhytur në mendime.

Më në fund u ndal dhe eci duke iu marrë këmbët drejt Laurentiusit. “Ishte kënaqësi e madhe,” tha ai me ceremoni, dhe i shtrëngoi dorën ngrohtësisht Laurentiusit. “E kalove shkëlqyeshëm provimin; mirëserdhe në vëllazërinë e Akademisë Dorpat.”

Pastaj tërhoqi dorën me të njëjtën lëvizje të befasishme dhe qëndroi duke e parë mendueshëm. “Hmm. E paske dorën të nxehtë. Mos ke ethe?”

“Po,” pohoi me ngurrim Laurentius. Ishte e kotë të përpiquej ta fshihte.

“Ç’ilaçe merrni?” pyeti profesori.

“Përpiqem ta kundërpeshoj elementet e nxehtë dhe të lagësht të etheve me tinkturë shelgu,” tha Laurentius, duke kuptuar në çast se duhet të kishte thënë diçka tjetër, ose asgjë fare. Përkrahësit e Boil dhe Njuton e mendonin të vjetruar teorinë e elementëve .

“Elementet!” kundërshtoi me klithma i habitur Dimberg. “Është një mënyrë krejt e gabuar dhe do të të sëmure më shumë. Duhet të gjesh *spiritus*-in e sëmundjes. Boil flet edhe për këtë. Molekulat që ngjisin shpirtin e sëmundjes duhet të shkatërrohen. Nuk ka asnjë mënyrë tjetër. Zbërthim i plotë, *nigredo*, kjo nevojitet. Përpara kësaj asnjë ndryshim nuk do të ndodhë.”

Laurentius tundi kokën. “E njoh në vija të përgjithshme atë

teori, por duhet të pranoj se një pikëpamje e tillë e shpirtit është e papajtueshme me bindjet e mia.”

“Nuk beson se substancat dhe sëmundjet kanë shpirta?” pyeti Dimberg, duke ngritur vetullat. “Gjërat kanë shpirta, ta them unë! Ato e shfaqin veten në mënyra të ndryshme. Madje fantasia u jep atyre trajtë. Mos do të më thuash pastaj që nuk beson se shpirti ekziston!”

Laurentius tundi kokën. “Sigurisht që besoj në ekzistencën e shpirtit. Për këtë s’ka dyshim.”

Dimberg hodhi një vështrim dyshues në drejtim të tij, ndoshta duke kujtuar rregullat e shqyrtimit të studentëve dhe kuptoi që nuk kishte kontrolluar fare pikëpamjet teologjike.

“Pra që shpirti është i pavdekshëm?” Bëri ai një pyetje zhbiruese.

“Ekzistenca pas vdekjes e shpirtit shpjegohet qartë në Bibël, dhe për më tepër mund të provohet shkencërisht,” tha Laurentius duke mbajtur qëndrimin më konservator teologjik të mundshëm. Disa prej radikalëve në Leiden kanë qenë të pikëpamjes se Bibla nuk thotë asgjë që shpirti ekziston në mënyrë të pavarur nga trupi pas vdekjes. Kjo pyetje për pavdekësinë e shpirtit ishte një temë e përhapur debati në rrethet më mendjehapura.

“Hmm? Por si është kjo puna e gjërave që kanë shpirt?” pyeti Dimberg, duke mos dashur ta lërë të qetë Laurentiusin.

“Siç e thatë edhe ju, i krijon imagjinata,” sugjeroi Laurentius.

“Në këtë pikë gabohesh. Imagjinata i jep formë, por ato ekzistojnë në mënyrë të pavarur nga imagjinata jonë apo perceptimet tona ndijore. Akademikë të ndryshëm kanë bërë studime mbi temën e poltergaistëve (fantazmave të zhurmshme, dhe vetë Profesori ynë Michael Dau ka shkruar gjithashtu për to,” tha profesori.

Laurentius u përkul. “E pranoj se jam pak i informuar mbi aspektin e frymës dhe të shpirtit. Por jam i lumtur që do të marr

këshillimin e një eksperti mbi temën në një këtë universitet.”

Dimberg ishte pa dyshim i kënaqur me argumentimin e fundit të Laurentiusit dhe miratoi me hungërimë. “Ma merr mendja se je mësuar me programin e leksioneve? Këtë semestër do të flas për parimet matematikore dhe gravitetin të Njutonit, të cilat janë sigurisht shumë të rëndësishme për të kuptuar çështjen e shpirtit. Pres me padurim të t ë shoh në leksionin tim javën tjetër.”

Laurentius u ndie i pamundur ta vazhdonte më tej bisedën. Ishte i përgjumur nga ethet, dhe proceset e të menduarit i ishin ngadalësuar. Por kishte dëgjuar mjaftueshëm për t’u bindur se të menduarit e Dimberg ishte mjaft modern dhe përparimtar. Kur ishte në Leiden Laurentius kishte dëgjuar sigurisht për teoritë e Njutonit, por askush nuk i kishte pranuar haptas apo t’i përfshinte në një program zyrtar leksionesh. Atje përkrahnin filozofinë e Dekart-it.

“Ju jam mirënjohës,” tha Laurentius.

Dimberg buzëqeshi dhe filloi të rrëmojë në vandakët e letrave që kishin mbuluar tryezën. Pas një copë here nxorri një fletë letre dhe qëndroi duke e parë me një shprehje hijerëndë në fytyrë.

“Mbi jetën studentore dhe shprehitë,” e informoi ai Laurentiusin me një ton zëri zyrtar. “Sigurohu të familjarizohesh me të. Mos përto. Por sonte duhet të mjekosh sëmundjen. Duhet patjetër ta bësh këtë.”

“Vërtet duhet ta bëj,” përsëriti Laurentiusi. “Do të mund të më jepnit ndonjë këshillë në këtë drejtim?”

Dimberg u gjallërua përsëri. “Përse, marrja e gjakut sigurisht! Së pari duhet të mposhtësh shpirtin e sëmundjes, ta dëbosh dhe ta shkatërrosh. Në kemi këtu një kirurg “berber” që e bën mirë atë punë. Gjaku i keq duhet të nxirret jashtë. Por pa teprim. Siç thotë Boil, edhe marrja e tepërt e gjakut nuk ishte ide e mirë. Pa teprim, më dëgjon? Dhe pas procedurës Boil këshillon të merret esencë ari, *aurum potabile*.”

“Dhe nga ta gjej? Pyeti Laurentius, duke u bërë edhe më i interesuar.

Dimberg për një çast u duk sikur s’po i vinin fjalët. “Për fat të keq ai flet në terma shumë të përgjithshme në këtë pikë,” shtoi ai me një zë më të ulët. Pastaj u kthye nga rafti i librave dhe filloi të shohë librat, duke turfulluar lehtë me vete. “Vërtet mjaft e përgjithshme.” Dimberg vështroi ngultas përhumbshëm anët e librave, dhe Laurentius-it iu krijua përshtypja se problemi i përgatitjes së *aurum potabile* e kishte shqetësuar për ca kohë tashmë. Pasi lëvizi sa para prapa mbi takat e këpucëve një copë herë u kthye përsëri me fytyrë nga Laurentius. “Por marrja e gjakut është çështja. Marrja e gjakut me masë. Me këtë duhet t’ia nisësh. Mos harro, *nigredo* është e domosdoshme me çdo kusht!”

Mbrëmja e së Mërkurës

LAURENTIUS I RA PËRQARK NGA PRAPA kishës së Shën Gjonit dhe doli në rrugën kryesore, dhe pastaj u nis në drejtim të sheshit të bashkisë së qytetit. Fytyra i digjte nga ethet dhe u ndie në ankth si ajo ora me kurdisje, që bën tik tak ndërsa susta e saj çmbështillet. Së pari duhet të reagonte ndaj idesë së marrjes së gjakut të Dimberg njësoj si ndaj çdo këshille të rastit, por pastaj kuptoi, për habinë e tij, që ai në fakt donte ta bënte. Ora bënte tik tak, dhe këmbët e tij e çonin përpara. Duke ndjekur udhëzimet e Dimberg ai shumë shpejt mbërriti në një ndërtesë me një emblemë me të kuqe e të bardhë që varej në një shtyllë jashtë, që i bënte reklamë klinikës së një kirurgu “berber”. Sipas Dimberg pronarët e saunës kohët e fundit kishin filluar të ofronin edhe shërbime të marrjes së gjakut, por pajisjet e tyre në përgjithësi ishin të papastra, dhe kishte patur raste të përsëritura të klientëve që ishin bërë më keq se ç’kishin qenë më parë. Praktika të tilla u ndaluan dhe e drejta për të marrë gjak dhe operacionet e thjeshta kirurgjikale i kaloi doktorëve dhe kirurgëve “berber” të qytetit. Pronarët e saunave kishin nam të keq, dhe shpesh mund të shiheshin duke u endur andej këndeve gjysmëlakuriq, dhe duke hyrë si kodosh hapur. Dimberg i kishte rrëfyer Laurentiusit me njëfarë keqardhjeje që ende nuk ia kishin dalë të hapnin një klinikë moderne në Dorpat, ndonëse Below, the profesori i mjekësisë,

kishte theksuar vazhdimisht rëndësinë e kësaj.

Laurentius i hodhi një sy edhe njëherë bisturisë dhe thikës në emblemë, sikur donte të sigurohej mirë që ishte vendi i duhur, më pas hyri brenda disi duke u matur. Gjërat e para që i zuri syri ishin një dysheme e lustruar me dyll, një çarçaf i palarë me një njollë të errët që ishte hedhur sipër një tryeze dhe burrin me pamje të ftohtë që ishte ulur aty. Ai kishte veshur një pallto të madhe të gjatë të zbukuruar me qëndisje të modës dhe një parukë të madhe për të rënë në sy, e cila ishte me kaçurrela dhe e pudrosur.

“Përshëndetje,” tha Laurentiusi.

“Ke ardhur për parukë? tha kirurgu “berber” me një zë monoton me një theks të papërcaktuar. “Flokët i ke shumë keq; do të t’i shkurtojme. Duhet rregulluar. Parruket e mia janë të cilësisë së parë, të gjithë zotërinjtë në qytet i blejnë te unë.”

Laurentius u përkul, duke u siguruar gjatë gjithë kohës që t’i mbante sytë ulur. “Në fakt erdha për marrjen e gjakut.”

“Ah, ashtu? Kam frikë se sot s’ka mundësi,” u përgjigj kirurgu “berber”, duke u dukur i zhgënjyer. “Ke ardhur në një kohë të papërshtatshme. Marsi është në një pozicion të pafavorshëm dhe sjell sëmundje. Por mund t’ju bëj një klizmë apo hedhje të kupave, janë në fakt më të mira se marrja e gjakut. Kushtojnë pak më shumë, por ia vlen.”

Laurentius qëndroi atje i pavendosur.

“Është për të mirën tënde,” i shpjegoi kirurgu “berber”. “Njeriu duhet të sigurohet ta bëjë marrjen e gjakut në ditë të caktuara.” Ai tregoi me gisht një copë letër në mur. “Kam shkruar gjithçka atje; ua dhashë matematicienëve të m’i llogaritnin. Është shumë e saktë dhe e besueshme. Por hajde brenda; do të të vëmë disa kupa menjëherë. Tani do të ishte çasti i volitshëm për të bërë një klizmë. Në një mënyrë apo në tjetrën duhet të dalësh jashtë, përpara marrjes së gjakut.”

Ai seç çakëlloi e kërciti në dollapin e tij dhe nxori një pompë klizme me pamje të qëndrueshme me një dorezë druri. Dukej e ngrënë nga përdorimi, dhe nuk dukej as e pastër. Kirurgu “berber” e pa me pamje të ngrysur ndërsa bëri disa lëvizje pompuese, pastaj tundi kokën me miratim. Laurentius e mori për erën e urinës dhe të feçeve kur i shpuan hundët, por që shpresoi të ishte vetëm një trillim i imagjinatës së tij tejet të fuqishme. Në atë çast mundësia që kjo ishte grahma që e kishte edhe më parë në vrimat e tij të hundës, që vinte nga tëmthi i zi i shpirtit të tij, dukej shumë më tërheqës së shpjegimi tjetër. Ai u drodh dhe shtrembëroi fytyrën. Klizmat ishin një lloj i zakonshëm mjekimi, por ai i kishte patur gjithmonë dyshues ndaj tyre. Ai i zbrazte zorrët në mënyrë të natyrshme sa herë të ishte e nevojshme, dhe s’kishte përse ta bënte këtë me ndihmën e një procesi artificial.

Duke vënë re reagimin e Laurentiusit shprehja e fytyrës e kirurgut “berber” u bë serioz dhe tundi kokën, duke hedhur sa andej këndej cullufet e tij të gjata. “Lëri tek; vetë Mbreti i Francës bën klizmë rregullisht, nuk mund të jesh më buzëhollë se ai. Fillimisht do të të pastrojmë me furçë, pastaj do të të bëjmë një klizmë të mirë.”

“Pothuajse nuk kam ngrënë asgjë gjithë ditën; s’është e nevojshme ta bëj,” tha Laurentius, duke u përpjekur të kundërshtonte me mirësjellje.

“Një gjë është të hash dhe një gjë krejt tjetër është të pastros zorrët. Grekët e lashtë dinin gjithçka për spastrimin e zorrëve, katarsis e quanin. Këtu qëndron e gjithë çështja e klizmës. Do të të shpëlajmë zorrët dhe do të bëhesh fringo i ri,” këmbënguli kirurgu “berber” duke folur e duke u shtyrë ngadalë më pranë Laurentiusit.

Laurentiusit iu krijua përshtypja se ai po planifikonte të bënte procedurën aty për aty, pa e çarë shumë kokën nëse kishte

apo jo pëlqimin e klientit.

“Kjo është e vërtetë, por e thashë më shumë në kuptim figurativ,” tha Laurentius, duke u zbrapsur ngadalë nga dera. “Të paktën, kështu ishte sigurisht në rastin e Aristotelit.”

“Oh, i kam bërë klizmë të gjithëve këtu: rektorit, profesorëve, madje edhe grave të tyre.” Zëri i kirurgut “berber” mori një ton të trishtuar. “Dhe sigurisht jo në kuptimin figurative. Të gjithëve iu bë katarsis, kjo është e sigurt.”

“Profesor Dimberg në fakt më këshilloi të më merrnin gjak; duhet të mjekoj sëmundjen tim,” u përpoq të kundërshtonte Laurentius.

“E di që do të shërosh sëmundjen tënde, por uli pantallonat dhe eja të ulesh te kjo karrige. Do të vendosim edhe një sahan poshtë teje,” tha kirurgu “berber” duke mos patur ndërmend t’ua vërë veshin kundërshtimeve të Laurentiusit.

Laurentius hodhi një vështrim të shpejtë pas tij, hapi me gishta derën me tahmim, dhe duke bërë një buzëqeshje me zor doli pa u ndier. “Mund të kthehem në një çast më të volitshëm,” tha ai me ngut, përpara se të zbriste rrugës si shigjetë.

“Dreqi ta marrë! Punë e katranosur!” tha ai me fishkëllimë nëpër dhëmbë.

Laurentius ndjeu se sapo shpëtoi paq. I pushtuar nga një ndjenjë e përzier euforie dhe paniku, eci rrugës në drejtim të universitetit, duke u përpjekur të mblidhte mendjen. Po tani? Ideja e të shkuarit te një tjetër kirurg “berber” për marrje gjaku tani dukej si budallallëk. Pas atij episodi me ndryshimin tepër entuziast nga katarsis nuk kishte asnjë dëshirë t’i binte në duar një tjetri mashtruesi që i dilte përpara. Madje edhe të mendonte për këtë bënte që grahma në vrimat e tij hundës të bëhej aq e fortë sa ai duhet të ndalej dhe të gulçonte.

“Dreqi e mori,” mallkoi ai me zë të ulët me vete, dhe u përkul përpara me duar mbi gjunj dhe u përpoq ta qetësonte

veten. Flokët i kishte të lagura nga pikëlat e shiut që s'pushonin së rëni, dhe mund të ndjente pika të ujit të shiut t'i shkonin çurkë jakës. Po binte ngadalë muzgu dhe rruga dukej sikur priste të mbërrinin hajdutët dhe vrasësit; ishte ajo kohë e ditës që sillte gjithmonë një nervozizëm të pakëndshëm. Nëse ende donte t'i merrej gjaku, atëherë gjëja më e mirë që duhet të bënte do të ishte të gjente dikë që ishte i mirarsimuar dhe më pak skllav i astrologjisë, dikush që të ngjallte besim që dinte s'e ç'bënte. Por ku mund të gjente dikë të tillë në këtë qytet të panjohur? Te farmacisti? Ndonëse mund të qëlloje të gjeje një farmacist me shkollë të lartë dhe me kompetencë në fushën e tij, dyqanet e tyre kishin tendencës të ishin strofka kumari dhe të pirjes së birrës, dhe nuk ishin kundër as ndaj pijeve më të forta. Në makutërinë për të shitur ilaçet e tyre ata mund të harronin të kishin mësuar ndonjë gjë për shkencat mjekësore, dhe do të fillonin të përpiqeshin të ta hidhnin duke të të dhënë lloj lloj përzierjesh të dyshimta. Barna qetësuese të bëra vetë, pudra, dhe llapa, dhe dreqi e di ç'tjetër. Ata do të fantazonin për t'u vendosur emra tepër të fryrë dhe të pakëndshëm si "Tableta të bardha të Rhazes" ose "vaj krimbash". Në pjesën më të madhe këto preparate nuk shërbenin për asgjë, megjithëse duhet t'i blejë me një çmim bukur të lartë. Laurentius vendosi të shtynte për më vonë kërkimin në farmacitë vendase. Gjithsesi ai duhet ta bënte vetë një procedurë të thjeshtë si marrja e gjakut. Ai ndoshta i kishte të gjithë mjetet e nevojshme; e rëndësishme ishte vetëm të përgatitej mirë për të....

"Po," tha Laurentius me vete. "Sigurisht."

Duke ndjerë se kishte mbërritur në njëfarë vendimi, ai u nis nëpër këmbësoren me gur kalldrëmi. Ndërsa ecte vuri re se si shiu kishte shpëlarë rërën midis gurëve, duke krijuar një model të gjatë breza breza nëpër tokë. Buzë rruge ishin hedhur plehra në baltë, dhe mund të shihte pika drite të verdhë

që pasqyroheshin aty këtu në pellgjet me ujë. Ishin të njëjtat drita të dridhura që ndriçonin fasadat me bojë të shtëpive dhe kalimtarët me formën e trupit të kërrusur dhe pallto të mëdha të ndritshme. M'u përpara tij ai vuri re një burrë dhe grua të rinj në moshë që po ecnin më nge, zënë dorë për dore, dhe që me sa duket e kishin harruar shiun. Laurentius nuk mundi të mos mendojë nga e pamja dhe nga e ecura se diku duhet të kishte parë këtë grua të re.

Ai e ngadalësoi pak hapin që të mund të vrojtonte më mirë flokët e lagur që i dilnin nga kapela, duke shpresuar se atje do të shihte një fytyrë të njohur.

“Flokët i kishte njësoj si...” Laurentius e gjeti veten duke menduar.

Pamja e jashtme e kësaj vajze që kishte dalë nga mjegulla e lagësht i ngriti moralin në mënyrë të pashpjegueshme. Mund të ishte vallë e njëjta zonjushë që kishte qëndruar te shkallët në dhomën e tij me qera dje në mbrëmje, me të cilën ai kishte folur? Laurentius tundi kokën. S'donte të ngutej shumë për ta zbuluar. Fundja, ai nuk mund t'i afrohej vajzës dhe të fillonte të shqyrtonte me imtësi fytyrën e saj, do të ishte e pasjellshme.

“Sigurisht, përse duhet ta vë në dyshim? Ka shumë mundësi që të jetë e njëjta,” tha ai me vete.

Kishte shumë të ngjarë që vajza e re të jetonte diku aty pranë, dhe kjo ishte arsyeja që tani në një interval kohe të shkurtër e kishte parë dy herë. Në këtë nuk kishte asgjë të pazakontë. Por nuk mund të largonte përshtypjen se herën e parë që e kishte parë kishte qenë në ëndërr, e jo në jetën reale. Në fakt ai kishte qenë aq i sigurt që ajo kishte qenë një fantazmë sa nuk i dukej e mundur të ekzistonte vërtet. Ç'pamje kishte patur ajo gjithsesi?

Ndërsa mendohej të kujtonte vegullimin e vajzës, hodhi vështrimin në tokë. Atje, në rrugën e përbaltur një stërqokë e ngordhur e shihte me sy të zgurdulluar. Krahët i kishte të

ngjeshura pas trupit dhe këmbët i kishte të përkulura sikur të ishte gati për t'u shkëputur nga dega, por dikush mund të thoshte me siguri që trupi i zogut ishte bërë dru.

“Pra atëherë,” mendoi Laurentius me vete, duke u ndalur.

Vajza dhe shoqëruesi i saj vazhduan të ecin, me shiun që vazhdonte të binte në kapelat dhe mantelet e tyre.

“Pra atëherë,” i përsëriti ai stërqokës me një ton zëri më të rreptë.

“Po, vërtet,” u duk sikur tha vështrimi i ngulët i stërqokës në kthim. Laurentius u ul galiç dhe e shop zogun me kujdes me një thupër. U shqetësua kur preku qenien e ngordhur me duart e tij, Zoti e di nga ç'ka ngordhur. Stërqoka u kthye nga ana tjetër.

Dua të përpiqem disi ta shtyj në buzë të rrugës,” vendosi ai, duke kujtuar se si rreckamani kishte ardhur dhe i kishte rrëmbyer paraketin. Me sa duket situata ishte pak më e mirë në qytet, përndryshe dikush do t'i kishte shkullur puplat stërqokës dhe do ta kishte ngrënë. Ndonëse ndoshta mund të kishte rënë pak më parë, kështu që asnjë nuk kishte patur kohë për këtë.

Ai futi disa thupra të lagura poshtë zogut të pisët, duke patur ndërmend ta ngrinte në njërin anë. Por siç ndodh rëndom me zogjtë e ngordhur, trupi i tij ishte çuditërisht shumë i lehtë, dhe ai e gjykoi keq qendrën e tij të gravitetit. Ai e hodhi me një lëvizje të shpejtë lart pothuajse deri lart në mes përpara se ta dërgonte aksidentalisht topin e butë me pupla në pellgun më të afërt.

“Dreqi e mori,” u gjend ai duke thënë, dhe befas ndjeu frikë.

Stërqoka e ngordhur ra në pellg me një plaquritje të lehtë. Vija e ujit që ishte grumbulluar prej reshjeve të shiut të disa ditëve e mori me vete trupin e zogut, dhe filloi ta lëvizë ngadalë drejt pellgut të vogël që ishte krijuar në mes të rrugës, duke ngecur në pengesa të ndryshme që haste. Laurentius vështroi ndërsa rrymat e padukshme luanin me qenien e ngordhur dhe

gjethet e njomura të panjës u grumbulluan rrotull formës së saj të vogël të trupit.

“Ya, ya!” tha me britma një zë.

Laurentius dëgjoi një trokëllimë dhe u shfaq një karrocë, nga rrotat e saj dhe thundrat e kalit u ngritën spërka uji. Ai u hodh pupthi anash, por nuk mundi të mos lagë çorapet e gjata. Shoferi i dha një vështrim gjithë inat, dhe pastaj i gjithë mjeti u përpi në muzg, si një demon që zhduket në errësirë. Thirrjet ya të shoferit dhe shungullima e rrotave u dëgjuan pak më gjatë, përpara se të binte përsëri heshtja. Stërqoka ishte zhdukur, ndoshta e kishin shtypur rrotat e karrocës në baltë. Laurentius mblodhi supet dhe pa rrotull.

S’dukej njeri rrotull. “Në shtëpi,” tha ai me vete.

Të paktën tani mund të shkonte diku në këtë qytet, në një vend që mund ta quante shtëpi. Mbase pasi të kthehej do të kishte një ide më të qartë se çdo të bënte pastaj. Duke ndjerë në vetvete se kishte marrë një vendim, filloi të ecë me hapa më të mëdhenj. Pasi mbërriti në kishën e Shën Gjonit, u kthye të kalonte përsëri pranë ndërtesës së universitetit, dhe prej andej mori drejtimin e Rrugës Broad. Pasi kaloi disa ndërtesa pas universitetit u ndesh me një grup të madh studentësh, që rrinin në dritë të zbehtë, jashtë asaj që dukej si një magazinë, duke diskutuar diçka midis tyre. Duke kaluar shumë pranë tyre, ai njohu Johannes, që e përshëndeti me një valëvitje miqësore të kapelës së tij.

“Mirëmbërëma! Ku po shkon më këmbë?” i thërriti Johannes atij. Po shkoj në dhomën time me qira,” u përgjigj Laurentius me një zë të lodhur.

“Do të shkojmë në qytet; dëshiron të vish me ne?” sugjeroi Johannes.

“Ndoshta, s’jam i sigurt...” u përgjigj Laurentius duke psherëtirë. Do të ishte një mundësi e mirë për të njohur pak më

mirë studentët e tjerë, por ai e kishte mjaft të qartë atë që do të ndodhte. Studentët gjermanë ishin shokë të mirë, kryesisht sepse ishin më të pasur se sa suedezët, dhe kishin nam që qerasnin këdo me të cilët shoqëroheshin. Ishte një çështje nderi për ta që gjithmonë tryeza të ishte plot e përplot, dhe që zemrat e njerëzve të ishin gjithmonë të gëzuara. Laurentius kishte filluar të ndjente një ndjesi të paqartë pritjeje me nervozizëm në gropë të barkut. Diçka i thoshte se duhet të shkonte, por njëkohësisht e paralajmëronte që ndoshta nuk ishte ide dhe aq e mirë.

“Hë de, eja me ne,” tha Johanne, duke u përpjekur ta nxisë Laurentiusin të vinte, dhe e tërhoqi nga krahu. Ishte e qartë që ishin mbledhur që më parë diku, dhe shokët ishin tashmë shend e verë.

Laurentius me mosbesim, i la ta marrin me vete për një copë herë, duke dëgjuar shakatë e tyre dhe duke u përpjekur të mos duket shumë si element i huaj. Ata i kishin hyrë që më parë një diskutimi filozofik, me sa duket rreth një teme të trajtuar në një leksion të kohëve të fundit.

“Plato jep një shembull të mirë të viryteve te *Menon*,” parashtroi një i ri me sy me rreth të kuq. “Ekziston një numër i madh i tyre, një mizëri, tamam si bletët!”

“Cilat? Bletët?” pyeti me habi Laurentius. “Në fakt, Plato shkroi se shpirti i një njeriu që ka bërë një jetë të mirë rilind si bletë. Shpirtrat e tyre janë si bletët.”

“Jo, ai është një diskutim tjetër! Ka shumë bletë, por të gjitha shprehin një koncept të vetëm. Konceptin e një blete! E njëjta gjë vlen edhe me virytet. Në fakt ka vetëm një viryt,” këmbënguli i riu.

“Por bletët kanë lindur nga prishja dhe kalbëzimi” e ndërpreu Johannes. “Plini thotë se...”

“Ajo është një temë krejt tjetër, pash Zotin mos u shmang përsëri,” murmuriti i riu që kishte filluar bisedën “Virytet...”

“Ato kanë lindur vërtet ashtu,” tha Johannes, duke mos dashur të tërhiqet. “Ato kanë lindur nga vdekja. Dhe Porfiri thotë se ato janë qenie tepër të drejta dhe mendjekthjellëta.”

“Epo, atëherë ti përfundimisht nuk je bletë,” tha me ton të prerë i riu që ishte përpjekur të diskutonte për virtytet. “Është thjesht një metaforë. E thashë me kuptim figurativ.” Dhe si për të përforcuar pikëpamjen e tij nxori shpatën dhe e tundi në ajër.

“Një metaforë për çfarë?” tha Johannes me një ton zëri pak tallës.

“Për gjënë më të rëndësishme,” u përgjigj i riu.

“Sepse mbledhin mjaltë? Një metaforë për bashkëpunimin?” pyeti Johannes.

Laurentius kuptoi se kjo ishte një lloj bisede që do të shkonte në mënyrë të pashmangshme mbrapsht, dhe ai ndruhej se nëse do të qëndronte me studentët prej kësaj do t’i vinin veç telashe. Ai ishte çliruar disi nga tensionimi që ishte grumbulluar brenda tij prej melankolisë së vjeshtës, nga ethet dhe frikë për situatën e tij të pasigurt. Por nuk kishte shumë mundësi zgjedhjeje. Atij ose do t’i merrnin gjak, ose duhet të kalonte kohë në shoqërinë e njerëzve dëfrimi i të cilëve do t’i qetësonte shpirtin. Duhet të bënte diçka! Por nuk do të ishte ide e mirë që ta linte veten të humbiste kontrollin dhe të bëhej tapë, edhe pse të humbte kontrollin, të harronte, ishte pikërisht ajo që donte në atë çast. Ora e tij vazhdonte të bënte tik tak por koha sa vinte e kalonte më ngadalë.

“Më duhet të shkoj patjetër,” i tha ai Johannes. “Kam ca punë për të zgjidhur sot.”

“Ke takim?” e pyeti Johannes me një buzëqeshje të madhe.

Natë

LAURENTIUS QËNDROI SHTRIRË duke dëgjuar shiun të pikonte jashtë. Pikë, pikë... Ishte gjëja e parë që cenonte vetëdijen e tij zgjuar. Si një orë e përjetshme që maste ditët, orët minutat e rrahjes së tij të zemrës ndërsa vetë ai ishte i përhumbur. Ishte ajo lloj ore që nuk kishte nevojë për kurdisje.

Diku atje lart, pika uji pothuajse të padukshme kishin filluar të pikonin nga të çarat e ngushta në çatinë me qepra. Pikat e vogla ishin mbledhur ngadalë në tavanin e dhomës së tij, tensioni sipërfaqësor u jepte atyre përkohësisht formë të paqartë sferike, përpara se të shkëputeshin nga mbërthimi i forcës së gravitetit dhe të binin në tokë me një zhurmë të lehtë pikimi. Pikë, pikë. Ato sa vinin dhe binin më shpesh, derisa në fund bënë një njollë ngjyrë kafe mbi dërrasat e dyshemesë . Ai ishte shumë i sigurt që nuk kishte qenë atje në mbrëmje.

Laurentius kishte marrë një qëndrim të pakujdesshëm në karrigen e tij, duke vështruar larg me sy të përhumbur, me shikimin ngultas në një pikë që kulminonte diku përtej bojatisjes me gëlqere, suvasë, murit me gurë, ajrit të mjegullt të qytetit. T'ia ngulësh sytë asgjësë. Sytë e tij dukeshin sikur ishin pikturuar në tiparet e plogëta të një të çmenduri, dhe shikimi i tij i ngulët ishte i zbrazët, që s'pulit qepallat, që shponte përjetësinë. Shumë mirë mund të kishte qenë i vdekur. Gjaku i tharë në parakrahun e tij, që ishte mbështetur në një tas gjysmë të mbushur me një lëng të errët,

e përforconte përshtypjen.

Pikë, pikë.

Ajrin e lagësht e ndjente të ftohtë në ballin e tij të djersitur, por nuk guxonte të lëvizte, as edhe për të fshirë djersën. Kishte frikë se prej mundimit më të vogël, do të humbte vetëdijen, që do të binte përpara dhe do të godiste kokën me zhurmë në dysheme. Zemra pothuajse i kishte pushuar së rrahuri, nga frika se muskujt do të zgjateshin së tepërmi dhe do të lëshoheshin; gjaku nuk i qarkullonte njëtrajtësisht në të gjithë trupin; venat e tij ishin mbushur me kripëra, i ishin bllokuar dhe i kishin dalë jashtë përdorimit. E gjithë lëvizja ndërpritet në mënyrë të pashmangshme, dhe të gjitha gjërat shkojnë drejt ndaljes përfundimtare. Po cili ishte, atëherë, vendi i burrit?

Laurentius ndjeu sikur trupi i tij ishte ai i një shenjtori të vdekur, i plogët dhe i pavdekshëm. Por e dinte që s'ishte e vërtetë, ishte e pamundur. Në çastin që trupi i humbi shpresat se do të lëvizte, me frymëmarrjen që kalonte nëpërmjet vrimave të hundës, diçka do të vdiste brenda tij. Kështu vdisnin njerëzit. Truri i tij, i fshehur brenda kockës së fortë të kafkës së tij, do të jepte një dridhje të fundit dhe do të pushonte së funksionuari, dhe vetëdija e tij do të zhdukej diku. Të gjitha ato gjëra që kishin ekzistuar në mënyrë të pakundërshtueshme, të cilat dikush mund t'i quante apo shihte, do të humbisnin. Por ku shkuan ato? Në asgjënë?

Ajri kishte filluar t'i vezullonte përpara syve, dhe ndonëse duhet të merrte ende një trajtë të qartë, kishte tashmë përmasa, dhe prej tij rrezatohej dritë. Ishte një dritë tepër e fortë për sytë e tij, të cilët ishin mësuar të tretnin vështrimin në zbrazëti.

Kapakët e syve u mbyllën me refleks.

Dukej sikur ai po vinte ngadalë në vehte. Duhet të kishte bërë ndonjë gabim të trashë...por cili mund të kishte qenë? Ku kishte qenë ai gjithë atë kohë? Ajo që nuk ka kuptim është e pamundur të merret me mend, sepse fjalët nuk mund ta kapin kurrë thelbin.

A kisha vetëdije? A jam unë vetëdija ime? A e zotërojmë, apo personifikojmë atë? Jo, tha me vete Laurentius. Ai nuk duhet ta lejonte veten të zhytej në këto mendime: ato do t'i lodhnin trurin, do t'i shteronin të gjitha energjitë, do të bënin që trupi të lëshonte të gjithë ngrohtësinë e tij, nga mbikafka e tij në ftohtësinë e dhomës. Ai duhet të përpiquej ta përmbante veten. Ta përmbante veten nga të menduarit, nga të folurit, gjëja më kryesore ishte të kishte në dorë vetëdijen e tij. Nëse do të kursente frymëmarrjet që i ishin caktuar, të ruante rrahjet që bënte ajo copë kërci, atëherë mund të jetonte. Ai ende duhet të jetonte, për ndonjë arsye.

Njolla vezulluese e ajrit përpara tij kishte filluar të marrë përvijime më të qarta, dhe përmes shkëlqimit verbues ai mund të shquante një formë trupi të zgjatur. Ishte një fytyrë e bardhë si shkumësi, që nxirrte në pah tavanin e errët në sfond, dhe flokë të gjatë që i derdheshin në supe siluetës. Dhe përmes dritës vezulluese Laurentius mund të shihte një aureolë, që po merrte ngadalë formë rreth siluetës së errët të kokës. Rreze drite që dalin vetëtimthi me hope nga imazhi vezullues, duke shpuar bebet e tij të syrit të picërruara dhe duke depërtuar në tru. Kapakët e tij të syve po pulisnin në mënyrë të pakontrollueshme.

Në çastin që mbylli sytë dhe pa errësirë, fytyra u shfaq qartë përpara tij. E kishte parë diku më parë. Ca kohë më parë, shumë kohë më parë. Mos kishte qenë ëndërr? Ai kishte qëndruar në këmbë pranë trekëmbëshit me barin dhe rërën nën këmbë. Kishte patur pemë ngjyrë të bardha argjendi që dukeshin si njerëz: rrënjët si këmbë, degët si gishtërinj. Gjethe të gjata, me formë shigjete.

Ai arriti të hapë me mundim sytë.

Qirinjtë po digjeshin me flakë të madhe, të cilët ndriçonin përvijimet e kanistrave dhe tasave mbi tryezën përpara tij. Mos e kishte nga ushqimi?

Shërimi i tij do të kërkonte energji, dhe ai kishte nevojë për ushqim për këtë. Laurentius u përpoq të mposhtet ankthin e tij dhe

të kuptonte përse ishte çuar nga gjumi i tij pa ëndrra, përse mund të shihte një person të qëndronte në këmbë përpara tij, dhe përse rrobat e saj ishin më të shndritshme, shumë më të shndritshme, se sa nga ç'mbante mend nga hera e mëparshme.

“Hera e mëparshme?” pyetja i kaloi për një çast në mendje.

Tani mund të shihte se gruaja e re ishte veshur me një rrobë të bardhë të gjatë, të mbërthyer rreth trupit nga fjongo të gjelbra, dhe flokët e saj ishin kapur me një shirit të artë. Duart i kishte të zgjatura sikur po lutej apo po ofronte të mira. Ai mund të shihte një kupë me huall mjalti të verdhë, shporta me portokalle, vazo të cekëta të mbushura me lule të verdha e të kuqe, mollë të gjelbra, domate të kuqe, shegë, një seri ngjyrash të forta.

Laurentius mbylli sytë në mënyrë të pavullnetshme.

Dreji e mori, mendoi me vete, duke kujtuar çfarë kishte ndodhur. Ai kishte vendosur të marrë vetë gjakun e tij. Ja përse krahët i kishte të gjakosura, dhe përse fantazmat ishin shfaqur, ato halucinacione. Gjëja më e mirë që mund të bënte ishte të priste deri në mëngjes, të mposhte brejtjen e ndërgegjes dhe të shkonte në një farmaci, apo të provonte fatin përsëri te ndonjë kirurg “berber”. Ai sigurisht nuk duhet të nxitohej, duke marrë parasysht gjendjen delikate në të cilën ndodhej. Ai duhet të ishte shumë i kujdesshëm me dhënie e gjakut, sepse duke humbur shumë gjak mund t’i binte të fikët.

Laurentius gulçoi me zemërim me vete. “Të kem kujdes mjaftueshëm!” Ai vështroi ngultas me sytë gjysmë të hapura, dhe tryeza përpara tij tani iu duk e boshatisur. Dhoma kishte ende një formë të çuditshme, e shformuar si një imazh që shihet me lupë. Filloi t’i vijë koka vërdallë, dhe iu desh të mbyllte sytë përsëri.

Sigurisht disa doktorë kishin mendimin plotësisht të kundërt, duke besuar që të fiktit gjatë marrjes së gjakut ishte shenja më e besueshme se trajtimi kishte funksionuar. Vetë Laurentius kishte qenë dyshues për të gjithë metodën. Mësuesit e tij në Leiden nuk

e kishin miratuar marrjen e vëllimeve të mëdha të gjakut nga trupi, duke thënë se për shkak të qarkullimit, një fenomen që Harvi kishte vërtetuar kohët e fundit, nuk ishte e nevojshme. Por vështrimi i Dimberg për çështjen kishte qenë shumë bindës, dhe nëse një autoritet skeptik si Boil e përkrahte gjithashtu, atëherë ia vlinte të paktën ta provoje. Sipas Boil, gjaku mbarte molekula të sëmundjes, dhe nëse ato nxirreshin me masë, trupi do ta kishte më të lehtë të përballej me ato që kishin mbetur. Sidoqoftë, marrja e gjakut ishte mënyra më e përhapur e mjekimit.

Ai u përpoq ta përqendronte vështrimin te diçka, por ishte e kotë.

Çfarë ndodhi në të vërtetë më parë?

Ai kishte qëndruar ulur në karrige, duke e mbajtur të hapur çarjen në parakrah me një shkop qelqi të vogël, dhe duke lexuar lutjet me vete.

Gjaku kishte pikuar në tas, dhe ishte mbushur pothuajse përgjysmë, kjo ishte gjëja e fundit që i kujtohej.

Atij duhet t'i ketë rënë të fikët. Shkopi duhet të ketë rrëshqitur nga vena e tij, dhe rrjedhja e gjakut më në fund ishte ndalur, përndryshe ai nuk do të ishte më aty. Sikur ta kishte kaluar të gjithë natën ulur në atë karrige pranë tryezës, duke kundruar jashtë dritares si kufoma e dikujt që ishte varur në dorezën e dritares? A kishte vdekur ai në të vërtetë?

E megjithatë, megjithatë, ai ishte i sigurt që dikush tjetër kishte qenë gjithashtu atje.

Laurentius u përpoq të ngrihej në këmbë me sforcim të madh. Veshët i gjëmonin, dhe duhet të mbahej te karrigia për t'u çuar. Ndërsa qëndroi atje duke u përpjekur të marrë veten, i hodhi një sy rrotull dhomës. Ishte bosh, askush nuk ndodhej atje. Eci disa hapa duke iu marrë këmbët drejt shtratit dhe ra mbi të. Gjymtyrët nuk i kishte më të ngrira, por e ndjente trupin të lehtë dhe të brishtë, si një gjethe e tharë. Ai ishte i dobët, por shqisat i funksiononin

në mënyrë disi ndryshe se si zakonisht. Zhurmat i dukeshin më të forta; drita në mënyrë të pashpjegueshme dukej ndryshe, pothuajse njësoj, por gjithsesi pak e ndryshuar. Mos bëhej kështu për shkak të sëmundjes së tij? Ai e dinte se sëmundja ishte Djalli, gënjimi, besimi i gabuar. Besimi i gabuar të tërhiqte menjëherë vëmendjen; çmenduria mund të dallohej së largu, të shkaktonte frikë, zgjonte kujtime dhe fantazma. Kujtimet, brazdat e gërvishtura në shpirtin e tij, ishin ende atje: ende mund t'i ndjente brenda tij. Por disi ato ishin më të cekëta, më të holla, sikur dikush t'i kishte hapur me forcë. Sikur dikush të kishte marrë një thikë të mprehtë dhe të kishte gërvishtur historitë e lemerishme dhe të kishte prishur imazhet nga faqet prej letre pergamene të një libri, dhe tani pluhuri i bojës së errët ishte përhapur në shpirtin e tij. Ndoshta nëse kollitej, molekulat e kujtimeve të tij do të dilnin fluturimthi prej gojës së tij, si bulëza të vogla.

Laurentius mori lirinë të kollitej një copë herë. Me çdo kollitje ai u ndie më i shëndetshëm, i përtërirë.

Me t'i pushuar kolla u shtri në shtrat duke menduar, dhe u kujtua se më vonë duhet të shkonte në banket. Pothuajse këdo që kishte takuar e kishte ftuar të shkonte atje, kështu që nuk bënte të mos shkonte. U ndie shumë i pafuqishëm, por duhet të përpiqej të dukej në formë të mirë dhe gjithashtu duhet të hante diçka. Ai ishte marrë vesh me shërbyesen se nuk donte të hante mëngjesin në dhomën e tij me qira, por për këtë kishte patur arsye të fortë: ai duhet të sigurohej që stomaku të mos treste atë ushqimin e keq plot me tallash; mund ta bënte t'i binte të fikët përsëri. Ai duhet të hante, por vetëm ushqim të cilësisë së mirë. Bukë të pjekur me miell të mirë, dhe madje edhe fruta, nëse do të mund të gjente dot. Mbajti mend shportën me huallin e mjaltit dhe shegët që kishte parë në dritën e dobët të dhomës së tij, dhe u përcoll. Pikërisht për këtë kishte nevojë.

“Po,” tha me vete, sikur të kishte marrë një vendim. Kishte

dy mundësi zgjedhjeje: mund të hante në një tavernë diku, ose të priste deri në çastin kur të bëhej banketi. Ata pa dyshim shërbenin pjatat më të mira në të gjithë Dorpat. Duhet vetëm të bënte edhe pak durim dhe të përpiqej të çlodhej; banketi duhet të fillonte në kohën e drekës. Laurentius u lëshua përsëri në shtrat dhe qëndroi shtrirë, duke menduar për mjaltin e ëmbël dhe mollët e kuqe të freskëta.

E Enjte

SHTEPIA PREJ GURI ishte lyer me kujdes me bojë gëlqereje të gjelbër dhe të verdhë, duke e nxjerrë në pah nga ndërtesat e tjera, të cilat kishin në përgjithësi dërrasa të trasha të murrme në anën e jashtme. Askush nuk i lyente shtëpitë në këto anë, dhe për shkak të motit ato prireshin të merrnin nuancat e ndryshme të ngjyrës së plumbit, të rejat pak më të çelëta, të vjetrat pak më të errëta, madje edhe të zeza ndonjëherë. Ngjyra tregonte kamje.

Në qiell kishte re të errëta, të ulëta dhe qirinjtë në shtëpinë me gurë tashmë ishin nderur. Drita e tyre e ngrohtë, që dridhet shkëlqente nga dritaret, dhe brenda dikush mund të shquante siluetat e njerëzve të pispillosur enkas për rastet e veçanta, duke u endur andej këndej dhe duke biseduar midis tyre. Ata ishin si silueta që artistët vizatonin ndonjëherë, tamam si vajza e Butades që kishte ruajtur hijen e të dashurit të saj në mur përpara se ai të shkonte në betejë. Shërbyesit që rrinin në sheshpushimin e shkallëve ishin veshur me të zezë të hijshme, dhe Laurentius nuk mundi të mos mendojë që ishte sikur kokat e gabuara ishin vënë sipër trupave të veshur e ngjeshur me veshje elegante. Këto ishin fytyrat e djemve të rinj: të puçërrosur, arrogantë, të papërshtatshëm. Vetëm pak më parë kishin shumë të ngjarë të kishin vrapuar andej këndej këmbëzbathur, të mbathur me rroba të varura, duke vënë kopicë cungje druri në një oborr apo duke çuar kuajt diku. Balta më e

keqe ishte larë prej tyre; ata ishin veshur bukur, dhe ishin dërguar të ndihmonin në pritjen e rektorit. Djemtë i shikonin studentët dhe profesorët e universitetit me një shprehje fytyre që tregonte mosbesim të përzierë me mungesë respekti. Ata e dinin se jetët që bënin në kopshtet e pasme, jashtë në fusha, ishin më të vërteta, më të sinqerta. Studentët rregulluar e veshur me rroba elegante, disa prej tyre me paruke dhe pallto të mëdha të qëndisura me fill ari, ishin të ftohtë dhe të huaj për ta. Ashtu siç zogjtë e bardhë që lëshojnë një klithje të mprehtë fluturonin në qiellin e zymtë të vjeshtës por jetonin gjatë aty ku dielli shkëlqente.

“Ndoshta në njëfarë kuptimi kështu qëndrojnë gjërat,” mendoi Laurentius, duke vështruar ndërsa shërbyesit ndezën pishtarët. Aftësia për shkrim e lexim, të lexuarit dhe gjuhët klasike do t’u siguronin studentëve një pozitë të privilegjuar ndaj djemve fshatarë, pasi ata të kishin mësuar se si lexohen pllakat e shkrimit me dyllë, nuk kishte kthim pas. Qysh atëherë e tutje bota e tyre kishte ndryshuar përgjithmonë dhe ishte e pamundur të harroje ndonjëherë fuqinë e fjalës së shkruar. Por jeta fshatare formohej diku gjatë. Nxitimi lart e poshtë në baltën e ftohtë, fjetja mbi bar të thatë, në dhomat e vogla të nxira me kafshë që hungërojnë dhe fëmijë qaramanë. Dhe mjellmat fluturuan lart në qiell, duke zgjuar te njerëzit poshtë një mall të pakuptueshëm. Shumë kohë më parë, në fshatin ku ai kishte studiuar me Atë Theodus, Laurentius kishte vështruar mjellmat me të njëjtin mall. Theodus ishte munduar t’i mësonte si të harronte, si ta forconte shpirtin e tij, por më kot. Melankolia kishte lënë gjurmët e saj në shpirtin e tij, dhe ishte një barrë të cilën ai do ta mbarte gjithmonë me vete, të cilën s’mund ta harronte kurrë. Vetëm shoqëria me të tjerët, idetë e tyre, librat që lexonte, dhe paraketi i tij që lëvizte pareshtur kishin arritur me raste t’ia largonin mendimet.

Si në përgjigje të dëshirave të tij, dikush që qëndronte pranë dyerve me panele të mëdha xhami opak njoftoi diçka me një

ulëritje, u përkul, dhe hapi të dyja kanatet e dyerve. Dy nga djemtë shtruan një qilim të gjerë të kuqërremë mbi shkallët prej guri.

Laurentius eci përpara drejt gjuhës së kuqe të shpalosur bashkë me të tjerët. Tashmë ishte shumë i vetëdijshëm se sa të pafuqishëm e kishte lënë marrja e gjakut dhe mund të ndjente rrëqethje t'i shkonin lart e poshtë shpinës, dhe ngërc në pulpat e këmbëve; mos ndoshta ishin ethet që i nisnin përsëri? U përpoq të përqendrohej te mjedisi rrethues. Cilët qenë gjitha ata njerëz të panjohur? Kishte shumë më tepër nga ç'priste të shihte në pritjen e rektorit të një universiteti provincial.

Ai u kollit qëllimisht, rregulloi shpatën që i varej nga ija dhe u fut në ndërtesë. Ndërsa këmbët iu zhytën në materialin e kuq të butë të qilimit, që ishte i butë si moçal, si një brinjë mali e tatëpjetë e mbuluar me gjak, ndjeu një dhimbje therëse në stomak. Çdo hap që hodhi la një gjurmë të butë në të, si një vulë në dyll, si një kujtim. Pas qilimit të kuq vazhdonin dërrasa dysHEMEJE. Nuk kishte pluhur apo baltë aty brenda, dhe ajri ishte shpues, i rëndë nga tymi i flakëve të qirinjve. Grahma e mëparshme ishte bërë disi më e fortë. Mos ishte vallë era rëndë e dyllit të qirinjve, apo vaji i trupit me aromë myshku i dikujt, ose sapuni që ishte përdorur për të larë dysHEMENË?

Laurentius iu morën pak këmbët por ia lejoi vetes të drejtohej më tej. Tani ndodhej aty dhe kjo s'mund të ç'bëhej. Ai duhet të përpiqej të harronte gjithçka që kishte ndodhur.

"Faleminderit," tha ai me mirësjellje ndërsa shërbyesi i mori pallton. Përshtypja e rreme e një brendësie moderne europiane ishte pothuajse e përsosur. Vetëm nëse dikush muntohej të ngrinte sytë dhe të shihte binarët e çatisë dhe anët me gunga të suvatimit që dikush mund të pikaste punën dekoruese të bërë shkel e shko me ngut. Por më poshtë, në planin normal të shikimit, kishte mure të lëmuara të veshura me dru, mbi të cilat ishin varur sixhade muri me modele bimësh dhe foto, dhe madje ishte edhe një gardërobë.

Njerëz që linin mantelet e tyre, ngrohnin duart për një çast të pllakat qeramike të sobës së gjelbër të çelët, dhe pastaj vazhdonin më tej brenda ndërtesës.

Laurentius zuri vend afër njërës prej mureve, duke u dukur si në gjemba. Për fat të mirë dhoma ishte e ngrohtë, gjë që do të ndihmonte lëngjet e tij të trupit në luftën e tyre me të ftohtin dhe lagështinë. Kuptoi se e kishte marrë shumë uria. Ai ndoqi me vëmendje vargun e të rinjve ndërsa hynin në dyert e hapura. Shumë prej tyre flisnin me njëri tjetrin sikur të njiheshin mirë tashmë, ndërsa disa të tjerë hidhnin vështrime kureshtarë në drejtim të tij. Ai u përpoq të gjente Peter-in dhe Johannes-in midis tyre, por ë gjitha fytyrat ishin të panjohura. Ishte shumë e qartë së të huajt nuk vinin shpesh në këto anë, dhe studentët që kishin qenë atje më gjatë nuk e fshihnin interesimin ndaj çdo të ardhuri rishtas. Ndoshta kishin dëgjuar tashmë për provimin e tij?

“Duhet të keni ardhur në Dorpat kohët e fundit?” iu drejtua atij një i ri i veshur me një mantel të modës dhe me parukë spitullaqe. Prej paraqitjes së tij ekstravagante dhe mburracake mund të nxirrje përfundimin se duhet të vinte nga një familje e pasur tregtare. Aristokratët kishin tendencën të ishin më pak të kujdesshëm me veshjen e tyre: ata kishin tituj që shprehnin rëndësinë e tyre, por qytetarët e zakonshëm përpiqeshin ta zëvendësonin mungesën e gjendjes shoqërore duke treguar haptas pasurinë e tyre.

Laurentius bën një lëvizje të paqartë me kokë. “Pak më parë, po.”

“Magnus Lundgreen, nën urdhrat tuaja,” tha burri, duke u paraqitur në mënyrën franceze.

“Laurentius Hylas.”

“Keni gjetur dhomë me qira?” e pyeti Magnus.

“Po, në shtëpinë Fendrius. Është një vend mjaft i rehatshëm,” u përgjigj Laurentius.

“Ah, atje. Po, ai është një vend pa diskutim i këndshëm. Ndonëse

qiraxhinjtë e fundit i nxorën jashtë. Aty ndodhi një skandal. Ishin gjermanë,” e informoi Magnus.

“Vërtet?” tha Laurentius, duke mos ditur ç’ti thotë tjetër.

“Kam dëgjuar se keni ardhur nga Lieden, e vërtet është?” vazhdoi Magnus me një ton zëri të gëzuar.

Laurentius pohoi me kokë. Pa dyshim lajmi i ardhjes së tij tashmë ishte përhapur.

Sjellja formale e Magnus fillimisht e zuri pak në befasi. Përdorimi i shumësit të vetës së dytë në përgjithësi një shenjë sqime, dhe sigurisht nuk ishte e përhapur. Dje, Peter dhe studentët gjermanë i ishin drejtuar në mënyrë shumë më miqësore. Laurentius e parapëlqente atë lloj drejtpërdrejtshmërie: se ç’kishte një lloj lirshmërie dhe qartësie të latinishtes. Kur i drejtoheshin në mënyrë të sjellshme ai zakonisht zgjidhte të përgjigjej me njëfarë strukture pavetore, që ishte zakonisht e vetmja mënyrë për të shmangur fyerjen. Ai fliste rrjedhshëm gjermanisht dhe suedisht, por të përpiquej të gjente formën e përshtatshme për t’u drejtuar gjithmonë e nxehte. Gjithmonë varej nga konteksti, por ai zakonisht merrte me mend se bashkëfolësi i tij e dinte cila ishte e sakta. Në këtë çast nuk mund të përcaktonte nëse Magnus po e qesëndiste me mirësjelljen e tij të tepruar, apo po përpiquej të tregohej miqësor.

Përpara se të kishte kohë për të përcaktuar cila ishte nga të dyja, të ftuarit u thirrën të zënë vend në tryezë, dhe ai dhe Magnus u ulën në vendet e caktuara për ta. Këto lloj eventesh organizoheshin gjithnjë me pompozitet të madh, dhe zakonisht nuk ekzistonte as shpresa më e vogël e të folurit më lirshëm apo të largoheshe nga tryeza pa kaluar të paktën dy orë. Sa herë që gjendej në evente të tilla Laurentiusit i kujtohej fati i trishtë i astronomit Tycho Brahe. Në një pritje ai u detyrua të frenonte funksionet e natyrshme të trupit aq gjatë sa i plasi fshikëza e urinës, dhe pastaj vdiq. Të paktën kështu kishte dëgjuar

Laurentius në rrethet studentore të Leiden-it.

“*Silentium!*” thirri dikush në anën tjetër të hollit.

Profesori i teologjisë Olaus Moberg u ngrit në këmbë dhe filloi të bëjë një lutje të shkurtër. Ai paralajmëroi për kohët e vështira që do të vinin, dhe tha një lutje për ata që në këtë mbrëmje nuk mund të shtronin në tryezat e tyre ushqim të tillë kaq të bollshëm dhe të kushtueshëm. Profesori i filozofisë Sjöbergh mori radhën, për të folur mbi temën e zisë së bukës dhe ndëshkimit të Zotit, e cila u bë me qëllimin që njerëzit të përpiqen të përmirësohen. Zoti gjithmonë i caktonte ndëshkimin më të ashpër njerëzve të tij të zgjedhur, pikërisht për të nxitur ata të bëhen më të mirë. Sjöbergh shtoi se ndërsa ata shihnin vdekje dhe zi bukë ngado, duhet të mbanin mend gjithmonë se në errësirën më të madhe do të shfaqej një dritë.

“*Lux luceat in tenebris. Le të sjellë dritë universiteti ynë në këtë tokë të errët! Vivat, crescat, floreat!*” thirri Sjöbergh.

Të gjithë u dukën shumë seriozë një copë herë, por pas pak u bënë përsëri të qeshur ndërsa shërbyesit filluan të sillnin pjatat në tryezë. Ato e shërbyen sipas vjetërsisë, që do të thoshte se Laurentius duhet të priste një copë herë përpara se t’i vinin pjatat e para. Tashmë ai ishte vërtet shumë i uritur.

Ai përshëndeti me kokë, ngriti krikëllin e birrës dhe buzëqeshi me respekt ndërsa studentët më të vjetër bënë dollitë e tyre tradicionale. Ishte e detyrueshme ta pije gotën me fund, por fatmirësisht birra kishte për habi shije të mirë.

Duke dëgjuar deri në fund dollitë e fundit nga shumë të tillave të gjata dhe të ngatërruara, personi pranë tij u kthye dhe e pyeti me gjysmë pëshpëritje, “S’besoj të kesh plane për mbrëmjen, apo jo?”

“Po, Peter Börk më tha se do të bëhet një shfaqje,” u përgjigj Laurentius, duke u ndjerë krenar që mund të provonte sa i mirinformuar ishte. “Por kam të ftohur; nuk do të mund të shkoj

ta shoh.”

“Eja. Do të jetë një event i rëndësishëm. Për Dorpat, Athinën e lumit Emajōgi-t, dhe Muzat.”

Laurentius ngriti kokën, me kureshtje. “Vërtet?”

Laurentius kishte menduar për Muzat kur në fund zgjodhi Dorpat nga të gjithë universitetet e tjerë provinciale. Dorpat kishte një reputacion të paqartë por ta padiskutueshëm si vendi ku Muzat ishin shumë frymëzuese.

“Çfarë lloj shfaqjeje është saktësisht?” e pyeti Laurentius. “Mos më pyet, dua të të befasoj. Më mirë prit ta shohësh vetë.

Laurentius tundi kokën. “Ke të drejtë sigurisht. Por për fat të keq s’jam i sigurt nëse do të jem mirë për të ardhur sot.”

Tashmë u ndie aq i brishtë nga marrja e gjakut sa nuk mund të përcaktonte me saktësi gjendjen e shëndetit të tij. Ndonjëherë do të ndjehej mirë, por pak pas fillonin t’i merreshin mendtë dhe fillonte të shqetësohej se mos do t’i binte të fikët nga ethet. Por kjo mund të ishte gjithashtu efekti i të mos ngrënit për shumë kohë. Kjo e bënte organizmin e tij gjithmonë të dobët, ashtu si zjarri në vatër kishte nevojë për dru për të qëndruar ndezur, trupi i njeriut kishte nevojë për ushqyerje të rregullt. Nëse zjarrit nuk i shtihej dru mjaftueshëm, pra nëse ai nuk ushqehej si duhet, flaka e tij do të fillonte të ulej derisa të shuhej pa çliruar fare ngrohtësi. Ai do të fillonte të ndjente errësirën e ftohtë t’i afrohej ngadalë.

Magnus i lëshoi një buzëqeshje të shkurtër Laurentiusit, pastaj u kthye t’ua bënte me shenjë studentëve më të rinj që t’u sillnin më në fund pjatat.

Më në fund, një i ri thatim iu afrua Laurentiusit dhe Magnusit, dhe duke puthitur buzët nga padurimi vendosi në tryezë midis tyre një pjatë balte fshatarake me glazurë të kaltërt. E paraqitur më një dhunti artistike të pamohueshme, sipër saj ishte pjata kryesore e mbrëmjes: peshk mlysh i pjekur i mbështjellë me , i mbuluar me një salcë kremi të shijshme. Lëkura ishte bërë kërce

dhe anët ishin pjekur si duhet dhe kishin marrë ngjyrë kafe; në salcën e bardhë notonin ca kokrra piperi. Laurentius e provoi pak.

“Me sa duket zia e bukës për të cilën Sjöbergh po ankohej ende nuk kishte arritur deri këtu. Ushqimi duket i shkëlqyer,” i komentoi ai personin pranë.

Magnus po shponte me një pirun të hollë dydhëmbësh peshkun e tij. Ngriti vetullat. “Sigurisht. S’kemi probleme këtu; ka rezerva plot. Gjithçka është shtrenjtuar, por sigurisht s’kemi përse të shqetësohemi se mos na merr uria.”

Laurentius këputi një copë bukë dhe filloi të qërojë peshkun e butë nga halat. Vuri re se vetëm nja dy të tjerë përveç personit pranë tij po përdornin pirunë; me sa duket një finesë e tillë ende nuk ishte përhapur në Dorpat. Ai u lehtësua prej kësaj, sa herë që duhet të përdorte pirunin s’dinte ta mbante në dorë. Dhe pasi vuri re se si fliste me gëzim personi pranë tij për zinë e bukës ndërsa valëviste pirunin në dorën e tij zakoni iu duk veçanërisht i pakëndshëm.

Laurentius kafshoi peshkun dhe kapërdui pak prej tij. Por u duk sikur ana e jashtme e pjekur që të hapte oreksin kishte krijuar pritshmëri të rreme. Peshku u shpërbë menjëherë në një masë veshtullore në gojë; shija ishte disi si baltë dhe i qelbur, dhe iu desh ta përmbante veten për të mos e pështyrë. Vetëm pasi piu një gllënjë të madhe birre të hidhur, dhe pasi përtypi një copë buke të thatë të thartuar mundi të gëlltitë me zor masën pa shije, të pështirë. Buka dukej njësoj si e mëngjesit të djeshëm, por megjithatë ishte shumë herë më pak e neveritshme se peshku.

“I mirë është peshku?” e pyeti ai personin ngjitur me të pas gllënjës së tij të tretë të birrës.

“Peshku këtu është gjithmonë shumë i mirë,” tha Magnus me miratim. “Veçanërisht peshku mlysh. Por s’e hamë shumë shpesh.”

Laurentius pa rrotull dhe vuri re që të gjithë po e shijonin peshkun, madje disa prej tyre po lëpinin gishtat. Padyshim problem nuk qëndronte te peshku apo te buka. Peshku ishte i mirë, ose të paktën ishte i ngrënshëm Ajo shije e prishur, si baltë duhet të ketë ardhur nga brenda tij. Që kur kishte ngordhur Klodia gjithçka mbante erë dhe kishte shije të neveritshme.

“Pra mendon se në Dorpart nuk ka rrezik për zi buke?” e pyeti personin pranë tij Laurentius.

“E di me siguri, nuk kemi fare përse të shqetësohemi këtu, siç ta thashë. Sidomos në këtë qytet. Ushtria i mban këtu rezervat e drithit. Mos u shqetëso, ha peshkun,” e qetësoi Magnus.

Por tashmë Laurentius po ndjehej keq. “Siç ta thashë, kam të ftohur. Më ka ikur oreksi.”

“Pra do të ma japësh mua ta ha peshkun tënd?” e pyeti Magnus, dhe përpara se të priste një përgjigje e lëvizi peshkun nga pjata e Laurentis në të tijën, sikur të të kishte lidhje të ngushta me të.

“Merre, të lutem,” tha Laurentius, duke vështruar me vëmendje ndërsa person pranë tij që hante gjithë qejf peshkun. “Por nga ajo çfarë tha Sjöbergh dikujt mund t’i krijohej përshtypja se fshatarët vuanin shumë. Kur po vija pashë vetë shumë njerëz të uritur.

“E vërtetë është se situata është shumë e keqe,” i tha personi pranë me një pohim me kokë. “Por ç’mund të bëjmë ne? Nuk mund të prodhojmë tepricë drithi për ta. Për sa i përket fshatarëve, Madhëria e Tij ka nxjerrë një dekret duke shfuqizuar bujkrobërinë dy vjet më parë, kështu që tani duhet të ndreqen vetë. Disi ata do t’i mbijetojnë dimrit. Kanë gjithmonë diçka të hequr mënjanë; gjërat s’janë aq keq sa duken. Për ndonjë arsye zëri i Magnus mori një ton pendimi. “Do të flasësh për mjerimin, atëherë mjerimi janë vetë punëtorët e rinj të fermës dhe vajzat të cilave u është bërë jeta e mjerueshme. Ata përfundimisht nuk do t’i mbijetojnë dot dimrit. Situata është rënduar shumë.”

“Këtë vë re edhe unë,” u pajtua Laurentius. “Qyteti madje

ka ngritur një lloj barake për ta. Më parë sorollateshin jashtë mureve të qytetit dhe vajtonin gjatë gjithë kohës. Ishte një skenë e tmerrshme. Çdo mëngjes ndonjë qytetar do të gjente një fëmijë të vogël apo vajzë të re jashtë derës së tij, të vdekur urie. Ata që janë afër vdekjes aq shumë u hahet bukë sa fillojnë të vajtojnë në mënyrë ngjethëse, duke u përgjëruar për një thërrime buke. Por kurrë nuk duhet t'u japësh. Sapo shtien në dorë një copë bukë dhe e hanë, bien thes. Jam tmerruar kur pashë një djalë dymbëdhjetë vjeçar të hante babëzisht gishtat e veta dhe të rënkonte 'Oh, kam shumë uri, shumë uri!' Kur më në fund i dhashë pak bukë, ai ma rrëmbeu nga dora, e hëngri si i babëzitur, pastaj u plandos përtokë dhe sa hap e mbyll sytë vdiq. Sigurisht, një përjetim i tillë të fut frikën. Mendoj se rastet e varfërisë së skajshme marrin kupona ushqimi nga qyteti, dhe nuk lejohen më brenda mureve të qytetit," shpjegoi Magnus, duke hedhur pas tufat e gjata të flokëve të parukës së tij ndërsa fliste.

"Kupona?" pyeti Laurentius.

"Cilido që i takon me ligj të mbështetet nga qyteti merr një kupon monedhë të cilin mund ta shkëmbejnë me bukë. Askush, sigurisht, nuk dëshiron të shohë gra dhe jetimë të vuajnë. Por kam dëgjuar tashmë histori për djemtë më të fortë që vidhnin kuponët, dhe disa njerëz madje thonë se po falsifikohen. Situatë fort e keqe. Të rrahësh me rrip burrat trupmëdhenj, të shqepësh në dru gratë dhe të kërcënosh fëmijët e tyre. Këto shpërndarje ushqimi s'janë ide e mirë: thjesht sjellin këtu më shumë lypës dhe horra, gjithsesi qyteti nuk mund t'i ushqejë të gjithë. Kush e di ç'do të ndodhë pastaj? Mund të fillojnë të bëjnë trazira, apo madje të sjellin murtajën me vete."

Duke mbaruar shpjegimin e tij, Magnus mblodhi supet dhe vazhdoi t'i heqë halat peshkut.

Pasdite e së Enjtes

ATA HYNË NË NJË DHOMË që ishte e zhveshur si një barakë. Fillimisht Laurentius kujtoi se mund të ishte një plevicë me bar të thatë apo qilar, u desh pak kohë që ai të kuptonte se po hynin në një teatër të përshtatur, që ishte ngritur në një dhomë bujtine. Pa dyshim s'mund të krahasohej kurrsesi me teatrot e Bollhuset apo të Londrës, por gjithsesi synonte të ishte një lloj teatri. Kishte një mbështetëse të partiturës të gdhendur bukur, dhe disa karrige për muzikantët e vendosur në mes të dhomës. Dy shandanë të mëdhenj, secili me disa krahë, ishin vendosur në secilën anë të skenës, duke hedhur një dritë ngjyrë të verdhë mjalti rrotull tyre. Por drita e qirinjve erëkeq të dhjamt që shkrihen mund të arrinte deri në radhët e para, dhe nga fundi i dhomës drita ishte e dobët, kështu që dikush mund të dallonte vetëm fytyrat e njerëzve dhe shkëlqimin e shkurtër të parukeve të rastit, të ngritura lart në kokat e atyre që i kishin veshur. Laurentius gjeti një vend në radhën e fundit ku ishte errësirë sterrë, dhe qëndroi duke parë ndërsa të rinjtë veshur me pallto të mëdha të qëndisura hynë dhe lexuan programin e shkruar me dorë të ngulur me gozhdë në derë, duke u përpjekur t'i mbanin sa më larg mureve rrobat e tyre elegante. Në lartësinë e supeve kishte trungje të zhveshur me dërrasa të trasha të mbërthyera tek to me gozhdë, dhe ishin nxirë me blozë nga tymi që vinte nga vatra, e cila kishte dalje

drejt e në dhomë. Me sa duket kishte një të çarë në çati diku, sepse uji i shiut po kullonte nëpër qeprat e çatisë dhe po binte pikë pikë në dysHEME e tokës. Ndonëse vetë toka ishte shkelur shumë me këmbë, kashta që e mbulonte ishte e lagur dhe vende vende e rrëshqitshme. Bujtinari po kujdesej që të gjithë të kishin nga një krikëll të madh me birrë të fortë, pothuajse duke ua ngjeshur me forcë krikëllat në duar studentëve. Mund të ishte teatër, por kurrë nuk duhej humbur mundësia për të bërë para. Laurentius si gjithë të tjerët kishte marrë krikëllin e birrës, dhe tani po përpiqej të lexonte tabelën duke u përpjekur të kuptonte ç’lloj shfaqjeje do të shihte. Por nuk njohu asnjë emër.

“Kompozitorë vendas janë?” e pyeti ai personin pranë tij.

“Përse pyet?” e pyeti personi pranë tij.

“Nuk njoh asnjë nga emrat,” tha Laurentius.

“Me të vërtetë e ke? Nuk njeh asnjërin fare?” u duk i habitur personi pranë tij.

“Përse duhet patjetër t’i njoh?” e pyeti Laurentius.

“Epo nuk e di...” u përbisht personi pranë tij.

Interpretuesit mbërritën pothuajse në heshtje të plotë, me pamje pak nervoze, dhe u ulën në karriget e vendosura pas murit, me kurrizin e drejtuar dhe duart mbi gjunjë, duke vështruar ngultas përpara, me pamje disi të pajetë, si skulptura. Laurentius njohu Peter-in ndërsa ai doli përpara publikut dhe ngriti dolli për interpretuesit dhe vizitorët, e cila u pasua nga një varg i gjatë në latinisht. Laurentius hamendësoi se duhet të ishte vetë vepra e Peterit sepse gjuha e figurshme ishte shumë e rënduar dhe dukej që ndiqte me kujdes një formulë të mësuar në universitet. Por megjithatë në të kishte disa lojëra fjalësh, dhe një strukturë mjaft të rregullt vargu, për një rezultat mjaft të këndshëm dhe sofistikuar. Peter falenderoi publikun me një përkulje të kokës, dhe paraqiti shkurtimisht fabulën e shfaqjes. Doli të ishte një vepër alegorike: Orfeu humbet të dashurën e tij që shkon në ferr,

dhe kthehet në tokën e të gjallëve, zemërlëshuar dhe i vetmuar. Ai fillon të ndjekë perëndinë e arteve dhe diturisë, Apolonin, i cili zemëron ndjekësit dëfryes të dehur të Dionisit, të cilët iu sulën dhe e shqyen copash. Shfaqen Muzat; ato mbledhin gjymtyrët e Orfeut dhe e varrosin poetin në Leibethra-n e tij të dashur. Orfeu vdes dhe më në fund ribashkohet me gruan e tij Evridiqi. Ishte e qartë se publiku duhet të kuptonte që fabula simbolizonte akademinë që u mbyll gjatë luftës dhe u rihap si shtëpi e Muzave. Por gjithashtu mund të kishte qenë një alegori mbi temën e zhvendosjes së akademisë në Pärnu për shkak të kushteve të pakontrollueshme, falë konflikteve të vazhdueshme me ushtarët vendas.

Laurentius buzëqeshi me krahasimin e ushtarëve Të Madhërisë së tij me dëfryesit e dehur zhurmëmëdhenj. Sigurisht nuk ishte shumë patriotike, por fatkeqësisht ishte shpesh herë afër së vërtetës.

Bisedat në holl pushuan, dhe njerëzit po qëndronin në pritje ndaj interpretuesve. Paraqitësi i programit bëri një shenjë me dorë dhe njëri prej tyre u ngrit dhe eci me vetëbesim por pak si i ngrirë deri në mes të skenës. Ai pa për një çast fletat e muzikës, pastaj ngriti llautën deri në gjoks dhe filloi t'i bjerë. Laurentius ishte shumë i sigurt që nuk e kishte dëgjuar melodinë më parë, ishte e vjetër, por karakteristike dhe dhe të ngjethte mishtë. Ai nuk kishte ndonjë njohuri të madhe për muzikën, por gjeti me hamendje se pjesa kishte ndikimin e veprave të Doëland. Kishte njëfarë ngjashmëri me *Lachrimae pavane*, dhe ishte kompozuar për të shprehur melankolinë dhe hidhërimin e Orfeut. Të gjithë dëgjuan me vëmendje, madje të mahnitur. Por ndërsa akti vazhdonte Laurentius filloi të ndjehej çuditërisht i ftohtë ndaj gjithçkaje. Muzika iu duk sikur sa vinte dhe bëhej më e qetë ashtu sikurse edhe graham në hundën e tij që sa vinte dhe bëhej gjithnjë e më e fortë. Birra e hidhur nuk kishte larguar shijen e

keqe të prishur të peshkut, dhe tani dukej sikur muzika e kishte gjallëruar shijen dhe po e tërhiqte nga gjuha thellë në hundën dhe në kokën e tij. U ndie i përgjumur nga humbja e gjakut. Pa dyshim marrja e gjakut nuk kishte qenë aspak ide e mirë.

“I pa shpresë,” pëshpëriti me vete.

Qirinjtë kishin filluar të kullojnë dhe të lëshojnë një tym të errët; sa vinte dhe bëhej më e vështirë të merrje frymë në dhomën me tavan të ulët, dhe kishte një ndjesi gërvishtëse në fund të fytit. Ndërsa Laurentius u mundua shumë të përmbante ngjarjen e kollës e mallkoi veten dhe filozofinë mekaniciste. Me sa duket, nga ndjekja e asaj këshille për marrjen e gjakut nuk kishte ardhur asnjë e mirë; vetëm sa e kishte bërë t’i rinisnin ethet. Por tani ai duhet të përpiqej të përqendrohej.

Pasi akti kishte përfunduar dy studentë erdhën rrotull duke prerë majat e fitilave me gërshërë të mëdha, por qirinjtë vazhdonin të digjeshin ngadalë pa flakë. Me sa duket duhet të kenë qenë nga ata të lirët. Muzikantët u larguan nga skena dhe tre të rinj dolën përpara publikut. Njëri prej tyre filloi të këndoje me moskokëçarje, ndërsa dy të tjerët filluan të vallëzojnë. Ishte e qartë se po përpiqeshin të sillnin një skenë operatike sipas mënyrës së atyre të vëna në skenë nga Moliërit and Lully në Francë. Përmasat e vënies skenike ishin disa herë më e vogël, por dikush nuk mund të mohonte se teatri moderne kishte mbërritur shpejt në këto anë. Sigurisht nuk ishte ajo çfarë Laurentius kishte pritur. Sa herë që dikush gjetkë fliste për Dorpat ata do të përmendnin gjithnjë se qyteti ishte një periferi e largët e perandorisë suedeze, se vendasit ishin të pakulturuar dhe të këqij, dhe se flisnin një gjuhë që askush tjetër nuk mund të kuptonte. Dhe situata në akademi nuk duhet të ishte më e mirë.

“Tamam vendi për dikë si unë që të vij dhe të strukem një copë herë,” kishte menduar me vete atëherë Laurentius.

Kështu kur shteti suedez i kishte dhënë një bursë për të ardhur dhe studiuar në Dorpat, ai e kishte marrë vendimin. Ky ishte vendi më i mirë për të që të priste pa u ndier që skandalet të harroheshin përpara se të kthehej përsëri në Leiden.

Por tani na doli që Profesor Dimberg e kishte lexuar Njutonin dhe Boilin, dhe studentët madje po vinin në skenë një opera. Dikush mund të merrte me mend që muzika që ai dëgjoji në fillim ishte shkruar brenda vendit ose të paktën diku në rajonin fqinjë, por nuk qëndronte kurrsesi më poshtë origjinalit në anglisht. Ai u përpoq të kridhej në skenën përpara tij.

Studentët që vallëzonin dukej qartë që ishin shumë më pak të shkathët krahasuar me muzikantët. Në dritën e dridhur të qiriut kërcimi gazmor i të rinjve dukej disi komik dhe i kotë. Laurentius mori me mend se ata duhet të përfaqësonin të dashurit meshkuj të Orfeut, me të cilët dëfrehej ai pas humbjes së Evridiqinë, dashurisë së tij të vërtetë të shenjtë që shkoi në ferr kur ktheu kokën dhe e vrau me një shikim të vetëm. Duke iu dorëzuar kështu dashurisë mishore. Por jo, mendoj Laurentius, duke tundur kokën. Sigurisht do të kishte qenë tepër e guximshme, dhe aspak në frymën e Luteranizmit e cila duhet të kishte pushtetin në universitetet suedeze.

Kishte shumë të ngjarë që burrat që vallëzonin duhet të përfaqësonin miqtë dhe shokët e tyre që ishin përpjekur të ngushëllonin Orfeun pas humbjes së Evridiqisë, por dikujt nuk mund të mos dyshonte se një interpretim i dytë të shkonte ndër mend. Homoseksualiteti ishte bërë pothuajse në modë në oborrin mbretëror anglez dhe francez, dhe Laurentius ishte mjaft i sigurt se nëse opera kishte mbërritur deri këtu, atëherë bashkë me to do të mbërrinin edhe ato lloj ndikimesh. Gjithsesi kjo ishte edhe një shenjë tjetër shenjë që ky vend as që i afrohet provincialitetit që ai kishte menduar. Në disa prej universiteteve gjermane, teatri ndalohej krejtësisht.

Ai qëndroi në majë të gishtave dhe pa rrotull hollit. Të rinjtë e tjerë rrinin e shihnin shfaqjen me admirim, dhe nuk kishte pothuajse asnjë që të bisedonte apo të bënte zhurmë. Kishte nja dy studentë që ishin ulur në një tryezë m'u në fund të dhomës dhe luanin me zare, por edhe ata dukeshin disi të qetë dhe të sjellshëm.

Laurentius piu një gllënjë të madhe birrë. E gjithë kjo përvojë po i dukej vërtet interesante.

Interpretuesit ndërruan vende: disa nga publiku duartrokiten, të tjerë tundën shamitë e tyre në shenjë miratimi, dhe biseda rifilloi pak.

Laurentius nuk mundi të mos pranonte mundimin që ishte bërë në vënien në skenë të shfaqjes. Rezultati ishte ai i frymës së teatrit anglez, ku Apoloni dhe marrëdhëniet antikomformiste të Hiacintit apo Mbretit Uilliam i Portokallit dhe Arnold van Keppel shpesh talleshin, por kurrë në mënyrë dashakeqe apo moralizuese, por më tepër me shaka.

Ai buzëqeshi dhe duartrokiti me të tjerët. Por trupin e kishte të rraskapitur nga ethet, dhe ankthi po i mblidhej në gjoks pasi kishte qëndruar aq gjatë pa ngrënë. Parakrahu po i dhimhte aty nga ku kishte dalë gjak. Duhet të përpiqej t'i largonte nga mendja ato gjëra. Birra ishte e mirë, dhe humori i shoqërisë e ftonte. Teatri njihej gjithashtu si ilaçi më i mirë për melankolinë. Ai kishte qenë në teatër në Gjermani, Holandë, Suedi dhe kishte parë plot shfaqje të cilat ishin shumë më të dobëta se kjo këtu në Dorpat.

“Përsëriteni! Përsëriteni!” thirri ai bashkë me të tjerët kur përfundoi akti i dytë.

Në mes të poteres Peter u ngrit nga karrigia e tij, dhe britmat u bënë edhe më të forta.

“Është ende herët për një përsëritje; fabula ende nuk ka përfunduar. Heroi ynë është i vetmuar dhe dëshpëruar; ai ka

mall për të dashurën e tij. Por s'është gjë e mirë që një burrë të mbetet i vetmuar: veç dëshpërim dhe fatkeqësi të sjell kjo. Ky ishte vetëm fillimi, themeli, nga i cili tani do të shkojmë përpara.”

Peter dha e mori me shenja që të gjithë të heshtnin, pastaj lexoi me zë të lartë një poemë me varg gjashtërokësh, duke bërë kujdes të madh me rrokjezin. Prej andej u bë e qartë se radhën e kishin menadet, detyra e llahtarshme e të cilave ishte t'i hiqnin kokën poetit të gjorë. Muzikantët filluan t'u bien përsëri veglat, por këtë herë më fuqishëm, dhe tani bashkë me llautën dikush mund të dëgjonte një flaut e madje edhe gajde. Tingulli i egër i thellë monoton i përshtatej dëshirës së shfrenuar për krimin që së shpejti do të kryhej.

Disa silueta të veshura me rroba të bardha, me funde të gjatë fërfëllitëse, hynë me nxitim në skenë, dhe Laurentius u përkul përpara për t'i parë më mirë. Këta ishin studentë më të rinj, dhe tiparet e tyre fëmijërore ishin të tendosura, faqet i kishin të lyera me të zezë, dhe në kokë kishin paruke të vjetra të kokolepsura të shpupurishura. Këmbët e tyre të zbathura shkelnin nëpër kashtën që ishte shtruar në dyshemenë e tokës, dhe u mblodhën si mizë rreth Orfeut, duke u rrotulluar dhe duke bërtitur fort. Kishin në kokë kurora të thurura me thupra shelgu, të cilat duke marrë parasysh klimën vendase ishin ndoshta zëvendësuesit më të afërt të degëve të ullirit.

“Eja, eja me ne,” këndonin ata. “Lëre pas, Apolonin e ftohtë dhe serioz dhe ktheu te Dionisi. Vetëm me të do të provosh gëzimin dhe euforinë e vërtetë.”

Laurentius i pa duke u rrëqethur i tëri. Djemtë e rinj iu dukën fytyra shumë të njohura, sikur t'i kishte parë diku më parë. Ata ishin veshur me lecka, dhe shkonin e vinin duke u lëkundur, duke përshkruar gjoja gra të çmendura greke, ndonëse dukeshin më shumë si vajza fshatare të uritura apo shtriga. Flokët i kishin të

lëshuar, dhe shikonin si të marrë, në përshtatje të rolit.

“Duken si endacakë, apo jo?” i komentoi Laurentius personit pranë tij.

“E vërtetë,” iu përgjigj duke murmuritur personi pranë tij. “Por këta janë prapëseprapë dëfryesit e dehur; nuk ke parë ende Muzat. Ato kanë sigurisht një pamje më të hijshme.”

Laurentius tundi kokën. Ai e dinte se Muzat do të sillnin gjymtyrët e shqyera të Orfeut në Leibethra, dhe në atë pikë bilbilat do të fillonin të këndonin sipër kokës së njerëzve. Kjo mund të shihej si një Aluzion për lumin Emajögi të Dorpat, i cili ishte i famshëm për bilbilat e tij.

“Menadet gjithmonë më janë dukur disi të rrëqethshme,” u përgjigj Laurentius me një buzëqeshje të madhe.

“Ata vagabondë?” u përgjigj personi pranë tij, duke bërë me shenjë në drejtim të të rinjve që hidheshin andej këndeje në skenë, duke u hequr si i habitur. “Mjaft e the këtë.”

“Jo domosdoshmërisht nga ata. Në përgjithësi,” u përgjigj Laurentius.

Personi pranë tij mblodhi supet. “Për të qenë i sigurtë kemi sa të duash nga ato rrugace dhe vagabondë. Periferitë e qytetit tani janë përplot me ta, dhe një rojë është vënë në portat, për të mos i lënë ata të futen dhe të sorollaten nëpër qytet. Por megjithatë ata arrijnë të hyjnë; se di çfarë mund të bëhet për këtë. Gjithsesi, me aq sa kuptoj unë, Peter nuk mundi të bindë asnjë grua të bënte rolin e të dehurave dëfryese. Do të ishin dukur pak më të hijshme, them unë.”

Laurentius tundi kokën duke u pajtuar ndërsa shihte rreckamanët që kërcenin, duke u ndjerë i veçuar dhe i dehur nga efekteve e birrës dhe të etheve të tij. Ai përfytyroi një prej tyre të mbante kafazin me paraketin e tij të ngordhur ndërsa vallëzonin me ngathtësi. Duke u përkulur dhe kënduar, e duke tundur degë të gjata shelgu.

Laurentius fërkoj ballin dhe tëmthat, dhe u përpoq të përqendrohej te menadet. Ato kishin filluar të vërtiteshin rrotull Orfeut dhe e gërvishtnin si qentë që i ndërsehen një dreri. I gjithë pompoziteti dhe marrëzia e skenës ishte zhdukur. Rreckamanët u mblohdën bashkë; një kukull skerme u shfaq prej diku, dhe pastaj filluan t'i shkulin kokën që ishte qepur në të.

“Hej!” bërtiti publiku me gjallëri.

Rreckamanët ngritën kokën lart, dhe parukja ngjyrëkafe me kaçurrela e cila duhet të ishte në vend të flokëve të Orpheus dukej frikshëm prej vërteti dhe mjerane në dritën e dobët të dhomës. Laurentiusi kujtoi ekzekutimet që kishte parë. Xhelati në fund kishte ngritur kokën lart që të gjithë ta shihnin fytyrën e personit të përbuzur i cili sapo kishte dhënë shpirt, si dhe gjakun që po shkonte çurg poshtë kodrës së gjelbër. Por ç'kishte ndodhur me trupin? Trupi i Orfeut i shqyer në copa; gratë e dehura u dendën me mishin e tij; gjaku që u rridhte në mjekra dhe në gjokse dhe ato e shtynin me verë të kuqe.

Laurentius kishte parë trupa që hidheshin grumbull dhe digjeshin, mishin të karbonizohet dhe flokët të digjen ngadalë nga flakët. Dhe mund të mbante mend grahmën...

Laurentius filloi të kollitet; iu shkundën shpatullat; ndjeu një dhimbje të fortë në stomak.

Mbrëmja e së Enjtes

SAPO PËRFUNDOI SHFAQJA Magnus u ofrua të njohë Laurentiusin me aktorët. Pasi skena e fundit ishte përsëritur dy herë dhe brohoritjet e fundit kishin pushuar, ata iu afruan turmës laragane të të rinjve të ulur në një nga tryezat. Ata ishin veshur me xhaketa, pa shami gushe dhe me jaka këmishe të hapura, duke u përpjekur qartë të imitonin stilin e veshjes që haset shpesh ndër aktorët anglezë, dhe po diskutonin diçka me rrëmbim midis tyre, duke dhënë e marrë me këmbë e me duar. Ata buzëqeshën në përgjigje të njohjes së ngatërruar të Magnus dhe i rrahën shpatullat ndërsa ata u prezantuan pa marrë radhën. Peter i dha dorën me përzemërsi Laurentius-it, qartazi sa për formë, dhe e pyeti si kishte shkuar provimi. Laurentiusi mori çibukun prej balte që i dhanë, dhe filloi të tymosë duhanin bashkë me të tjerët. Zakonisht tymosja shihej si një ves i keq, dhe studentët me prirje Pietiste kishin të ngjarë të bënin qëndresën e tyre ndaj kësaj sa herë që kishin rastin. Por në këtë grup shokësh, kjo ishte thjesht një pjesë tjetër e jetës së përditshme studentore.

“Do të doja ta zhvilloja në një opera të plotë tragjike,” filloi të thoshte Peter. “Shto edhe disa skena hapësire të stilit të Monteverdit, dhe sigurisht pjesa e fundit me Muzat duhet të nxirret më mirë në pah.”

“Ti dhe dëshira jote e zjarrtë për Italinë! Asnjë nuk vë në teatër Monteverdin në ditët tona. Komeditë angleze janë shumë më të

mira, sigurisht,” kundërshtoi dikush. Laurentius kujtoi se ai ishte prezantuar si Matthias. “Gjithashtu efekti lehtësues të komedive është shumë më i madh. Sigurisht dua të them komeditë e mira, nuk mund të përfshijmë në atë kategori ato shfaqjet komike në parqet e lodrave.”

Grupi i shokëve shpërtheu duke qeshur, dhe Laurentius kujtoi çfarë kishte thënë kirurgu “berber” për katarsisin ose pastrimin. “Mendoj se komedia është në fakt një çështje mjaft e ndërlikuar. Është e lehtë të shohësh se si kuptimi më i thellë i një vepre të zëvendësohet nga një satirë fyese dhe e padrejtë. Shumë komedi bashkëkohore angleze janë jashtëzakonisht vulgare,” tha ai, duke u futur si pykë në bisedë.

“Si zakonisht,” u pajtua me një valëvitje të paqartë të dorës. “Por unë po flas për parimin e thjeshtë. Siç e dini, në komeditë në fillim gjithçka ka tendencën të shkojë keq për protagonistin, por në fund gjithçka rregullohet, kjo dinamikë pastron shpirtin dhe i ngre moralin publikut. Tragjeditë, gjithsesi, e bëjnë të trishtuar dikë.”

“Tragjeditë janë mësimdhënëse, shpjegoi Peter. Ato na kujtojnë se edhe kur dikush po përjeton lumturinë më të madhe të jetës së tij, fati mund të çojë në rrënimin e tij. Qëllimi i teatrit nuk është të ngjallë ndjenja të këndshme, por të edukojë publikun.”

“Por si mund të edukojnë njerëzit gjithë ato histori të trishta për ferrin dhe menadet?” pyeti Matthias, të cilit nuk iu ndenj pa sfiduar Peter-in. “Për më tepër, ka qaq shumë poshtërsi dhe mosmarrëveshje rrotull nesh në këto kohë sa zor se mund të kuptosh përse duhet të përshkruhen edhe në skenë.”

“Matthias, ti qerrata!” ngriti zërin Peter. “I përdor këto marifete të ulëta për të treguar se ke të drejtë! Epo, mirë atëherë, do të të jap një përgjigje. Në botë ka me të vërtetë plot poshtërsi dhe mosmarrëveshje, por nuk mund t’u jepet një kuptim më i gjerë. Është thjesht rastësi, episode pa lidhje. Vetëm teatri dhe sidomos

tragjedia është e aftë t'i lidhë së bashku këto episode. Ashtu si një kapak libri kap fletët e palidhura në një." Pastaj Peter u ngrit në këmbë dhe filloi të zbrazet me zë të lartë:

"Në thellësinë e saj shoh të mbledhura, të lidhura nga dashuria në një vëllim të vetëm, atë që është e shpërndarë në fletë libri në të gjithë universin: substancat dhe vetitë jothelbësore dhe lidhja midis tyre, të shkrira bashkë në mënyrë të atillë që ajo çfarë them është veçse një sqarim."

Të tjerët tundën kokën dhe u kukurisën të ndërgjegjshëm për këtë, madje edhe Matthias buzëqeshi.

"Sigurisht e di që Dante, të cilin po citon, e quajti veprën e tij *Komedia Hyjnore*?" tha Matthias.

"I ke rënë pikës," klithi Peter me emocion, dhe kapsalliti sytë. "Por sot të gjitha komeditë hyjnore janë zëvendësuar me ato njerëzore, dhe vetëm tragjedia ka fuqinë dhe thellësinë të dalë mbi palaçollëkun."

Pavarësisht asaj që u tha mësuesi i i frëngjishtes dhe i vallëzimit Z. Bazancourt, i cili kishte qëndruar me ta në heshtje deri tani, u gjallërua dhe filloi të shajë nxënësit e tij. "Në këto anë shumë pak vëmendje frëngjishtes. Edhe as vallëzim nuk duan të studiojnë, janë të gjithë shumë të zënë me sportin e skermës!"

"Pikërisht!" u pajtua Matthias prerazi. "Për të vënë në skenë siç duhet një operë duhet të ketë lëvizje. Vallëzimi mund të lehtësojë barrën nga shpirtrat tanë dhe të mbartë mendimet tona në vende të tjera."

Pastaj grupi i shokëve filloi një diskutim të ngatërruar për anët e mira dhe të këqija për shkrimin e veprave bashkëkohore teatrale dhe zotësitë e dobëta në frëngjisht në studentëve në Dorpat. Pas kësaj, biseda u zhvendos në pyetjen tipike të njësisë së vendit, veprimit dhe kohës. Dhe kjo çoi në mënyrë të pashmangshme

te diskutimi i operës si një shfaqje e plotë e cila ishte e aftë të bashkonte të gjitha format e tjera të artit.

Por të gjitha ato fjalë nga njëri vesh i hynë e nga tjetri i dolën Laurentiusit. Ai qëndroi ulur aty pak më gjatë, duke parë studentët të diskutonin me një shprehje të përgjumur në fytyrën e tij, por më në fund kërkoi ndjesë dhe u ngrit e iku. Tashmë grahma e qirinjve që nxjerrin blozë dhe duhanit të hidhur që digjej në çibukët prej balte ishte bërë aq e fortë sa ai nuk mund të qëndronte më në dhomë. Që prej fundit të shfaqjes askush nuk i kishte prerë majat e fitilave të qirinjve, dhe tani po digjeshin përbrenda si filli i këpucarit i zhytur në katran. Kundërmimi i përzierë me grahmën e prishjes që i vinte në vrimat e hundës, duke krijuar një përzierje të re të neveritshme që ai nuk mund ta duronte më gjatë.

“Ah, për mendimin tim kënga është edhe më e rëndësishme, apo jo Laurentius?” Peter i thirri nga pas.

Laurentius arriti t’ia bëjë me dorë shkurtimisht përpara se të dilte në errësirën e lagësht. “Muzika është forma e artit të Muzave!” thirri Peter.

Jashtë, ende binte shi dhe feneri mbi derën e bujtinës bënte hije të gjata te pemët që pikonin. Laurentius u ul në një stol poshtë gjerbave të ndërtesës dhe shtriqi këmbët përpara. Nga ajri i pastër jashtë iu morën mendtë. E mbështeti kokën pas murit të drunjte dhe mbylli sytë, dhe mund të dëgjonte zhurma të paqarta, dhe çokitje krikëllash birre. Pika shiu po pikonin nga gjerbat, duke formuar pellgje rreth ndërtesës, si një hendek i vogël me ujë. Era e ftohtë i solli flokët në fytyrë, por ai nuk ngriti dorën për t’i bërë anash. Laurentius po mendonte për flokët e Orfeut, dhe se si menadet ia shpupurishën ato. Ai kujtoi se si ato ia shkulën kokën dhe e brejtën trupin e tij. Do të kishte qenë një vënie në skenë amatore, po të mos ish për këtë episod që ia doli të ishte tmerrësisht realist, dhe e zuri në befasi.

Laurentius tundi kokën, lëvizte këmbët dhe s’po e zinte vendi.

U ndie i sëmurë dhe me nerva të cingërisura. Duhet të ishte brenda në të ngrohtë, por e dinte që nuk do të shijonte lllomotitjen aty brenda; nuk do të ishte në gjendje të përqendrohej si duhet. Do të ngatërrohej në ndonjë budallallëk. Gjëja më e arsyeshme që mund të bënte ishte të shkonte në dhomën e tij me qira, por u ndie çuditërisht i flashkët dhe apatik. Ndërsa u kollit, imazhe të kohëve të fundit i erdhën në mendje, kombinuar me fantazma që mendja e tij krijonte. U përpoq të mendonte për paraketin e tij, por kjo veç e bëri të kërveshet. Në vend të kësaj, imazhi i kafazit dhe i rreckamanit u shfaq papritur para syve.

Plaku kishte bërë si i tërbuar njësoj si ato menade. Uria i kishte bërë atë të kafshonte njerëz, t'u griste rrobat dhe të hidhej sa andej këndeje. Nëse do të kishte njerëz të tjerë si ai rrotull ndoshta ata do ta kishin bërë copash ndihmësin e lëkurëpunuesit dhe do ta kishin kullufitur, do t'i kishin brejtur gjymtyrët e tij dhe kokën nga trupi i tij. Laurentius filloi të mendojë se pavarësisht pikëpamjeve të tij të çuditshme për magjinë dhe gjithçka që ka të bëjë me të, lëkurëpunuesi duhet të ketë patur të drejtë për plakun. Ishte gjë e mirë që djali kishte arritur ta godiste me shkopin e tij. Kush e di çfarë mund të kishte ndodhur po të mos e bënte këtë.

Por a kishte qenë ai vërtet përgjegjës për vdekjen e atij plaku? Ai kishte patur një sjellje të çuditshme edhe atje lart pranë plevicës, kështu që mund të ishte bërë si i tërbuar nga uria, dhe Laurentus në këtë rast nuk kishte pasur fare të bënte me atë që kishte pasuar. A e kishte ngrënë vërtet plaku paraketin e tij? A i shkuli puplat asaj dhe e përplau?

Laurentius s'duronte dot të mendonte më gjatë për këtë.

U përpoq të përfytyronte Muzat të vallëzonin në Leibethra, bilbilat të këndonin, dhe blerimin rreth e rrotull. Kjo kishte qenë skena e fundit e shfaqjes. Por kishte qenë shumë më e dobët teatralisht, dhe shumë më pak realiste se tërbimi i menadeve. Përpara syve të tij u shfaq imazhi i një lirishteje me bar ngjyrëkaf

dhe një qiell i ulët, gri. Ai ishte dymbëdhjetë vjeç, i veshur me pantallona të grisura, dhe s'kishte çizme të vetat për të mbathur. Qëndroi atje këmbëzbathur në tokën e ftohtë dhe një burrë me një veshje të zezë, doli nga pemët e fuqishme dhe u afrua. Kishte vënë në kokë që kurorë të bardhë të përhitur.

Laurentius kishte parë në drejtim të burrit, sytë e tij ishin plot hutim dhe turp. Xhelati e kishte fshirë shpatën e tij në disa fije bari, dhe sekretari i gjykatës tha diçka. Kishte vështuar në ata sy për njëfarë kohe, dhe atje kishte parë çmenduri dhe brengë. Ethet që vinin valë valë e pushtuan të tërin, tamam si tani. Dikush e kishte mbërthyer nga shpatullat; ai i kishte bërë ballë dhe një nga fshatarët e kishte qëlluar me pëllëmbë në fytyrë. Atij i kishte filluar t'i dalë gjak nga buza. Gjaku kishte qenë i kuq, si lëngu i shegëve.

Laurentius filloi të kollitet dhe ndjeu një dhimbje të bezdisshme në fund të fytit. E zuri një shtrëngim në stomak; kishte një shije të thartë në gojë dhe një dhimbje thumbuese në gjuhë. Kishte nevojë të hante diçka; ishte shumë i uritur. Dhe diçka për të pirë, për të hequr shijen e gojës.

Kujtoi shportën me fruta, bukën dhe verën nga ai mëngjes. Mos kish qenë një vegullim? Ai i kishte Dimberg-ut se nuk besonte në shpirtra dhe fantazma, por imazhet ishin dukur aq reale. Ushqimi dhe pija mund të kenë qenë veç një turbullirë e dëshirës së tij të kotë dhe vegullimet fantazmagorike të trurit tij të lodhur, me ethe. Duhet të përpiquej të qëndronte i kthjellët. Por ishte dukur vërtet sikur dikush tjetër kishte qenë në dhomë me të. Ai kishte parë një fytyrë me një aureolë të bardhë përreth saj...

“Eh?” pyeti një zë m'u sipër tij.

Laurentius u përmend i trembur, dhe vështroi lart me habi. Përpara tij qëndronte një grua që nuk e kishte parë kurrë më parë në jetën e tij. Një çast më parë i ishte dukur të kishte parë një skenë shumë të ndryshme. Një fytyrë e zbehtë, flokë të zinj, lëkurë të

tejdokshme. Një shportë plot me fruta me huall mjalti. Me syrin e mendjes ai kishte parë gjithçka shumë qartë, tamam si në atë mëngjes. Nëse një pamje e ngajshme do t'i ishte shfaqur nga errësira, nuk do të habitet aspak.

“Si?” i shkau nga goja Laurentiusit si përgjigje, dhe pa si guhak fytyrën e pisët, të skuqur që e vështronte nga lart.

Me fundin me copë të ashpër, të lagur nga shiu, këmbët e zbathura, flokët e ngatërruara dhe shikimin e egër në sytë e saj, gruaja nuk i përngjante aspak fantazmës së tij. Laurentius ishte aq i habitur sa harroi të mënjanojë vështrimin, dhe vetëm po rrinte atje duke parë si guhak.

“Si?” u përgjigj fantazma, dhe ia bëri me shenjë të vinte me gishtin e saj.

Laurentius qëndroi i ulur aty ku ishte, duke dystuar flokët me një dorë, duke mos ditur ç'të thotë. Më pas kuptoi se i ende po shihte drejt e në sy gruan dhe i uli shpejt sytë.

“Dreqi e mori,” shqiptoi me fishkëllimë Laurentius nëpër dhëmbë. Kjo s' duhej të ndodhte.

“*Fucken*,” parashtrroi gruaja me një gjermanishte të çalë. “*Das he fucken?*”

“Më fal,” murmuriti Laurentius ende i hutuar. “Të lutem largohu.”

Gruaja murmuriti diçka me një zë të përvajshëm dhe e nduku Laurentiusin përsëri nga palltoja e madhe.

“Jo!” tha Laurentius, që tashmë ishte inatosur. “Si guxon?”

“Eja, eja,” tha ajo duke vazhduar ta ndukë. Më në fund Laurentius u ngrit dhe ndoqi gruan.

Nuk ishte i sigurt përse e bëri këtë, ndonëse mund të kishte qenë se e pa aq gjatë në sy. Ata ecën nëpër një shesh me baltë, kaluan disa shtëpi guri dhe u larguan nga qyteti nëpër Portën Ruse. Rojet nuk u kushtuan asnjë vëmendje. Gruaja kishte një vështrim të egërsuar dhe lëvizjet e saj ishin të ngrira dhe me hope, por

vazhdonte rrugën me një ndjenjë qëllimi. Ajo e dinte saktësisht se ku donte të shkonte. Duke ecur me hap të shpejtë, arritën te fortifikimet e bregut të lumit. Prej andej një rrugë e shtruar me dërrasa të trasha mështekne kalonte nëpër ultësirat e zeza. Laurentius kishte qenë më parë atje dje në mëngjes, dhe ai i njohu pemët e shelgjeve në të cilat kishte hipur për të marrë lëvore. Atje ishte vendi ku fshatarët kishin qëndruar duke e parë.

Për ndonjë arsye ndjeu se duhet të shpjegonte diçka, të shfaqësohej me gruan. Kështu që tregoi me gisht në drejtim të pemëve të shelgjeve dhe tha vetëm “ethe”. Por gruaja nuk u ndal për të parë; thjesht ia bëri me shenjë Laurentiusit që të vazhdonin dhe ata u futën më thellë në periferitë e rrënuara të qytetit, duke lëvizur përpara në mënyrë të paepur, sikur në një ëndërr.

Laurentius u përpoq të përqendrohej në atë që po ndodhte. Dje në mëngjes... dje në mëngjes Dimberg i kishte thënë të familjarizohej me një përmbledhje rreth jetës dhe zakonet e studentëve, prej të cilës kishte mësuar që ishte e detyrueshme për të gjithë studentët të futeshin në banesat e tyre me qira nga ora nëntë në mbrëmje, përndryshe ushtarët kishin të drejtën t’i shoqëronin në qelitë e paraburgimit. Do të ishte pa dyshim një përvojë e pakëndshme, të cilën ai duhet të përpiqej sa më shumë ta shmangte. Laurentius provoi të ndalonte fare, por siç i ndodhte rëndom kur shihte ëndërr nuk mundi t’i komandonte gjymtyrët; këmbët e tij sikur i bindeshin gruas, e jo atij.

Ai rrëmoi xhepin e tij të gjoksit për të gjetur orën. Ende kishte edhe ca kohë para se të shkonte ora nëntë. “*Fucken, fucken,*” përsëriti gruaja, dhe ia bëri me shenjë të vazhdonte rrugën. Ai bëri edhe një përpjekje tjetër për të qëndruar pa lëvizur, por krijesa që e ndukte papritur u bë shumë e fortë, dhe pothuajse ia doli ta rrëzojë përtokë.

Laurentius futi dorën në xhepin e gjoksin nxori një monedhë të vogël nga kuleta.

“Merre...” i tha ai gruas.

Por ajo i hodhi një vështrim parave dhe shpërtheu në lot. Pastaj ra në gjunjë në tokën me baltë u kap fort pas çizmeve të gjata të Laurentiusin, duke qarë me dënësë në mënyrë të papërmbajtshme.

“Mos qaj, mos qaj,” u përpoq Laurentius ta ngushëllonte.

Me sa duket kjo ishte një prej atyre vajzave që kishin pushuar nga puna në fermën ku punonte. Vajzat merreshin në punë për të mbledhur dhe shirë çfarë kishte mbetur në fusha në përfundim të verës, por të korrat e këqija i përngjanin farave të qimnonit, barit për gjumë, apo kakërdhive të minjve më shumë se sa kokrrave të drithit, dhe fermerët nuk shpresonin të ushqenin familjet e tyre gjatë dimrit, le pastaj punëtoret e fermës. Kështu që ajo ishte detyruar të zbriste në qytet për të kërkuar ushqim.

“Mjaft qafe,” i tha Laurentius, duke shpresuar ta qetësojë.

Gruaja u hodh përpjetë dhe filloi ta ndukë përsëri. Ata ecën buzë lumit dhe Laurentius i ngriti sytë dhe pa retë e zeza, duke vënë re se si përplaseshin dhe ndërthureshin njëra me tjetrën ndërsa kalonin.

“Prit,” tha ai. “Ndalo. Nuk do të të vij më tutje. Pikësëpari nuk e di përse erdha me ty, por tani nuk do të vij më tutje.”

Gruaja e pa drejt e në sy, kaloi dorën në flokë dhe shpërtheu përsëri në lot. Dikur mund të kishte qenë e bukur, por tani ishte prishur nga uria, faqet i kishte të rrufitura dhe lëkurën të plasaritur nga i ftohti dhe lagështira. Laurentius e ndihmoi të ngrihej nga toka, dhe ai s’ e priste që trupin ta kishte kaq të lehtë, madje edhe për të.

“Fëmija,” filloi të vajtojë gruaja. “Fëmija im është sëmure.”

Laurentius filloi të kërkojë në xhep për një monedhë tjetër, por s’denji dot pa menduar se po ta merrnin vesh lypësit e tjerë nuk do të merrte dot frymë nga zhvatjet e tyre. Ndonëse në fakt nuk kishte asgjë të pazakontë në lidhje me këtë situatë. Një grua kishte lindur fëmijë dhe i dhanë duart. Kishte shumë të ngjarë që asnjë madje

të mos e dinte kush ishte babai, ose ai nuk kishte dashur ta njohë si fëmijën e tij. Në kohëra zie buke për këto gra mbetej vetëm jeta e prostitutës. Por kjo ndoshta nuk do të mjaftonte për të mbajtur frymën gjallë, dhe dimri po afronte shpejt.

“Merre,” tha Laurentius. “Merre, dhe më ço te fëmija yt.”

Ai kujtoi kohët kur kishte qenë sëmurë, se si kishte pritur për dikë të vinte dhe të kujdesej për të, por më kot. Papritur e ngau kolla dhe gruaja pa nga ai pak e trembur. Ishte hera e parë që fytyra e saj shprehte diçka tjetër përveç zbrazëtisë dhe dëshpërimit.

“Kam ethe,” pëshpëriti Laurentius për t’u shpjeguar. Ata ecën edhe pak më tutje dhe më në fund arritën në një plevicë të madhe, e cila nga zhurmat murmuritëse, rrufitëse, dhe kollitëse, mund të thoshe se ishte plot me njerëz. Me sa duket ishte një vendbanim i përkohshëm, dhe Laurentius kujtoi atë që Magnus dhe tregtari i barit të thatë i kishin thënë se qyteti kishte ngritur një strehë për gratë dhe fëmijët e uritur që vinin nga fshati. Fillimisht kishte më shumë prej tyre se sa burra, meqë burrave të aftë mund t’u ziheshin duart me diçka në këmbim të diçkaje për të ngrënë. Laurentius pa brenda matanë pragut. Nga brendësia e ftohtë, e lagësht, vinte një grahmë prishjeje, ai lloj kundërmimi që dikush mund të gjente në një gropë plehrash.

Fillimisht nuk mundi të shohë asgjë fare, por më pas përvijime më të qarta filluan ngadalë të marrin formë veçmas nga errësira. Hamendësoi se dy kodrinat e vogla pranë mureve duhet të jenë fëmijë. Gra ishin ulur në tokën e zhveshur ; vetëm nja dy prej tyre ishin ulur sipër dengeve me kashtë të mykur, me siguri të mbledhur me mundim nga ndonjë dysHEME plevice apo mullar bari të lagur, nga ai që nuk bënte më për ushqim të thatë për bagëti. Laurentius e dinte shumë mirë sa e vështirë ishte të gjeje kashtë të mirë në Dorpat, ai e kishte blerë sa sytë e ballit kashtën për dyshekun.

Me kujdes kaloi përmes hyrjes, por askush nuk i kushtoi

vëmendje: ishin të ligështuar dhe të pavëmendshëm nga uria dhe lagështira e ftohtë, dhe nuk rrinin vetëm. Një plakë e keqe, ngriti sytë dhe e pa me ligësi.

“Mirëmbërma,” tha Laurentius, duke mos iu drejtuar ndonjërit në veçanti.

Gruaja me të cilën kishte ardhur u ul galiç pranë një njeriu trupvogël të mbuluar me një mantel të vjetër. Nga jaka e zgjyrosur kishte dalë një kokë mbuluar me flokë të verdhë. Laurentius u përkul pranë tyre dhe vuri pëllëmbën e dorës mbi ballin e fëmijës. Edhe pse ishte me ethe mund të ndjente nxehtësinë në dorën e tij.

“Ka nevojë të pijë shumë ujë,” i tha gruas, duke i hedhur një shikim të shpejtë në drejtim të saj. Nuk ishte e qartë nëse ajo e kishte kuptuar, por ajo tundi kokën dhe i tha diçka plakës që dukej e inatosur në gjuhën e tyre. Plaka murmuriti, u ngrit në këmbë, dhe doli jashtë.

Laurentius vështroi fëmijën. Mund ta dëgjonte teksa merrte frymë, me nxitim dhe me zë të ngjirur. Duhet të kishte ethe të forta; ndoshta ishte afër fazës kur gjaku trashet dhe ndalon së qarkulluari. Me pamje të shqetësuar, ai futi dorën në xhepin e gjoksit dhe nxori një pako të vogël me copëza të lëvores së shelgut të argjendtë të cilat i kishte mbledhur mëngjesin e një dite më parë. Pavarësisht këshillës së Dimberg për mjekësinë korpuskulare, ai i kishte mbajtur. Nuk ishin tharë ende si duhet, që do të thoshte se do të bënin shumë pak efekt, por megjithatë do të mjaftonin për fëmijën.

“Kemi nevojë për pak ujë. Ujë të zier,” tha Laurentius pa i ngritur sytë.

Gruaja tundi kokën.

Laurentius i dha asaj pakon dhe u përpoq t’i shpjegonte çfarë të bënte me rripat e lëvores. Gruaja dinte të fliste vetëm një a dy fjalë gjermanisht, dhe nuk kuptoi shumë nga sa tha ai. Por Laurentius më në fund ia doli t’i shpjegojë me gjeste se sa herë në ditë dhe se

për sa kohë ajo duhet t'i jepte lëvoren e bërë pluhur, dhe ajo vuri buzën në gaz.

Edhe Laurentius u përpoq të buzëqeshte, por sa ngriti pak cepin e buzës. Ai s'mund të ishte aspak i sigurt që temperatura nuk do t'i ngrihej fëmijës më vonë: lëvorja nuk mjaftonte për ta mjekuar si duhet. Por ndjeu se do të ishte e pahijshme për një të krishterë të mos i jepte vajzës së vogël ilaçin që i kishte mbetur.

Ai largoi nga fytyra e fëmijës së flinte flokët, dhe i preku përsëri ballin. Me këtë ajo u zgjua e trembur, hapi sytë, dhe vështroi lart me habi. Faqet i kishte thatanike, dhe sytë i dukeshin të mëdha në mënyrë jonormale në fytyrën e saj të vogël.

“*Kuningas*,” tha fëmija, qartë e shkoqur.

“Çfarë?” tha Laurentius, duke mos arritur të kuptojë fjalën estoniane.

“Mbreti,” përsëri gruaja në gjermanisht.

Ai qeshi dhe tundi kokën. “S’jam mbret. Jam veç një student universiteti.”

Ai ia bëri me shenjë gruas. “Thuaja asaj.”

Gruaja tha diçka por fëmija vazhdoi të shohë përqark syshqyer dhe syngulur; pastaj tregoi me gisht drejt derës së hapur, diku në largësi, dhe përsëriti.

“Mbreti.”

Laurentius pa në drejtim të tregimit të saj me gisht, por gjithçka që arriti të shoh në errësirë dhe mjegullën e hollë të shiut ishin vetëm disa pemë të largëta që tundeshin nga era.

E enjte, Mbrëmje Vonë

NDËRKOHË QË mbërriti në portat e qytetit lagështira në lëkurën e fortë të çizmeve. Shiu kishte filluar të binte më me rrebesh, dhe ai u mbështoll më fort me pallto dhe u përpoq të ulte kapelën përpara për të mbrojtur fytyrën nga pikat e shiut që i hidhte era. Në atë çast dëgjoi rënien e daulleve dhe të bërtiturat e postrojës. Pas pak sytë i zunë një llambë prej vajguri që varej në fund të një alebarde, pastaj rojet me uniforma erdhën nga aty pranë. Llamba e vogël lëshoi një dritë të dobët të verdhë, dhe postrojeve iu deshën ta ulnin afër Laurentiusit, derisa pothuajse i preku fytyrën. Ata e panë me kureshtje.

“I huaj jeni?” e pyeti njëri prej tyre.

“Jo, jam student; sapo kam ardhur,” iu përgjigj Laurentius.

“Mirë pra, Z. Student duhet të shkoni menjëherë në dhomën tuaj. Ora po vete pothuajse nëntë. I dëgjove daullet që sapo ranë? Ranë që të njoftojnë të gjithë të mos sorollaten më rrugëve. Apo nuk dëgjon mirë nga veshët?” tha njëri nga ushtarët me një ton zëri si ai i një zhurmëmadhi në një park lodrash. Ai qëndroi atje duke parë drejt e në sy Laurentiusin, në pritje të një përgjigjeje.

Laurentius ktheu kokën mënjanë dhe bëri një gjest të paqartë me dorë. S’ia kishte ngenë të ofendohej; gjithsesi tashmë ishte tepër i lodhur.

“Atje po shkoj,” tha Laurentius.

“Është ligj!” shtoi një rojë tjetër me një zë pak të zhgënjyer përpara se të kthehej dhe ikte. Ata mund të jenë zhgënjyer vërtet që nuk arritën të preknin në sedër Laurentiusin dhe të fillonin një grindje. Mund të thoshje me siguri se detyra e postrojes së mbrëmjes s’ ishte punë shumë e këndshme, dhe çuarja e një studenti në qelitë e paraburgimit do të siguronte pak larmi.

“Kujdes ku shkel!” bërtiti një rojë tjetër si për t’i thënë mirupafshim.

Duke u përpjekur shumë të buzëqeshte, Laurentius vazhdoi të ecte. Përpara se të përprihej përsëri nga errësira arriti të dallojë postrojet duke hedhur një sy vjedhurazi përmes një dere dhe duke ardhur rrotull brenda duke kërcitur me zhurmë alebardat e tyre. Me një mot aq të lagësht, nuk kishte kuptim të mbanin me vete topat e krahut. Gjithsesi Laurentius nuk ishte i sigurt nëse në ato anë do të kishte mjaftueshëm armë zjarri që secili nga postrojat të mbante një të tillë. Ushtarët në Dorpat ishin kryesisht fshatarë suedezë që jetonin tashmë prej vitesh atje, dhe hynin në sherre vazhdimisht me studentët. Telashet me sa duket kishin filluar sepse banorët e qytetit, që ishin kryesisht me origjinë gjermane, dhe ata studentë që vinin nga fisnikëria vendase, i trajtonin të porsaardhurit suedez me një lloj dyshimi dhe përbuzjeje, gjë që çonte në fyerje, grindje, dhe mllafe të ndërsjella. Banorët e qytetit akuzuan ushtarët e pikave të fortifikuara për nisjen e sherreve, për vjedhje, dhe që deheshin, dhe zakonisht me arsye. Konflikti fillimisht kishte ndodhur për motive kombëtare, por me kalimin e kohës ishte përhapur nga studentët me prejardhje gjermane duke përfshirë të gjithë anëtarët e akademisë. Tashmë kjo ndarje klasash ishte ishte konsoliduar fort dhe dukej e pamundur për t’u zgjidhur, nuk kishte asnjë forcë vullneti nga secila palë për të bërë këtë. Në këtë kontekst ushtarët gjetën kënaqësi në zbatimin e ligjit që kërkonte që të gjithë studentët të shkonin në dhomat e tyre jo më vonë se ora nëntë. Të shihje zellin luftarak me të cilin ata kryenin

detyrën e tyre ishte mjaft argëtuese.

Laurentius mblodhi supet dhe nxitoi në drejtim të shtëpisë. Këmbët i kishte të lagura dhe të ftohta; parakrahu i dhembte në vendin ku e kishte prerë me bisturinë një mbrëmje më parë, dhe venat e tij ndjeheshin të brishta si xhami. Por ai tashmë shpresonte të kishte nxjerrë gjithë gjakun e keq prej tyre.

Tani kishte nevojë vetëm të ecte edhe pak më tutje Rrugës Broad, dhe më pas pak para se të mbërrinte në ndërtesën kryesore të universitetit duhet të kthehej në Rrugën e ngushtë Cloister. Atje, pak përpara se të shfaqej parasysh bastionit Gustav, qëndronte një shtëpi që ishte restauruar dhe lyer me gëlqere të bardhë kohët e fundit. Shpresonte që shërbyesja të kishte ndezur në mbrëmje zjarrin, që dhoma të ishte e ngrohtë. Ndoshta mund t'i kishin dërguar edhe kashtën. Ndoshta për herë të parë prej shumë kohësh, do të flinte në një shtrat të ngrohtë, të butë. S'mbahej mend qëkur nuk kishte shijuar një rehati të tillë. Udhëtimi i gjatë, pensionet e paqytetëruara dhe shiu i vazhdueshëm, e kishin rraskapitur. Dhe kulmi ishte se e kishte kaluar natën e parë në dhomën e tij me qira si ndër ethe duke u përpushur në dërrasat e forta të shtratit, dhe gjithë natën tjetër e kishte kaluar ulur në karrigen e tij me krahun të mbështetur në një tas me gjak. Ndërsa mendoi për këtë, ndjeu një dhimbje shtrënguese në stomak. Tashmë ishte shumë i lodhur.

“Si një kufomë e gjatë,” s’ndjenji dot pa menduar ai.

Mori kthesën dhe hyri në oborrin me baltë prapa banesës së tij me qira, duke u mbajtur me duar në mur ndërsa u përpoq të shmangte pellgjet më të mëdhenj. Atëherë vuri re dikë që qëndronte atje, poshtë strehës pranë derës së pasme. Ndjeu një afsh të nxehtë frike t’i ngrihet në trup, dhe kërkoi verbtas instinktivisht shpatën në mill. Por pastaj vetëm tundi kokën dhe buzëqeshi zyrtë me vete. Ishte me ethe dhe i sflitur. Tepër i lodhur për t’u tronditur vërtet, tepër i pafuqishëm për të bërë lëvizje energjike.

“Përshëndetje,” tha ai i kapitur.

Ai ishte aq i raskapitur që shkoi të vizitojë fëmijën e sëmurë sa asgjë nuk mund ta habiste tashmë. Ai kish pritur disi madje të shihte atje përsëri gruan e re. Pas ngjarjeve të mëngjesit takimi dukej tashmë i pashmangshëm. Laurentius eci deri te shkallët dhe u mbështet te parmaku. Çizmet e tij lanë gjurmë balte në dërrasa, dhe kapela i pikonte ujë. Por vajza po qëndronte atje këmbëzbathur, e veshur me një bluzë të hollë të bardhë, si një ditë më parë.

“Unë...” filloi të thotë Laurentius.

Ishte e qartë se si ethet e veta shto këtu që pa edhe fëmijën në kllapi, bënë që t’i rriten nivelet e tëmthit të zi në trup. Me sa duket marrja e gjakut nuk e kishte ndihmuar aspak. Të gjithë këta takime të rastit të papritura, klima me lagështirë dhe të qenurit jashtë në këtë orë të vonë vetëm sa i bënë gjërat më keq. Ai u përpoq të buzëqeshë, dhe me ngathtësi u përpoq të gjejë fjalët e duhura. Por ç’t’i thoshte ai asaj?

Ai kishte ndjerë një shqetësim dhe paretat të ngjashme atje në plevicë, dhe në fund thjesht kishte vënë në kokë kapelën në heshtje dhe ishte larguar. Edhe atëherë nuk kishte ditur c’të thotë, nëna e fëmijës së sëmurë i kishte kthyer kurrizin dhe filloi t’i pëshpëritë diçka vajzës me zë qetësues, e cila ende fliste si në kllapi që kishte parë një mbret.

“A...” filloi të thoshte Laurentius, por nuk arriti përsëri të hapte një bisedë.

Laurentius ishte i huaj në këtë qytet, dhe u ndie si i ardhur që qëndronte në atë rrugëhyrje, njësoi siç ishte ndjerë në plevicë. Tashmë e kishin zënë ethe të forta përsëri, dhe gjaku i nxehtë që i qarkullonte nëpër vena e përgjumi. Siç i ndodhte shpesh kur ishte i sëmurë, ndjente sikur gjysma e tij ndodhej diku tjetër. Diku ku njerëzit zgjuar dhe esëll nuk shkonin kurrë. Ja përse kur pa pemët u ndie aq i shqetësuar dhe i frikësuar ndërsa u largua nga plevica. Kishte frikë se mund të shihte diçka në mes tyre, një lloj lëvizjeje përveç fëshfëritjes dhe lëkundjeve të degëve dhe pikimit të shiut.

Fundja, fëmija kishte treguar me gisht nga pemët. Ishte e vërtetë se fëmijët që shpesh flasin përçart kur janë sëmurë, por gjithashtu mund të jenë shumë më perceptues ndaj fantazmave dhe shpirtave se sa të rriturit. Të sëmurët shpesh mund të shohin përtej objekteve të përditshëm dhe shohin gjëra që njerëzit e shëndetshëm nuk mund t'i shohin. Laurentius gjithmonë e largonte vështrimin nga gjëra të tilla, prej frikës.

Shpirtrat e shëndetshme janë shpesh aq të topitura sa bëhen të pandjeshme, por shpirtrat e njerëzve të sëmurë dhe që po vdesin mezi mbahen në trupat e tyre dhe mund të jenë aq të ndjeshëm sa edhe një tel llaute. Ata mund të shohin demonë, ndonjëherë madje edhe engjëj. Ndërsa kishte ecur buzë lumit, nëpër shkurrishtë, Laurentius kishte parë me ankth rrotull, me frikën se sëmundja dhe melankolia mund ta bënin të shihte kalimthi një kurorë dhe mantel diku midis pemëve. Ose atje sipër lumit të errët të qetë, me shelgje të argjendtë në të dyja anë, ai do të shihte një pjesë mjegulle më të errët, rroba dhe një fytyrë... Ndërsa kaloi pemët prej të cilave kishte prerë lëvore pothuajse ia nisi vrapit, duke u penguar në degët e lëmuara dhe duke rrëshqitur në gjethet e gjata në formë shigjete. Ai kishte mbërthyer me sy pellgjet, duke parë majat e pista të çizmeve ndërsa ato nxitonin gjatë kthimit për në shtëpi, duke patur një ndjesi të thellë bezdisjeje që i përdridhej në stomak si gjarpër. Çfarë do të bënte nëse edhe ai do të thirrej me shenjë? Po të shfaqej një dorë nga errësira dhe t'ia bënte me shenjë të vinte? Tani që e kishte parë gruan në sy, mos do të thoshte se mbreti dhe shpura e tij kishte mbërritur tashmë?

Ai tundi kokën.

Kur dëgjoi dërdëllitjen e zhurmshme të rojeve në portë ndjeu t'i kthehet njëfarë guximi. Por sapo hodhi vështrimin te gruaja e re që qëndronte në dritën e dobët të shkallët, mendimi i tij i parë ishte se mbreti mund fshihej në errësirë pas saj. Këtë priste të shihte dhe kishte frikë.

“Çfarë bëre për të mjekuar sëmundjen tënde, siç të këshillova unë?” pyeti më në fund vajza, që me sa duket vendosi të fillojë vetë bisedën.

“S’bëra asgjë, në fakt. Në vend të kësaj shkova në banket. Në këto rrethana nuk mund të mos e pranoja ftesën,” tha Laurentius, duke e parë që dha një përgjigje çuditërisht të logjikshme. Por nuk mund ta shpërfillte ndjesinë e çuditshme që po qëndronte pas kurrizit të dikujt dhe se ai person po fliste në vend të tij. Sikur të mos kishte asnjë ndikim në atë që ai thoshte. “Ishte një event i shkëlqyer.”

“I mirë ishte ushqimi?” e pyeti vajza.

Laurentius u përpoq të kuptonte nëse në zërin e saj kishte një notë ironie.

“Po,” pranoi ai. “Ushqimi ishte vërtet shumë i mirë. Por këto kohët e fundit nuk kam patur oreks. Nuk munda të ha asgjë.”

“S’ke oreks?” Tani toni i saj i zërit i tingëlloi vërtet ironik. “Në ditët tona kjo është një ankesë vërtetë e pazakontë.”

Laurentius buzëqeshi me dëshpërim. “E di. Por gjithçka që ha ka shijen e dheut; thjesht më zihet në fytyrë dhe më bën të ndjehem i sëmurë.”

“Mos ndoshta nga buka dhe vera ime nuk do të të përzihet? A dëshiron ndoshta të hash diçka tani?” tha vajza duke e parë me turp.

Laurentius uli sytë poshtë. U ndie jashtëzakonisht i pafuqishëm, dhe duhet të mbështetej te parmaku i shkallëve. Dita kishte qenë tepër e mbingarkuar për të. Ishte i lodhur, ishte ende i dehur me ethe dhe birra. Ai kundroi poshtë dërrasat me dëshpërim, duke kujtuar shportën me fruta dhe huallin e mjaltit që kishte parë një natë më parë. Por jo... ai duhet të përpiqej të tregojë i arsyeshëm.

“Më fal...” murmuriti ai, dhe u ul te shkallët. “Kam ethe.”

“Oh, s’ka nevojë të më kërkosh ndjesë. Po të përcjell deri në dhomën tënde,” tha vajza me dashamirësi, dhe tundi kokën në

mënyrë miqësore.

Fillimisht Laurentius mendoi të mos e pranonte ofrimin e saj për ta ndihmuar dhe t'i shpjegonte që do të rregullohej vetë, që nuk kishte nevojë për ndihmën e saj, por u ndie shumë i lodhur. Kështu që u mbajt te parakrahu që ajo i zgjati dhe u përpoq të buzëqeshë.

“Je shumë bujare,” tha ai.

U ngjiten nëpër shkallën e errët, dhe në gjendjen e tij të ethshme krahu i vajzës në kontakt me të tijin iu duk i ftohtë akull.

“Pra edhe ti banuake këtu?” e pyeti Laurentius, si për t'u gjendur në bisedë.

“Vij ndonjëherë këtu, po...” u përgjigj vajza disi e hutuar, duke e lënë fjalinë përgjysmë. Vazhduan të ecin të shoqëruar nga kërcitja e shkallëve prej druri. Laurentius kishte një dhimbje therëse në këmbët e tij, ishte mirënjohës që vajza po e mbante. Pasi mbërritën lart te dera e dhomës së tij u ndalën, dhe Laurentius mori frymë thellë, duke menduar ç'të thoshte. Situata dukej e sikletshme, dhe ai duhet të gjente një zgjidhje sa më të njerëzishme.

“Po t'u desh diçka, më thuaj. Mund të të bëj edhe diçka për të ngrënë,” tha vajza, duke thyer heshtjen përpara se Laurentius të thoshte diçka.

“Natën e mirë,” tha Laurentius me një buzëqeshje, i lehtësuar që të paktën tha diçka.

“Natën e mirë,” tha vajza, dhe i dha atij një paninë.

Laurentius e mori pa u menduar. Buka ishte e ngrohtë, sikur sapo të kishte dalë nga furra. E nxehtë si ethet e tij, mendoi. Vajza u kthye për t'u larguar, dhe Laurentius e pa në heshtje të zbrësë shkallët.

“Si e ke emrin?” tha ai në drejtim të hijes, e cila ishte ende e dukshme në dritën e dobët.

“Klodia,” dëgjoji ai zërin të vinte nga poshtë. “Natën e mirë.”

Laurentius mori frymë fort dhe u mbajt te korniza e derës për

të mbledhur veten. E njihte shumë mirë këtë ndjesi. E kishte ndier edhe më parë. Vetëm një çast më parë gjithçka ishte shpërbërë rrotull tij; gjithçka ishte e pangjashme dhe e paqëllimshme; ditët kishin kaluar si re në qiell, duke u mbështjellë herë po herë jo te njëra tjetra, pa asnjë kuptim. Por pastaj papritur, një qëllim kishte lindur, një histori me një fillim dhe një mbarim. Të gjithë ata elementë të ndryshëm tani ishin lidhur në mënyrë të pazgjidhshme, nuk ishim më episode të veçanta që dikush duhet të mendohej t’i lidhte së bashku. Retë dukeshin si zogj dhe kafshë; të gjithë kishin logjikë e kuptim, një vend tek i cili ato më në fund do të mbërrinin. Të gjitha kishin drejtimin e tyre, vend tek i cili më në fund mbërrinin. Ai buzëqeshi, hapi derën dhe u ul në dyshekun e tij të butë, të mbushur me kashtë. U shtri ngadalë me kurriz. Dhoma iu duk e ngrohtë.

“Klodia.”

Ishte aq i lodhur sa e zuri gjumi në çast, pa lexuar as një lutje mbrëmjeje.

Natë

KONTROLLOJ COPËN E PALOSUR TË LETRËS në dorën time. Ndoshta do të më hyjë në punë, ndonëse s'jam i sigurt. Por ç'mund të bëj tjetër? Duhet ta provoj gjithsesi. Dal jashtë për të marrë pak ujë, dhe ajri i mbrëmjes është i ftohtë dhe i lagësht. Papritmas bëhet qetësi e madhe. Mbështetem te muri dhe mbaj vesh. Pikim, pikim, i ndjekur nga një pllaquritje, ndërsa uji rrjedh curril nga gjerbat. Kova poshtë tyre është mbushur plot, dhe uji derdhet herë pas here prej saj në tokë; është formuar një pellg i madh rrotull saj. Përkulem, dhe marr me garuzhde pak ujë nga kova në bardhakun tim, dhe e pi. Duhet të ziej menjëherë pak ilaç, por do të më duhet të shkoj në shpellë, këtu s'mund të ndezësh zjarr. Jashtë ka shumë lagështirë.

E fus copën e letrës poshtë rrobave dhe vrapoj shpejt përmes barit të lagur në drejtim të hyrjes së shpellës, tutje midis pemëve. Atje poshtë dikur ka pasur gurore rëre . Asnjë nuk e di me siguri se kur filluan të gërmojnë, por një numër i madh shpellash dhe kalimesh u gërmuan, disa të ngushta, disa më të gjera, duke u degëzuar në të gjitha drejtimet. Njëherë disa prej grave të tjera u futën pak më thellë për të parë rrotull, por unë nuk guxova. Është errësirë atje poshtë; ka diçka të mistershme dhe kërcënuese; nënat e trembin fëmijët e tyre me histori për kanibalët që jetojnë atje poshtë. Vetëm pak ditë më parë dikush nxori nga toka disa kocka me formë të çuditshme; ato dukeshin tamam si kockat e ndonjë

shpirti të lig. Sigurisht, janë thjesht histori, për t'i penguar fëmijët të vijnë rrotull atje poshtë dhe të mos humbasin në shpella. Të shkosh atje është ngjedbëse, por s'kam ku të shkoj tjetër për të bërë zjarr.

Më janë lagur flokët nga shiu; uji më ka kulluar deri në skalp, duke më shkaktuar gudulisje dhe të kruajtura. Nga rrobat e mia vjen një erë e lagësht duhani, dhe shiu kërcet vazhdimisht jashtë hyrjes së shpellës. Tashmë zjarri pothuajse është fikur; kanë mbetur vetëm ca cungje me nyja që digjen pa flakë. S'e di nëse ka ngelur mjaftueshëm qymyr për të mbajtur përsëri të ndezur zjarrin. Shtie pak ujë me garuzhde në tenxhere, dhe hedh nën të disa degë më të holla dhe në dukje më të thata. Më herët atë ditë dikush solli aty një deng të madh me shkarpa, duke shpresuar që zjarri do t'i thante. Por shkarpat shkarpa janë: digjen shpejt pa lëshuar shumë nxehtësi.

Fus ca thupra dhe fije të thata bari midis degëve dhe u fryj. Kashta fillon të ndizet; nxihet dhe të përdridhet; zjarri ndizet për një çast, pastaj shuhet përsëri. Flaka kërkon rrugën me hahmin përgjatë fijeve të barit. Një shtëllungë e dendur tymi gri fillon të ngrihet nga zjarri dhe del nga hyrja e shpellës, dhe duket sikur është ndezur me një ngjyrë të verdhë të zbehtë si ethet e verdha. Një shkulum ere e kthen tymin përsëri në shpellë dhe avujt hundëshpues më zënë frymën. Përkulem në tokë dhe i fryj kashtës dhe ajo fillon të digjet përsëri, por përsëri thuprat nuk ndizen. Fillojnë të më merren mendtë nga fryrja shumë fort dhe tymi fillon të më mbysë. Unë lëshohem përmbys dhe vazhdoj të fryj. Më pas dengu i shkarpave ndizet me një kërcitje, dhe flakët më përcëllojnë flokët dhe fytyrën.

Kthehem mënjane dhe qëndroj shtrirë në tokën e lagësht, dhe tymi fillon të pakësohet ndërsa shtëllunga e tymit del jashtë hyrjes së shpellës. Tani mund të ngrihem në këmbë përsëri. Pres që të ziej uji, por s'jam i sigurt nëse vërshëllima vjen nga drutë që digjen

apo nga uji në tenxhere.

“Oh Zot,” them unë me një gjysmë zëri. Nxjerr nga xhepi diskun që Maarja shtriga më dha. Faqja e kundërt është e lëmuar; ka përvijimin e një varëseje me kryq, të skalitur me gjilpërë të thatë me shumë mjeshtëri: është një vepër shumë e bukur arti. Por kjo është vetëm njëra anë, në tjetrën ka mbishkrime. Këto përdoren për të kapur shpirtrat e shtrupëzuar. Shtriga tha që të gjitha e shenjat e silfëve ndodhen atje, dhe se me ndihmën e tyre mund të bëj çfarë të dua. Nuk e di si kanë funksionuar më parë, por nuk më ka ngelur asnjë shpresë tjetër. Kështu shtrij rripat e gjatë të lëvores në pëllëmbën e dorës sime dhe e fus diskun midis tyre. Le t’i thërmojë rripat e t’i bëjë pluhur, nga pluhuri të bëhet ilaçi, miell për të bërë prekur bukën që do të shërojë vajzën time të vogël.

Hedh pluhurin në ujë dhe bëj shenjën e kryqit sipër saj me një gur. Copat e lëvores pluskojnë në ujin e errët pa rënë në fund. Duhet trazuar.

“Dreqi e mori,” pëshpërij dhe pështyp pas supit të majtë.

Ilaçi i shtrigës duhet të përzihet me thonjtë e gishtave të dorës, por të mitë janë thyer nga puna e rëndë. Shtrigat e mirëfillta nuk punojnë, prandaj mund t’i mbajnë thonjtë e gjata. Por ndoshta gjysmë thoi mund të bëjë punë.

“Dhimbje korbës, sëmundje laraskës bishtgjatë. Amen, amen, amen.”

Kështu më mësoi ajo. Jo se kam shumë besim në këtë magji, pikësëpari unë nuk desha të shkoja ta shikoja. Thonë se ajo merret vesh me vetë Djallin, dhe se ai me siguri do ta marrë shpirtin e saj në fund. Po unë ç’kam? Ai nuk do të tërhiqë zvarrë shpirtin tim. Ndonëse do të isha i lumtur të merrte timin, vetëm të linte të qetë shpirtin e vajzës sime të vogël të gjorë.

Uji fillon të nxjerrë fluska dhe unë përpiqem të mbaj mend se sa duhet të ziente. Aq kohë sa të them dhjetë herë ngadalë Lutjen

Ati Ynë. “Ati ynë që je në qiell. U shenjtëroftë emri yt. Ardhtë mbretëria jote...”

Diku aty pranë dëgjoj një zhurmë fëshfëritëse. Hidhem përpjetë i trembur.

“Kush është aty?”

Asnjë përgjigje, dëgjohej vetëm buçitja e erës dhe kërcitja e zjarrit. Por duket sikur atje tej është një lloj zogu, rreh flatrat me shiun dhe qiellin në sfond, një hije e errët që rri pezull në kufirin midis errësirës dhe dritës. Është një laraskë bishtgjatë? Një korbë? S’arrij të shoh qartë. E heq tenxheren nga zjarri dhe eci disa hapa larg unazës së dritës, duke u përpjekur të mësoj sytë me errësirën. Jashtë është errësirë pus; nuk arrij të shikoj asgjë. Qëndroj aty për njëfarë kohe, duke ndjerë ngrohtësinë e zjarrit në kurriz dhe ajrin e freskët të mbrëmjes në fytyrë. Ngadalë fillojnë të formohen konture, një pemë e madhe me degë të varura dhe gjethe të gjata në formë shigjete. Poshtë saj ndodhet një siluetë e paqartë, me një mantel të gjerë të hedhur në supe, me sy që i ndrijnë si yje. Apo është thjesht pasqyrimi i zjarrit? Vë re një zog me pamje të çuditshme që i ka qëndruar në sup; pastaj papritmas rreh flatrat dhe vjen fluturimthi drejt e tek unë. Kapet mirë me kthetra në fytyrën dhe flokët e mi; fillon të më gërvishtë me kthetra. Unë bërtas fort.

Përpiqem ta shqis, por nuk arrij ta kap, përpjekjet më shkojnë bosh. Dëgjoj disa zëra të frikësuar, që bërtasin fort. Duket sikur janë afër plevicës.

“Jam këtu,” bërtas. “Këtu, ndihmë!” Zogu i zi kapet me thonj në flokët e mi.

E Premte

LAURENTIUSIN E ZURI KOLLA, dhe po i dhembte stomaku. Kishte një ndjesi gërricëse në fund të fytit dhe një dhimbje në gjoks. U kapërdi në përpjekje për të hequr ndjesinë e acarimit, për të zbutur dhimbjen, por më kot. Po i merreshin mendtë, dhe po i mbahej fryma. Ishte një stërmundim i madh të merrje frymë normalisht.

“Një, dy; një, dy,” përsëriti ai me vete.

Më në fund pezmatimi i fytit i kaloi dhe u ngrit në gjunjë për të parë jastëkun. Gjak ishte? Për fat të mirë atje nuk pa asnjë njollë të errët, ndonëse këllëfi i jastëkut ishte vende vende i pisët dhe duhet të lahej. Tundi kokën dhe u përpoq të përqendrohej, por mendimet ende i kishte të turbullta.

Vetëm një çast më parë ai kishte qenë duke parë ëndërr. Por në kujtesën e tij nuk kishte ngelur asgjë që i përngjante një tregimi, vetëm një ndjenjë e turbullt faji. Por faj për çfarë? Për atë që kishte bërë atë mbrëmje? Që shkoi në mënyrë të papërgjegjshme me atë grua te streha, që i dha ilaçin e tij, dhe bashkë me të shpresë? Ai e dinte shumë mirë se t’i jepte dikujt shpresë do të thoshte edhe të merrje për sipër një detyrim. Një njeri që është i uritur, i vetmuar dhe në mjerim, i torturuar, më në fund ndalet i nënshtuar. Ai lodhet së vrapuari; do vetëm që gjithçka të mbarojë. Po nëse i jep shpresë, mbahen tek ty me të gjithë peshën. Cila është gjëja e duhur për t’u bërë në këto rrethana? Bota është e mbushur plot

me njerëz të tillë, dhe njeriu mezi mban veten e tij. Por Perëndia është i largët dhe i huaj për ata njerëz; ato parapëlqejnë të shohin Djallin dhe shpirtra të ligj ngado që shohin. Ndoshta do të ishte më mirë për ta të kërkonin ndihmë nga shkencat mjekësore; mund t'u ndodheshin më pranë tyre se Perëndia.

Laurentius tundi kokën. Shkenca ishte ndoshta gjëja më e mirë për ta; ata gjithmonë do të njollosnin besimin me besëtytnitë e tyre, do ta kthenin lutjen në magji. Ai mund të ndante ilacin e tij për shembull; s'e kishte problem të përgatiste ca më shumë.

Ai lexoi me zë të lartë një psalm mëngjesi: "He read out a morning Psalm: "Zoti u dërgoi atyre një llambë që ata të mos humbitnin në errësirë apo të pengoheshin në tokën e ashpër..." Por tani ai duhet të shkante dhe të studionte, që drita e nxënies të ndriçonte rrugën e tij. Ai sigurohej të përmendte akademinë në lutjen e tij ndërmjetësuese, po kështu edhe fshatarët që vuanin urie dhe paraketin e tij.

"Klodia... Klodia..."

Ai përsëriti emrin që ishte aq i afërt për të. Paraketi kishte qenë gjithmonë pranë tij, duke ia zbutur melankolinë. Po ajo vajzë? Dje mbrëmë ai kishte qenë aq i lodhur sa s'guxoi të mendojë shumë për atë që kishte ndodhur. Por sot? Jo, ende nuk mund t'ia lejonte vetes të mendonte për këtë, ishte e pamundur të kuptoje, të merrje vesh gjë nga kjo punë. Ai duhet të përqendrohej në shërimin e tij. Tinkura i kishte mbaruar, kështu që do t'i duhej të përgatiste prapë. Por dje ai kishte falur të gjithë lëvoren e shelgut, prandaj duhet të provonte ndonjë ilaç tjetër. Ndoshta duhet të provonte tinkturën e arit që Boil kishte përmendur? Laurentius u ngrit ndenjor dhe, i trullosur nga gjumi, filloi të rregullohej pak. Tani ethet e kishin liruuar pak. Fjetja në një dyshek të butë me kashtë të freskët e kishte ndihmuar pak. Dhe tani që dhoma ishte më e ngrohtë jastëku e kishte humbur pak erën e mykut nga udhëtimi.

Ndoshta kjo ishte arsyeja përse kundërmimi i kalbur që i

vinte në vrimat e hundës ndjehej më pak. Koka ende i dhembte pak, por mund ta kishte nga birra në banket. Ky mendim e bëri të buzëqeshë lehtë. Një dhimbje koke ishte një shenjë e sigurt që ishte pranuar si anëtar me të drejta të plota në komunitetin e studentëve. Kjo gjithashtu do të thoshte se ai duhet të ndiqte leksionet. Sigurisht që do t'i ndiqte! Profesor Dimberg e kishte këshilluar fort të shkonte në leksionin privat të Sjöbergh mbi shpirtin, dhe duke marrë parasysh rrethanat dukej si gjëja e duhur për të bërë. Për më tepër, një ditë më parë ai kishte lexuar në manualin e studentit se të gjithë studentët ishin të detyruar të ndiqnin universitetin sipas një orari, dhe të studionin me zell dhe saktësi.

“Zell dhe saktësi!” përsëriti Laurentius me vete.

Ndoshta marrja e gjakut e djeshme në fund i kishte shërbyer? U përpoq të kujtonte teoritë që kishte studiuar mbi temën. E dinte që marrja e gjakut duhet të zbuste sëmundjen, por mund të flashkëte edhe organizmin. Prandaj, ishte shumë e rëndësishme të fillonte trajtimin fuqizues menjëherë më pas. Ai duhet të rrethohej nga njerëz të tjerë, të ndihmohej nga gëzimi dhe lumturia e tyre. Vetmia vetëm do ta rriste vetminë: shpirti fillon të dhembë dhe kujtimet do të çliroheshin. Përvojat e reja ndihmojnë të luftosh melankolinë.

“Atëherë,” tha Laurentius duke brofur qëllimisht në këmbë. Ai duhet të largonte nga mendimet e tij gjithçka përveç ditës në vazhdim, të vepronte sipas një plani racional. Bëri disa hapa në drejtim të lavamanit për t’u larë, por gati sa s’ra me fytyrë në tokë. Po i merreshin mendtë.

“Sigurisht,” tha ai, duke u mërzhitur me veten ndërsa kërkoi me tahmim shtratin pas tij dhe u ul përsëri. Mund të shihte një mjegullinë vezulluese përpara tij, të gjitha objektet në dhomën e tij u dukën disi të tejdukshme, të ndërthurur te njëri tjetri. Dalëngadalë ia doli të përqëndrojë shikimin e tij përsëri, dhe

u gjend duke ia ngulur sytë një panineje të vogël mbi tryezën përpara tij.

Që atëherë nga episodi rrugës për në Dorpat, kur karroca ishte rrëzuar, kur përpiqej të hante diçka i vinte për të vjellë. Në hundën dhe gojën e tij kishte një kundërmim të kalbur të vazhdueshëm, i cili bënte që gjithçka që hante t'i dukej e pështirë. Ja përse ai nuk kishte mundur të hante asgjë gjatë këtyre ditëve të fundit. Mungesa e oreksit mund të ishte gjë e mirë në kohë zie buke, por ishte e vërtetë se uria nuk e ndihmonte aspak shëndetin e tij. Ai duhet të hante diçka.

Klodia i kishte dhënë atë panine dje. Ai kishte qenë pak i çoroditur, i hutuar nga gjithë ngjarjet e çuditshme të ditës, dhe nuk kishte vendosur çfarë të bënte me të, kështu që e vuri në tryezën pranë shtratit të tij. Të hapte oreksin kur e shihje, por ishte i bindur se do të kishte të njëjtën shije si gjithçka tjetër. Dhe nuk kishte asgjë për të pirë, për ta hequr shijen. Por ç'kishte thënë Klodia dje në mbrëmje? “Ndoshta nga buka dhe vera nuk do të të vijë për të vjellë?” Sa keq që ajo s'kishte patur verë...

“Shumë mirë,” i tha Laurentius panines.

Vendosi ta marrë me vete; madje do të rrezikonte ta hante më vonë gjatë ditës. U ngrit përsëri në këmbë, këtë herë shumë ngadalë, dhe me kujdes filloi të vishej. Dje venat i kishte ndjerë të brishta si xhami, dhe tani e njëjta ndjesi delikate ishte përhapur në të gjithë gjymtyrët e tij. I hodhi një vështrim të shpejtë rrotull dhomës për të parë si ishte, pastaj zbriti poshtë. Jashtë, binte ende një shi i imët i ftohtë, duke krijuar valëzime në pellgje. Vuri re shërbyesen që po mbante ca cungje pranë strehës.

“Mirëmëngjesi!” i thirri Laurentius. Pastaj kujtoi cungjet në dhomën e tij. “Shoh se dje i paskan sjellë drutë më në fund; me sa duket nuk harxhova gjysmën e kuotës sime për t'i blerë.

Gjithashtu faleminderit që ndeze zjarrin. Dhomën e gjeta shumë të ngrohtë kur u ktheva.”

“Oh, s’e ndeza unë zjarrin!” u përgjigj vajza, e zënë pak në befasi. “Pronarja më thirri ta ndihmoja me diçka, dhe më vjen zor ta pranoj por harrova fare. Të lutem më fal, po shkoj menjëherë ta ndez.”

Ajo mori edhe disa shkarpa të tjera, dhe duke i shtrënguar pas gjoksit, u ngjiti lart duke përplasur këmbët me zhurmë. Laurentius qëndroi duke e parë ndërsa ajo iku.

“E çuditshme,” mendoi ai. Mos u ngatërrova unë, apo ajo?” Ndoshta kishte qenë i dehur nga birra e djeshme? Laurentius mblodhi supet dhe u nis nëpër shiun e imët të mëngjesit, drejt akademisë.

Si zakonisht leksioni filloi me një lutje, që u pasua, siç premtoi edhe Dimberg, nga leksioni privat i filozofisë i semestrit të vjeshtës. Profesor Sjöbergh kishte njoftuar se do të ishte një vazhdim i diskutimeve të përgjithshme filozofike të vitit të kaluar, dhe jepej si një leksion plotësues për ata studentë që duhet të përgatiteshin për diskutimin e tezës së tyre akademike. Nuk ishte e detyrueshme, kështu që vetëm disa studentë më të vjetër kishin ardhur vetëm; ata më të rinj ose ishin ende në shtrat, ose ishin nisur për në qytet për të pirë birrë. Pavarësisht pjesëmarrjes së vogël Profesor Sjöbergh ishte me një gjendje shpirtërore entuziaste, dhe shumë shpejt u duk qartë se ai e merrte shumë seriozisht temën e shpirtit, me sa duket ishte në interesin personal të tij. Ai vuri në dukje se dikush duhet vetëm të dilte në rrugë për t’u përballur me pyetjen se si shpirtat e njerëzve mbaheshin të palëvizshëm brenda trupave të tyre. Dorpat ishte plot me njerëz që gati sa s’jepnin shpirt dhe një numër jo i vogël që mezi mbanin shpirtin gjallë. Gjatë leksionit u bë gjithashtu e qartë se ai ishte shumë i interesuar në idetë e reja për natyrën e shpirtit të cilat po i binin përqark

korrespondencave akademike. Sjöbergh kishte një rreth të gjerë korrespondentësh, dhe ecte me hapin e drejtimeve të reja të mendimit. Midis të njohurve të tij kishte filozofë nga Gjermania dhe Anglia, dhe madje merrte letra nga Italia herë më herë. Gjithashtu Dimberg i kishte blerë në udhëtimet e tij disa nga librat më të fundit.

Studentët dëgjuan fjalët hyrëse të Profesor Sjöbergh me një çikë interes, por nuk para u entuziazmuan shumë nga leksioni. Pavarësisht mendimit të ri novator që ai përmendi, ai nuk kishte bërë një ndryshim rrënjësor në strukturën e leksionin e tij, dhe studentët ishin të detyruar të vazhdonin diskutimin e traktatit *Mbi Shpirtin* të Aristotelit për të katërtin semestër rresht. Leksionet mbi temën e shpirtit kishin filluar me këtë botim që nga Mesjeta, dhe shumica e studentëve reagonin tani me njëfarë përbuzjeje skeptike. E dinin shumë mirë se filozofia moderne kishte përmbysur të gjitha qëndrimet e Aristotelit, dhe tani ai kishte vetëm interes historik.

Vetëm nga fundi i leksionit, kur Sjöbergh përmendi teatrin anatomik që Profesor Below po planifikonte, salla u gjallërua përsëri.

“Këtë vit planifikojmë t’i bëjmë gjërat ndryshe. Synim ynë është të njohim më mirë anatominë e njeriut, që do të na ndihmojë dhe udhëzojë në studimet tona më të gjera. Shumë pyetje që lidhen me shpirtin duhet të na bëhen më të qarta. Do të vazhdojmë me një autopsi sapo qyteti të na sigurojë kufomën e duhur, mundësisht madje edhe brenda këtyre dy ditëve.”

Studentët ishin pa dyshim të entuziazmuar nga mundësia. Gjetkë, autopsitë ishin pjesë e metodës së standarde të mësimdhënies, por në Dorpat ende nuk ishte bërë asnjë autopsi e një kufome njerëzore. Profesor Below planifikonte të bënte një provë fillestare, me synimin për të siguruar zyrtarisht në vijim mbështetjen e qytetit. Ai shpresonte të shuante kureshtjen

e publikut duke e bërë autopsinë të hapur për të gjithë, siç ishte praktikuar edhe më parë për disa vite në Leiden dhe Upsalë. Deri atëherë kryesisht vetëm maceve dhe qenve u ishte bërë diseksioni për mësimin e studentëve dhe argëtimin e qytetarëve, ndonëse edhe një kalë të ngordhur kishin tërhequr një herë në tryezën e diseksionit. Por ndryshe nga ç’pritej kjo nuk kishte ngjallur shumë interes. Në Dorpat nuk kishte shumë studentë mjekësie, dhe studentët e tjerë nuk tërhiqeshin shumë të shihnin organet e brendshme të kafshëve; mund t’i shihnin ato përditë në treg. Por autopsia e organizmit të një kufome njeriu ishte diçka krejt tjetër. Universiteti do t’u vinte një tarifë qytetarëve për ta parë, kështu që nga e gjithë sipërmarrja mund të dilte fitimprurëse.

Një nga studentët ngriti dorën për të bërë një pyetje, duke iu mbajtur goja nga entuziazmi. “Më falni, a nuk duhet të diskutonim qarkullimin e gjakut? Si dhe cila është pikëpamja juaj për vendndodhjen e shpirtit? A do ta trajtojmë temën e gjakut si një substancë që mbart forcën jetësore nëpër trup?” Për një çast, Profesor Sjöbergh u duk i përhumbur në mendime. Por më pas, duke shpërfillur pyetjen e studentit, u kthye nga Laurentius dhe pyeti, “Je nga Leiden, apo jo?”

“Po,” iu përgjigj Laurentius me një tundje të kokës.

“Atëherë pa dyshim që je i familjarizuar me mendimin që shpirti ndodhet në gjëndrën pineale?”

“Ajo është pikëpamja Karteziane, po. Por jam i sigurt që është e gabuar.”

“Pra qenke Platonist?”

“Jo. Unë jam vërtet një përkrahës i Filozofit,” pranoi Laurentius, duke kuptuar që kjo do ta vinte në pozitë disi të vështirë. Nga mënyra se si salla reagoi ndaj leksionit ishte e qartë se askush nuk kishte më vlerësim për Aristotelin në këto anë. Përkrahësit e tij ishin krimba librash që ishin mësuar me të

vjetrën dhe nuk mund të duronin fare metodën eksperimentale. Laurentius e dinte nga përvoja e vet në Leiden ç’lloj grindjesh mund të shkaktonte kjo pyetje.

“Ah, atëherë beson se ai ka të drejtë kur shtron parimisht se shpirti është trajta e trupit?” pyeti Sjöbergh me një ton zëri pak tallës.

Laurentius hodhi një vështrim të shpejtë rrotull dhe filloi të përpiqej të mbronte pozitën e tij. “A nuk është shpirti materializimi i trupit? Ja përse ne nuk gjejmë shpirtin kur bëjmë autopsinë e një personi, sepse një trup i vdekur nuk është më një person i vërtetë? Ne mund ta ndajmë trupin në copa të vogla, por nuk do të gjejmë shpirtin, sepse thjesht nuk ndodhet më aty.

Por cilido që është gjallë ndonjëherë provon një dhimbje brenda shpirtit të tij, apo jo? Ne jemi gjallë, dhe prandaj ndjejmë shpirtat tanë brenda nesh.”

Peter mori radhën: “Jam i sigurt që teatri anatomik do ta na e qartësojë këtë çështje. Ndoshta Zoti Hylas ka ndarë në copa shumë kufoma dhe prandaj është plotësisht i bindur për pikëpamjet e tij, por përvoja të mëson më mirë se fjalët, dhe përvoja është pikërisht ajo që na duhet. Fundja, ç’është teatri përveçse përvojë?”

Ai u përkul, dhe u kthye nga Laurentius dhe buzëqeshi, duke e bërë të qartë se ndërhyrja e tij nuk duhet të merrej shumë seriozisht.

Profesor Sjöbergh u kthye nga studenti që kishte bërë fillimisht pyetjen. “Jam i sigurt se do të mund t’u përgjigjemi atyre pyetjeve gjatë diskutimit.” Ai bëri me shenjë me kokë në drejtim të Laurentiusit. “Ndoshta Profesor Hylas mund të paraqesë një përmbledhje të teorive lidhur me temën? Por sigurohu të mos lësh të patrajtuara çështjet e gjakut dhe të gjendrës pineale, përndryshe bashkëstudentët e tu do të të bëjnë

disa pyetje shumë të sikletshme.”

Kërkesa e Sjöbergh nuk ishte në vetvete e pazakontë. Studentët që kishin ardhur nga larg shpesh e duhet të forcojnë reputacionin e tyre, duke vërtetuar aftësitë e tyre në debat dhe njohjen e latinishtes. Studimet që Laurentius kishte përfunduar luanin padyshim këtu rolin e tyre, të ishte nga Leiden prej tij pritej që të ishte më i ditur se studentët e tjerë në disa çështje, të cilët ishin kryesisht nga provinca. Por faktori vendimtar ishte mundësisht se Dimberg u kishte treguar profesorëve të tjerë diskutimin e tij, ‘Mbi Magjepsjen’. Sjöbergh pa dyshim mendonte se Laurentius ishte i aftë t’u paraqiste pikëpamjet më të reja studentëve të tjerë. Gjithsesi, një diskutim provë i këtij lloji përbëhej zakonisht vetëm nga një përmbledhje e shkruar nga vetë profesori kryetar, fjalë të cilat i kishte vënë në gojën e studentit. Shpesh kjo do të ishte e vetmja mënyrë që profesori të shprehte idetë radikale të cilat mund të mos pajtoheshin me ato të pranuar përgjithësisht në akademi.

“Do të isha shumë i lumtur të shkruaja për atë temë, sigurisht duke marrë me mend që mund t’i drejtohem ekspertizën personale të Profesor Sjöbergh, dhe sigurisht të përdor bibliotekën e tij të shkëlqyer,” u përgjigj Laurentius, duke pranuar propozimin e tij.

“Sigurisht,” tha Sjöbergh. “Eja të më takosh në drekëherë sot dhe mund ta diskutojmë çështjen më tej. Por duhet të kesh parasysh se duhet t’i mbulosh vetë kostot e printimit. Nuk mund të bënim përjashtim në rastin tënd, sidomos në rrethanat e tanishme.”

E premtë Drekëherë

PO BINTE SHI ME RREBESH AQ TË MADH sa asnjë nga studentët nuk guxonte të dilte jashtë, dhe ishin mbledhur në katin e parë të akademisë, duke u fjalosur me njëri tjetrin.

“S’e di, s’duket sikur shiu ka ndërmend të pushojë,” tha Peter duke psherëtirë ndërsa vështroi jashtë lumin e shiut që vërshonte në rrugë. “Asnjëri prej nesh nuk do të mbërrijë në shtëpi përpara mbrëmjes po të rrimë këtu duke pritur të pushojë.

Laurentius mblodhi supet.

“Në anën tjetër të rrugës është një tavernë e mirë, m’u pas kishës, duhet të shkojmë të hamë diçka atje, dhe shërbejnë edhe kafe, ose të paktën kështu bënë dje. Të gjithëve do të na bënte mirë të pinim nga një tani,” vazhdoi Peter me një krekosje prej të dituri. Të tjerët tundën kokën dhe dolën të gjithë duke u turrur nga dera, duke mbajtur me dorë kapelat me njërën dorë. Ata u pllaquritën nëpër ujin e shiut me mantelet e tyre që u fërfëlloheshin prapa, u kthyen në qoshe dhe u futën drejt e në derën e ndërtesës së parë ku mbërritën. Laurentiusi vrapoi bashkë me ta, hapi derën e madhe të tavernës dhe mbërriti në një dhomë të ngrohtë që mbante aromë kafeje. Në këtë qytet me ndërtesa të gjata, të holla, të mesjetës pothuajse çdo shkallë të çonte te ndonjë lloj taverne. Disa qytetarë kishin siguruar nga qyteti edhe një leje për prodhim birre, dhe shisnin ushqim

dhe pije nga kati i parë i shtëpive të tyre. Peter shpjegoi se ende nuk ishin hapur kafene të mirëfillta në Dorpat, por kishte disa vende ku mund të pije kafe. Laurentius nuk u habit shumë ta dëgjonte atë të fliste për kulturën e pirjes së kafesë. Nëse këtu kishte ardhur opera, nuk kishte asnjë arsye përse s’duhet të vinte edhe kafeja. Gjithsesi këtë zbulim e kishte pritur me kënaqësi, sepse ishte mësuar të pinte kafe në Holandë, dhe kishte pritur që Dorpat të ishte një vend shumë më provincial.

Laurentius fshiu shpejt fytyrën me duart e tij të lagura, dhe u ul në tryezën pranë dritares me studentët e tjerë. “Një llullë dhe një kafe, të lutem,” i tha ai vajzës që erdhi te tryeza, “...me sheqer,” shtoi ai pasi u ndal për t’u menduar. Të tjerët porositën pije të ndryshme, duke ngritur zërin të gjithë bashkë, dhe u hap një diskutim se çfarë të porosisnin për të ngrënë.

Laurentius u ul duke parë jashtë dritares, duke pritur duke u dridhur se ç’shije do të kishte në Dorpat. Në Holandë, e kishin zakon të bënin kafe me filxhana me bisht të gjatë, të stilit turk. Por gjatë përgatitjes, ka shumë hapësirë që shumë gjëra të shkojnë keq: ishte e rëndësishme të mos ziente shumë kafeja, për shembull. Sidoqoftë, vendosi ta porosisë kafënë me sheqer për të qenë i sigurt. Mund ta bënte shumë të ëmbël, por të paktën do të fshihte shijen e pakëndshme prej përgatitjes jo si duhet. Kishte frikë se përndryshe mund të kishte shije të neveritshme, si gjithçka tjetër në Dorpat.

Peter dhe studenti i shkurtër i ulur pranë tij kishte filluar të diskutonte për diçka, duke kaluar lehtësisht në dialektin e gjuhës Elfdalian të rajonit të vendlindjes, nga e cila Laurentius kuptonte vetëm një a dy fjalë. Por iu krijua përshtypja se po flisnin për çështje financiare. Ai u përpuiq të ndiqte bisedën për njëfarë kohe, por në fund u kthye të shikojë përsëri nga dritarja. Uji i shiut binte rrëke në xhamat e trashë të dritareve, por ai mund të shquante vetëm figurat e mjegullta të njerëzve

në rrugë. Shtrëngonin fort në kokë kapelat e tyre të errëta të shiut, ndërsa buzët e tyre fërfëllinin në shi, që tani sikur po binte akoma më me rrebesh. Ata u kërrusën ndërsa përpiqeshin të ecnin kundër erës, në nxitim për të gjetur strehë, të mbërrinin në vend cilido të ishte ai. Dje në mbrëmje, kur takoi Klodia-n, edhe Laurentius kishte patur një qëllim. Ai ndjeu me të vërtetë që kishte një vullnet të vetin, që mund të pëpiqej të fitonte diçka, të dëshironte diçka. Të arrinte diçka. Por tani ajo ndjenjë i ishte larguar, dhe mendimet e tij ishin përsëri të rrëmujshme.

“Kush i porositi llullat?” pyeti kamerierja.

Laurentius i buzëqeshi asaj, mori llullën e tij dhe e pufi fort. Duhani të shponte hundët dhe kishte një shije të hidhur, por ai vazhdoi të tymoste gjithsesi, duke shpresuar se bashkë me ngrohtësinë e dhomës tymi i nxehtë të mos lejonte t'i përkeqësohej sëmundja e tij e lagështisë për një farë kohe. Ishte e kotë të porosisje diçka për të ngrënë sepse ishte shumë i sigurt se nuk do të mund të kapërdinte asnjë kafshatë.

“Faleminderit,” i tha ai kamerieres.

Sapo ishte zgjuar, e kishte bërë planin e ditës, ndërsa ende mund të mendonte kthjellët. Ai duhet ta ndante në mënyrë të arsyeshme kohën që kishte në dispozicion përpara se nivelet e tëmthit të sëmundjes së tij të rriteshin përsëri. Nuk mund të kishte asnjë rrezik shmangieje; gjithçka duhet të ishte e parashikueshme, e sigurt dhe e qartë. Të gjitha takimet e rastit dhe ftesat e papritura do të kushtonin më shumë hutim dhe do ta përkeqësonin gjendjen e tij shëndetësore. Ai duhet të bënte një plan të rreptë dhe t'i përmbahej atij. Ishte pikërisht si ai planifikimi i paraprak: zbatimi i paracaktuar, i pagabueshëm i lëvizjes lokale. Me fjalë të tjera, shkencë.

Ishte si duhet të duket një shigjetë ndërsa fluturon nga harku, drejt e në objektivin e saj. Shkopi i drunjte ishte i pajetë dhe i mungonte shpirti por shpejtësia paravajtëse e çoi

pashmangshmërisht në pikën e marrë në shënjestër. Dikush mund të përcaktonte që më parë pikën të cilën maja do të shponte, vullneti i vetë shigjetës nuk kishte asnjë ndikim mbi këtë. Por dje në mbrëmje ai kishte patur qëllimin e tij. Ai kishte qenë më shumë se vetëm një forcë mekanike e vënë në lëvizje si organoja e automatizuar e Kircher. Ai kishte ndjerë vërtet të kishte një vullnet të të lirë të vetin, ai kishte përjetuar një ndjesi që i ngjante lirisë. A ishte e mundur që shigjeta të ndalej në mes të fluturimit, të thyhej në dysh nga sforcimi dhe të humbiste bishtin e saj prej puple pate të murrme? Të luhatej, të ndërronte drejtim, të bënte diçka tjetër nga mbërritja me saktësi në objektivin e paracaktuar? Dje në mbrëmje atij i ishte dukur se kështu kishte qenë.

“Çfarë mendon për temën e diskutimit që Sjöbergh propozoi?” e pyeti Peter, me sa duket pasi mbylli me sukses debatin me personin pranë tij.

Laurentius mblodhi supet. “Unë në fakt kam shkruar tashmë disa diskutime, jo për vlerësim, thjesht për t’u ushtruar. Por s’e di fare sa e pasur është biblioteka e tij. Mund të jetë e vështirë të bëj një përmbledhje të rrymave më të fundit të mendimit pa patur literaturën e duhur.”

“Me sa di unë ai ka një përzgjedhje të mirë të shkrimeve të fundit,” tha Peter. “Por ky Sjöbergh i yni në fshehtësi është një është Kartezian i kushtuar... Do ta shohësh vetë pas pak, ai me siguri i ka të gjitha librat që të duhen.”

“Pra i jep hua librat e tij?” e pyeti Laurentius me habi.

“Kështu ka bërë herë pas here në të kaluarën,” u përgjigj Peter.

Kjo padyshim e ka përmirësuar pak situatën. Duke marrë parasysh gjendjen në të cilën ishte, ideja e të punuarit në shtëpinë e dikujt tjetër, e frikësoi. Edhe më shumë nëse familja ishte e madhe. Do të ishte më tepër një vizitë shoqërore se sa

një mundësi për studim akademik. Kishte nga ata studentë të cilët qëllimisht e përdornin këtë lloj detyre studimi për t'u sistemuar në shtëpinë e profesorit. Të paktën atëherë nuk duhet të shqetësoheshin nga u vinin vaktet.

“Ku banon ai gjithsesi?” e pyeti Laurentius.

“M'u prapa akademisë. Dreka është shumë e mirë në shtëpinë e tij; kam qenë vetë disa herë atje,” u përgjigj Peter.

Më pas ai filloi të zbulojë cilët nga profesorët kishin namin që ushqenin studentët e tyre. Tashmë ai kishte njëfarë kohe ndodhej në Dorpat, që do të thoshte se ishte i informuar për figurat e ndryshme vendase. E dinte cilët profesorë mbanin prerë njëfarë largësie nga studentët e tyre dhe kurrë nuk i ftonin në shtëpi, duke e bërë të qartë që nuk do të donin të shiheshin në një shoqëri kaq të dyshimtë. Dhe kishte një kategori tjetër profesorësh që ftonin herë pas here njerëz në shtëpitë e tyre, por u jepnin ushqim të paktë dhe birrë të butë për të pirë. “Ndonjëherë mund të pish madje edhe verë në shtëpinë e Sjöbergh, po pati,” shpjegoi i riu ulur pranë Peter-it. Laurentius vuri re se ndonëse çizmet e tij ishin bërë copë copë, me takat e ngrëna, ai mbante veshur një pallto të madhe të qepur bukur. Gjithashtu kapelja e tij me strehë të ngushtë, e palosur dhe e kapur me gjilpërë në tre vende, madje kishte edhe një pupël të lagur që dilte prej saj. Me nga ç'dukej ai i përkiste atij grupi studentësh që e harxhonin të gjithë bursën e shtetit dhe kuotën nga prindërit e tyre për të blerë rroba të bukura dhe për dëfrime dhe më pas detyroheshin t'a shtynin keq e keq pjesën tjetër të vitit në kurriz të shokëve apo edhe të profesorëve. Laurentius ishte i sigurt se Peter dhe ky student ishin ngrënë me fjalë pikërisht rreth kësaj teme. Këta tipa do të përfundonin zakonisht duke punuar si mësues privatë. Mirësjellja ishte një koncept i kushtëzuar për ta, që do të thoshte se ishin të prerë për të shkuar mirë me njerëzit. Laurentius-it i pëlqenin këta tipa

shumë më tepër nga ata që i përmbaheshin në mënyrë obsesive rregullave të mirësjelljes, atyre zakonisht u ishte rritur shumë mendja në mënyrë të pajustificueshme dhe do të vringëllonin shpatat e tyre edhe me një fjalë të gabuar. Për fat të keq, këta lloj studentësh përbënin shumicën.

Ai buzëqeshi dhe tundi kokën me mirënjohje. Gjithsesi, tani ai kishte filluar të shqetësohej se çfarë do të ndodhte nëse ushqimi në shtëpinë e Sjöbergh do të kishte të njëjtën shije të keqe si kudo gjetkë, dhe se si mund të ruante mirësjelljen për të shmangur të bënte diçka të pahijshme.

“Nuk para më pëlqen të shkoj nëpër dreka,” shpjegoi Laurentius. “Shpresoj që të mos fyhet nëse shkoj ta takoj pas drekës.”

“Epo, nuk e di...Përse duhet të fyej? Mendoj se të ka ftuar më tepër për mirësjellje. Por megjithatë do të ishte më mirë ta njoftoje që nuk mund të shkosh,” e këshilloi Peter.

“Do të ishte pak e çuditshme që unë të shkoja dhe të thosha në emrin tim që për fat të keq nuk mund të shkoj,” tha Laurentius me skepticizëm.

“Mund të shkoj unë!” tha studenti me kapelën me modë, duke iu zgjuar interesimi. Ndoshta do të më ftojë mua për drekë në vendin tënd?”

Peter i rrahu shpatullat. “Ti, Jonas, je shumë finok.”

Laurentius mblodhi supet. “Sigurisht, përse jo? I thuaj që unë s’ndihem mirë, jam me ethe dhe duhet të shkoj në shtëpi. Është e vërtetë gjithsesi. Tashmë do të isha në dhomën time, nëse nuk do të binte kaq shumë shi. Thuajti që do të vij më mirë në mbrëmje.”

Jonas filloi ta pijë krikëllin e tij të birrës me gllënjka të mëdha. “Por ç’ke me ushqimin këtu, nëse mundem të të pyes? Magnus tha që nuk hëngre asgjë edhe në banket?”

“Vërtet?” e pyeti Laurentius me habi.

“Po. Rastisi të diskutonim për zotërinë tuaj. Po përgatitesh për dimrin? Me sa di unë të gjithë njerëzit po përgatiten për dimrin duke ngrënë sa më shumë. Apo ndoshta po solidarizohesh me fshatarët?” pyeti Jonas dhe ia plasi së qeshurit.

Laurentius buzëqeshi nga zori. “Me sa di unë agjërimi nuk është quajtur kurrë krim. Por nëse më kujtohet mirë, grykësia është një nga shtatë mëkatet mortar. Nuk e di, a është më mirë të përgatitesh për dimrin apo për vdekjen?”

Jonas pushoi së qeshuri dhe tundi kokën. “Një gjë është të kujdesesh për shpirtin tënd. Por nëse shpirti nuk është më brenda teje, atëherë s’ të mbetet gjë tjetër për t’u kujdesur, apo jo?”

Me këtë befasi të gjithë heshtën. Ndenjën duke parë nga dritarja e vogël fshatarët me mjekra të kreshta dhe kapele të vjetra, duke ecur me mundim këmbëzbathur në rrugën e lagësht. Pavarësisht që rojet ishin urdhëruar të mos linin më të futeshin në portat e qytetit rreckamanë, ja ku ishin, duke tërhequr me mundim këmbët zvarrë në shi, me pëllëmbët e rrokura fort si të luteshin, dhe shikimet ulur.

Me sa duket shpresonin të gjenin punë për të fituar para sa për të blerë pak bukë dhe të mbanin disi frymën gjallë. Por s’kishte gjasa me kushtet e mjerueshme në të cilat ndodheshin. Laurentius kujtoi fshatarët që kishte parë të cilët kishin marrë arratinë nga zia e bukës, dhe tani qëndronin shtrirë në barin e thatë të mykur në plevicën, duke pritur ushqim nga qyteti. Ai mendoi për vajzën të cilës i kishte dhënë ilaçin e fundit të etheve që kishte patur, dhe për nënën e saj, e cila përpiqej të shiste trupin e saj për të fituar para për t’u ushqyer.

“Po, plotësisht e pashpresë,” tha Laurentius duke u pajtuar.

U gjend duke pyetur veten nëse kishte mbetur ndopak ilaç, dhe nëse kishte patur ndopak efekt. Ai tani duhet të shkonte përsëri në farmaci për të marrë ilaçe të tjera. Fundja, ai i kishte

dhënë shpresë vajzës dhe nënës së saj. Duhet të shkonte në lumë për të mbledhur më shumë lëvore shelgu; pastaj mund të shkonte në plevicë dhe të shihte si ishin. Ai kishte marrë mbi vete një detyrim, duke shkuar atje dje në mbrëmje. Por për ndonjë arsye të panjohur që atëherë ai ishte ndjerë në faj, sikur të kishte bërë diçka të gabuar, të kishte bërë një punë të keqe dhe jo të mirë. Prandaj duhet të kthehej. Me kushtet e motit gjasat nuk ishin të mira, por s'kishte të bënte tjetër. Edhe pse nuk ishte i sigurt nëse do të mund të gjente përsëri ndërtesën e duhur.

“Përveç të tjerave, kush është përgjegjës për plevicën që u ngrit për fshatarët? Di që ata zakonisht nuk lejohen të kalojnë portat e qytetit?” pyeti Laurentiusi.

“Pikërisht, nuk lejohen! Nga ana tjetër pa shih këtë tufën këtu!” thirri Jonas. E mbaroi të gjithë birrën me një pamje të zemëruar në fytyrë, sikur të ishte fyer personalisht që kishte fshatarë të uritur që sorollateshin kot rrugëve.

Peter tundi kokën. “S’besoj të ketë më shumë se nja dy ushtarë me shërbim; ata vetëm mund ta kontrollojnë plevicën herë pas here. Kanë gjëra të tjera për t’u shqetësuar. Pikërisht sot në mëngjes dëgjova nga pronarja se po planifikojnë të transportojnë drithë së shpejti nga këtu në Suedi. Situata mund të fillojë të përkeqësohet shumë,” tha Peter, duke u dukur vërtet i shqetësuar. Ekzistonte rreziku që nëse numri i fshatarëve të uritur do të vazhdonte të rritej, atëherë qyteti duhet të fillonte të përdorte ushtarët për t’i ndaluar të hyjnë në qytet. Në këto rrethana ekzistonte rreziku që të përhapej murtaja, dhe nëse ajo arrinte në qytet, nuk do të kursente asnjë. Student apo fshatar qoftë. “Ajo plevicë në fakt është shumë larg qytetit, në drejtim të Aruküla, kështu që nuk ka të ngjarë të përfundojnë këtu rastësisht. Qyteti shpreson se nëse përhapet sëmundja, të paktën nuk do të arrijë menjëherë qytetarët,” shtoi Peter.

Pasdite e të Premtes

AI MUND TË SILLTE NDËRMEND MURET E
ERRËT, të lartë, rënkimet e fëmijëve të uritur, rrugën
e përbaltur. Ata kishin dalë nga Porta Ruse, kishin kaluar urën
e prishur mbi një lumë me shelgje në të dyja anët, më pas
kishin dalë nga rruga. Ajo pjesë kishte qenë e qartë. Qëndroi
atje duke parë pemët të cilave u kishte hequr lëvoren disa ditë
më parë. Ai kujtoi se si fshatarët kishin dalë nga askund, dhe
ai e kishte vënë dorën instinktivisht në dorezën e shpatës. Por
tani nuk dukej këmbë njeriu. Lumi dukej i qetë dhe i parrezik;
rruga dukej në gjendje më të mirë nga sa i kujtohej, madje edhe
shtëpitë e vjetra në anën tjetër të lumit dukeshin më ftuese se
më parë.

“E pra,” tha ai. Iu afrua njëerës nga pemët, preu shpejt disa
rripa lëvoreje për t’i marrë me vete dhe vazhdoi me ngut rrugën.
Mbi kasollet e këqija për përbënin periferinë e qytetit, kishte
rënë një heshtje e çuditshme. Herë pas here dikush do të vinte
dhe do t’i hidhte Laurentiusit një vështrim të shpejtë me bisht
të syrit, dhe sikurse më parë fëmijë me syshqyer rrinin dhe e
shihnin nga rrugëhyrjet, por këtë herë mori guximin të mos
shfaqte shqetësim. Të gjitha ndërtesat iu dukën të panjohura,
kështu që vazhdoi të ecë jo në një drejtim të caktuar, herë herë
duke vështruar ngultas përtej shtëpive për të parë nëse mund të
dallonte diçka të ngjashme me plevicën. Por nuk mbante mend

cilën rrugë ai dhe gruaja kishin marrë. Peter kishte përmendur se plevica ndodhej diku në Aruküla, por duke qenë se ai ende s' ishte mësuar me gjeografinë e Dorpat nuk ia kishte idenë fare ku binte. Ngado që hidhte sytë kishte vetëm shtëpi të ulëta dhe anekse të vogla ndërtesash, asgjë që përputhej me sa mbante mend nga kishin qenë.

Qëkur në kujtimet e tij ishte kthyer vajza e sëmurë ndërsa ishte në kafene, veç aty i rrinte mendja. A kishte bërë efekt pluhuri? A kishte mjaftuar? A ia kishte dhënë si duhet e ëma e saj? Ndoshta ai shqetësohej për vajzën sepse ishte i sëmurë vetë, sepse njëjtësohej me të. Ndoshta ai nuhaste se nëse ajo do të përmirësohej, do të përmirësohej edhe ai.

Laurentius vazhdoi rrugën me ngut pa u shqetësuar nëse po shkante në drejtimin e duhur.

Kishte qëndruar në kafene duke folur me Peter dhe Jonas më gjatë seç duhej përpara se t'i thoshte atyre që duhet të merrte ilaç dhe të shkante në farmaci. Farmacisti për habi i ishte dukur i edukuar dhe tregonte njëfarë ekspertize në fushën e tij, duke folur gjatë dhe me gojëtarë për mjekime të ndryshme, dhe duke përdorur shumë terma latine të mësuara. Me krenari i tregoi Laurentiusit një listë me barna që e kishte shtypur në shtypshkronjën e Dorpat. Kur dëgjoi se Laurentius vinte nga Leiden, filloi t'i thotë me britma gjithçka për situatën në Dorpat, veçanërisht për klimën, për të cilën ai kishte bindjen se ndikojnë në zhvillimin e disa llojeve të sëmundjeve, sidomos melankolisë, dhe gjithashtu shtoi se moçalet aty rrotull ndikonin gjithashtu. Laurentius madje filloi të pendohet që s'kishte shkuar më parë në farmaci përpara marrjes së gjakut. Ky s'iu duk aspak si sharlatan. Vetëm kur mori një shprehje fytyre tinëzare dhe filloi të shfajësojë popullatën vendase për dobësinë për pijen, e kuptoi Laurentius që diçka nuk shkante. Pas sharlatanizmit, dobësia për pijen alkoolike njihej si

sëmundja e dytë profesionale e farmacistëve.

Kur farmacisti pothuajse e detyroi Laurentiusin të merrte një shishe të vogël ilaçi që ai e kishte bërë sipas një recete personale, ai me nxitim filloi t'i shpjegojë se ai donte vetëm një ilaç të zakonshëm ethesh. Ai ishte përpjekur t'i shpjegojë farmacistit që duhej bërë kujdes i madh në përgatitjen e tinkturave, pasi shumë alkool mund të dëmtonte më shumë se sa të shëronte, duke e bërë njeriun e sëmurë t'i përgjigjet më pak mjekimit. Por farmacisti s'donte të dëgjonte.

“Thjesht pallavra, kishte thënë ai. “Është e vërtetuar shkencërisht. Sa më i fortë të jetë alkooli, aq më e efektshme është tinktura. E fërkon kështu para prapa qafës.”

Me mirësjellje Laurentius nuk e pranoi tinkturën me nepërkë dhe bleu një shishe të vogël me alkool të zakonshëm. Për të bërë si duhet një tinkturë ai duhet të distilonte një esencë të lëvores së shelgut, por nëse e njomte lëvoren në alkool dhe ta përdorte me kujdes duhet të ndihmonte në marrjen e shëndetit të brishtë të fëmijës. Po t'i mësonte nënës si t'i jepte fëmijës ilaçin, atëherë ajo do ta mjekonte vetë fëmijën. Ndonëse nga ajo që tha farmacisti për vendasit, ekzistonte gjithmonë rreziku që ajo ta pinte vetë.

Periferitë e qytetit kaluan; rruga filloi të gjarpërohet në ngjitje matanë një pellgu të vogël, dhe aty Laurentius kuptoi ku ishte. Mund të dallonte të njëjtin shteg të ngushtë për këmbësorë përgjatë të cilit kishte ecur dje në mbrëmje. Ky ishte vendi ku ai ishte trembur nga vegullimi e një mbreti elf, që rrinte pezull mbi lumë. Tani vetëm buzëqeshi duke menduar se sa besëtytnor kishte qenë.

Ai vazhdoi të ecë, duke u përpjekur dhe përpëlitur nëpër mozaikun e fushave me baltë duke kaluar herë pas here ca pemë, derisa më në fund dalloj një ndërtesë që i ngjante një plevicë, që qëndronte e vetmuar , e lënë shkretë në brinjë të kodrës.

Atje nuk kishte roje; dhe asnjëri nga banorët e mëparshëm nuk dukej gjëkund. Dyert e mëdha dykanatëshe ishin të hapura kanat më kanat dhe hapësira ku duzina njerëzish kishin qenë shtrirë ngjeshur përbri njëri tjetrit tani ishte e zbrazët. Përveç copëzash të rreckosura rrobe të shpërndara në dysheme, nuk kishte asgjë që tregonte se më parë këtu kishin jetuar njerëz. Një dorë kash të aty këtu, ca copa katrore në dyshemenë e tokës, por përveç kësaj zbrazëti. Laurentius filloi të dyshojë se qyteti kishte vendosur të mbyllë strehën dhe të urdhërojë ushtarët të largojnë të gjithë. Por pastaj ai vuri re se të paktën një person ishte ende atje, i kërrusur në errësirë në të djathtë të tij, duke ia ngulur sytë fort me armiqtësi.

“Tungjatjeta,” i shkau goja Laurentiusit. “Ku janë të tjerët?”

Pyetjes iu përgjigj me një tundje të kokës në shenjë mohimi, nga e cila Laurentius nxori përfundimin se njeriu i kërrusur me sa duket nuk kuptonte gjermanisht. Por u përpoq ta provonte përsëri.

“Të tjerët, ku shkuan?”

Plaka vazhdoi duke e vështruar ngultas lart, duke ia bërë me shenjë diku në largësi. Laurentius hoqi vështrimin.

“Ushtarët?” pyeti ai.

Plaka ia bëri me shenjë me dorë përsëri drejt pyllit, dhe kur Laurentius pa mund të dallonte vërtet një objekt të paqartë, të kaltërremë në kontrast me sfondin e murrme të pyllit, që shtrihej përgjatë bregut të lumit. Mund të kishte qenë një ushtar, por mund të kishte qenë edhe thjesht një trung peme ose një popël guri e madhe.

“Faleminderit,” tha Laurentius.

Ai shpejtoi hapin me një pamje të shqetësuar në fytyrë. Me sa duket një numër i madh njerëzish kishin shkuar përpara tij në atë drejtim, sepse bari ishte shkelur dhe rruga ishte bërë gjithë baltë. Me t’iu afruar formës së rimitë doli të ishte vërtet një

ushtar. Laurentius u ndal dhe po rrinte me siklet. Ç'të thoshte?

“Po bie shi me shtamba,” vërejti ai si një mënyrë për ta përshëndetur.

Ushtari bëri një gjest miqësor me dorë, me sa duket kuptoi nga veshja e Laurentius dhe shpata e tij që nuk ishte fshatar. “Ç’shi i madh po bie!” u përgjigj ushtari.

“E kanë mbyllur strehën atëherë?” pyeti Laurentius duke u përprjekur ta bëjë pyetjen të tingëllojë veç si kureshtje kalimtare.

“Jo, jo,” u duk i gëzuar ushtari që e informoi. “Pjesa më e madhe e tyre janë këtu në këtë shpellë.”

Vetëm atëherë Laurentius vuri re se po qëndronte shumë pranë hyrjes së diçkaje që dukej si një shpellë e bërë nga njeriu. Brenda ai mund të dallonte kurrizet e njerëzve dhe kapelet e tyre, dhe kishte fëmijë që qëndronin në anën e jashtme, të shtrënguar pas prindërve të tyre për t’u mbrojtur nga shiu i rrëmbyer.

“Atëherë çfarë po ndodh?” pyeti Laurentius.

“Epo, sot në mëngjes dëgjuam që po rriheshin këtu gjatë natës. Ishte një histori e ngatërruar; përmendën njëfarë mbreti shelgu lotues apo verri. Gjithsesi ata goditën një nga gratë me kopaçe dhe e tërhoqën me zor te shpellat. Kur ne mbërritëm për rojën e ndërresës së mëngjesit ajo ishte tashmë gjysmë e vdekur. Tani do ta marrin me barelë; ka ardhur edhe Pastor Mellinck,” shpjegoi ushtari.

Ndërsa turma u hap dhe dy fshatarë që mbanin barelën dolën nga mesi i tyre, Laurentiusit i shkuan mornica në të gjithë trupin. Skena i kujtoi kur pa rreckamanin që e zvarritin pasi ndihmësi i lëkurëpunuesit e kishte lënë thes në vend. Ai nuk kishte nevojë të pyeste kush ndodhej shtrirë poshtë rrobës së lagur. Pastori po ecte pas barelës, i veshur me një veladon të gjerë të zi, dhe i fliste ushtarit pas tij me një ton zëri serioz. Ushtari tundte kokën, duke kërkuar me tahmim dorezën e shpatës ndërsa ecte.

“Ke mësuar kush është fajtori?” e pyeti Laurentius duke u përpjekur të përmbajë një valë të fortë të vjelle. Një grahmë kalbësie po përhapej nga diku aty rrotull.

“Nga ta dimë? Të gjithë thonë se s’kanë parë asgjë. Incidente si ky ndodhin shpesh këto kohë. Qyteti i jep grave xhitona që t’i shkëmbejnë me ushqim, më pas vijnë djem dhe ua marrin. Nëse gruaja ka ndopak mend në kokë ajo ia mbath për të shpëtuar kokën, por nëse ajo bën qëndresë, do të hajë dackë. Kështu qëndrojnë gjërat këtu rrotull, kupton,” shpjegoi ushtari, duke treguar siguri për atë që fliste. “Kemi lloj lloj telashesh këtu, por nuk kemi mjaftueshëm burra për të zbatuar ligjin.”

Fshatarët gulçuan, dhe shanë me vete ndërsa kaluan me barelën, dhe Laurentius uli sytë në tokë duke u përpjekur të mos e shohë. Ai mund të shihte bar të gjatë, të kafenjtë, të lagur nga shiu, dhe shtegun me baltë përpara. Burrat po ecnin me hap të shpejtë, dhe ngarkesa u lëkund pak me ritmin e hapave të tyre. Shumë shpejt u afruan pranë Laurentiusit dhe filluan të zbresin pjerrësirën. Më pas njëri prej tyre rrëshkiti në barin e lagur dhe pothuajse u rrëzua, ndërsa tjetri u lëkund ndërsa u pëpoq të ruajë ekuilibrin. Mbulesa që ishte hedhur sipër barelës rrëshkiti në njëren anë, dhe një këmbë thatime e mbuluar me rripa lëkure të grisura kishte dalë në anë në një kënd të çuditshëm.

“Ç’punë e katranosur!” thirri një nga fshatarët.

Ushtari u sul drejt tyre dhe mbërtheu barelën. “Gati sa nuk u rrëzua!” tha ai me moskokëçarje dhe e vuri këmbën përsëri në barelë.

Turma filloi të thërrasë me të madhe. Dikush filloi t’u drejtohet me një zë autoritar, ndërsa të tjetrë murmurisnin me zemërim. Disa po tregonin me gisht në drejtim të Laurentiusit.

“Ç’kanë?” pyeti ai.

Tashmë pastori dhe ushtari që e shoqëronte kishin ardhur pranë Laurentiusit. Pastori ngriti dorën e tij dhe preku lehtë buzën

e kapeles së tij, duke buzëqeshur vesh më vesh. Ai ishte tek të pesëdhjetat, me mjekërr të rritur, dhe flokët i kishte të prera shkurt si Pietist apo si një Kokërrumbullakët Anglez. Laurentius e hodhi vështrimin poshtë. “Mirëmbërma.”

“Përshëndetje. Jacob Mellinck, bariu i shpirtrave. Ç’ë mirë të sjell këtu?” pyeti pastori me gaz. “Kishe dalë për të bërë një shëtitje?”

“Laurentius Hylas, jam regjistruar në universitet këto kohët e fundit,” tha Laurentius me një ton zëri që tingëllonte ngurrues. “Po shëtisja vërtet këtu rrotull; po njihesha me këto anë. Shikoj se ka shumë moçale këtu, dhe kam dëgjuar të flitet gjithashtu për burime shëruese. Kam mësuar se po bëhen madje kërkime balneologjike?”

Kjo kishte qenë një nga dijet vendase që farmacisti kishte ndarë me Laurentiusin. Ai i kishte thënë se një Profesor Micrandër (jo më pak se vetë miku i tij) kishte bërë disa kërkime për vetitë shëruese të ujërave afër Dorpat.

“Po, është e vërtetë,” u përgjigj pastori. “Edhe unë jam përfshirë në to, burimet këtu prodhojnë një llum që mund të përthithet lehtë nga kyçet dhe mund të shërojë shumë sëmundje të rënda. Por në ditët tona kemi në dispozicion gjithnjë e më pak kohë për kërkime. Mund të shohësh vetë se me ç’duhet të përballem përditë, me masat e paditura.”

Mellinck bëri një gjest në drejtim të turmës së zhurmshme të grave dhe fëmijëve. Fëmijët me sa duket po përpiqeshin t’u shpjegonin diçka nënave të tyre, duke tundur kokat të shqetësuar. Ata ishin të përbaltur dhe xanxarë dhe pastori po tregohej zemërgjerë kur i përshkruante si të paditur.

“Çfarë ndodhi? Përse janë aq të zemëruar?” pyeti Laurentiusi.

“Pikërisht në këtë çast? Epo, shih, kufomës filloi t’i dalë gjak. Thonë se gjaku fillon të rrjedhë kur kufomën e kalojnë pranë vrasësit. Por është thjesht një besëtytni e kotë, sigurisht. Ushtarët

ia ndërruan pozicionin gruas, ja përse asaj filloi t'i dalë gjak.”

“Ah, ashtu?” tha Laurentius, duke mos ditur ç'të thotë tjetër. Ai mund të shihte gjakun ngjyrë të kuqe të fortë që rridhte në fijet e barit, duke u përzier me ujin e shiut, dhe në pellgjet e ujit që mblidheshin në gjurmët e këmbëve të burrave ishin formuar disa vija veshtullore të kafenjta.

“A ka vdekur, pra?” e pyeti ai pastorin.

“Po, vdiq përpara se të vija unë. Ishte sigurisht një skenë e neveritshme. Fillimisht mendova se ndodhi prej atyre xhitonave, kemi patur shumë probleme prej tyre, do të ishte më mirë sikur qyteti të gjente një mënyrë tjetër për të trajtuar çështjen. Por me sa duket ishte në fakt e njëjta histori e vjetër e magjisë. Po flisnin për një mbret që ishte ardhur prej diku dhe i kishte dhënë gruas një pluhur, që ajo të shkonte të adhuronte Satanain. Zakonisht ata thjesht vijnë dhe na ankohen për këtë, por në këto kohë të vështira ata kanë filluar të bëjnë vetë drejtësi.”

Laurentius mezi arriti të tundë kokën. Ai duhet ta kishte ditur që kështu do të ndodhte. Iu mbushën sytë me lot ndërsa e pushtoi turpi dhe bretja e ndërgegjes. Ndoshta kishte njëfarë të vërtete në atë që thoshin për kufomën që nxirrte gjak pranë vrasësit, edhe pse fenomeni nuk kishte bazë shkencore. Gjithsesi, ai ia kishte dhënë fëmijës ilaçin, kështu që mund të shihej si ai në të cilin binte drejtpërdrejt përgjegjësia për vdekjen e nënës së saj. Atij nuk i kishte shkuar kurrë në mendje se njerëzit mund të mendonin se mund të ishte ndonjë pluhur shtrigani. Por kështu si qëndronin punët, edhe shkasi më i vogël mjaftonte për të akuzuar dikë për aktivitete okulte.

“Po, kjo është një histori e njohur në këto anë,” tha më në fund pastori. “Po përpiqem vazhdimisht t'u them se magjia është thjesht një trillim i imagjinatës, që shkaktohet nga melankolia, por provo t'u shpjegosh këtyre njerëzve diçka në terma praktikë! Ata thjesht nuk të dëgjojnë. Ata do të këmbëngulin se ata bëjnë ujdi

me Satananë dhe fluturojnë në qiell mbi dhi, dhe lloj lloj gjërash si këto. Dikur një plak më siguroi me kokëfortësi se ai ishte një njeri-ujk, dhe se vizitonte shpesh ferrin për të marrë drithë. Gjykata e kishte mbyllur çështjen dy herë, por plaku i çmendur vazhdonte në të tijën. Ata sikur nuk janë mirë nga trutë,” tha Mellinck, me sa duket shumë i mërzhitur nga situata.

Laurentius buzëqeshi me trishtim. Me sa duket pikëpamjet e pastorit mbi temën vinin direkt nga vepra e Johann Weyer-it mbi iluzionin e demonëve.

“Për mendimin tim *De praestigii daemonum* paraqet një shpjegim mjaft të drejtë,” tha Laurentius, sa për të thënë diçka, për të fshehur brengën dhe dëshpërimin e tij. Ai e kishte përdorur pikërisht këtë libër që të përpiquej të kuptonte më mirë sëmundjen e tij, të përpiquej të gjente një ilaç.

“Oh, e paske lexuar?” pyeti pastori, duke u gjallëruar. “Është një temë shumë e ndjeshme. Për një farë kohe kam cituar Weyer-in duke u përpjekur të bëj të qartë se magjia është një sëmundje e mendjes më tepër se sa diçka e bazuar në realitet. Por përsëri na ka hapur shumë telashe. Meqë ti je i porsaardhur në qytet duhet të të paralajmëroj se njerëzit këtu janë shumë besëtytnorë. Shohin shpirtra dhe demon ngado. Kanë dëgjuar mjaftueshëm mësimet e Krishtit sa për të përdorur Biblën në magjitë e tyre. Unë dhe Forselius kemi filluar madje të drejtojmë shkolla për fshatarët, për të trajtuar injorancën dhe besëtytninë e skajshme që mbizotëron. Sa keq më vjen që Forselius gjeti vdekjen në atë mënyrë. Por fatmirësisht po hapen shkolla të reja gjatë gjithë kohës, dhe besoj se situata dalëngadalë ka filluar të përmirësohet,” duke vështruar larg mendueshëm ndërsa fliste.

“Më vjen mirë të dëgjoj këtë,” u pajtua Laurentius i hutuar. “Por ajo gruaja...a kishte familjarë a të afërm?”

Nuk guxoi të pyesë drejtpërdrejtë për vajzën e sëmurë, që të mos ngjallte dyshime të mëtejshme. Por as nuk mund ta

harronte çështjen.

“Të afërm?” pyeti pastori me një ton zëri të habitur. “Po të kishte të afërm nuk do të ishte futur në telashe. Pikërisht ata që s’kanë asnjë e kanë jetën më të vështirë. Në këto anë i dërgojnë që dhjetë vjeç fëmijët më të mëdhenj të shkojnë të punojnë për të panjohur, pastaj kur vijnë kohët e vështira atyre nuk u mbetet askush. Këtu rrotull ka shumë jetimë.”

Laurentius e dinte që më parë se si qëndronin punët. Një herë ai madje ishte endur vetë lart e poshtë si këta fëmijë. Në moshën tetë vjeçare atë e kishin larguar nga shtëpia, dhe tani nuk mbante mend asgjë fare, as fytyrën e nënës dhe babait të tij. Ai ishte detyruar të gjente punë në ferma, të jetonte mes të panjohurve, duke mbajtur frymën gjallë me mbeturina, duke e zënë gjumi duke qarë çdo natë. Gjatë gjithë kohës kishte patur një dëshirë të fortë për të shkuar në shtëpi; njëherë madje ishte përpjekur t’ia mbathte. “Kjo grua kishte edhe një fëmijë,” vazhdoi pastori. “Ka shumë të ngjarë të ketë bërë fëmijë me një të panjohur në fshat, dhe pastaj nënë e bijë u kishin treguar derën. E gjora e vogël është ende atje në plevicë. Duket e sëmurë.”

Laurentius dhe pastori shkuan bashkë në plevicë dhe hynë në derë. Plaka ia nguli sytë me dyshim përsëri nga qoshja, por kur Mellinck i foli ajo i drejtoi prapa plevicës, ku gjetën vajzën që flinte nën mantelin e një ushtari të vjetër. Pastori kroi kokën mendueshëm. “Tani për tani do ta marr në shtëpinë time, derisa të dimë ç’do të ndodhë. Nëse mbijeton, sigurisht, askush s’mund ta dijë ende. Por po e lamë këtu me siguri do të vdesë.”

Laurentius u ul galiç për të parë siluetën e vogël që flinte. Vajza i hapi pak sytë dhe psherëtiu.

“Mbreti,” pëshpëriti ajo me zë shumë të ulët.

Mbrëmja e së Premtes

IFTOHTI KISHTE MBËRRITUR PAPRITUR, dhe kur Laurentius arriti në shtëpinë e Sjöbergh shiu i mëparshëm ia kishte lënë vendin, flokëve të mëdhenj të lagësht të dëborës. Fillimisht shkrinin sapo preknin tokën, duke formuar llucë të madhe nën këmbët e njerëzve dhe patkonjtë e kuajve, ndërsa moti sa vinte dhe bëhej më i ftohtë bora zuri një shtresë të trashë të bardhë mbi baltën. Era kishte nisur përsëri dhe po tundte me zhurmë xhamat e dritareve duke hedhur në to flokë dëbore të bardhë, u futeshin njerëzve në jaka dhe dhe u binin në fytyra.

Laurentius e shtyu shportën me dru më pranë vatrës dhe hodhi nja dy cungje të tjerë në zjarr.

Druri digjej përbrenda dhe vërshëllente ndërsa lëshonte lagështirën e tij në dhomë. Flaka e dobët nuk lëshonte më shumë nxehtësi se sa për t'u ndier disa hapa larg vatrës. Por kur Laurentius u ul galiç përpara vatrës, duke u dridhur nga i ftohti, papritur filloi të ndjejë vapë dhe paretati. Ai mund të dëgjonte grykën e oxhakut prej guri të kërciste, dhe tymin e dendur gri dhe ajrin e ngrohtë të zhdukeshin lart në oxhak me një fishkëllimë. Ndërsa u përkul për të rregulluar drutë që të digjeshin më mirë, ndjeu fytyrën t'i skuqej flakë si e një pijaneci dhe lëkura i dogji, ndonëse mund të ishte edhe sepse ethet po i shtoheshin përsëri. Temperatura në dhomë luhatej vazhdimisht midis të shumë të ngrohtës dhe të ftohtës. Ngrohtësia përhapej

nga vatra në rrathë bashkëqendrorë, si rrudhja e sipërfaqes së ujit kur në të është hedhur një gur. Dobësoheshin nja dy hapa larg qendrës, duke formuar rrathë të vegjël ndërsa përplaseshin me pengesa të ndryshme, duke përshkuar në mënyrë të pabarabartë hapësirën e dhomës së vogël. Muret e jashtme të ndërtesës duhet ta kishin mbajtur atë ngrohtësi brenda, duke e kthyer mbrapsht në dhomë, duke e mbledhur, duke e rritur atë. Por në fakt jo. Ata ishin bërë me suva, pluhur, që ishin ngurtësuar. Ishin një urë mes ngrohtësisë dhe të ftohtit, një urë midis të hapësirave të banueshme dhe të papabanueshme.

Laurentius u lëkund mbi taka.

Ai kishte ndezur vetë zjarrin, pa marrë shërbyesen, duke u përpjekur fort ta ndezë me shkarpat e lëvores së mështeknës me duart e mpira nga i ftohti, duke u irrituar edhe më shumë se sa shumë kohë iu desh. Por ta thërriste shërbyesen vetëm sa do t'i bënte gjërat më keq. Ai duhet të bënte bisedë, të bënte shaka. Ai nuk kishte kohë për të tilla formalitete tani.

Laurentius u ul në tryezë dhe e mbështeti kokën në duar.

Sapo kishte parë kufomën e gruas në barelë pranë shpellave kishte qenë i sigurt se melankolia do t'i thellohej. Kishte ndjerë frikë, pothuajse panik. Duke parë kufomën ai kishte kuptuar se ai nuk ishte shumë ndryshe nga ata njerëz që jetonin me frikën e paarsyeshme të magjisë, të cilët ishin mbërthyer nga kthetrat e besëtytnisë të çmendur, të cilët mund të shpëtoheshin vetëm nga arsimimi. Dikur edhe ai kishte qenë një si ta; edhe ai kishte patur frikë. Ndërsa qëndronte atje pranë shpellës, kishte ndjerë se ata po shiheshin nga një mbret, që kishte veshur mantel dhe mbante kurorë. Dhe të gjithë njerëzit atje dukeshin sikur ishin pikturuar në letër: të vegjël, me përmasa të vogla, dy dimensionale, me ngjyra të panatyrshme. Sikur të shihte një tablo pjesë e të cilës ishte edhe ai. Vetëm mbreti dukej i vërtetë.

Gjaku kishte rrjedhur në fijet e barit. Por pastaj kishte

ardhur Pastor Mellinck dhe kishte folur për shkrimtarët, teoritë dhe metodologjitë e diskutuara, dhe u ankua për strukturat financiare. Ai solli një shpjegim llogjik për gjithçka, vërtetoi se s'po ndodhte asgjë e pazakontë dhe e mbinatyrshme. Dhe shtoi se për shkak të të korrave të këqija nisma fisnike e Forselius mund të dështojë. Laurentius kishte pohuar me kokë, dhe ndërsa i dha dorën Mellinck kishte thënë se duhet të shkonte patjetër ta vizitonte. Laurentiusit i ishte dukur sikur ishte në shërbesën e të dielës, ku prifti i kishte dhënë bekimin e tij pas Meshe. Ai e kishte ndjerë ankthin t'i ulej ngadalë, duke i lënë vend një vezullimi të shkurtër përpara syve të tij, përpara se qartësia të fillonte të shfaqej. Ndërsa po shkonte drejt qytetit kishte filluar të bjerë borë. E dinte tashmë që vetëm studimi mund ta shpëtonte. Nxitoi të shkojë në shtëpinë e Sjöbergh, madje me padurim. Pothuajse me gaz.

Kujdestarja e shtëpisë e kishte treguar udhën lart shkallëve në një studio pak të tejnxehur. Të gjithë librat ishin me lidhje lëkure, me shirita të ngritur nga jashtë, dhe në çdo shpinë libri kishte të ngjitur një copë pergamenë. Titujt e shkurtuar të librave ishin gdhendur në pergamenë me një shkrim dore të bukur. Ndërsa në rastin e librave me shumë vëllime kishte një varg mjaft të gjatë shkronjash. Mund të kishte mbi dyqind libra në rafte të cilat vishnin muret e dhomës, kryesisht botime bashkëkohore. Sjöbergh i kushtoi vëmendje dhe madje i kërkoi ndjesë, në njëfarë mënyre, për sjelljen e tij atë mëngjes. Ai i kishte shpjeguar se pranimi i heshtur i tepërt mund të vriste rrahjen e një çështjeje, dhe se ai priste që diskutimi të ngjallte një debat nxitës. Ai nuk kishte asnjë dyshim që një i ri i edukuar si Laurentius ishte i aftë të shkruante një tezë, dhe ai planifikonte t'a linte të lirë të vepronte.

“Shpjegimet Karteziane i plotësojnë shumë më mirë njohuritë tona bashkëkohore të fizikës; Aristoteli tani është

i vjetruar,” tha profesori me një shprehje fytyrë që linte të kuptonte që i vinte keq për këtë fakt. “Por teoritë e Dekartit për shpirtin kanë marrë një vëmendje të madhe kritike. Sigurohu që t’i diskutosh edhe ato.”

Laurentius tundi kokën. Pas një diskutimi të shkurtër me profesorin dhe pasi dëgjoi këshillën e tij vendosi të marrë me vete vetëm tre libra. I pari ishte natyrisht *Mbi Shpirtin* e Aristotelit; pastaj vëllimi i i dytë i enciklopedisë së Alsted që trajtonte pneumatikën dhe psikologjinë në përgjithësi, dhe libri i tretë ishte *Passiones animae* e Dekartit. Ai ishte shumë i vendosur të fillonte të shkruante diskutimin e tij që këtë mbrëmje. Gjithë padurim që do të shkonte në shtëpi ta fillonte, tashmë po hartonte argumentet dhe po planifikonte strukturën në mendje. Mund të ishte pikërisht ajo që i duhej për të kuptuar sëmundjen e tij. Ndoshta edhe mund t’i jepte atij njëfarë shpjegimi për gjithçka tjetër që po ndodhte. Ishte përshëndetur me Sjöbergh, duke u përpjekur të mos dukej se po nxitonte, dhe kishte dalë jashtë, drejt e në shkullmin e flokëve të bardhë të dëborës. Ishte një mbrëmje e bukur, e freskët vjeshte, dhe kishte zënë një stuhi vorbullore bore. Ai i mbajti më mirë librat e vëllimshëm të rëndë të cilët i kishte mbështjellë me një rrobë, u mbështoll me pallto dhe nxitoi për në shtëpi, i gëzuar. Librat i kishte, tani duhej vetëm t’i futej punës. Tani kishte një objektiv të qartë përpara tij, si një shigjetë që gjuhet nga një hark.

Fillimisht kishin filluar t’i merreshin mend kur u ul galiç përpara zjarrit, duke u përpjekur me nxitim të ndizte cungjet që fishkëllenin. Ndërsa ai rrëmbeu cungjet zhvoshku çokët e gishtave në vatrën prej guri, duke u gjakosur, dhe tani ndjeu një dhimbje thumbuese. Me sa duket zjarri nuk donte të ndizej, megjithëse ai i frynte vazhdimisht, cungjet nuk merrnin flakë. Tymi që të shponte hundët i kujtoi që grahma e rëndë, të prishur, ende nuk ishte larguar. Ai pa skenën nga shpella, episodin nga

ëndërra e tij, ku rrinte ulur galiç përpara cungjeve të lagësht, në përpyetje për t'i ndezur me një dorë kashtë. Atje kish qenë një korbë, apo ndoshta një laraskë bishtgjatë... Për ndonjë arsye kishte filluar të shqetësohej përsëri për vajzën e sëmurë. Ethet filluan t'i shtoheshin dhe sa vinte dhe bëhej më nervoz.

“Jo, duhet t'i shtrohem punës!” tha ai me vete.

Me vendosmëri kapi fort një nga librat dhe e tërhoqi nga vetja. Enciklopedia e Alsted ofronte një përmbledhje të mirë të teorive përkatëse; ishte e organizuar me rregull, dhe gjithashtu e shkruar mjaft mirë. Mendoi se do të bënte mirë të përdorte një strukturë të ngjashme. Laurentius gjeti një fletë letre për të marrë shënime dhe u përpoq të përqendrohej. Libri ishte i madh dhe i rëndë, por shkronja ishte e vogël dhe e zbehtë, dhe të vriste sytë kur e lexoje, sikur t'i ishin gërvishtur me limë. Gërvishtëse, acaruese, hutuese. Ishte e qartë që printeri ishte munduar të fusë brenda çdo faqeje sa më shumë tekst, por për shkak të syrit të vogël të shkronjës të gjitha hollësitë ishin përzierë, teksti po dridhej në dritën regëtitëse të qiriut, duke e vështirësuar edhe më shumë leximin. Laurentius tundi kokën i irrituar, dhe iu afrua edhe më shumë shkrimit. Por fjalët dhe shkronjat mbeteshin të largëta dhe të shkëputura sikur t'i shihte përmes një mjegulle. Ndonjëherë ato ishin të mjegulluara, por pastaj papritmas ato do të dilnin duke notuar nga mjegulla bardhoshe dhe do të vinin drejt tij, duke marrë një qartësi të madhe. Pavarësisht të gjitha përpyetjeve të tij ai nuk mund t'i lidhte fjalitë, ato ishin fraza boshe, të pazëshme, të shurdhëta, që nuk kishin asnjë kuptim, dhe ai s'arrinte t'i kapte dot. Letra e verdhë, poroze e e enciklopedisë filloi të shndrijë në dritën e qiriut, duke mbizotëruar në të gjithë fushëpamjen e tij me ndriçimin e saj; më pas sytë filluan t'i digjnin dhe iu desh t'i mbyllte. U bë i vetëdijshëm për një zhurmë zukatëse, një gumëzhimë e çuditshme shqetësuese, që theu heshtjen

mbytëse.

“I pashpresë,” tha Laurentius me vete.

Vuri mënjandë vëllimin dhe pa nga dritarja, por ende mund të shihte rreshtat e tekstit të dridheshin përpara syve; pothuajse mund të shquante disa nga shkronjat veç e veç. Mund të shihte flokët e bardhë të borës që vërtiteshin në ajrin e natës. Mori frymë. Pastaj përsëri. Mori frymë, nxori frymën. Fryma e tij u duk pothuajse si një mjegull që rrinte pezull në ajër përpara tij. Ndjeu përsëri në gojë një shije të keqe. Flokët e dëborës po godisnin xhamin e dritares më një tingull të lehtë të thatë, dhe kornizat e dritares po kërcisnin nga shkulmi i erës.

“Çfarë do të ndodhë?” pyeti me vete Laurentius. Ndjesia e plogështisë së bezdisshme po bëhej më mbytëse. U ndie fare i vetëm, i pafuqishëm dhe i pambrojtur. Entuziazmi i mëparshëm për diskutimin ishte zhdukur fare.

“Klodia...”

Laurentius-it iu duk sikur nuk ishte edhe aq i pranishëm në dhomë, sikur të ndodhej fizikisht në dhomën e tij me qira, por disi ndryshe nga zakonisht. Sikur të ishte duke ëndërruar dhe të ishte i ndarë nga realiteti, rrinte shtrirë me sytë mbyllur, duke iu dorëzuar harresës. A s’ishte më e aftë vetëdija e tij të dallonte midis realitetit dhe imagjinatës? Të gjitha ngjyrat e dhomës iu dukën shumë të zbehta; madje edhe flaka e qiriut ishte disi e ftohtë, pothuajse në ngjyrë të bardhë borë. Të ishte ky realiteti? Pastaj, me cep të syrit, ai vuri re diçka të zezë që lëvizti nëpër murin e zbehtë. Një merimangë. Ai e vështroi, duke menduar se do të kishte njëfarë kohe që zvarritej aty, pas kurrrizit të tij, larg nga fushëpamja e tij. Mendoj se sa shpesh duhet të kishte ndodhur. Gjërat janë përpara syve të tu, gjithandej, por ti nuk i dallon; s’je fare në dijeni të ekzistencës së tyre. I vë re kur të shfaqen para syve, kur fillojnë të lëvizin, kur zhurmojnë dhe kërcëjnë pupthi. Por ku ishin ato pjesën tjetër të kohës? A

ekzistonin vërtet? Kur kam vënë kokën në jastëk dhe dikush vjen të më qëndrojë te koka e shtratit, më shikon dhe më ledhaton në kokë aq lehtë sa nuk e ndjej, a ka ndodhur vërtet? Nëse sytë i kam të mbyllura, nuk kam nga ta di.

Laurentius iu afrua murit dhe vrojtoi merimangën. Po lëvizte drejt diçkaje, drejt një qëllimi të paditur.

“Në shoqërinë time do të rrish tani,” i pëshpëriti ai merimangës. “E ftohtë dhe e zezë.”

Ose ndoshta ishte thjesht një qenie mekanike, si ajo që kishte përshkruar Dekarti. Një qenie që nuk kishte vullnet të lirë, as shpirt, as lëngje të trupit, thjesht një nxitje për të ecur përpara. Nuk ndjente dhimbje, nuk e ndante dot të mirën nga e keqja. Një shigjetë e gjuajtur nga një hark. Ai e vështroi merimangën të shkonte në punë të saj, dhe shpresoi që gjërat të ishin vërtet kështu. Por insekti nuk donte t’ia dinte ç’mendonte ai, ajo vazhdonte rrugën e saj, duke mbërritur më në fund në dritare dhe duke u kacavjerrë në kornizën e dritares. Atje përtej dritares ai mund të shihte errësirën e paanë. Të ftohtë dhe të zezë.

Laurentius tundi kokën. Jo, ajo merimangë nuk ishte bashkudhëtarja e tij. Bashkudhëtarët e tij ishin zogjtë lart në qiell, të lehtë dhe rrezëllitës.

Ai hapi dritaren dhe u përkul jashtë. Ajri gjallërues, i ftohtë e ndihmoi të përqendronte mendimet, dhe ai i mbushi mushkëritë me të.

Në ndonjë mënyrë apo tjetrën ai duhet të baraspeshonte nxehtësinë e etheve të tij. Qëndroi duke parë me vëmendje ndërsa shtëllunga avulli i dilnin nga goja, gjë që vërtetonte se ende merrte frymë, ende ishte gjallë. Qëndroi në heshtje të plotë, duke thithur ajrin e freskët, duke parë se si cirkat e avullit i fluturonin nga goja, më pas shpërndareshin, duke u zhdukur bashkë me shkëlqimin e butë të dritës së qiriut në tokën e

premtuar të errësirës përtej.

A ishte fryma e tij si merimanga që ikte me ngut nëpër mur? Gjithnjë e pranishme, por në dukje sikur nuk ekziston deri në çastin kur shfaqet. Një çast më parë e njëjta frymë që ishte zhdukur në errësirë kishte qenë brenda mushkërive të tij, në kontakt me gjakun, duke gjallëruar trupin e tij. E njëjta frymë tani do të përthithej në ajrin e lagësht të natës dhe u bë pjesë e tij; do të vazhdonte të futej dhe dilte nga mushkëritë edhe ndërsa shpirti i tij dhe arsyeja e tij topiteshin nga rënia e mbrëmjes. Edhe kur ishte plandosur në shtrat, edhe kur e kishte zënë gjumi, në zbrazëtirën e kujtimeve. Pra a ishte kjo frymë që qarkullonte brenda dhe jashtë tij vetë jeta, ajo që e bënte njerëzor? Nëse dikush do t'i vendoste një pasqyrë, sipërfaqja e xhamit do të tregonte avullin e kondensuar, ngrohtësinë e trupit, lëngjet e lagështa të trupit të tij. Kjo ishte jeta, gjithnjë e pranishme. Si cungjet që vërshëllejnë në vatër, duke treguar ekzistencën e diçkaje të paprekshme. Në të njëjtën mënyrë që pasqyrimi në pasqyrë përfaqësonte ekzistencën e një personi, një pikturë përfaqësonte fytyrën dhe trupin e një njeriu dhe shkronjat në letër përfaqësonin zërin. Njëfarë forme ekzistence po vihej re. Gjithnjë e huaj në vetvete, gjithnjë e pasigurt.

Laurentius mund të shihte tek e tuk disa drita të dobëta që dridheshin në errësirë, qirinj që njerëzit i kishin ndezur për t'i vënë shenjë shtëpive të tyre. Për të mbrojtur ngrohtësinë e tyre dhe për t'i mbajtur të huajit larg. Ndjeu fort të ishte i huaj në këtë qytet. Të gjithë këtu ishin të huaj.

Ai psherëtiu.

Ethet e kishin fajin për të gjitha këto. Duhet të përpiqej të bëhej më mirë, ta mbante të kthjellët mendjen. Nuk mbetej veçse të merrte alkoolin që siguroi nga farmacisti dhe lëvoren e shelgut që kishte mbledhur pranë lumit. Nuk mund të lejonte që ethet t'i përkeqësoheshin, dhe tani lëvorja e shelgut dhe alkooli

ishin tashmë të vetmit ilaçe që dispononte. Ndoshta çfarë vërtet i nevojitej ishte *aurum potabile*, por as Dimberg nuk e dinte si ta bënte.

“Nga ta gjej vallë?” murmuriti ai me vete. Por e dinte që ishte thjesht ëndrra e paarritshme e alkimistëve, jo një ilaç i provuar nga shkenca mjekësore.

E gjeti veten duke menduar për vajzën e sëmurë, dhe për vegullimin e mbretit. Ngriti që përtokë çantën e shpinës për të kërkuar brenda saj shishen me alkool, dhe ndërsa rrëmonte nëpër gjërat e tij, gjeti një panine të ndenjtur, që mund të hahej në fund të çantës. Buzëqeshi pa dashur.

“Sigurisht,” tha ai me vete.

Ishte paninja që i kishte dhënë Klodia. Kishte ditë të tëra që nuk hante si duhet, dhe prandaj ndihej i pafuqishëm gjatë gjithë kohës nga uria. Ishte e pamundur të shërohej ndërsa ishte në një gjendje kaq të dobët. Duhet ta detyronte veten të hante, sido që ta kishte shijen ushqimi. Nga marrja e gjakut kishte rënë mbrojtja e trupit; tani duhet ta ripërtërinte. Si e kishte shpjeguar Dimberg kiminë pas saj? Laurentus mori paninen dhe e vuri në pëllëmbë të dorës.

“Shumë mirë,” tha, dhe e kafshoi.

S’ ishte habi që pati shije të hidhur si pelin. Por arriti të çojë poshtë disa kafshata të mëdha, sa për të hequr sa më shpejt nga goja shijen e pakëndshme të substancës. Pasi e përcolli, gjithsesi i solli ëmbëlsi në stomak. Sikur sapo të kishte ngrënë mjaltë.

Natë

MBRËMJA KA RËNË PËRSËRI. Bora ka shkrirë duke lënë pas pellgje balte me ujë. Është një mbrëmje me mjegull, me shi, siç ndodh gjithmonë nga këto anë. Po udhëtoj me karrocë me kumbarin tim, dhe rrimë ndenjor në heshtje duke shikuar nga dritarja. Qepenat e dritareve janë pothuajse të mbyllur, dritaret janë të zgjyrosura me blozë, me lyrë dhe të veshura me avull nga fryma e ngrohtë e udhëtarëve. S'e di fare ku jemi. Por rruga ngjan disi e njohur. Kam qenë këtu më parë. Karroca vazhdon të shkojë me rrapëllimë; sa vjen dhe më pak zëra dëgjohen nga jashtë, dhe nuk ka më ndërtesa nga të cilat të kthehet jehona e trokëllitjes së thundrave të kuajve. Më pas, papritur, përpara nesh shfaqet një tokë e pashfrytëzuar, e përhimë, dhe karroca shkon me zhurmë, ndërsa ne rrimë pa folur. Më në fund karroca ndalet, kumbari im hap derën dhe unë dal jashtë. Përpara meje ndodhet një hapësirë toke tmerrësisht e shkretë, qendra e vatrës të së cilës është një shtëpi e vetme, disa pemë me xhunga degësh të ngatërruara që rriten përreth saj. Shtëpia është prej druri, e gjatë dhe e ngushtë si qivur, me një çati të ulët. Të shqetëson fakti që s'duket asnjë shenjë e dorës së njeriut. As hi që tregon se ku kanë qenë ndezur zjarre, as rroba të lara të varura jashtë për t'u tharë, as qenë që lehin, as mace që gjuajnë. Asgjë prej atyre gjërave të përditshme që janë pjesë e pashmangshme e jetës njerëzore, pa të cilat nuk mund të mbijetojmë. Mund

të shoh pemë shelgu të fuqishme dhe kodrina rëre me gropa, vendkalime dhe shpella të gërmuara brenda tyre. Ndërsa dal nga karroca më rrëqethen shpatullat nga ajri i ftohtë. Ndihem pak i frikësuar, por mundohem fort ta shtyp atë ndjenjë. Vazhdoj të eci në rrugën e lagur të shtruar me zhavorr. Breza të holla mjegulle rrëshqasin midis kodrinave, duke zbritur deri poshtë në lugina; ndjej këmbët e mia të z bathura dhe pantallonat poshtë të më lagen ndërsa fërkohe pas fijeve të barit. Në këto anë askush nuk më njeh, ndonëse kam ardhur shumë herë ta vizitoj këtë vend. Është vendi ku vij vazhdimisht në ëndrrat e mia. Eci nëpër rrugën e prishur nga moti që më çon drejt e te shtëpia. Aty këtu ka pellgje të vogla me ujë ngjyrëkafe, dhe rrotat e karrocës kanë lënë vende vende traga me baltë në zhavorr. Rëra kërcet poshtë këmbëve të mia ndërsa vazhdoj të eci, duke u përpjekur të shmang pellgjet dhe duke i hedhur një vështrim të shpejtë herë pas here hyrjeve të shpellave dhe strofkave në të djathtën time. Ngre sytë dhe vështroj qiellin, dhe yjet janë pika të vogla shpuese, që që dridhen me lëvizjen e ajrit, dhe ka rripa rripa të lehtë resh që zgjatëshin në të gjithë sfondin e errët. Shtëpia përpara meje është krejtësisht e zakonshme: mure gri, që kanë filluar të kalben, dhe dritare të irnosura. I afrohem dhe përkulem për të hyrë në rrugëhyrjen e ulët. Muret janë bërë me qepëra druri, të mbuluar me njolla breza breza nga shumë vite shi; çatia është e bërë me degë, dhe vende vende përmes të çarave duket qielli i natës ngjyrë e purpurt e errët. Mund të shoh një korridor, dhe në secilën anë të tij ndodhen shtretër fushor të bërë me shkopinj drurësh të rrumbullakët të trashë sa krahu, ku njerëz rrinë shtrirë në heshtje. Por e di edhe pa parë. Burra dhe gra të rinj e të vjetër. I afrohem pa zhurmë njërës prej siluetave që rri shtrirë në shtratin prej dërrase. Burri ka flokë të gjatë gri që i bien mbi fytyrë; frymëmarrjen e ka të rregullt dhe të qëndrueshme si dikush që po fle, por sytë i ka të zgurdulluar. Më sheh drejt e në sy por nuk më thotë asgjë. Unë

i buzëqesh. E njoh këtë vend. Këtë pamje kishte plevica pranë Aruküla, vendi ku njerëzit strehoheshin nga uria, ndërtesa që unë vizitova një herë në jetën reale. Një grua është shtrirë shumë pranë burrit, e ka fytyrën me të prera, por ka vënë një buzëqeshje në buzë. Rripat e shapkave të saj janë grisur. I njoh të gjithë këtu. Mbaj fajin për vdekjet e tyre. Më vret shumë ndërgjegjja, por s'mund të bëj asgjë. Çfarëdo që përpiqem të bëj mbulohet nga një mallkim të cilin nuk e kuptoj, nga një ndjenjë e ankthshme faji për atë që ka ndodhur. Dua të çlirohem nga e gjithë kjo, por e di shumë mirë që nuk është e mundur. Do ta mbaj këtë barrë gjatë gjithë jetës sime. Kam vrarë shumë herë. Dhe asnjë person i vetëm nuk e di.

Dua të turrem tek ta, t'u kërkoj falje, t'u shpjegoj gjithçka.

“Nuk e dija...” Pëshpërij me gjysmë zëri.

Gjithë ato vite më parë, kur shihja atë shtrigë, atë grua, të ekzekutohet, sepse unë ia kisha zënë emrin në gojë, tmerrohesha nga fuqia e shtrigave. Si gjithë të tjerët, gjithmonë si të tjerët. Ajo u përpëliti, dikush e kishte mbërthyer fort, dhe shpata goditi qafën e saj. Dhe u rrija dhe shihja gruan që tregova me gisht. Vetëm atëherë kuptova se në vështrimin e saj nuk kishte keqdashje, vetëm brengë dhe pikëllim. Mund të shihja tëmthin e zi të vdekjes në ato sy. Frika dhe padituria kishte vulosur fatin e të gjithë atyre njerëzve, vetë frikën dhe paditurinë time, ato mjete të Djallit, ato demonë. Unë e kam fajin, sepse isha ai fëmija besëtytnor që nuk ia kishte idenë ç'po bënte. Unë i dënova ata; unë tregova me gisht; unë thashë fjalën.

“Shtrigë!” bërtita unë.

Edhe ajo grua është gjithashtu këtu tani, në njërin prej shtretërve prapa. Por unë kurrë nuk do ta gjej. Këta burra dhe gra u vranë sepse unë i akuzova ata për magji. Ata u çuan në brinjë të kodrës, iu prenë kokat, dhe toka u përlye me gjak. E shoh skenën orë e çast në ëndrrat e mia. Trupa dhe koka që hidhen në flakë,

shtrirë në mes të degëve që digjen. Fshatarët po vinin rrotull në vendin e ekzekutimit, me kokat ulur. Ata erdhën të më presin fytin ndërsa flija. U zgjova duke bërëtitur dhe mora arratinë. Po të mos ia kisha dalë të shkoja me vrap në kishë, do të më kishin kapur dhe do të më kishin vvarë. Atje nuk kishte njeri: hapësira e errët ishte e boshatisur përveç disa pulave që bridhnin andej këndeje nëpër pllakat e gurit. Burrat hynë në derë, me thika në dorë. Qielli pas tyre po zbardhej ndërsa po agonte. Në atë çast erdhi pastori dhe pa ç’po ndodhte. “Largohuni,” kishte thënë ai. Ata u kthyen dhe u larguan, dhe unë mbeta vetëm me pulat. Mëngjesin e të nesërme pastori më çoi në kodrinën e ekzekutimit dhe më foli për besëtytninë, për tëmthin e zi dhe për fantazmat. Kuptova se e vetmja mënyrë për të mbijetuar ishte të mos besoja më në shtriga; të pranoja se magjia ishte thjesht një vegim, një iluzion. Por ende nuk kishte përfunduar. Tmerri i asaj që ndodhi ka mbetur në shpirtin tim, duhet ta marr me vete ngado që shkoj. Është aty në sytë e mi që ta shohin të gjithë.

Kthehem, mbyll derën dhe dal nga ndërtesa. Pemët, e errëta, gati të zeza, që kullojnë ujë, më rrinë mbi kokë. Ndërsa vazhdoj të eci dalëngadalë bëhen gjithnjë e më të ulëta, dhe më në fund i lënë vend gëmushave ngjyrë të gjelbër të errët dhe kullotave të valëzuara. Ndjek me vëmendje një parakalim xixëllonjash që zvarriten në një fije bari të padukshme, jo thjesht të vetmuara, të shpërndara aty këtu, por një tufë e madhe që përparon në mbrëmjen e lagësht të vjeshtës, qindra drita vezulluese. Ato drita sikur shënonin kufirin midis dy botësh të ndryshme. Dhe unë qëndroj aty midis të dyjave.

Dikush po afrohet nga ana tjetër e livadhut të errët, por drita e ftohtë e xixëllonjave është tepër e dobët që unë të shoh qartë. Silueta afrohet më pranë; vjen tek unë, dhe tani ndjej frymën e dikujt në fytyrën time.

E shtunë

DËGJOHET NJË TROKITJE NË DERË. Është errësirë e plotë përveç disa thëngjijve që digjen pa flakë në vatër, që bëjnë dritë të dobët si xixëllonja. Laurentius u ngrit dhe pa rrotull i hutuar. Zjarri në vatër nuk e ndriçonte mirë dhomën; sa e hijëzonte atë vende vende me ngjyrë më të çelët, duke bërë të mundur të shquheshin thellësitë e disa objekteve. E trokitura në derë vazhdoi, por dukej të kishte një ton më shumë kureshtar se sa këmbëngulës.

“Prisni një çast!” thirri Laurentius.

Hodhi mantelin e tij supeve, eci duke iu marrë këmbët përgjumësh drejt derës, dhe e hapi derën duke e tërhequr fort, me pamje të bezdisur. Aty, nën dritën e dridhur të qiriut qëndronte shërbyesja, veshur me një këmishë nate, me flokë të lëshuara. Ajo po e shihte drejt e në sy me një shprehje të alarmuar në fytyrë.

“Ju po bërtisnit ashtu?” e pyeti ajo.

“Kush, unë po bërtisja?” Laurentius nuk e kuptoi fillimisht pyetjen. Ai duhet të ndalej dhe të mendonte për një çast dhe të pyeste veten nëse kishte qenë vërtet ai. I kishin thënë më parë që kishte rënkuar dhe ishte ankuar disa herë nëpër gjumë. Ai nuk ishte habitur me këtë, sepse ai shpesh bënte një gjumë të trazuar dhe shihte ëndrra që e çonin në vende nga të cilat të largohej. Vendosi që ëndrrat e tij duhet të hulumtoheshin shkencërisht,

dhe ai gjithmonë i mbante shënim, i kategorizonte dhe i analizonte, por nuk kishte arritur ndonjë qartësi në shpjegimin e tyre. Ndonëse besohej gjerësisht se ëndrrat janë të frymëzuara hyjnisht, ose se shfaqin ngjarje të së ardhmes, Laurentius ishte i bindur se ato nuk ishin veçse mendime të rastësishme, gjurma kujtimesh të lëna pas në tru. Ato grumbulloheshin njëra mbi tjetrën, duke u gërshetuar dhe përzierë në mënyra nga më të mahnitshmet. Nëse hidhnin vështrim në të ardhmen, kjo ndodhte sepse e ardhmja ishte potencialisht e pranishme në gjithçka që ai shihte. Çdo imazh, çdo veprim, përmbante potencialisht qëllimin e vet përfundimtar, realitetin e ardhshëm.

“Po, dëgjova dikë të bërtasë,” shpjegoi shërbyesja. “S’ë di përse, por vendosa të vij për të parë ç’bëhej. Këto ditë gjithmonë ndodh ndonjë telash. Njerëz që rënkojnë dhe ankohen jashtë në rrugë, gra që bëjnë lindje të parakohshme. Disa njerëz tremben se mos po afrojnë kohët e fundit, se nga çasti në çast bisha me brirë do të vijë për të sunduar mbi ne të gjithë. Kohët e fundit gjithashtu kam parë ëndrra të cilat të fusin tmerrin vetëm duke i çuar nëpër mend. Zgjohem, dhe trupi im kullon djersë i tëri, sikur të kem qenë në ndonjë sauna, dhe lloj lloj përbindëshash lugat më ndjekin. S’më bën zemra as t’i flas pastorit për këtë,” tha ajo, duke u skuqur me turp.

Laurentius u përpoq të buzëqeshte për ta qetësuar. “Jam i sigurt që gjithçka është thjesht ko incidencë. Unë gjithnjë s’fle mirë; shoh lloj lloj ëndrrash të çuditshme. Por jam i sigurt që nuk kanë ndonjë domethënie të veçantë.”

“Oh vërtet?” tha shërbyesja, duke gëzuar si fëmijë nga kjo. “Pastori ynë i merr seriozisht ëndrrat. Thotë se i shohim për të na treguar gjërat që do të vijnë.”

“Këto janë fjalë boshe; sot askush nuk beson që ëndrrat mund të na paralajmërojnë për telashet në të ardhmen,” tha Laurentius me përbuzje, por pastaj i erdhi në mendje se nuk

ishite me vend të binte në kundërshtim me pastorin e shërbyeses. “Ndonjëherë mund të jetë e vërtetë, por shumica e teologëve janë të mendimit se ëndrrat profetike janë në fakt shumë të rralla.”

Laurentius ndjeu njëfarë lehtësimi që mund të fliste kaq hapur. Te kjo vajzë seç kishte diçka realiste dhe të logjikshme, që kishte një efekt qetësues tek ai. Ai kërkoi me tahmin orën në xhepin e mantelit dhe pa shpejt sa ishte ora.

“Ëndrrat janë si halucinacionet; janë fryt i imagjinatës sonë,” filloi të shpjegojë ai me nxitim. “Gjërat që ndodhin në ëndrrat tona shkaktohen nga fantazmat, imazhet që vijnë nga brenda nesh dhe lidhen me frikat dhe dëshirat tona të forta. Le të supozojmë, për shembull, se shohin diçka vërtet të tmerrshme në jetën reale. Ai imazh më pas ruhet brenda nesh, dhe mund të përzihet me imazhet nga ditët e mëparshme, ose me përvojat e mëparshme që kemi patur. Shpesh gjërat që shohim dhe bëjmë në ëndrrat tona nuk janë në fakt aspak veprimet tona. Prandaj dikush mund të pyesë nëse kemi liri veprimi në ëndrrat tona apo jo.”

Duke vënë re që vajza nuk po reagonte fare, Laurentius tundi kokën dhe vazhdoi të shpjegonte. “Shumica prej nesh kemi parë ëndrra ku e gjejmë veten duke bërë gjëra që zgjuar do t’i mendonim si të parregullta. Nëse kemi liri në ëndrrat tona, a duhet të ndjehemi fajtor për këto gjëra? A jemi madje të lirë kur jemi zgjuar? Duke pranuar këtë, kur ëndërrojmë ndonjëherë nuk e dimë çfarë po bëjmë. Por ndonjëherë bëjmë gjëra që e dimë se janë gabim. Por ndonjëherë bëjmë gjëra të cilat i dimë që janë gabim. Në këto raste, a jemi të lirë apo jo? Ne mund të na duket se jemi. Por nëse vërtet jemi të tillë, a duhet të bëhemi me faj për gjërat që bëjmë?”

Laurentius vuri re vajzën që sa vinte dhe shprehte më shumë moskuptim në fytyrë, dhe kuptoi se të gjithë argumentet e tij

ishin bërë me qëllimin për të bindur atë vetë. Ai vendosi ta lërë pa përgjigje pyetjen e tij teorike, dhe qëndroi atje duke lëvizur sa para prapa mbi takat e këpucëve me siklet.

“Më fal, por s’ta di emrin,” tha ai më në fund, duke vendosur të ndryshojë temën.

“Madlin,” tha vajza duke tundur kokën dhe duke buzëqeshur.

“E di çfarë, Madlin,” ia nisi Laurentius. “Ndoshta mund të ndezësh zjarrin dhe pastaj të më sjellësh një krikëll birre? S’besoj se do të kthehem në shtrat; më mirë po çohem. Ora është pothuajse pesë gjithsesi.”

“Po, është pothuajse koha për t’u zgjuar. Do të shkoj të marr menjëherë cungjet e drurëve. Zoti Laurentius duhet të presë këtu.”

Laurentius vështroi me vëmendje ndërsa ajo u largua. Për ndonjë arsye ai ishte me humor të gëzueshëm. Madje mendoi të fillonte punën mbi tezat kryesore të diskutimit të tij.

Ishte sikur sjellja e logjikshme dhe me këmbë në tokë e vajzës ia kishte bërë problemet të duken më pak të rënda, i kishte lehtësuar ato. Kuptoi se kishte vërtet nevojë për dikë t’i qëndronte pranë, dikë me të cilin të fliste. Ndoshta duhet të kishte marrë me qira një dhomë me dikë tjetër, në vend të lidhej pas shërbyeses për t’i bërë shoqëri. Njerëzit mund të nxirrnin lloj lloj përfundimesh për këtë, dhe kështu siç qëndronin punët tani, nuk donte telashe. Por s’do të ishte e lehtë të gjeje dikë me të cilin të vendosesh, dhe nuk ishte i sigurt se kjo do t’i bënte punë.

Laurentius u ul në tryezë dhe ndezi qiriun. Libri i Alsted tani lexohej me më shumë lehtësi, dhe ai shumë shpejt filloi të mbajë shënime. Kur u kthye shërbyesja me mëngjesin dhe birrën ai kishte arritur të shkruante skicë-idenë në vija të përgjithshme të diskutimit të tij.

“Ja pra,” tha Laurentius i lumtur. “Mbarova një pjesë të

mirë të punës. Eja dhe ulu të hash me mua.”

“S’jam e sigurt s’e mundem. Pronares nuk do t’i pëlqente po ta zbulonte. Mund ta kisha pisk punën,” u përgjigj shërbyesja. “S’po të kërkoj të vish në shtrat me mua,” u përpoq të bënte shaka Laurentius, por vetëm sa ia doli të skuqej. Dua të më bësh shoqëri një copë herë; është e mërzitshme të hash vetëm.”

Vajza zuri vend me mosbesim në fund të shtratit dhe qëndroi drejt dhe e nervozuar.

“Do të qëndroj këtu për një copë herë atëherë, por nuk mund të qëndroj gjatë,” tha ajo.

“Shumë mirë,” tha Laurentius me një tundje të kokës, dhe i futi një kafshatë bukës që shërbyesja kishte sjellë. Por u ndal në vend në mes të kafshatës. Shija ishte e padurueshme. Paninja e djeshme kishte patur shije shumë më të mirë, edhe pse kishte qëndruar gjithë ditën në çantën e tij dhe ishte e fortë gur dhe e mbuluar me pluhur. Prapëseprapë të hapte oreksin.

Ai uli në tryezë copën e bukës gjysmë të ngrënë dhe psherëtiu. “Në fakt, s’do të ha tani, e do ti?”

Madlin mblodhi supet. “Them ta marr me vete. Do të ishte disi e çuditshme të filloja ta haja përpara teje.”

“Mos u shqetëso, për mua s’ka problem,” tha Laurentius, duke u përpjekur ta ndihmonte në kapërcente turpin.

Shërbyesja ngurroi, por u ngrit dhe mori bukën nga dora e tij. Gati duke mbajtur psherëtimën, ajo filloi ta hajë me ngurrim. Laurentius pa ndërsa thërrimet e bukës binin në dysheme, dhe kuptoi se në fakt ishte tmerrësisht i uritur. Por ishte shumë i bindur se s’mund të hante një tjetër kafshatë. Mund të arrinte të shtynte një gllënjë të madhe apo dy birre të thartë.

“Meqë ra fjala, jam shumë i sigurt se më parë pashë një vajzë tjetër,” tha ai për të thyer heshtjen, e cila kishte filluar të bëhet e sikletshme. “Kishte flokë të zinj. Mora me mend se edhe ajo duhet të jetojë në këtë shtëpi. Tha se e quanin Klodia.” Për

një çast Madlin ndaloi së ngrëni. Por në vend të përgjigjej tundi kokën në shenjë mohimi dhe vazhdoi të përtypej. Ajo kapërdiu më në fund një kafshatë me bukë të tharë. “Nuk njoh askënd me atë emër. Por në këtë kohë lloj lloj njerëzish sorollaten këtej. Duhet të mbyllim mundësisht dyert natën, cilido mund të hyjë brenda. Me raste u jap ushqimet e mbetura njerëzve të uritur, të cilët kanë filluar enden andej këndeje, thjesht nga dhembshuria e krishterë. Por do të sigurohem që asgjë e tillë të mos ndodhë më, mos u shqetëso për atë.”

Shërbyesja me sa duket ishte pak e shqetësuar, por nuk u habit shumë nga pyetja e Laurentiusit.

“Ajo të jepte përshtypjen e një zonjushe të re të këndshme dhe shumë të edukuar.”

Madlin mblodhi supet.” S’ e kam idenë... por do të të bëj një çaj; do të hedh disa thupra mjedre në ujë të nxehtë, të bën mirë për ndezjen e tepërt.” Ajo i dha Laurentiusit një buzëqeshje dashamirëse, pastroi thërrimet e bukës nga prehri i saj dhe u ngrit me një shprehje të vendosur në fytyrë. “Dhe do të bëj një zjarr, bubulak, do ta ngrohë shumë shpejt dhomën. Mos u shqetëso. Vetëm mundohu të qëndrosh i qetë.”

Ajo doli pa u ndier nga dera, duke e lënë Laurentiusin të ulur atje, të pështjelluar. Nga shprehja e saj e fytyrës ai nuk kishte arritur të nxjerrë asnjë përfundim, por ishte mjaft i sigurt se Madlin e dinte kush ishte Klodia. E dinte, por për ndonjë arsye nuk mund t’i tregonte ndokujt. Ndoshta Klodia ishte e bija e pronares por ngaqë ishte një vajzë vullnetdobët që duhet të mbahej në dhomën e saj? Ndoshta kishte patur ndonjë histori dashurie që kishte shkuar keq dhe ajo ishte larguar nga sytë e njerëzve derisa të pushonin thashethemet. Ndoshta mund të kishte ndodhur që qiraxhiu i mëparshëm ta kishte lënë shtatzënë (fundja do të kishte patur njëfarë skandali), dhe tani familja po priste që të lindte fëmija në fshehtësi, duke u përprjekur të

mbajë të fshehur të vërtetën e turpshme. Por ajo s' ishte dukur të ishte shtatzënë, mendoi Laurentius. Dhe sjellja e saj kishte qenë mjaft e çuditshme, ndoshta ishte e marrë? Ndoshta kishte një arsye krejt tjetër përse ishte fshehur? A mund të ishte i sigurt ai që ajo madje të ekzistonte?

Laurentius tundi kokën dhe u ul përsëri në tryezë, duke u përpjekur të qetësonte veten siç e kishte këshilluar Madlin. Mori fletat e letrave dhe filloi të shqyrtojë me rregull tezat e që kishte shkruar për diskutimin e tij. Më pas përzgjodhi disa referenca të përshtatshme dhe filloi të bëjë shënime në fund të faqes për to. Por zhurma e njerëzve që lëvizin plot gjallëri dhe që flasin nuk e la të përqendrohet. Ai u përpoq shumë të kuptonte fjalët, madje u përkul për të vënë veshin në vatër, me shpresën për të dëgjuar çfarë thuhej nëpërmjet oxhakut. Por më kot. Iu kthye librit të tij, e mbështeti kokën në duar, dhe nguli shikimin te fjalitë, duke u përpjekur t'i lexojë me zor, por fjalët dukeshin të pakuptimta. Diçka po e bezdiste atë rreth bisedës që sapo kishte bërë. Ndoshta Madlin dinte vërtet diçka? Dhe me kë po fliste ajo atje poshtë?

U ngrit në këmbë me një vështrim të vendosur në fytyrë dhe zbriti poshtë. Jashtë ishte ende errësirë pus, dhe ai duhet të gjente rrugën me tahmin nëpër korridor dhe të kërkonte me prekje derën. Me sa duket Madlin kishte ndezur vërtet llambën në kuzhinë, por drita e saj nuk arrinte deri në oborr përmes dritareve apo të çarave të derës, dhe nuk dukej të kishte drita të tjera që të ndriçonin aty pranë. Era po ulërinte, dhe shkulet e saj e hidhnin shiun në fytyrën e tij.

“Mirëmëngjesi,” tha dikush nga diku aty afër.

“Mirëmëngjesi,” tha Laurentius, duke parë rrotull i shqetësuar. Atje, qëndronte te shkallët disa hapa larg tij, vajza me flokë të errët.

“Përsëri ti,” tha Laurentius. “Kush je ti?”

“Kishe të drejtë, unë jetoj vërtet këtu,” tha Klodia. “Por duhet të më premtosh që nuk do t’i tregosh askujt. Dhe mos e shqetëso më Madlinën me pyetjet e tua; s’ka ç’të të thotë. Po e bezdis më kot vajzën e gjorë.”

Laurentius e vështroi drejt e në sy dhe menjëherë ndjeu se s’kishte më për çfarë ta pyeste.

“Shumë mirë, nuk do të pyes për asgjë tjetër. Por gjithsesi dua të të takoj. Paninja që më dhe dje ka qenë e vetmja gjë që kam mundur të ha këto ditët e fundit. Kishte shijen e mjaltit; gjithçka tjetër që ha ka shije të prishur.”

Klodia buzëqeshi. “Do të sjell mëngjesin në dhomën tënde.”

Mëngjesi i të Shtunës

SIPAS ARISTOTELIT ka tre forma shpirti: vegetative, e ndjeshme dhe e arsyeshme.

Shpirtrat vegetativë dhe të ndjeshëm ekzistojnë në të gjitha gjallesat, por shpirti i arsyeshëm gjendet vetëm te njerëzit.”

Laurentius po shkruante. Fjalët po i vinin lehtë, dhe duhet vetëm të ndalte për t’u menduar kur i dukej se argumentet e tij kishin rrezik të binin shumë në kontradiktë me qëndrimet Platoniste dhe Karteziane. Fundja, vetë Luter ka qenë kundër Aristotelit dhe ka paralajmëruar që të mos merret shumë seriozisht filozofimi i tij, duke provuar se Platonizmi ishte më i mirë në çdo anë se filozofia Aristoteliane. Dekarti në fakt ka qenë i të njëjtit mendim, dhe si përfundim ka mbërritur në qëndrime filozofike që ishin pothuajse Platoniste të mirëfillta. Në fillim të shekullit Aristoteli ishte shumë i vlerësuar, por tashmë, ndërsa shekulli mbyllej, qëndrimet kishin ndryshuar krejtësisht. Gjithsesi, Laurentius duhet të bënte kujdes të mos kundërshtonte me tepri pikëpamjet filozofike bashkëkohëse.

“Ndonëse njeriu është me të vërtetë i gjallë dhe i aftë për ndijim që nga çasti kur lind, shpirti i tij i arsyeshëm materializohet me kalimin e kohës.”

Kjo ishte teza që gjithnjë hapte pjesën më të madhe të problemeve, sepse tregonte se kishte njerëz që u mungonte shpirti i arsyeshëm. Sigurisht kjo ishte e gabuar, çdo njeri kishte një shpirt, madje edhe si embrion, por duhej ende të materializohej. Ashtu

siç e nesërmja ndjek të sotmen: ende mund të mos ekzistojë, por është në mënyrë të paevitueshme duke lindur, në varësi të asaj që ndodhi dje dhe sot.

Laurentius u ndal të mendohet për një çast. Ndoshta kjo nuk ishte një analogji edhe aq e mirë? Bëri një shenjë në anë të letrës dhe shkroi pranë saj “shikojë më vonë”.

Për herë të parë prej disa ditësh ai nuk u ndie aspak i uritur, dhe arsyeja e tij, ajo që përbënte shpirtin e tij, që ishte e aftë të kuptonte botën që na rrethon, që bënte lidhjet, dhe i shprehte ato me fjalë. Ai ishte i lumtur, më i lumtur prej vitesh. Tëmthi i zi që trazohej brenda tij, kundërmimet mbytëse dhe sëmundja e tij dukeshin sikur ishin zhdukur. Ndjehej si tjetër njeri. Ishte sikur Klodia t’i kishte sjellë atij ambrozian, ushqimin e perëndive, që i bënte ato të pavdekshme. *Aurum potabile*.

Pasi takoi Klodian te shkallët Laurentius ishte kthyer me bindje në dhomën e tij. Ai kishte qëndruar atje dhe kishte pritur në dritën e dobët, me qiriun që digjej mbi tryezë dhe enciklopedinë e Alsted të hapur përpara, dhe kishte vështruar i përhumbur tekstin, duke menduar për Klodian, duke mos ditur ç’të bëjë. Ç’të kuptonte ai nga ajo që kishte ndodhur? Si të vepronte?

Kur ajo më në fund erdhi, dhe hyri pa trokitur, Laurentius s’dinte ç’të bënte përveç se ta përshëndeste me një tundje të kokës dhe një buzëqeshje. U ndie në siklet, sikur dikush i rëndësishëm kishte filluar t’i shërbejë me kënaqësi pa ndonjë arsye. Situata madje u duk e rrezikshme, sikur nga një lëvizje e vetme e gabuar mund të shpërthente kaosi, duke prishur ekuilibrin e brishtë që ishte vendosur mrekullisht. Iu duk si një luan që i lëpin gishtërinjtë, i mrekullueshëm dhe i frikshëm njëkohësisht, dhe ai nuk guxoi të tërheqë dorën, apo ta zgjaste për të ledhatuar kokën e kafshës.

Kështu që qëndroi duke parë në heshtje ndërsa Klodia vendosi një copë buke në tryezë, e mbuloi me një pecetë të bardhë, dhe pranë saj uli një kanë prej balte. Rregulloi flokët dhe i buzëqeshi

pak me tallje. “Kam dëgjuar se ke disa pikëpamje interesante mbi temën e ëndrrave.”

“Unë? Epo, nuk mendoj se ëndrrat janë të parëndësishme, por më tepër se ato interpretohen keq,” tregoi pa dashje Laurentiusit.

Klodia bëri një hap në drejtim të tij. “I mban mend ëndrrat që sheh?” pyeti ajo.

Laurentius u ndal për të menduar. Ishte e vërtetë se ai ndonjëherë zgjohej i sigurt se kishte parë në ëndërr diçka të rëndësishme, por e kishte të pamundur të kujtonte çfarë kishte qenë. Ndonjëherë më vonë do të kuptonte ndjesinë e paqartë, shpesh në një kontekst krejt tjetër, që ai mund të kishte përjetuar tashmë diçka në ëndrrat e tij. Por zakonisht këto ishin hollësi të veçanta, imazhe të shkëputura nga e tëra. Ëndrrat që mbante mend qartë, ato të cilat ai i kishte shkruar me nënshtrim, ishin kryesisht të një natyre të parëndësishme.

“Ndonjëherë,” u përgjigj Laurentius.

“E çfarë ke parë?” e pyeti Klodia.

Laurentius u përpoq të kujtohej. Madlin i kishte thënë më parë që ai kishte bërë titull fort në gjumë. Çfarë të kishte parë në ëndërr? Kodrina rëre, xixëllonja. Dikush i ishte afruar nga ana tjetër e një livadhi dhe qëndroi shumë pranë tij. Kishte qenë Klodia.

“Ti,” tha ai. “Të pashë në ëndërr.”

Klodia bëri edhe një hapa para drejt tij. “Je i sigurt?”

Laurentius qeshi i pasigurt. “Jo, në fakt s’jam i sigurt. Ishte errësirë, dhe ti po ecje nëpër një livadh.”

“Unë isha atje?” e pyeti Klodia.

“Të dëgjova të merrje frymë,” u përgjigj Laurentius.

Klodia u afrua shumë pranë tij, sa që flokët e saj i preknin fytyrën, dhe ai mund të ndjente aromën e luleve dhe të natës. Ai madje mund ta dëgjonte atë të merrte frymë, si një këngë e ulët nën zë. Laurentius s’dinte ç’të bënte. Qëndroi atje duke e parë drejt e në sy, i pafuqishëm për të hequr vështrimin, për të thënë

apo bërë diçka. Më në fund, ajo buzëqeshi, u kthye, dhe doli nga dhoma.

“Të bëftë mirë,” tha Klodia nga rrugëhyrja.

Pasi zhurma e këmbëve të saj që zbresin poshtë nuk u dëgjua më, Laurentius u ul ngadalë në tryezë. Më pas, me një krekosje formale, sikur të bënte ndonjë lloj rituali, filloi të hajë ushqimin që ishte shtruar për të. Theu bukën dhe hodhi në gotë pak verë, pothuajse sikur ishte një aktor në skenë që po e shihte një publik prej njëqind vetësh, ose një prift që jep Kungimin përpara të gjithë kongregacionit.

Edhe kjo bukë ka shijen e mjaltit, pothuajse sikur është bërë me mjaltë. Ndoshta kjo ishte zgjidhja? Ndoshta verë mjalti dhe bukë mjalti ishte çfarë i duhej për të mjekuar teprinë e tëmthit të zi në trupin e tij? Vetitë mjekësore të mjaltit njihen që kur s’mbahet mend. Mjalti mund të përdoret për të konservuar dhe për të mbrojtur, dhe madje mund të shërojë melankolinë. Pas vdekjes së tij në Babilon, Aleksandri i Madh u kthye në Greqi i balsamosur me mjalt të butë, të ëmbël, i lidhur me spango me dyllë blete.

“Dyll blete,” tha Laurentius duke ndërprerë fillin e tij të mendimit.

Sigurisht! Pohoi ai me vete, duke u përpjekur të mos rrëmbehej nga mendimet e tij, i shqetësuar se mund të prishnin natyrën e qetë formale të rastit. Ai duhet të mbante shënim të gjitha këto më vonë; tani për tani vetëm do t’i ngulte në kujtesë.

Hëngri ngadalë deri në kafshatën e fundit bukën dhe piu të gjithë kanën me verë; më pas palosi në dysh pecetën e bardhë dhe me të mbuloi thërrimet që kishin rënë në tryezë. Pecetën e ndjeu të fortë në duar, sikur sapo të ishte endur dhe të ishte hekurosuar me hekur të nxehtë.

Vetëm atëherë u çua dhe shkoi te tryeza e tij e shkrimit. Ndërsa eci nëpër dhomë ndjeu sikur trupin se kishte të vetin; gjymtyrët iu dukën sikur silleshin çuditshëm, duhet t’u thoshte këmbëve dhe

krahëve ç'të bënin, t'u jepte udhëzime të qarta që ato të ecnin përpara. Mendimet i pushtuan mendjen; mund të shihte shkëndija të shndritshme aty këtu, si drita e diellit pranverore që pasqyrohet në ujërat e lumit. Gjithçka ishte e qartë, e kthjellët.

U ul me nxitim dhe filloi të marrë shënime. Në mendje e tij nuk kishte më asnjë pyetje në lidhje me se si duhet t'i kundërvihet Neoplatonistëve apo Panteistëve të ndikuar nga Spinoza. Sipas mendimit bashkëkohor shpirti ishte njëfarë ideje e lindur substanciale; disa njerëz madje besonin se në kuptimin individual nuk ekzistonte fare. Por Laurentius ishte i bindur se shpirti ishte një imazh, një fantazmë, një trillim i imagjinatës, ashtu si drita apo një pasqyrim. I ngjashëm me një pikturë me ngjyra dylli të shkrirë, një vizatim në dyllë. Shpirti hyn nga jashtë, dhe vazhdon të ekzistojë si brenda dhe jashtë nesh, si fryma që nxjerrim, si bletët kur largohen nga zgjoi për të mbledhur pjalm. Vjen si një luzmë bletësh; pastaj mbush zgjuan e boshatisur plot me huall, dhe atje ruan mjaltin. Dhe largohet nga trupii njësoj si bletët largohen nga zgjoi, një luzmë që niset papritur në një ditë të nxehtë, e drejtuar diku gjetkë.

Ai shkroi me nxitim një shënim për vete në anë të letrës: “Përvojat dhe veprimet tona gdhenden në shpirtin tonë si mbi rrasa dylli. Ashtu si një pikturë nuk ekziston derisa dikush e ka pikturuar atë, shpirti ynë nuk ekziston derisa të kemi përjetuar botën. Shpirti ynë dhe vetë identitetet tona vijnë në ekzistencë në sajë të veprimtarive tona, nëpërmjet të kuptuarit tonë të botës dhe ndërveprimit me të. Përndryshe ne jemi veç një lëvozhgë, një pllakë dërrase bosh, një *tabula rasa*.”

Laurentius i shkroi fjalët në një fletë letre bosh. Nëse nuk do të kishte shkruar në të, mund të ishte përdorur për të shkruar një poemë apo për të vizatuar një pikturë, për çfarëdo lloj gjëje. Me të shumë thjesht mund të kishte mbështjellë një copë peshk në treg apo të kishte shkruar në të një nga poemat e dashurisë më

frymëzuese. Ose të dyja bashkë.

Ai gjeti traktatin e Aristotelit mbi shpirtin dhe përgatiti një tezë prej tij: “E zëmë se syri të ishte një kafshë, atëherë shikimi do të ishte shpirti i saj, sepse shikimi është substanca apo esenca e syrit që i përgjigjet formulës , syri është thjesht materia e shikimit, kur shikimi hiqet syri nuk është më sy, përveçse sa për emër, është një sy i vërtetë sa mund të jetë syri i një statuje apo figure të pikturuar.”

Laurentius i shtoi një referim nga Aristoteli në anë të faqes, dhe filloi të shkruajë një shpjegim.

“Ta mbash diçka para syve dhe të vrojtosh botën është një veprim, një ndërhyrje, që tregon se jemi gjallë. Karroca merr qëllim dhe jetë kur njerëzit hyjnë në të: këta njerëz përbëjnë shpirtin e karrocës. Karroca lëviz dhe sillet sipas vullnetit të atyre njerëzve. Ashtu si një kafaz zogu, esenca e të cilit dhe të mbajë zogun. Nëse nuk ka zog brenda tij, atëherë quhet kafaz sa për emër. Ashtu si shpirti i zgjoit të bletëve është qëllimi i tij, të mbajë bletë.”

Pasi mbaroi fjalinë, Laurentius ngriti stilolapsin dhe shkroi një referim nga Virgjili në atë të letrës. Sipas Virgjilit, bletët ndonjëherë mund të mbartin sëmundje në zgjua. Ato do të ikin nga goja e zgjoit, bien në kontakt me helme dhe sëmundje, më pas kthehen dhe infektojnë të gjithë koloninë. Zgjoi i infektuar mund të vulosë me dyll huajt e mjaltit, por ato rrjedhin pashmangshmërisht, dhe me kalimin e kohës i gjithë zgjoi sëmuret dhe bëhet vetë një burim infeksioni. Në mënyrë të ngjashme, njerëzit që mbartin tepër përvoja të tmerrshme dhe tepër melankoli në shpirtat e tyre mund t’u shtypin atë dhe t’u mbajnë brenda vetes, por ajo pashmangshmërisht do të dalë. Ata fillojnë të rrezatojnë melankoli nga sytë e tyre, ashtu si një qiri rrezaton dritë, dhe ata infektojnë të tjerët me të. Laurentius gjeti një shembull mbi atë temë: “Kur një korbë ulet mbi një kafshë të ngordhur, fillimisht i nxjerr sytë, dhe prej andej trurin. Kështu Satanai rrok me vështrimin e tij syrin e një njeriu dhe i nxjerr trurin, duke e lënë atë pamend.” Na pëlqen

apo jo të gjitha aktivitetet me të cilat merremi, madje edhe thjesht veprimi i të parit diçka, gjithmonë shkakton një lloj ndryshimi tek ne dhe në mjedisin tonë.

Laurentius kujtoi rrëfenjën e Orfeut dhe Evridiqisë të cilën Peter e kishte vënë në skenë. Kur Orfeu u kthye për të parë Evridiqinë ai nëpërmjet veprimeve të tij e çoi në ferr. Pati një trokitje në derë Madlin hyn pa prituri te dera. Ajo mbante një turrë me dru zjarri. Duke i hedhur një vështrim të shpejtë mëngjesit të Laurentius zbriti përsëri shkallët me zhurmë.

Kur u kthye, duke mbajtur një thëngjill të ndezur, nga shprehja e saj e fytyrës dukej qartë që ajo ishte e pakënaqur për diçka, por nuk foli.

“Këtu erdhi Klodia,” tha Laurentius për të thyer heshtjen e sikletshme, ndonëse ishte i sigurt që Madlin tashmë e dinte.

“S’dua të di më. Por nëse dikush pyet, unë s’kam parë e s’kam dëgjuar gjë. Mos u shqetëso, s’kam ndërmend të filloj të të nxjerr sekretet,” tha Madlin me zemërim me një pamje të vendosur në fytyrë dhe filloi t’i fryjë copës së thëngjillit, duke u përpjekur të ndezë zjarrin.

“Por s’kam bërë asgjë,” tregoi pa dashje Laurentius për t’u mbrojtur. “S’e kuptoj përse je kaq e bezdisur.”

Madlin u ndal së bëri atë që po bënte dhe u ngrit. “Do të kesh telashe nga kjo. Shumë telashe, ta them unë. Pronarja i ka ndaluar qiraxhinjtë të sjellin të panjohur këtu, dhe ju mund të më tregoni lloj lloj historish, por unë nuk jam edhe aq budallaqë. E di shumë mirë ç’djallëzira bëjnë njerëzit dhe çfarë flasin pas kurrizit.”

Laurentius tundi kokën. Ai kishte shpresuar që gjithçka që po i ndodhte do të shkonte drejt një përfundimi të natyrshëm, një që ishte si llogjik dhe i kuptueshëm. Për tani për tani me sa duket shpjegimi mbetej i pakapshëm.

“Shumë mirë, nuk do të të mërzit më me pyetje,” e siguroi atë Laurentius.

“Ajo që duhet të të bëjë pyetje jam unë,” tha Madlin, ia ktheu ajo me të njëjtat fjalë. “Por s’kam ndërmend ta bëj. Nuk dua të ngatërrohem në atë punë.” Ajo qëndroi atje me duart në ije, me pamje të inatosur.

“Dhe do të parapëlqejë të mos më shqetësojë më për këtë,” shtoi ajo.

Laurentius tundi kokën përsëri. Nuk kishte plan ta ndiqte më tej çështjen. I dinte mirë rrëfenjat që e paralajmëronin heroin të mos bëhej tepër kurioz. Do të ishte më mirë që disa gjëra në jetë të liheshin të fshehta; nëse ato do të nxirreshin në ditë për diell mund të prisheshin si një lule e këputur. Nëse ai do të mund të ruante gjendjen e tij të kthjellët të tanishme dhe të vazhdonte të shkruante, atëherë nuk do të kishte nevojë të bënte më shumë pyetje.

“Të premtoj që nuk do ta bëj,” tha ai.

Shprehja e fytyrës së Madlin ishte zbutur pak, e madje buzëqeshi, fare pak, ndërsa u largua. Laurentius u ul duke parë një copë herë derën përpara se t’i kthehej librit dhe i hodhi një sy asaj që kishte shkruar deri tani. Duhet të bënte disa korrigjime në disa vende, por vendosi ta lërë për më vonë atë punë të mërzitshme dhe t’i hynte menjëherë tezës tjetër. Ishte e rëndësishme të vepronte ndërsa ende ndjente sikur fluturonte. Ashtu si në ëndërr, ana e tij e logjikshme e dinte se trupi i tij nuk mund të ishte edhe aq i lehtë, por ajri po e mbante disi peshën e tij. Ndërsa uli sytë poshtë, majat e pemëve dhe ndërtesat dukeshin të gjitha shumë të vogla, sikur t’i shihte nga një kambanore kishe. Përjetimi ishte qiellor. E dinte se nuk do të zgjaste për një kohë të gjatë.

“Gjithçka që fshihet në vende të fshehta, në qytete, në ushtri dhe gjëra të njëllajta me këto, mund të bëhet e dukshme nëpërmjet dritës së përthyer,” shkroi ai ndërsa nisi një rresht të ri.

Duhet të citonte përmendësh, sepse nuk i kishte veprat e Roger Bacon.

Mesditë e së Shtunës

NË NJËRËN ANË TË DHOMËS, m'u poshtë dritareve qëndronte një tryezë me veshje metalike që vinte pothuajse në lartësinë e gjoksit. Gjatë gjithë syprinës së saj kishte hulli, dhe një kovë e madhe ishte vendosur për të mbledhur lëngjet e trupit. Tryeza ishte vendosur mbi një podium të madh të sajuar që ishte mbuluar me një pëlhurë të errët, dhe ndikimi i përgjithshëm ishte shumë dramatik. Ishte qartësisht një përpjekje për të imituar teatrin anatomik në Leiden, dhe disa nga elementët e konstruksionit Laurentius i njihte më parë. Profesor Below ishte arsimuar në Hollandë njësoj si ai, kështu që mendimi i tij se ç'pamje duhet të kishte teatri anatomik vinte drejtpërdrejtë nga shkolla që kishte ndjekur. Pranë podiumit qëndronte detyrimisht një skelet: asistenti i anatomisë duhet të tregojë atë pjesë të trupit që po shqyrtohej në një çast të caktuar. Skeleti nuk ishte në gjendje të mirë, dhe dosa nga kockat ishin të thyera apo mungonin. Dikush kishte ngjitur me ngjitëse brinjët e poshtme, dhe teli i tendosur i futur nëpër falangjet e gishtave ishte shtrembëruar, duke i bërë të duken të dalë në kënde të panatyrshme. Në murin e sallës në disa fletë letre të bardha me shkëlqim ishin pikturuar moto si *memento mori*, ndonëse në ato kohëra të vështira një këshillë e tillë dukej jo vetëm e padobishme por mund të ishte e dëmshme. Me gjithë ndodhitë e çuditshme dhe shqetësimet e vazhdueshme studentëve dhe mësuesve vdekja u rrinte para syve me ngjyra të gjalla, dhe

nuk do të donin t'ua kujtoje. Ndoshta kjo ishte arsyeja përse nuk kishte edhe aq shumë njerëz siç mund të pritej në këtë autopsi të parë publike të një kufome njerëzore. Profesor Below me sa duket i kishte thënë për vite guvernatorit të qytetit që universiteti kishte nevojë për kufoma për qëllime studimore por vetëm tani ata kishin arritur të siguronin një. Në këto rrethana mundësisht nuk mungonte materiali i duhur; vonesa kishte ndodhur kryesisht nga mungesa e entuziazmit nga ana e zyrtarëve të qytetit dhe çështjet e një natyre teknike.

“Dje u bë e qartë se asnjë nga studentët tanë të tanishëm nuk ka marrë pjesë më parë në një autopsi shkencore,” ia nisi Profesor Below. “Prandaj do të marrë Laurentius Hylas si asistentin tim. Di që ai ka qenë i pranishëm në një autopsi në Leiden të paktën një herë më parë.” Laurentius nuk u zu në befasi nga propozimi i Below, meqenëse profesori e kishte ndalur një ditë më parë dhe e kishte njoftuar se do të donte që të bëhej asistenti i tij. Ai i kishte thënë Laurentiusit që nuk do të bënte asgjë që kërkonte njohuri të veçantë, kryesorja ishte të mos të të binte të fikët nga gjaku. Njerëzit ndonjëherë papritur bëhen nervoz në autopsinë e tyre të parë anatomike, megjithëse e kanë përjetuar vetë luftën. Sipas Below, ata që kanë parë vdekje dhe gjymtim në betejë janë veçanërisht të ndjeshëm. “Lufta i bën njerëzit burracakë,” shpjegoi Below. “Burracakë dhe besëtytnorë. Nëse doni një këshillë nga unë, kurrë mos u bëni ushtar.”

“A nuk është të parit e vdekjes që i bën njerëzit burracakë?” kishte sugjeruar Laurentius. “Vetëm njerëzit që kanë parë vdekje janë trima.”

“Por doktorët shohin vdekje gjatë gjithë kohës,” tha Below duke bërë një gjest përbuzës me dorë. “Vdekja në vetvete nuk është asgjë. Jo vdekja, por frika nga vdekja është çelësi. Po, vërtetë. Lufta është plot me lloj lloj tmerresh, përfshirë jetën e njeriut që largohet nga trupi fizik dhe kjo i bën njerëzit burracakë.

Vdekja është një gjendje e të mos qenurit dhe si e tillë nuk ka ndikim tek ne, ose mund të ketë ndikim vetëm tërthorazi. Ndikim të drejtpërdrejtë tek ne ka ajo që është në shpirtat tanë, që është e gjallë. Pa jetë, trupi është vetëm një lëvozhgë bosh.”

Kur Below e thirri Laurentiusin të vinte te podium, ai pati një ndjenjë frike, të njëjtën ndjesi që i bën zakonisht njerëzit burracakë. Kishte qenë i qetë dhe i lumtur gjithë mëngjesin, por tani mund të ndjente ankthin t’i shtohej përsëri në stomak.

“Mos rri ashtu i turpshëm, pse nuk vjen të më ndihmosh,” tha Below, duke e nxitur Laurentius të vinte ndërsa ai filloi të shkarkonte instrumentet e tij në mes të tryezës. “Siç diskutova me Profesor Sjöbergh, mund të fillojmë duke u njohur me kokën e njeriut.”

Sjöbergh iu afrua tryezës dhe ia bëri me shenjë me kokë Below-ut. Duke u kthyer nga e gjithë salla, ai ngriti një pyetje që u bë për të qenë retorike: “Normalisht kjo nuk është pjesë e një shpjegimi paraprak, por mund t’ia fillojmë me strukturën e kafkës dhe të trurit?”

Një murmuritje miratimi erdhi nga grupi i madh i studentëve, dhe njëri prej tyre bërtiti fort: “Është gjithnjë më mirë t’a zëmë nga fillimi.” Kjo u pasua nga një e qeshur pak nga zori. Ndonëse të gjithë kanë parë ekzekutime dhe vdekje, autopsia gjakftohtë e një trupi njeriu ngjallte pak frikë. Vetëm të shihje Profesor Below, veshur me përparësen e tij prej lëkure, duke vënë sharra, thika dhe pinca mbi tryezë mjaftonte për të shqetësuar disa nga studentët, edhe përpara se t’i përdorte.

Laurentius zuri vend në podium, dhe pothuajse menjëherë dera e sallës u hap dhe sollën brenda një kufomë të mbështjellë me copa pëlhere.

“Aha,” tha Below.

Murmuritja e zërave filloi të bjerë, dhe pjesëmarrësit kureshtarë u grumbulluan edhe më pranë. “Ngrijeni mbi podium menjëherë.

Po, ashtu, silleni këtu,” udhëzoi Below.

Ai filloi të çmbështjellë kufomën, me një pamje të përqendruar eksperti në fytyrë.

“Siç mund ta shohim, në këtë rast rigor mortis nuk është i pranishëm.” Ai ngriti një nga krahët e kufomës dhe e la të rrëzohet i këputur. “Kjo tregon se kemi të bëjmë me një individ që ka vdekur më shumë se dy ditë më parë. Ndonëse ka sigurisht raste në shkrimet popullore që nuk kanë shfaqur fare rigor mortis, sidomos ata të një moshe më të madhe.”

Ai e ngriti pak kufomën duke e kapur nga shpatullat, lëvizti me shkathtësi kokën para prapa, pastaj murmuriti diçka me vete, duke u dukur pak i habitur.

Tashmë, Laurentius ishte bërë në fytyrë i bardhë si bora. Flokët dhe mjekra e kadavrës anatomike ishin ishin rruar, por ai e kishte njohur fytyrën menjëherë. Ai madje mbante mend të kishte parë në sytë gri e zbehtë të plakut, pak para se ai t’ia mbathte me kafazin e tij. Në të njëjtën kohë kur kishte filluar t’i ndejë erën asaj grahme. Në mënyrë instinktive kishte zënë hundët me dorë, por me sa dukej kufoma ende nuk kishte filluar të kalbëzohet. Madje dukej sikur e kishin larë përpara se ta sillnin këtu. Mund të supozoje pa frikë se plaku nuk ishte larë e fërkuar aq mirë për një kohë të gjatë, apo kurrë ndonjëherë më parë në jetën e tij. Estonians mbaheshin për frekuentues të zellshëm të saunave, por ishte e qartë që nga takimi i parë me plakun se një veprimtari e tillë nuk kishte qenë përparësi e tij. Tani, gjithsesi, trupi i tij i vjetër ishte shpëlarë dhe rrinte i shtrirë atje përpara Laurentiusit, i zverdhur dhe me muskuj si një vizatim anatomie.

“Siç mund ta shihni kadavra ka një dëmtim të vogël në kafkë, por kjo nuk do të ndikojë aspak në paraqitjen që ne do t’i bëjmë. Asistent, më jep thikën,” tha Below, duke filluar hapjen e kadavrës. Laurentius iu afrua tryezës, duke ecur duke u lëkundur pak, dhe i dha Below një thikë të gjatë. Below e mbërtheu me një vështrim

pyetës. Pati arsye ta bënte këtë, sepse fytyra e Laurentiusit ishte bërë tani bojëhiri si kufoma e shtrirë në tryezë. Duke kuptuar që Below po e shihte, Laurentius u përpoq të buzëqeshë, por rezultati nuk ishte bindës.

“Fillimisht do të hapim kafkën,” shpjegoi Below. “Për të bërë këtë do të bëjmë një çarje rrethore në kokë, dhe do të tërheqim lëkurën. Pastaj do të mund të sharrojmë kockat.”

Mori në dorë thikën dhe bëri prerjen e parë, duke nxjerrë disa pika gjaku të trashë të kuq. Ndërsa ndiqte me vëmendje profesorin e zënë me punë, Laurentius po mendonte vazhdimisht për bisedën e tyre atë mëngjes. Ishte e vërtetë se nuk kishte arsye për të patur frikë nga vdekja: Sapo jeta të linte trupin, nuk do të kthehej kurrë më. Por ai ende ndihej i shqetësuar. Herën e fundit që kishte parë plakun, ai kishte qenë në lëvizje, mirë e bukur.

“Pasi të çaj kockën e ballit, *os frontale*, mund të fillojë të çaj kockën kafkore, *os parietale*. Mbani shënim se nyja midis kockës tëmthore dhe kockës kafkore, *sutura squamosa*, është e vështirë për t’u sharruar, dhe në kadavra të kësaj moshe zakonisht është tërësisht e kockëzuar. Prandaj këshillohet të bëhet çarja e para m’u sipër kësaj nyje.”

Ndërsa Below përshkroi pjesët e kafkës që ai po shqyrtonte, Laurentius tregoi me gisht vendet përkatëse në skeletin anatomik, dhe studentët i panë dhe tundën kokën me shprehje serioze në fytyrë. Më pas Below e ktheu anash kokën e burrit, duke u përgatitur të bëjë një tjetër çarje, dhe u ndal për të marrë frymë thellë. Nga gjithë tërheqjet nga të gjitha anët gjatë demonstrimit sytë e plakut ishin hapur, dhe ai e nguli shikimin e tij të menduar dhe të pikëlluar te Laurentius. Tani Laurentius mund të shihte me qetësi në ata sy, pa asnjë ndjenjë faji. A kishte mbetur ende ndonjë shenjë jete atje? Jo, aspak. Sytë e plakut ishin të shpërqëndruar, me shkëlqim të qelqtë, si sytë e një peshku pasi kishte qëndruar në diell në treg për një kohë të gjatë. Por atje në plevicë ata kishin

qenë plot jetë, ngjyrë të kaltërt të ndezur, dhe të ngulur. Laurentius kishte parë në ata sy, dhe ja përse plaku tani rrinte shtrirë në atë tryezë metali, i vdekur. Dhe kështu ndodhte gjithmonë. Sa herë që ai shihte për një kohë të gjatë në sytë e dikujt, ata sëmureshin apo vdisnin. Ai s'mund të bënte asgjë për këtë. Ishte melankolia e tij, mallkimi që mbante në shpirt, syri i keq, që nuk i nënshtrohej arsyes së tij.

Below filloi të bëjë një prerje të mëtejshme, nga balli te veshët. Në këtë pikë, Laurentiusi ishte i sigurt që pa sytë e plakut të puliten pak. Kundërmimi i neveritshëm nga i cili ai tani jetonte me aq frikë filloi t'i gudulisë përsëri hundët, fillimisht gati i pakapshëm. Pastaj u bë i vetëdijshëm për shijen e keqe, e prishur e duhanit në gojë, dhe instinktivist u përpoq ta pështynte. Që prej mëngjesit, kur Klodia i kishte shërbyer mëngjesin, ai nuk i ishte dashur të duronte ato grahma të pështira, armiqësore. Ndoshta duke parë vdekje perceptimi i shqisave të tij i prishjes dhe i kalbjes ishte rritur? Ndoshta Below nuk kishte patur të drejtë kur kishte thënë se të shohësh vdekjen nuk do të thoshte asgjë. Fundja, doktorët kishin parë trupin njerëzor, gjakun, zorrët, kockat, por nuk panë vetë vdekjen. Natyra e vërtetë e vdekjes nuk gjendej në ato gjëra. Laurentius filloi të ndjejë një dhimbje therëse me rrahje në kokë, dhe një lëndim në sy, vetë gjakun dhe kockat e tij, dhe një gudulisje si të të futet një fije floku apo pupël në sy.

“Pupla?” filli i mendimit i Laurentiusit papritur u ndal, dhe shkopi tregues i rrëshqiti nga dora. Iu morën këmbët dhe zgjati dorën për t'u mbështetur, dhe gati sa nuk hodhi skeletin. Ai u lëkund në shufrën e hollë në të cilën varej pezull, dhe krahët e tij eshtake që mbaheshin nga teli, u tundën me tërbim sa andej këndeje. Kafka u anua anash, dhe tani dukej sikur shihte me qortim Laurentiusin.

Profesor Below u kthye nga Laurentius me një shprehje të bezdisur në fytyrë, dhe disa prej studentëve ngritën sytë të

alarmuar, por përpara se të thoshin diçka, dëgjuan një zë që thirri.

“Aaah!” erdhi një britmë nga sipër tryezës.

Zhurma erdhi nga kadavra anatomike, që tashmë ishte ngritur ndenjor, dhe kishte vënë duart në kokë. Gjaku po i shkonte çurg nëpër gishta ndërsa ai përpiquej të mbante me dorë plagën e hapur. Ajo që kishte nisur si një dënesje e mekur ishte kthyer në një kujë e ngjirur, e fortë. Gjaku po rridhte nëpër shpatullat dhe stomakun e plakut, dhe trupi i larë para pak kohësh ishte lyer në gjak të kuq të trashë.

Studentët shtynë me bërryla njëri tjetrin ndërsa u përpoqën të zbrapsen nga podium, dhe dikush thirri “Na ndihhtë Zoti!” Laurentiusit u ndie sikur ishte i pirë, dhe nuk po kuptonte mirë ç’po ndodhte. E gjithë skena ishte surreale dhe groteske.

Vetëm Profesor Below qëndroi i qetë, duke u përkulur nga plaku dhe duke i shpjeguar: “Do të jesh mirë; je në duart e një doktori. Një doktori, më kupton?” Por ai tundi kokën me dëshpërim. “Ndoshta nuk kupton gjermanisht, mund t’i shpjegojë dikush ju lutem që jam doktor? Do t’i hedh një sy kokës së tij. Do të më duhet t’ia mbështjellë me fasha, por nëse vazhdon të bëjë si histerik dhe të rrotullohet andej këndeje kam frikë se s’do të jetë e pamundur.” Ai u ndal për një çast para se të mbyste duke bërëtitur zhurmën e turmës që ia kishte mbathur në korridor. “Dhe kush dreqin e kontrollon kufomën? Do të sigurohem vetë që të mbajë përgjegjësinë!”

“Mos doni të thoni ...” Sjöbergh filloi të thotë duke iu dridhur zëri. “Sigurisht, duke marrë parasysh se...”

Plaku ende bërtiste i alarmuar. Duke parë rrëmujën e përgjithshme dhe turbullimin e pjesëmarrësve ai me të gjitha gjasat kishte menduar se kishte mbërritur në ferr.

“Kush flet estonisht këtu?” tha me britma i zemëruar Below. “Eja këtu menjëherë!”

Pastaj u kthye dhe iu drejtua me mirësjellje Sjöbergh: “Nuk

ka nevojë për supozime këtu; është një animacion i pezulluar, *vita minima*, një fenomen shumë i zakonshëm. Një doktor i mirë, do ta kishte dalluar menjëherë. Që në fillim mendova se kishte diçka të dyshimtë në këtë. Këta diletantë vetëm telashe na hapin. Ata mund të vijnë dhe të shqyrtojnë si duhet kadavrën e tyre me ne, por a e bëjnë thua! Sharlatanë janë, të gjithë bashkë!”

Pasdite e së Shtunës

“TINGËLLON VËRTET E ÇUDITSHME,” tha Mellinck, duke u pajtuar me Laurentiusin.

Laurentius tundi kokën me shqetësim. Ngjarjet e mëngjesit e kishin lënë me një ndjesi rraskapitjeje, zbrazëtie, që u përkeqësua ndërsa ai i tregonte historinë pastorit. Fillimisht gjithçka ishte dukur shumë e qartë, sikur ta kishte pritur. Me të marrë veten nga tronditja e fillimit nga ajo që kishte ndodhur në teatrin anatomik ai kishte provuar përsëri ndjesinë e çuditshme të të qenurit i lehtë, sikur sapo kishte mësuar zgjidhjen e një problemi që e kishte munduar për një kohë të gjatë, sikur papritur të ishte shëruar nga sëmundja e tij. Gjithë të tjerë ishin mbledhur rrotull të shqetësuar, por ai kishte qëndruar në mes tyre, disi i veçuar, sikur qëndronte pezull në ajër dhe shihte poshtë çfarë po ndodhte. Drita në dhomë ishte bërë vezulluese, e qartë, e artë, por të gjitha ngjyrat përveç të verdhës ishin zbutur disi, dhe shumë objekte dukeshin sikur s’kishin fare ngjyrë. Duke qëndruar atje në rrezatimin e artë, kishte vështruar me vëmendje ndërsa Below, që nuk kishte arritur të merrte ndihmë prej asnjërit, e nënshtrroi plakun me *oleum dulce vitrioli* dhe filloi të qepë plagën që kishte në kokë, duke diskutuar diçka me Sjöbergh ndërsa e bënte këtë. Studentët, që dukeshin të vegjël si xhuxhat në një përrallë, po arsyetonin mes njëri tjetrit, fillimisht me një gjendje paniku, por sa vjen e duke iu çelur humori. Ishte e qartë se diçka e pazakontë kishte ndodhur, por pasi e morën

veten nga tronditja dukej më shumë qesharake se sa e lemerishme. Vetë Laurentius ishte ndërë gjithnjë e më shumë i pushtuar nga një eufori e çuditshme, dehëse, derisa papritur arriti një gjendje mendjekthjellësie të plotë. Të gjitha kundërmimet dhe dhimbjet ishin zhdukur. E dinte me shumë siguri që gjithçka që duhet të bënte tani ishte të shkonte në morg dhe të gjente gruan fshatare dhe ta kthente në jetë. Dhe pas kësaj ai do të mund të shpëtonte të gjithë njerëzit e tjerë që kishin vdekur apo ishin sëmëurur nga shikimi i tij.

Ai ishte larguar me nxitim nga salla, ishte turrur në rrugë dhe pyeti të parët njerëz që ndeshi për vendndodhjen e morgut. Njerëzit e kishin vënë re buzëqeshjen e tij vesh më vesh dhe i buzëqeshën edhe ata, duke i treguar me kënaqësi rrugën për atje pa e pyetur se çfarë priste me padurim të shihte atje. Pavarësisht rigës së vazhdueshme të shiut atij i dukej sikur tani ishte verë apo pranverë. Madje dhe era e rëndë e tymit gri të oxhaqeve që rri pezull mbi qytet në lartësi të ulët dhe grahma që të shpon hundët e bajgave të kalit ishin aroma të mira dhe të këndshme për të, si aroma e trëndafilave. Ai kishte shkuar drejt e në godinën e morgut më një pamje të guximshme dhe të vendosur në fytyrë dhe i tha rojës që kishte ardhur nga universiteti me porosi të Profesor Below. Një gabim i madh pakujdesie kishte ndodhur me një trup të vdekur që sapo ishte dërguar, dhe ai duhet ta hetonte urgjentisht çështjen.

“Ishte një rast më për t’u ardhur keq i një plaku në animacion të pezulluar. Ka shkaqe për t’u besuar se mund të ketë raste të tjera të tilla,” tha Laurentius, duke marrë një ton zëri autoritar për të bindur ushtarin. “Shumë mirë, por a mund të kërkonti vetë trupat?” tha ushtari, me padurim për t’ia plotësuar kërkesën. Hapi një derë që të çonte në një dhomë të nëndheshme me tavan të ulët.

Brenda ishte më ftohtë dhe më me lagështirë se jashtë në rrugë. Të sistemuar në shtretër dërrase ishin nja dhjetë kufoma që prisnin të varroseshin , të gjitha raste ku qyteti kishte patur gisht në një

mënyrë apo tjetrën. Pjesa më e madhe e këtyre vdekjeve kishin qenë të dhunshme, dhe sipas dekretit të shtetit cilado çështje e dyshimtë duhet të hetohet nga një gjykatës. Vetëm atëherë një anëtar i familjes do të mund të merrte kufomën dhe do ta varroste, ndonëse në rrethanat e tanishme shpesh ndodhte që askush të mos vinte, dhe qyteti duhet të spastronte vetë kufomat. Kishte mundësi që nëse rritej numri i të vdekurve siç kishte ndodhur nuk mbetej zgjidhje tjetër veçse të shugurohej një copë toke pranë varrezave dhe të varroseshin aty trupat e paidentifikuara në një varr të përbashkët për të varfrit.

Laurentius shkoi me nxitim nga një trup në tjetrin, duke hedhur herë herë një vështrim të shpejtë poshtë çarçafëve që i mbulonte. Pastaj u ndal. I njohu ato rripa shapakash të grisura, ishin të njëjtat që kishte parë të dalin nga poshtë çarçafit kur barela që mbarte kufomën që kullonte gjak kaloi pranë tij tutje te shpellat. Bëri anash me nxitim mbulesën dhe pa trupin e dobët të gruas të cilën e kishte parë gjallë vetëm një herë, pas shfaqjes teatrale të Peter. Krahët dhe këmbët e gruas ishin vënë drejt; flokët i kishte të lëshuara, ndërsa kokën të anuar prapa. Laurentius vuri re se fytyra e saj ishte mbuluar me të prera të vogla. Ai u përkul përpara për ta parë më mirë në dritën e dobët të dhomës, dhe u zbraps nga frika. Sigurisht nuk ishte lënë kështu aq gjatë sa korbat dhe laraskat bishtgjata t'i nxirrnin me sqep sytë! Ai mund të shihte veç dy vrima të zeza. Laurentius qëndroi duke parë gropat bosh ku kishin qenë sytë e saj. Më në fund e mbuloi përsëri trupin me çarçafin me një pamje të dëshpëruar në fytyrë. Tani s'mund të bënte më asgjë.

“Këtu s’duket të ketë asnjë arsye për t’u shqetësuar; gjithçka është në rregull,” i shpjegoi ai ushtarit me një zë të dëshpëruar. “Ditën e mirë.”

Ai u largua me nxitim nga morgu, por me të dalë u ndal i pavendosur. Gjithçka që mund të shihte përpara tij ishin pemë që kullonin nga uji i shiut ; nuk kishte këmbë njeriu. Ngriti sytë për

të parë degët pa gjethe, i pushtuar nga pasiguria se çfarë do të bënte më tej. Në atë çast, një tufë harabelash erdhën si një shkullm i papritur ere dhe kaluan shumë pranë fluturimthi, një apo dy madje i kaluan midis këmbëve. Mendimet në kokën e tij endeshin gjithashtu aty këtu, duke u shtjellë në mënyrë të pakontrollueshme përpara se të zhdukeshin, njëlloj si harabelat. Madje u ndie pak i turpëruar për atë që kishte ndodhur. Shpresonte që kur kishte dalë ashtu me vrap nga universiteti, të mos ishte dukur tepër e çuditshme. Ishte i sigurt të kishte parë Profesor Below ta shihte shtrembër me mosmiratim. Ai mund të vendoste t'i shkruante Leiden-it për të zbuluar ç'përshtypje kishte lënë atje. Bazuar në sjelljen e tij pikërisht në këtë çast, mund të merrej me mend që s'ishte në rregull nga trutë. Lloj lloj telashesh mund t'i hapeshin po të hetohej e kaluara e tij. Dikush madje mund të parashtronte rrethanat e largimit të tij nga Universiteti Leiden. Nëse njerëzit vazhdonin të sëmureshin rëndë apo të kishin të papritura të çuditshme pasi hynin në kontakt me të, atëherë dikush mund të bënte lidhjen. Një përfundim i tillë mund mund të hidhej poshtë duke u quajtur thjesht besëtytni, por dikush me një intelekt të mprehtë si i Below do të mund të dallonte shkaqet më të thella, sidomos pas asaj që kishte ndodhur në sallë.

“Por çfarë ndodhi në fakt atje?” mendoi me vete Laurentius.

Plaku ishte kthyer në jetë. Sigurisht mund të kishte qenë një koincidençë. Por ai ende s'mund të kuptonte se si mund të kishte ndodhur. Duhet ta diskutonte me dikë, por nuk do të kishte qenë me vend të shkonte të takonte Profesor Below apo Sjöbergh. I vetmi që mbetej ishte Mellinck, i cili e kishte ftuar tashmë t'i shkonte për vizitë. E qetësonte fakti që ishte pastor, dhe me sa duket edhe shumë mendjegjerë.

Kështu kishte shkuar të kërkojë Mellinck. Fillimisht pamja e hequr dhe e turbulluar e Laurentiusit me sa duket e shqetësoi pak pastorin, por kur ai filloi të tregojë ngjarjet e mëngjesit, shprehja

e fytyrës së pastorit u zbut. Ai e kuptoi përse Laurentius ishte aq i mërzhitur.

“Kështu beson që ti disi e ktheve në jetë këtë plak?” e pyeti më në fund Mellinck.

Laurentius tundi kokën me shqetësim. Nuk kishte guxuar t’i tregonte më tepër seç duhej pastorit.

“Në të vërtetë nuk ka asgjë të padëgjuar rreth kësaj që ka ndodhur, siç tha edhe vetë Below, rastet e animacionit të pezulluar janë mjaft të zakonshme këto kohë,” tha mendueshëm Mellinck. “Duke e parë këtë nga një këndvështrim fetar, ekziston sigurisht edhe sindroma e Lazërit. Ndodh rëndom veçanërisht në kohëra konfliktesh, dhe dobia e saj është të nderojë Perëndinë. Ne dimë nga shkrimet e Shën Nikollës, për shembull, që ai arriti të kthejë në jetë tre djem që ishin vvarë nga një kasap. Kjo ndodhi gjatë zisë së bukës, dhe qytetarët mezi prisnin t’i hanin. Ata ishin bërë copa copa dhe ishin varur në çengelat e mishit. Por nuk dukej sikur dikush të kishte filluar të hajë atë plak, apo jo?”

Laurentius tundi kokën në shenjë mohimi. “Below vetëm kishte arritur të bëjë çarjen e parë.”

“Sigurisht, ka plot raste njerëzore edhe këtu,” tha Mellinck duke bërë po me kokë. “Kam dëgjuar disa histori vërtet rrëqethëse. Por s’kanë lidhje me këtë çështje. The që Below kishte arritur të bënte një çarje. A u zhduk e prera kur plaku u kthye në jetë?”

“Jo, ndodhi e kundërta, gjaku filloi t’i shkojë çurg. Ishte një skenë e tmerrshme.”

“Pra nuk u zhduk. E sigurt është se një njeri nuk mund të kthejë dikë në jetë vetë, nevojitet ndërhyrja e Zotit. Por në ato raste personi zakonisht mëkëmbet plotësisht, si ata djem që shpëtoi Shën Nikolla. Në ta nuk ka ngelur asnjë lëndim. Sigurisht, gjithmonë është e mundur të ketë qenë ndonjë lloj mashtrimi demoniak, por në raste të tilla personi nuk kthehet vërtet në jetë, edhe nëse sytë i ka të hapur. Ti po thua që e gjithë salla e pa ringjalljen?”

“Po, sigurisht,” tha Laurentius, në pamje pak i bezdisur nga pyetja.

“S’ke pse fyhesh,” tha Mellinck me një buzëqeshje. “Thjesht doja të peshoja të gjithë mundësitë, një nga një... Por nëse do mendimin tim për këtë çështje, këtu kemi të bëjmë thjesht me një ngjarje të rastësishme. Këto gjëra dihet që ndodhin, ndonëse e pranoj që meritojnë vëmendje, sepse janë një tjetër provë e kohërave të jashtëzakonshme në të cilat jetojmë. Nuk janë parë kometa kohët e fundit, dhe ato shoqërojnë zakonisht ngjarje të tilla të pazakonta. Por ndoshta mund të ketë ndodhur që nuk i kanë vënë re. Këto kohët e fundit qielli ka qenë gjithnjë i vrenjtur, dhe nuk kam patur mundësi të bëj vëzhgimet e mia astronomike të zakonshme.”

Ndërsa Mellinck vazhdonte të fliste mendueshëm në të njëjtën mënyrë Laurentius filloi t’i krijohej përshtypja se e kishte lënë veten të mërzitej shumë nga diçka që mund të ishte e pazakontë por megjithatë lehtësisht e shpjegueshme. Fundja, teoria e animacionit të pezulluar e Below ndoshta jepte shpjegimin më të besueshëm. “Meqë ra fjala, si është ajo vajza e vogël që strehove?” e pyeti Laurentius kur pa se Mellinck kishte shprehur gjithçka që kishte mbi temën.

“Ah, ajo,” tha pastori pasi u ndal për të menduar për një çast. “S’është mirë. Ethet ende nuk i kanë pushuar, kam frikë se lëngjet e trupit të saj janë çekulibruar. S’kemi ç’të bëjmë veçse ta vendosim në një dhomë të ngrohtë, të thatë, dhe të përpiqemi të ulim disi lëngun e trupit të saj të ftohtë, të lagësht.”

“Më rastisi të kem disa ilaçe pluhur me vete që i përdor për ethet e mia, mund të provosh t’ia japësh?” sugjeroi Laurentius.

“Vërtet?” pyeti Mellinck me interes. “Ç’lloj?”

“Lëvore shelgu, e përgatitur sipas recetës së Galen. Zakonisht bëj një tinkturë prej saj, por kohët e fundit nuk kam patur kohë ta përgatis. Prandaj efekti është më i vogël,” shpjegoi Laurentius.

Mellinck u duk entuziast të mësonte më shumë për recetën e tij, kështu që Laurentiusit iu desh t'i tregojë gjerë e gjatë për rezultatet që ai kishte arritur me lëvoren.

“Le të shkojmë ta provojmë menjëherë,” sugjeroi Mellinck.

Ata zbritën poshtë në katin e parë dhe hynë në një dhomë të vogël pranë kuzhinës, ku një trup i vogël ishte shtrirë në një shtrat të ulët, i mbuluar me një batanije të hollë.

“Ka ethe të forta prandaj e kemi lënë të nxjerrë me djersë avujt e ftohjes; ata nuk duhet të bllokohen poshtë batanijeve të trasha,” shpjegoi Mellinck. “Ventilimi duhet të jetë shumë i mirë, por dhoma nuk duhet të jetë as tepër e ftohtë. Në këtë çast është paksa e vështirë të arrish kushtet e duhura. E kam mbështjellë me leckat të lagura që t'i nxjerrim avujt e ftohjes, por deri tani pa sukses.”

Shërbyesja solli një enë me ujë të nxehtë dhe Mellinck i hodhi brenda pluhurat. “Mendoj se s’ka nevojë të zihet apo jo?”

“Kam vënë re që po ta ziesh me zjarr të ulët jep rezultatet më të mira,” u përgjigj Laurentius.

Vajza e ktheu enën në kuzhinë, e shoqëruar nga Mellinck, duke e lënë Laurentiusin vetëm me vajzën e sëmurë në dhomën e vogël. Ai mund të dëgjonte frymëmarrjen e saj të shpeshtë, të parregullt. Dhe fishkëllimën e ajrit ndërsa kalonte midis buzëve të saj të thara. Ai iu aftua ngadalë anës së shtratit dhe shtriu dorën për të prekur ballin e fëmijës. Ishte shumë i nxehtë. Vajza hapi sytë dhe e vështroi drejt e në sy e trembur.

Laurentius donte të hiqte shikimin, por fëmija i kapi dorën dhe ai u gjend duke parë përsëri në ata sy grit ë groposur. Ajo i buzëqeshi pak me cep të buzës.

“E di,” tha Laurentus me zë të ulët. “*Kuningas*.”

Ai u përpoq të shqiptonte qartë fjalën estoniane, që ta thoshte njësoj siç mbante mend ta kishte thënë vajza dhe pastori. “Nuk jam mbret.” Tundi kokën. “Nuk jam më mbret.”

Vajza po e shihte ngultas Laurentiusin, dhe ai vuri re se sytë e

saj të lodhur kishin formuar rrathë ngjyrë mavi të errët. Në sytë e saj kishte një vështrim të ngulët të pajetë, të lodhur, të njëjtin që kishte parë në sytë e plakut. Tashmë Laurentius kishte filluar t'i binte erë vdekje përsëri, sytë po i kruheshin; i dukej sikur dikush po i ngjishte gishtat e mëdhenj në kapakët e syve. Ai u kukëzua në tokë, duke patur frikë se mos kokërdhokët e syve do t'i dilnin, dhe i erdhi për të vjellë. Në atë çast kujtoi atë që Plini kishte shkruar se është e pamundur t'i nxjerrësh syrin një burri pa e bërë atë të vjellë. Duke u mbështetur në këtë Plini kishte nxjerrë përfundimin që shikimi dhe tretja ishin të lidhura në një mënyrë apo tjetrën.

Mbrëmja e Së Shtunës

PËRMES REVE TË RIMTA dhe mjegullinës së lagësht të atmosferës, hëna dukej si pasqyrimi i një fener që pluskon mbi sipërfaqen e një pellgu me baltë. Të shtyrë lehtë nga era, mollokë të bardhë të krijuar nga ngjeshja e bulëzave të ujit u rrokullisën nëpër trupin qiellor të poetëve, duke u zgjeruar në fije fibroze, duke krijuar njolla të errëta dhe forma fantastike. Ishte sikur perëndia e erërave të veriut që shtyn përpara pa mëshirë të bindurit e saj, duke kërkuar prej tyre gjithnjë e më shumë. Vallëzimi i tyre qiellor u bë gjithnjë e më shumë i shfrenuar, dhe copat e reve bënë salto të çmendura ndërsa lëviznin me shpejtësi nëpër njollat e zbehta të dritës. Vallëzimi i dalldisur ngadalë mori një përvijim më të qartë, derisa papritur hëna u shfaq me gjithë shkëlqimin e saj të ftohtë. Drita vezulloi përmes pëlhurës si rrjetë merimange të errësirës, dhe pas të kthetrave të çrregullta të reve kanosej rreziku. Fije të bardha të holla u vërtitën rreth trupit qiellor ndërsa ai u rrotullua ngadalë.

Laurentius tashmë e kishte ndjerë se drita në dhomën e tij kishte ndryshuar përpara se të bëhej plotësisht i vetëdijshëm për të. Qiri në tryezë përpara tij po kullonte nga rryma e ajrit fëshfëritëse që vinte nga e e çara në dritare. Tavani i varur po pasqyronte zjarrin e ngadalshëm që digjej me flakë të ulët, dritën e dridhur të thëngjijve që krijonin konture të pakuptueshme në gjithë sipërfaqen e murit. Enciklopedia e Alsted rrinte e hapur

përpara tij. Kishte njëfarë kohe që kthente para prapa faqet e librit të vëllimshëm, po shikimi i tij ishte i mbërthyer tek një pikë në anën tjetër të murit, pas flakëve, në zbrazëtinë përtej, dhe i dukej plotësisht i shkëputur nga realiteti, i prishur mendsh madje. Mund të ndjente në sytë e tij një dhimbje therëse gërvishtëse, sikur rërë apo dhé ishte futur poshtë kapakëve të syve dhe nuk mund t'i mbyllte. Ndoshta kështu i bëhej sepse kishte lexuar për një kohë shumë të gjatë, duke u përpjekur shumë për të kuptuar tekstin që kishte përpara. Qiriu ishte dridhur, duke e shpërqendruar.

U ngrit, dhe filloi të ecë lart e poshtë nëpër dhomë me zemërim.

Në atë çast ai do të kishte dashur të shikonte veprat e Robert Boil, të cilat Dimberg i kishte këshilluar, por ai duhet të kënaqej me ato që kishte. Ishte i sigurt që dikush duhet të kishte shkruar për këto që ai po përjetonte. Në vend që të sëmureshin nga shikimi i tij, njerëzit tani kishin filluar të shëroheshin. Më parë shikimi i tij kishte qenë si vështrimi keqardhës që Orfeu i kishte dhënë Evridiqisë, i dhembshur, i dëshiruar, por vdekjeprurës. Ai kishte qëndruar në dritë, dhe cilido që kishte parë ia kishte mbathur drejt errësirës.

“Po tani?” pyeti ai me vete.

Tani ishte i sigurt që vajza në shtëpinë e Pastor Mellinck do të shërohej. Kur kishte parë në sytë e saj të lodhur vuri re të njëjtin shkëlqim të artë që ishte shfaqur në sytë e plakut. Ajri kishte filluar të vezullojë; muret ishin bërë të tejdukshëm, dhe iu duk sikur po fluturonte lart. Ndoshta tani vajzës do t'i kishin rënë ethet dhe po rrinte ulur në shtrat, duke pyetur për të ëmën. Shërbyesja do t'i sillte diçka për të ngrënë dhe do t'i shpjegonte se të ëmën e kishte gjetur një fatkeqësi. Vajza do të dëgjonte ndërsa hante supë, por nuk do të kapte plotësisht kuptimin e atyre fjalëve. Do të kalonin vite përpara se asaj do t'i thuheshin rrethanat e vërteta të vdekjes së nënës së saj. Duke marrë parasysh gjithçka, kështu ishte e shkruar të ndodhte. Por përse? Ai hodhi një vështrim të shpejtë

nga dritarja. Klodia. Klodia ishte arsyeja. Paraketi i tij kishte qenë me të kur kishte ardhur në këtë vend. Ai kishte qenë i sëmurë, dhe vetëm cicërima e saj dhe natyra e saj e ngrohtë i kishte mbajtur të ekuilibruar lëngjet e trupit të tij.

Por pastaj dikush se çfarë i kishte dhënë të hajë, dhe ajo kishte ngordhur.

Laurentius hapi dritaren dhe vështroi jashtë hënën. “Lum ata që janë të uritur dhe të etur, sepse ata do të ngopen, pëshpëriti ai.

Në dritën e dobët jashtë ai mund të shquante një rig të imët shiu, që binte me një murmurimë të lehtë. Dukej pothuajse si një mjegull e bardhë që bënte gjithçka të lagësht dhe të ftohtë ndërsa zbriste. Një shkëlqim i paqartë vinte prej saj ndërsa ajo përhapej, duke rrjedhur si lëng, duke u pllaquritur në degët e pemëve, duke spërkatur gjithandej kopshtin, dhe duke pikuar nga çatitë e shtëpive, duke i shpëlarë gjërat që ishin fshehur prej kohësh dhe duke i nxjerrë ato sheshit, siç edhe ka përshtuar Roger Bacon.

“S’ka shkuar akoma ora,” tha ai me vete.

Sa kishte qenë ora kur ai e kishte takuar Klodian këtu? Mos ishte natë? Laurentius pa orën e tij dhe pa se ora sapo kishte kaluar tetën.

Brofi në këmbë dhe me një pamje të vendosur në fytyrë doli me nxitim nga dera dhe vrapoi poshtë në kuzhinë.

“Kush është Klodia?” e pyeti ai Madlin-ën që ishte ende aty.

Ajo e pa drejt e në sy me një shprehje fytyre të menduar, por nuk tha asgjë.

“Kush është Klodia?” Përsëriti pyetjen Laurentiusi.

“Merre shtruar,” tha ajo për ta qetësuar. “Kush?” e pyeti Laurentius. Ndjeu sytë t’i kruheshin. Madlin iu afrua Laurentiusit, e pushtoi për mes, dhe shpërtheu në lot.

Laurentius u mundua t’i shmangej, por arriti të ndalet në rrugë e sipër dhe pushtoi për mes Madlinën. I rrahu supet, duke mos ditur t’i thotë diçka me mend.

“Mos qaj,” ishte gjithçka që arriti të thotë.

Madlin u ndie e fuqishme por e butë dhe e ngrohtë në krahët e tij. Ai mund të ndjente kraharorin e saj të madh të ngjeshur pas trupit të tij, dhe ritmin e frymëmarrjes së saj njëkohësisht me zhurmën e dënesjes. Aroma kuzhine vinin nga rrobat e saj. Por megjithatë asaj i dukej sikur nuk po e arrinte plotësisht; ai sikur rrinte pezull sipër, dhe i shihte të dy që qëndronin bashkë. Sikur ai po rrinte në majë të një kulle kishe, duke u zgatur përpara në mënyrë të shkujdesur nga dritarëza e hapur e dhomës së kambanës, me erën që i fishkëllente në vesh, duke parë poshtë njerëzit e vegjël, kokëjashtë, me kësulata dhe kapelat e tyre. Ashtu si Dekarti shikoi nga dritarja dhe pa pallton e madhe dhe kapelen. Laurentius qëndroi atje, duke u përkulur përpara pa lezet për të përqaftuar Madlinën ndërsa ajo dënesej me ndërprerje. Pas tyre ishte një sobë e ndezur, dhe thikat dhe pirunët ishin shtruar në tryezë.

Laurentius filloi të ndjehej në siklet.

“Mira pra, nuk do të bëj më pyetje. Hë de, mos qaj tani,” tha ai, duke u përpjekur ta ngushëllojë Madlin-ën.

Për ndonjë arsye ai nuk mund të kuptonte përse iu mbushën sytë me lot. Pa takt, bëri një hap prapa nga Madlin dhe i hodhi një vështrim të shpejtë rrotull kuzhinës me një shprehje fytyre plot keqardhje. U ndie gjithë pikëllim dhe mall. Me sa duket duhet të përshëndetej me Madlin dhe këtë vend.

“Lamtumirë, Madlin,” tha ai, duke u larguar prej saj. Pothuajse vrapoi për të ikur, duke përplasur këmbët me zhurmë nëpër kuzhinë dhe doli nga dera. Madlin mbylli derën ngadalë prapa tij, duke fshirë lotët me dorën tjetër, dhe Laurentius dëgjoi që i vuri shulin derës nga ana tjetër.

Ai u ndal dhe u mbështet në kornizën e derës, duke marrë frymë thellë dhe duke parë jashtë në oborr. Po binte ende një rigë shi, avulli i lehtë, i ftohtë po kullonte poshtë, duke ndriçuar dritën e ftohtë të hënës. Që në ditën e parë të mbërritjes së tij në Estoni

ishite mbështjellë gjithnjë e më fort me atë frymë të lagësht derisa një ditë nuk i dha më vëmendje, u mësua. Sëmundja e tij sa vinte dhe përkeqësohej, dhe ai kishte gjithnjë e më shumë frikë, deri në çastin në sallë kur plaku ishte kthyer në jetë. Pastaj ishte ndjerë mirë përsëri. I shëndetshëm por disi i largët, sikur nuk banonte më në të njëjtin dimension me të tjerët. Sikur të kishte hequr dorë nga një pjesë e vetvetes.

“Do të vish?” pyeti një zë.

Laurentius pa rrotull por nuk po shihte askënd.

“Po vij,” u përgjigj ai instinktivisht, sikur t’ia përsëriste pyetjen vetes.

Diçka e butë dhe e njohur, u fërkua shumë pak për një çast me fytyrën e tij, pastaj erdhi Klodia, duke ngjitur me vrap shkallët. Laurentius pa flokët e saj të errët, të derdhur, dhe filloi të ndjekë shkëlqimin që përhapej prej tyre. Parmaku i shkallëve iu duk i ftohtë dhe i lagur nga mbrëmja e vjeshtës.

“Prit,” thirri ai pas saj.

Vajza qeshi dhe vrapoi përpara.

Kur ai shkoi lart në dhomën e tij ishte shtruar një tryezë bukë, një tabaka druri plot me djathë, dhe një gotë vezulluese me verë të bardhë. Klodia ishte ulur pranë tryezës.

“Urdhëro e ha,” tha ajo.

Laurentius kuptoi sa shumë ishte i uritur kur iu afrua tryezës. Theu një copë bukë dhe mbushi një gotë verë. Nuk guxoi të bëjë pyetje apo të thoshte diçka. E gjithë situata dukej tepër e pasigurt, tepër e pagjasë, dhe sytë ende i dhembnin.

“Klodia,” ia nisi duke belbëzuar.

Ajo erdhi dhe qëndroi përpara tij, duke e parë drejt e në sy. Sytë e saj ishin si ngjyrë lëngu të artë, dhe frymëmarrja e saj dukej si këngë e lehtë nën zë.

Natë

MMUND TË DËGJOJ ZOGJTË TË KËNDOJNË, gjethet të fëshfërijnë, hapat e dikujt, tingujt e një instrumenti muzikor që luhen diku larg. Ngrihem drejt, duke u mbështetur në mermerin që është ngrohur nga drita e diellit, dhe u ktheva të shikoj në drejtim të detit.

Ku ndodhem?

Uji ngjyrë argjile dukej sikur ishte bërë blu në horizont, dhe nga mjegullina e errët mund të shoh teksa formohet një breg vezullues dhe konturet e maleve, të ngjyra me të kuqe në dritën e diellit. Mund të ndjej erën e mirë të trëndafilave të bukur, përzierë me aromën e fortë të drurit të trumzës, dhe dëgjoj bletët të zukatin. Gjithandej, ka një numër të pafund bletësh.

Më duket sikur sapo jam zgjuar nga një ëndërr dhe përpiqem të mbahem fort pas kësaj ndjesie të brishtë, dhe copëzave kalimtare të kujtimeve. Rrok pamjen e detit, pemëve, kopshtit. Atje poshtë është një bletore, në një rradhë të drejtë buzë një muri të ulët janë vënë zgjoj bletësh. Muri harkohet anë një pllaje të vogël dhe duket të mos jetë ndërtuar me llaç çimentoje. Shtëpia ku jam ka qenë këtu për një kohë të gjatë, dikush erdhi në këtë shpat mali shumë vite më parë dhe ndërtoi muret e parë në buzë të bokërimës së malit; pastaj bënë një kopsht në tokë pjellore që uji e kishte sjellë me vete në pllajë. Kështu duhet të ishte. Kthehem, dhe ende mund të dëgjoj murmurimën e largët të bisedës që vjen nga dhomat e

tjera të shtëpisë. Ndërsa eci drejt atyre zërave vij në një oborr të brendshëm me një pellg, dhe shoh një rreze të vetme tërthore dielli që binte në të. Dalloj një paraket me pupla me ngjyra të ndezura që qëndron në majë të një peme që rritet në një vazo të madhe qeramike. Zogu po fishkëllente shtruar me vete, duke tundur kokën, duke u hedhur me padurim nga një këmbë në tjetrën, duke kërkuar vëmendje. I afrohem dhe kërcen në gishtin që i kam zgjatur. Kërkoj instinktivisht në xhepin e rripit, për ca fara luledielli. Por aty s'ka.

“Ku jam?” e pyes paraketin.

“Ciu!” përgjigjet zogu, dhe më jep një të pickuar të fortë me sqep.

“Më vjen keq, nuk kam ç'të të jap për të ngrënë,” i kërkon ndjesë ai zogut.

“Ciu!” bën prapë zogu. Në atë cast dikush nxjerr kokën te dera e dhomës ngjitur.

“Mos përmende gjë ushqimin? Eja, sapo kemi filluar ngrënien.”

Vështroj nga personi që m'u drejtua, por është zhdukur. Mund të dëgjoj murmurimën e bisedës që vjen nga rrugëhyrja, dhe marr me mend se mund të jetë rruga për te një holl ngrënieje në verë. Ul me kujdes dorën që zogu të kërcëjë përsëri në degë dhe shëtis kolonadën që kufizon oborrin. Pak më tutje mund të shoh njerëz të ulur në një tryezë në stola të gjatë, jo të mbështetur në divane, sipas stilit Romak. I njoh këta njerëz; fytyrat e tyre më janë të njohura. Ndërsa ata kthehen të shikojnë në drejtimin tim shoh ngjyrën e errët të fytyrave të tyre dhe sytë ngjyrëar, dhe dëgjoj flatrat membranore në kurrizet e tyre të fëshfërijnë. Është një tryezë katrore e shtruar me copa buke, kana me ujë, verë dhe fruta. Dhe ka shegë, rrush dhe huall mjalti.

SHËNIM I AUTORIT

Melankolia ka filluar të shihet si një sëmundje e shekullit të shtatëmbëdhjetë, por koncepti i saj ka ekzistuar në një formë apo në tjetrën të paktën që në shekullin e katërt, kur Evagrius Ponticus iu referua për herë të parë në udhëzimet e tij praktike për murgj. Atje, ai përshkroi “demonin e mesditës”, që shkaktonte lodhje të gjymtyrëve dhe humor të keq, apo më thjesht plogështi apo përtaci kompulsive. Gjatë periudhës Antike dhe Mesjetës sëmundja ende nuk kishte marrë një ngjyrim romantik, dhe përshkruhej thjesht si përgjumje dhe plogështi (një nga shtatë mëkatet mortare. Prekte më shumë ata që merreshin me punë intelektuale, si murgjit dhe filozofët. Gjatë periudhës së Humanistëve (dhe sidomos në veprat e Petrarkë), *acedia* e Mesjetës u poetizua gjithnjë e më shumë dhe plogështi u zëvendësua nga termi “mërzi,” që do të thotë humor i keq. Ende shihej në terma negativë, por theksi u zhvendos nga përgjumje dhe plogështi në mungesë dëshire. Pikërisht në këtë formë koncepti u përhap gjatë periudhës së hershme moderne, poetët dhe mbretërit vuanin prej saj, dhe artistët e pasqyronin (ndër të tjerë, Albrecht Dürer). Vepra me rëndësi më të madhe mbi temën ishte *Anatomia e Melankolisë* nga Robert Burton (shkruar me pseudonimin Demokriti i Ri). Në gati 500 faqe jepej një analizë e plotë e fenomenit:

Kur rri zgjuar fill i vetëm,
Dhe prapësitë e mia rinumëroj,
Mendimet më tiranizojnë,
Frika dhe pikëllimi më befasojnë,
Dhe nëse qëndroj në vend apo shkoj,
Më duket sikur koha shumë ngadalë kalon,
Të gjitha brengat e mia të kësaj janë dëfrim,
Asgjë s'më çmend më shumë se melankolia.

Vesi që njihet me emrin *acedia*, që e kishte patur prejardhjen në traditat e monakizmit latin folës, prandaj mori një diagnozë mjekësore që e kishte prejardhjen nga greqishtja e lashtë. Sëmundja ishte e ngjashme me të kuptuarit tonë të ditëve tona të depresionit psikik, ndonëse shpjegimi i saj i dhënë në mjekësinë humorale (apo të katër lëngjeve të trupit) do të thotë se ka disa dallime të rëndësishme.

Mjekësia humorale bazohej në konceptet Antike të botës që formohej nga elementët që përkufizoheshin tradicionalisht si zjarri, uji, dheu dhe ajri, ndonëse njerëzit prireshin të flisnin më shumë për nxehtësinë, ftohtësinë, thatësinë dhe lagështirën. Këto ishin vetitë që i jepnin një substance qenësinë e saj, dhe një lëndë e dhënë mund të përshkruhej për sa i përket ekuilibrit specifik midis tyre. Sipas Galen, një mjek filozof që ishte aktiv në shekullin e dytë dhe si rrjedhojë pati një ndikim të madh, barasvlerësit e këtyre elementëve mund të gjendeshin në trupin e njeriut dhe njiheshin si katër lëngjet e trupit: tëmthi i verdhë, flegma, tëmthi i zi dhe gjaku. Shëndeti i një personi, apo lloji i sëmundjes që e mundonte, do të varej nga ekuilibri i lëngjeve të tij të trupit. Ashtu siç mund të konceptoheshin të ndryshoheshin këto katër elementë brenda një substance të dhënë për ta ndryshuar atë (shndërrim), kështu edhe qëllimi i mjekësisë ishte të ndryshonte ekuilibrin brenda trupit. Nëse qëllimi i alkimisë ishte të arrinte ekuilibrin e

përsosur, dhe si rrjedhim të prodhonte metalin e përsosur, arin, atëherë synimi i shkencës mjekësore ishte të arrinte ekuilibrin e lëngjeve të trupit, në formën e shëndetit të mirë.

Për shkak të kësaj baze teorike, mjekësia dhe alkimia mbetën të lidhura ngushtë me njëra tjetrën për shekuj, dhe shumica e doktorëve ishin në njëfarë mase edhe alkimistë .

Faza e parë e procesit alkimik njihej si *nigredo* ose shpërbërja, që prishte lidhjet brenda një substance të dhënë. Përfaqësimet simbolike të këtij procesi ishin shkatërrimi, vdekja, kalbja, dhe sëmundja. Të gjitha këto ishin në antitezë me jetën, por ishin të nevojshme për të rindërtuar substancën, në një formë të re, të përmirësuar. Faza përfundimtare e këtij procesi ishte *rubedo*, që ndër të tjera përfaqësohej nga ari, mjalti, dielli, jeta (e përjetshme) dhe shëndeti i mirë. Kështu ari u bë simboli i përsosmërisë dhe shëndetit të mirë për shkak të asaj që përfaqësonte në alkimi, jo thjesht prej vlerës së tij materiale.

Ndonëse në periudhën e hershme moderne pati shumë ndryshime në mendimin shkencor, alkimia nuk u zhduk, në fakt fitoi përkrahës të rinj ndër shkencëtarët më përparimtar (duke përfshirë këtu për shembull, Isak Njuton dhe Robert Boil). Ndonëse ata e deklaruan të pasaktë teorinë e katër elementëve, ajo u zëvendësua nga teori të tjera (si teoria korpuskulare e Robert Boil), disa prej të cilave ofruan mundësi më të mëdha për hamendje të ndryshme. Në mjekësi, teoria humorale (apo e katër lëngjeve të trupit) vazhdoi të ekzistojë për shumë vite, dhe në shekullin e shtatëmbëdhjetë iu dha përsëri rëndësi si një mënyrë për të shpjeguar magjinë.

Studiuesve të ditëve tona u duket e vështirë të kuptojnë se si njerëzit që përveç kësaj ishin plotësisht të arsyeshëm, dhe të aftë të bënin zbulime të rëndësishme në shkencat natyrore, vazhdonin me kokëfortësi të besonin në magji të zezë dhe shtriga. Gjithsesi magjia e zezë shihej si një çështje shkencore. Magjia e zezë,

sipas një teorie të shekullit të gjashtëmbëdhjetë, lidhej me një tepricë tëmthi të zi brenda trupit, që e bënte shtrigën të përjetonte iluzione. Ky ishte mendimi i shtruar nga Johann Weyer në librin e tij *De praestigiis daemonum* (Mbi iluzionet e demonëve). Ndonëse autori nuk e hidhte poshtë ekzistencën e demonëve apo Satanait, në përgjithësi mendonte se shtrigat ishin njerëz të sëmurë që ishin në ndonjë mënyrë të mangët nga mendja, dhe shihnin vegullime. Provë se këtë mendim kishin edhe në Estoni dhe Livonie vjen nga e ashtuquajtura Çështja e Njeriut-ujk Thies, e 1692”, në të cilën pretendimi i një plaku që është një njeri-ujk u përqesh nga gjykatësit, të cilët shpallën një vendim për “mashttrim djallëzor”. S’ishte diçka e rrallë që të ashtuquajturat shtriga të besonin se fluturonin për në mbledhjet e shtrigave dhe shndërroheshin në krijesa të ndryshme, dhe madje ndonjëherë përpiqeshin t’ia provonin këtë edhe skeptikëve. Kështu në kontekstin e hershëm modern shtrigëria ishte një fenomen shumë më shumanësh dhe i ndërlikuar se konceptet e ditëve tona të magjisë së zezë. Ishte një pjesë përbërëse e botëkuptimit të asaj periudhe, që lidhej me të gjitha llojet e përfytyrueshme të të këqijave të shoqërisë, që nga mospranimi i zakoneve vendase deri tek teologjia heretike, si edhe sëmundja dhe çmenduria. Këto ishin rrethanat për bindjen e përhapur që të vjetrit dhe të sëmurët kanë më shumë të ngjarë të jenë shtriga, ishte sëmundja e tyre ajo që përbënte një kërcënim për shoqërinë dhe rrjedhimisht magjia e tyre. Ashtu siç shpërthimet e sëmundjeve ngjitëse shkaktojnë histeri në masë sot e kësaj dite (saga e “murtajës së derrave”, AIDS), periudhën e hershme moderne tensionet shoqërore, sëmundjet ngjitëse, zia e bukës, e të tjera kategorizoheshin me termi jo shkencor “magji”. Pamja e shëmtuar e shtrigës përforconte praninë e sëmundjes, sipas Aristotelit esenca e njeriut shprehej nga trajta e tij, shpirti. Nëse shpirti i tij ishte i sëmurë apo i dëmtuar në ndonjë mënyrë, atëherë kjo do të pasqyrohej në pamjen e

jashtme. Kjo bindje ishte paraqitur në pikturat e asaj kohe, në të cilat tradhtari Juda shfaqej si i shëmtuar, për shembull. Kështu një njeri shpirti i të cilit ishte i shëmtuar shihej gjithashtu edhe si i shëmtuar fizikisht. Kështu e përshkroi filozofi Thomas Aquinas në shpjegimin e tij mbi *De anima* (On the soul) të Aristotelit:

Siç thotë ai, nuk ka më arsye për të pyetur nëse shpirti dhe trupi së bashku krijojnë një të tërë veç të pyesësh të njëjtën gjë për dyllin dhe gjurmën e shtypjes të lënë mbi të, apo për cilindo substancë dhe trajtën e saj. Sepse, ashtu si tregohet në Librin VIII, të *Metafizikës*, trajta lidhet drejtpërdrejt me substancën si realiteti i substancës; dhe me të ekzistuar substanca, *i jepet trajta*.

Meqë sytë siguronin lidhjen më të drejtpërdrejtë me shpirtin (“dritarja e shpirtit”), veprimet e të parit dhe vështrimit me vëmendje shiheshin në fakt si një zgjatim i shpirtit. Ashtu si një vulë lë një gjurmë shtypje në dyllë, kështu, sipas teorisë së njohjes së Aristotelit, përvojat e jashtme lënë një gjurmë(mbresë) në shpirtin tonë duke e bërë t’i përngjajë përvojave tona. Nëse ato përvoja ishin mjaftueshëm traumatike, atëherë kjo mund të ndikonte negativisht në shpirtin, duke çuar në prishje(fizike) të shpirtit dhe sëmundje. Ndonjëherë kjo prishje do të shfaqej si “sy i keq”.

Fenomeni i syrit të keq ka qenë njohur që në Antikitet, dhe përshkrime të tij mund të gjenden në veprat e autorëve të kësaj periudhe, të cilët e lidhnin në përgjithësi me xhelozinë. Në greqisht fenomeni filloi të përshkruhej me termin teknik *baskaino*, i cili në botën latinfolëse u kthye në *fascino*. Në të tretin e *Eklogë-ve* të Virgjil-it, për shembull, përshkruhet si më poshtë:

Këta vërtet, mendoj këtu diçka luhet,
Shumë të tretur duken,
Ndonjë sy i keq i ka parë qengjthat e mi.

Gjatë Antikitetit besimi te syrin e keq ishte i përhapur, madje ishin miratuar ligje për të ndëshkuar njerëzit që e përdornin për të shkaktuar dëme të llojeve të ndryshme (një shembull mund të gjendet në *Leges decemvirales*, kodeksin e ligjit romak që daton që nga viti 449 Para Krishtit). Një bindje e ngjashme popullore në efektet e dëmshme të syrit të keq zgjati gjatë gjithë Mesjetës. Kishte raste kur njerëzit që besonin se syri i keq mund të përdorej për të topitur tehun e një shpatës apo t’i bënin keq foshnjave të porsalindura. Një rast i tillë ishte përshkruar nga Shën Gregori i Tourse, që shkroi se mbreti frank Chilperic kishte frikë të nxirrte në sy të njerëzve djalin e tij se mos e gjente ndonjë e keqe. Po kështu në mënyrë të ngjashme quhej e rrezikshme që gratë shtatzëna të shihnin nga dritare nga frika se mos u zinte syri ndonjë njeri të gjymtuar apo të degjeneruar, i cili mund t’u bënte keq në ndonjë mënyrë foshnjave të tyre të palindura. Sidomos fëmijët dhe njerëzit e sëmurë mendoheshin të pambrojtur ndaj përvojave të këqija, meqë trupi i tyre ishte i pafuqishëm dhe disa lloje përshtypjesh mund t’i dëshpëronin. Gjithashtu u shtjelluan shpjegime të ndryshme teorike për syrin e keq, bazuar në idetë filozofike antike dhe në traditat biblike. Kështu i përshkruan filozofi francez i shekullit të trembëdhjetë Pjetër i Limózhë punët e syrit të keq apo të magjepsjes:

Një qen i tërbuar ka helm në trurin e tij. Një kafshim nga një qen i tillë, pavarësisht në cilën pjesë të trupit, më vonë do të infektojë trurin apo një pjesë të ngjashme trupi. Prandaj ka të ngjarë që avujt epshorë që ngrihen nga zemra e gruas deri në sy gjithashtu infektojnë vështrimin e saj, po të vrojtojmë nxjerrjet e gazeve të vështrimit që infekton sytë e një burri dhe më pas zemrën e tij, shohim se janë të njëjtët me ata që u larguan nga zemra e gruas.

Kjo siguron një provë të qartë që syri i keq mendohej të funksiononte si një sëmundje ngjitëse. Sëmundja, e shfaqur nga një formë degjenerimi apo sjelljeje demonike, quhej e dëmshme për shoqërinë dhe duhet të çrrënjosej. Përpjekjet për të luftuar magjinë bëheshin me synimin për të mbajtur shoqërinë të shëndetshme, dhe mund të shiheshin t'i shërbenin një qëllimi higjeniko-sanitar ose profilaktik. Ndërkohë që shëndeti i mirë lidhej me përkorën, elementët e ekuilibruar dhe arin, për shembull, sëmundja lidhej me gjithçka të errët, me tëmthin e zi dhe me demonët. E gjithë ekzistenca e vdekshme madje shihej si një formë sëmundjeje, me vdekjen që pritej me kënaqësi si shpëtim. Ky është njëri shpjegim që iu bë dialogut *Phaedo* të fjalëve të fundit të Sokratit, në të cilin Sokrati përmend që ai i detyrohet Asklep-it një gjel të njomë; me vdekjen e tij ai më në fund do të shërohet nga sëmundja që quhet jetë. Vetë jeta shpesh shihet si e sëmurë, e degjeneruar, e lemerishme, demonike.

Tmerret e jetës së përditshme u përshkruan me ngjyra të gjalla sidomos gjatë zive të bukës që ranë në fund të shekullit të shtatëmbëdhjetë. Gjatë verave të viteve 1695–97 në të gjithë Europën veriore(duke përfshirë Estoninë) kishte rreshje të vazhdueshme shiu, që shkatërruan të korrat duke e rritur shumë çmimin e barit të thatë. Qyteti Tartu (që në atë kohë njihej si Dorpat), ku ndodheshin depot e drithit të ushtrisë suedeze, ngriti një strehë për gratë dhe fëmijët e varfër. Gjithsesi, iniciativa përfundoi kur u pa se tashmë numri i njerëzve në nevojë ishte i papërballueshëm.

Në fillim të pranverës së 1697, në kulmin e zisë së bukës, skamja dhe mjerimi i fshatarësisë thuhej të ishin aq e skajshëm sa askujt nuk i bëhej ta përshkruante. Thuhej se situata ishte më e rëndë se zia e bukës gjatë rrethimit të Jeruzalemit (cf. Vajtimet 4:4–5). Kishte raste kur prindërit hanin fëmijët e tyre, dhe fëmijë që kishin ikur nga shtëpia apo ishin përzënë të cilët do të përfundonin duke

ngrënë kufoma të shtrira buzë rruge. Të përballur me zgjedhjen midis urisë dhe kanibalizmit, shumë njerëz zgjidhnin vetëvrasjen, dhe trupat e tyre mund të gjendeshin të varur në pemë pylli, apo të mbytur në lumenj.

Në të njëjtën periudhë që Estonia pati një sërë të korra të mëdha të këqija që i mori jetën rreth 70,000 njerëzve, profesori i matematikës Sven Dimberg po punonte në Akademinë Gustavo Carolina në Dorpat. Ai ishte një nga të parët njerëz në rajonin nordik që jepte mësim matematikën Njutonike, dhe njihte teoritë e Robert Boil të kimisë. Profesori i filozofisë Gabriel Sjöbergh ishte gjithashtu i mirinformuar për teoritë e Dekartit, dhe profesori i mjekësisë Jakob Friedrich Below, i cili ishte shkolluar në Holandë, organizonte diseksione anatomike të kafshëve dhe njerëzve për qëllime mësimore dhe për të “shuar kuriozitetin e publikut”. Pastorët pietistë kishin ngritur shkolla për fshatarësinë, dhe prej iniciativës së Bengt Gottfried Forselius në atë zonë kishte kaluar vetëm një duzinë vitesh. Gjatë gjithë shekullit të shtatëmbëdhjetë në Estoni u dënuan me vdekje në total pesëdhjetë e tre njerëz për magji të zezë, gjysmë e të cilëve burra.¹ Ankesat vinin zakonisht nga fshatarë të tjerë që pretendonin se shtriga e dyshuar i kishte shkaktuar dëm në një mënyrë apo tjetër familjes apo pronës së tyre. Rreth pesëdhjetë vjet kishin kaluar që nga kryengritja e Vöhandu-t, që përfundoi me djegien e mullirit vendas. Sipas kujtesës popullore kjo gjë kishte zemëruar shpirtin e lumit, duke shkaktuar si rrjedhim të korra të këqija.

* Midis 1400 dhe 1750 u ekzekutuan rreth 40,000 njerëz të akuzuar për magji të zezë në të gjithë Europën.

**Lista me titujt e librave të përkthyer
nga znj. Orkida Muça**

1. “Ese mbi Psikoanalizën”, Sigmund Freud, 2006.
2. “Shitorja”, Emyr Humphryes, 2007,
3. “Incidenti Tragjik i Aziz Bey”, Ayfer Tunch, 2008,
4. “Brenda trurit të Rikas”, Levent Mete, 2008,
5. “Djali i Briskut”, Gönül Kivilcim, 2009,
6. “Fajin e ka molla”, Cem Selsen, 2009,
7. “Sarkofagu”, Cem Mumcu, 2009,
8. “Të burgosur të vetvetes”, Gonduz H. Vassaf, 2010,
9. “Shtëpia e Babait Tim,” Orhan Kemal, 2010,
10. “Paqja”, Ahmet Hamdi Tanpınar, 2011,
11. “Destina”, Mine Kirikkanat, 2012,
12. “Të tjerët “(ÖTEKİ), Ece Vahapoğlu, 2013,
13. “Akulloreshitësi”, Katri Lipson, 2015.
14. “Leri planet, hidhu ne det”, Jason Fried & David H. Hansson, 2015
15. “Shkuesja”, Elin Hilderbrand, 2015

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Friedenthal, Meelis

Mbreti i shelgjeve (Zogjtë e muzave) / Meelis
Friedenthal ; përkth. Orkida Muça ; red. Rexhep
Hida. – Tiranë : Fan Noli, 2017

... f. ; ... cm.

Tit. origj.: Mesilased (The Bees)

ISBN 978-9928-203-93-9

1.Letërsia estoneze 2.Romane

821.511.113 -31